Çmimi lekë 6

(12)

monumentet 2 1971

monumentet



DO NOT COPY

2, 1971

DO NOT COPY

› **parë:** Pamje e pjesëshme e lagjes Mangalem të qytetit muze të Beratit.

MINISTRIA E ARËSIMIT DHE E KULTURËS

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

2, 1971

REDAKSIA:

Gani Strazimiri (Kryeredaktor)
Aleksandër Meksi, Apollon Baçe, Emin Riza, Gjerak Karaiskaj, Neritan Ceka,
Selim Islami (Zëv. Kryeredaktor), Stilian Adhami.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

1 — F. PRENDI, K. ZHEKU — Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike. ..... (7 — 21)

2 — H. ÇEKA — Dega jugore e Rrugës Egnatia. ..... (25 — 32)

3 — V. TOÇI — Amfiteatri i Dyrrahit ..... (37 — 41)

4 — A. BAÇE — Qyteti i fortifikuar i Beratit. ..... (43 — 58)

5 — DH. DHAMO — Mbi disa vepra të panjohura të piktorit shqiptar të shek. XVI Nikollës. ..... (63 — 69)

6 — A. MEKSI — Restaurimi i kishës së Marmiroit. ..... (73 — 82)

7 — G. STRAZIMIRI — Gjirokastra dhe vlerat e saj kulturale. ..... (85 — 99)

8 — S. BEJKO — Kalaja e Tepelenës. ..... (103 — 110)

9 — E. RIZA, K. ZHEKU — Banesa tiranase. ..... (113 — 125)

10 — V. SHTYLLA — Studim mbi restaurimin e një banese të Shkodrës. ..... (129 — 135)

MATERIALE DHE KUMTESA

1 — SH. HAXHIHYSENI — Vëndbanimi i fortifikuar ilir në Tervol. ..... (139 — 143)

2 — L. DERVENI — Gjurmime të reja në kalanë e Margëlliçit. ..... (147 — 150)

3 — F. MIRAJ — Muret antike të Porsqopit. ..... (153 — 155)

4 — TH. KAMBERI — Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite. ..... (157 — 161)

5 — D. HALILAJ — Gjurmë të vjetra në Gollobordë. ..... (165)

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

1 — TH. POPA — H. Nallbani, Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasit. ..... (167 — 168)

KRONIKË

1 — Puna konservuese restauruese dhe kërkimore në Institutin e Monumenteve të Kulturës gjatë vitit 1970. ..... (170 — 173)

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLES DES MARTIERES

ARTICLES

1. — F. PRENDI — K. ZHEGU — Lisus à la lumière des récentes données archéologiques ..... (22 — 24)
2. — H. ÇEKA — La branche sud de la voie Egnatia ..... (33 — 36)
3. — V. TOÇI — L'amphithéâtre de Dyrrah ..... (37 — 41)
4. — A. BAÇE — La ville fortifiée de Berat ..... (59 — 62)
5. — DH. DHAMO — A propos de certaines oeuvres jusqu'ici inconnues de Nicolas, peintre albanais du XVIe siècle ..... (70 — 72)
6. — A. MEKSI — Restauration de l'église de Marmiro ..... (83)
7. — G. STRAZIMIRI — Gjirokastër et ses valeurs culturelles ..... (100 — 102)
8. — S. BEJKO — La forteresse de Tepelene ..... (111 — 112)
9. — E. RIZA K. ZHEKU — La maison tiranoise ..... (126 — 128)
10. — V. SHTYLLA — Restauration d'une habitation à Shkodër ..... (136 — 137)

COMMUNICATIONS ET MATERIAUX

1. — SH. HAXHIHYSENI — L'agglomération fortifiée illyrienne de Tervol (144 — 145)
2. — L. DERVENI — Récentes fouilles à la forteresse de Margëlliç ..... (151)
3. — F. MIRAJ — Les murs antiques de Persqop ..... (156)
4. — TH. KAMBERI — Données sur la technique de construction appliquée dans l'habitation type de Gjirokastër (162 — 163)
5. — D. HALILAJ — Vestiges antiques à Golloborde ..... (166)

CRITIQUE ET BIBLIOGRAPHIE

1. — TH. POPA — A propos de l'oeuvre du peintre David Selenicasi ..... (169)

CHRONIQUE

1. — Le travail de conservation, de restauration et de recherche de l'Institut des monuments culturels en 1970.

DO NOT COPY

ARTIKUJ

Frano PRENDI – Koço ZHEKU

DO NOT COPY

LISI NË DRITËN E TË DHËNAVE TË REJA ARKEOLOGJIKE

Në literaturën historike arkeologjike ekzistojnë pikëpamje të ndryshme për themelimin e qytetit të lashtë të Lezhës, i njohur nga burimet e shkruara antike me emrin Lis (Λίσσος, Lissus), prej të cilit rrjedh, në pajtim me ligjet fonetike të shqipes, emri i sotëm i qytetit: Lesh, Lezhë.

Disa studjues si Ljubiç, Bauer, Han, Hekard, Degrand, Majer, Ipen, Flus, Prashniker, Shober, Bomo etj., duke u mbështetur në tekstin e Diodorit të Siqelisë, ku thuhet se Lisin e themeloi Dionisi plak, tirani i Sirakuzës (XV, 13, 14), e quajnë këtë qytet të lashtë si koloni helene [1]), kurse të tjerë si Lucius, Fortis, Katalinić, Myler, Beloh, Novak etj., duke e vlerësuar në mënyrë kritike dëshminë e sipërpërmendur, kanë shprehur mendimin se fjala Λίσσον ose Λίσση te Diodori duhet lexuar Ἴσσαν, Ἴσση [2]), ose, të paktën, duhet kuptuar qyteti antik Issa në ishullin dalmatin të Visit, të cilin edhe Pseudo Skymni, i mbështetur në autorë shumë më të hershëm dhe të mirëbesuar si Timeu dhe Eratosteni, e përmend si koloni sirakuziane [3]).

Historiografia shqiptare, duke mos u thelluar në këto pikëpamje të kundërta për çështjen e sipërme, ka qëndruar deri tani, pa të drejtë për mendimin tonë, në pozitat e atyre që e quanin Lisin si koloni helene, kurse muret rrethuese të tij si vepër kryekëput dioniziane [4]).

Ne nuk do të merremi këtu me shtjellimin e argumentave të shumtë historikë që provojnë të kundërtën, pasi këtë e ka bërë 30 vjet më parë G. Novaku, në studimin e tij mbi veprimtarinë kolonizuese të Dionisit

1) S. Gliubich, **Nummographia dalmata,** Oesterr. Geschichtsquellen XI, Wien 1851, fq. 123-125; A. Bauer, **Die Anfänge österreichischer Geschichte,** në Archaeologisch-epigraphische Mitt. XVIII, Wien 1895, f. 130; J. G. Hahn, **Albanesische Studien,** Jena 1854, fq. 92; H. Hecquard, **Histoire et description de la Haute Albanie,** Paris 1857, fq. 51; A. Degrand, **Souvenirs de la Haute Albanie,** Paris 1901, fq. 176; E. Meyer, **Geschichte des Altertums** V2 Stuttgartu, Berlin, 1913, fq. 162-163; Th. A. Ippen, **Skutari und die Nordalbanische Küstenebene'** Sarajevo 1907, fq. 55 vv.; Fluss; në Pauly-Wissowa, **Real-Encoclopädie, d. classischen Altertumswissenschaft,** s.v. Lissos; C. Praschniker – A. Schober, **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1919, fq. 14; R.L. Beaumont, **Greek Influence in the Adriatik,** në J.H.S. LVI 1936 fq. 202-203; po ai **«Corinth, Ambracia, Apollonia»** shih shtesën në JHS LXXII 1952; fq. 68 vv.; Diodori, Bibliot. hist. XV 13, 14.

2) Lucius, **De regno Dalmatiae et Chroatiae,** Amstelodami 1668, I, 26; Fortis, **Voyage en Dalmatie II,** Bern, 1778 fq. 223; Cattalinich, Stoira della Dalmazia I fq. 53; Geographi Graeci Minores, rec. C. Müllerus, Paris 1855; fq. 29-30 shen. parag. 25; J. Beloch, **Griesch. Geschichte,** III 1, 2. Berlin fq. 118; G. Novak, **Kolonizatorsko djelovanje Dionizija starijega na Jadranu** në Serta Hoffileriana, 1940, f. 111 vv.

3) G. Novak, **po aty,** fq. 118.

4) Historia e Shqipërisë, I, Tiranë 1959 f. 61; S. Pulaha, **Vështrim mbi historinë e Lezhës,** në «Lissus» 1967, f. 85.

PO ZHUTOHET

të Sirakuzës në Adriatik [5]), por do të përpiqemi që nëpërmjet të dhënave të reja arkeologjike, të përfituara nga punimet me karakter zbulimi dhe restaurimi që ndërmori Instituti i monumenteve të kulturës në pika të ndryshme të mureve rrethuese të Lisit, të sjellim prova të tjera, edhe më bindëse, në favor të gjenezës autoktone ilire të këtij qyteti, si edhe të përcaktojmë me saktësi më të madhe, veçoritë konstruktive dhe arkitektonike të sistemit mbrojtës të tij.

Gjatë gërmimeve arkeologjike dyvjeçare (1968--1969), këto janë të para gërmime sistematike që ndërmerren në këtë truall të lashtë me histori shumëshekullore, u bë edhe një përcaktim i hollësishëm topografik i zonës së qytetit antik, duke përfshirë këtu edhe kështjellën e tij mbi majën e Shelbuemit, e cila në burimet e shkruara historike njihet me emrin Akrolis (Ακρολίσσος).

Si rrjedhim i kësaj pune u arrit të fiksohen qartë disa mbeturina muresh rrethuese, të panjohura më parë, të cilat, nga pikëpamja teknike dhe stilistike, ndryshojnë shumë, jo vetëm midis tyre, por edhe nga vetë muret rrethuese, tashmë të njohura të Lisit.

Gjurmët e mureve më primitive, të cilat padyshim, kanë qenë pjesë përbërëse e sistemit fortifikues të një vendbanimi prehistorik ilir, u vunë re në majën e malit të Shelbuemit, ku, siç dihet, Prashniker e Shober fiksuan të parët mbeturinat e Akrolisit antik [6]), ndërsa gjurmët e mureve teknikisht më të përparuara, u diktuan pak më poshtë kështjellës së sotme mesjetare, në anën perëndimore të saj.

Muret e vendbanimit të fortifikuar ilir mbi majën e Shelbuemit, janë ruajtur pjesërisht dhe në një lartësi maksimale deri në 1.50 m. Dy faqet e dukshme të murit janë ndërtuar me gurë të mëdhenj e mesatarë të papunuar dhe të vendosur njëri mbi tjetrin në të thatë (fig. 1), duke krijuar shpesh zbrazëti të mëdha midis tyre. Hapësira në mes të faqeve të murit ka qenë e mbushur me gurë mesatarë e të vegjël. Trashësia e tij arrin në 3.20 m. Në anën juglindore të këtij sistemi mbrojtës, u dalluan edhe gjurmët e një hyrjeje (fig. 2).

Në përshkrimin mjaft të hollësishëm që Prashniker dhe Shober, i bëjnë Akrolisit, nuk i përmendin fare këto lloj muresh, megjithëse në skicë-planimetrinë e tyre, për çudi shënohen madje me të njëjtën ngjyrë, sikurse edhe muret antike të Akrolisit, [7]) Kjo na shtyn të mendojmë se arkeologët austriakë, duhet t'i kenë vërejtur këto konstruksione mbrojtëse, por s'kanë mundur t'i dallojnë teknikisht dhe, si rrjedhim, kronologjikisht nga muret e Akrolisit antik. Për ne, këto ndërtime fortifikuese ndryshojnë në çdo pikëpamje, prandaj dhe duhen dalluar në kohë. Tipologjikisht ata kanë ngjashmëri të madhe me ato të qytezave ilire të Marshejt e Gajtanit të rrethit të Shkodrës, të cilët, në mbështetje të të dhënave stratigrafike të përfituara nga gërmimet sistematike në Gajtan, datohen si të fillimit të epokës së hekurit [8]). Kësaj periudhe afërsisht duhet t'i përkasin edhe muret rrethuese të vendbanimit ilir të Shelbuemit.

Një interes të veçantë paraqesin sidomos mbeturinat e mureve mbrojtëse të një vendbanimi të dytë mbi majën e kodrës së kalasë, të ruajtura në një lartësi maksimale deri në 1.20 m.

Nga sa mund të dallohet, këto mure kanë qenë ndërtuar me gurë të mëdhenj dhe mesatarë të përpunuar përciptas ose fare të papunuar dhe të vendosur njëri mbi tjetrin në të thatë. Bloqet e përpunuara krijojnë vende-vende mundësi për një puthitje normale, sidomos në fugaturat horizontale, ndërsa ato të papunuara, lënë zbrazëti midis tyre nganjëherë të mëdha, të cilat janë mbushur me gurë të vegjël (fig. 3).

Në krahasim me muret rrethuese të vendbanimit të parë mbi majën e Shelbuemit, muret e vendbanimit të dytë, të cilat stilistikisht anojnë nga poligonali i parregullt, shprehin qartë një shkallë më të përparuar përsa i përket teknikës së punimit të gurëve dhe të vendosjes së tyre në muraturë dhe, si rrjedhim, i përkasin një periudhe historike pak a shumë më të vonë. Po t'i krahasojmë këto mure me konstruksionet e fuqishme dhe të ruajtura mjaft mirë të sistemit mbrojtës të Lisit, (TAB. II, 3) do vërejmë se këto qëndrojnë në lidhje të ngushta gjenetike midis tyre, lidhje të cilat shfaqen jo vetëm në ngjashmërinë e madhe teknike, në nxjerrjen dhe coptimin e shkëmbenjve në bloqe, por edhe në mënyrën pjesërisht të përafërt të punimit të gurëve. Në këto rrethana muret e këtij vendbanimi të dytë ilir, që, si duket, zëvendësoi të parin për arësye të kushteve jo të favorshme topografike dhe ekonomike të tij, duhen quajtur si një fazë pararendëse e sistemit fortifikues të qytetit të lashtë të Lisit.

Për datimin e këtyre mureve rrethuese ilire jemi të detyruar hë për hë, në mungesë të të dhënave stratigrafike, t'u drejtohemi veçantive konstruktive dhe stilistike të tyre, të cilat në krahasim me muret e mëvonshme të qytetit, janë më të hershme se të shek. IV para e. sonë. Kësaj periudhe i përkasin edhe ato pak fragmente keramike lokale të gjetura rastësisht pranë këtyre mureve ose gjatë gërmimeve të rregullta si ele-

5) G. Novak, **vep. cit.** f. 111 vv.
6) Praschniker-Schober, **vep. cit.** f. 23-25.
7) » » **po aty.**
8) S. Islami — H. Ceka, **Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilire në territorin e Shqipërisë,** «Konferenca e parë e stud. Albanologjike», Tiranë 1965, f. 450-451.

mente sporadike në shtresat e përzjera të periudhës helenistiko-romake, fragmente të cilat, nga pikëpamja teknike dhe tipologjike, riprodhojnë të gjitha veçoritë e poçerisë prehistorike ilire.

Në qoftë se për dy qendrat e sipërme të fortifikuara ilire kumtohet për të parën herë në këtë punim, ndryshe qëndron çështja me muret e sistemit mbrojtës të Lisit antik, të përmendura që në shek. XV nga Qiriaku i Ankonës [9]). Siç dihet, muret rrethuese të këtij qyteti, për një kohë të gjatë ja tërhoqën vëmendjen studjuesve të huaj dhe në mënyrë të veçantë Prashnikerit e Shoberit, të cilët të parët u morën edhe me përshkrimin e hollësishëm dhe studimin e gjithanshëm të tyre. Por gjatë vlerësimit arkeologjik të pjesshëm apo të përgjithshëm të këtij monumenti, studjues të ndryshëm shfaqën edhe mendime të ndryshme sidomos për çështje të karakterit konstruktivo-stilistik dhe kronologjik të mureve, të cilët, duke i shikuar sot në dritën e vëzhgimeve të reja arkeologjike dhe të përfundimeve të gërmimeve sistematike, diktojnë nevojën jo aq për korrigjime të rastit, se sa për një rishikim dhe vlerësim të gjithmbarshëm të tyre.

* * *

Planimetria e Lisit, e hartuar nga Prashnikeri e Shoberi [10]), mendojmë se në vija të përgjithshme dhe sidomos përsa i përket drejtimit të mureve perimetrale dhe murit të brendshëm, që ndan pjesën e sipërme të qytetit nga ajo e poshtmja, i afrohet mjaft gjendjes së vërtetë. Nëpërmjet plotësimeve deri diku të pranueshme, arkeologët austriakë kanë arritur ta mbyllin rrethin e mureve mbrojtëse duke i zbritur ato që nga maja e kodrës, e deri në breg të lumit Drin. Ajo që na duket pak e shpejtuar në plotësimin e kësaj planimetrie, është vendosja e kullave në të shumtën e rasteve me hamendje, veçanërisht në dy krahët anësorë të mureve, shumë pak të ruajtur, që zbresin tatëpjetë kodrës në drejtim të lumit. Këtë e kanë arritur duke u mbështetur, siç e pohojnë edhe vetë hartuesit e saj, në disa kritere (sipas mendimit tonë jo gjithmonë të drejta) siç janë, grumbujt e gurëve të rrëzuar apo thyerja e drejtimit të murit. Ka edhe pasaktësi të tilla në fiksimin e këtyre komponenteve arkitektonike të sistemit mbrojtës të qytetit, të cilat kanë ardhur si rrjedhim i vrojtimeve nganjëherë të sipërfaqshme dhe të shpejta, pasi nuk ka se si shpjegohet fakti që kthesa e shkallëzuar e murit verior si edhe hyrja në afërsi të



Fig. 1



Fig. 2

9) CIL III, 1 nr. 1704.
10) Praschniker — Schober, **vep. cit.** f. 15, fig. 22.

POROTOPY

saj të merren për kulla [11]), aq më tepër kur kemi parasysh se kjo planimetri u hartua gjysmë shekulli më parë, kur muret ishin në një gjendje më të mirë konservimi se sa sot.

Në planimetrinë tonë *) ndreqen një pjesë e mirë e këtyre gabimeve dhe pasaktësive të planimetrisë së mëparëshme; për më tepër aty bëhen edhe disa plotësime të reja që qëndrojnë në përcaktimin e një numri të madh të panjohur portash në rrethimin e pjesës së sipërme të qytetit, si edhe në fiksimin e një muri në pjesën e poshtme të tij, që bashkonte me sa duket, dy krahët e mureve perimetrale në afërsi dhe paralel me bregun e Drinit, duke e ndarë kështu, ndoshta, qytetin nga porti i hapur breglumor i tij (fig. 4).

Megjithkëtë duhet theksuar se planimetria jonë është ende larg për të thënë se i ka zgjidhur si duhet të gjitha çështjet nganjëherë shumë të ndërlikuara planimetrike të qytetit. Për t'ja arritur këtij qëllimi, kërkohet patjetër, ndërhyrja e vazhdueshme e operacioneve arkeologjike, pasi riforcimet e mëvonshme disaherë e kanë transformuar konfiguracionin planimetrik të mureve aq tepër sa është vështirë të kuptohet.

Muret rrethues të qytetit kanë qenë ndërtuar me gurë gëlqerorë të nxjerrë nga shtresat shkëmbore të vetë kodrës. Ata janë shkëputur nga shkëmbinjtë masivë dhe janë coptuar në bloqe me anën e pykave metalike, siç e tregojnë vetë gjurmët e këtij instrumenti të lëna mbi gurë (fig. 5). Muret qëndrojnë mbi themele të sajuar, zakonisht prej një radhë bloqesh jo shumë të trasha, por me faqen mbështetëse të tyre pak a shumë të gjerë për t'i krijuar një bazament sa më të përshtatshëm murit që ngrihet mbi të. Në vende jo të sheshta, gurët e themelit shpesh herë janë të shkallëzuar dhe largësitë e këtij shkallëzimi i shohim të ndryshojnë në funksion të pjerrësisë ku më shumë e ku më pak të theksuar të terrenit. Në disa raste si themel është shtrytëzuar edhe shkëmbi i gjallë, faqja mbështetëse e të cilit thellohej si fole drejtkëndëshe qëllimisht për të ndaluar rrëshqitjen e mundëshme të muraturës. Dy faqet e murit, e brendshmja dhe e jashtmja, janë ndërtuar me bloqe të mëdha, të daltuar anash në një sipërfaqe të kufizuar sa për të lejuar një mbështetje dhe puthitje të mirë midis tyre në fugaturat horizontale dhe vertikale. Balli i dukshëm i bloqeve, përkundrazi, me anë të një punimi me çekiç është lënë i gufmuar (konveks) (Fig. 9).

Zbrazëtia brenda dy faqeve të murit ka qenë e mbushur me gurë të përmasave të ndryshme dhe veçanërisht me çakëll të trashë, të përfituar nga thyerja e gurit gjatë procesit të gdhendjes së tij (fig. 6). Këto mure, në gjerësinë e tyre dhe në largësi të ndryshme, përforcoheshin me anë muraturash të tërthorta prej gurësh, herë të punuar, herë të papunuar, që lidheshin konstruktivisht me faqet anësore (fig. 7).

Një nga vecoritë tekniko-stilistike që bie më shumë në sy në këtë sistem muresh fortifikimi, është, padyshim, edhe gdhendja e thellë në formë kornize (fig. 8) e gurëve të qosheve, në këndet e kullave, të hyrjeve dhe të vetë kthesave të shkallëzuara të murit, tipar ky karakteristik edhe për shumë fortifikime të tjera të krahinave iliro-epirote, të cilin tani vonë, shkencëtari anglez N.G.L. Hamond, shpejtoi ta caktojë edhe në kohë, duke e lidhur me periudhën e fundit të sundimit të Pirros. [12])

Muret perimetrale të qytetit me një gjatësi lineare prej më se **2.000** m. kanë një trashësi që lëvizë nga 3.20 në 3.50 m.

Stili i mureve rrethuese është trapezoidal i parregullt pseudoizodomik (fig. 9) dhe poligonal (fig. 10). por shpeshherë ndodh që të dy këto stile t'i gjejmë të mbërthyer në të njejtën pjesë muri ose të gërshetuar



Fig. 3

11) **Po aty,** f. 20, fig. 22.
*) Rilevimi topografik i Lisit dhe Akrolisit është bërë nga tipografi Petro Maraci.
12) N.G.L. Hammond, **Epirus,** Oxfora 1967, f. 584.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

midis tyre në një mënyrë të tillë, sa që është vështirë të dallohet se ku fillon njeri e ku mbaron tjetri.

Prashniker dhe Shober me të drejtë i patën quajtur këto konstruksione, pavarësisht nga karakteri i tyre i ndryshëm stilistik, si të një faze të vetme ndërtimi [13]), por nuk na duken bindës, atëherë, kur ata përpiqen ta shpjegojnë këtë fenomen me natyrën, herë të pjerrët, herë të sheshtë të terrenit, mbi të cilin këto mure ngriheshin [14]). Bashkekzistenca e këtyre dy stileve në sistemin fortifikues të Lisit, mendojmë se duhet shpjeguar, jo aq me relievin e terrenit, se sa me formacionin shkëmbor-masiv të vendit, prej të cilit janë nxjerrë gurët dhe me nevojën e një shfrytëzimi maksimal të bloqeve me vëllimet dhe format e nxjerra prej gurores.

Ndryshe nga arkeologët austriakë, Bomo, i cili kohët e fundit u muar me shqyrtimin e kronologjisë së disa fortifikimeve iliro-epirote, dalloi në sistemin mbrojtës të Lisit jo një, por dy faza ndërtimi. Fazën e parë të përfaqësuar sipas mendimit të tij, nga stili poligonal, pa rreshta, ai e lidh me qënjen e një vendbanimi të fortifikuar para shek. IV para erës sonë, kurse fazën e dytë të përfaqësuar nga stili poligonal këndrejtë me rreshta i përafërt me trapezoidalin e parregullt si vepër dioniziane [15]). Provat që ai sjell në favor të këtij periodizimi të mureve rrethues të Lisit, për mendimin tonë, nuk kanë asnjë mbështetje dhe as që nuk e vlen për t'ja nënshtruar ndonjë diskutimi të veçantë. U tha edhe më lart dhe kjo në bazë të vëzhgimeve tona të vazhdueshme dhe të zbulimeve të reja arkeologjike, se këto dy stile janë aq mjesnërisht të ndërthurura midis tyre, sa që nuk lënë as më të voglin dyshim për karakterin bashkëkohës të përdorimit të tyre.

Ndryshe nga muret e njëkohshme perimetrale të qytetit, muri i brendshëm ndarës paraqet një teknikë tjetër ndërtimi, me veçori dalluese konstruksioni dhe punimi guri. Ky mur, trashësia e të cilit arrin në 1.70 m., në mbushje të brendshme përmban gurë të vegjël dhe nga njëherë fragmente keramike të shek. II-I p.e. sonë. Bloqet e gurëve në përgjithësi janë punuar në forma afërsisht trapezoidale, sikurse edhe ato të mureve rrethuese, por me një ndryshim, se faqet e dukshme të tyre nuk janë më të gufmuara, por të gdhendura rrafsh. Shpesh ato janë pajisur me vija të thelluara paralele në drejtime të ndryshme, të cilat i kanë shërbyer për lehtësimin e procesit të daltimit të gurit, por që më vonë janë lënë, siç duket, edhe për efekte dekorative. Këto veçori teknike e dallojnë mirë këtë mur të brendshëm, të ngritur nga themelet, si një fazë të dytë ndërtimi në kuadrin e sistemit mbrojtës të qytetit. Kjo bëhet edhe më e qartë kur kemi parasysh, se copa të vogla muri me një teknikë të ngjashme punim guri, janë gjetur edhe mbi mbeturinat e mureve perimetrale (fig. 12), si dëshmitarë të një ripërtëritjeje të tyre në një periudhë më të vonë, kur ato ishin dëmtuar rëndë nga koha.

* * *

Në sistemin e fortifikimit të Lisit antik, në mënyrë të veçantë të tërheqin vëmendjen hyrjet e shumta, me anë të të cilave qyteti komunikonte me territorin e jashtëm ose midis rajoneve të brendshme të tij. Në vetëvete, ato përfaqësojnë elementet më të rëndësishme dhe njëkohësisht më interesante nga pikëpamja arkitektonike. Deri më sot ne kemi arritur të fiksojmë 10 hyrje dhe të gjitha këto në rrethimin e rajonit të lartë të qytetit. Nga këto 8 janë të jashtme dhe dy

13) Praschniker — Schober, **vep. cit.,** f. 16.
14) » — » **po aty.**
15) R. L. Beaumont, **Corinth, Ambracia, Apollonia** (shih shtesën) f. 72.

DO NOT COPY

të brendshme. Janë zbuluar vetëm 6, prej të cilave 5 janë restauruar deri në masën e lejuar nga materiali i gjetur në vend (fig. 13).

Hyrjet e zbuluara nga pikëpamja tipologjike dhe e konstruksionit, në vija të përgjithshme, kanë ngjashmëri të madhe midis tyre. Kryesisht ato paraqesin tipet më të thjeshta të hyrjeve të njohura nga fortifikimet iliro-epirote. Një korridor apo udhëkalimi e gjatë, e formuar nga ndërprerja e murit rrethues ose nga thyerja e drejtimit të tij prej nga kanë rrjedhur edhe ato pak ndryshime të vogla që mund të vërehen në konfiguracionin planimetrik të tyre (fig. 13). Përmasat e portave janë të ndryshme: më e vogla 1.60 m. e gjerë te hyrja, me udhëkalimi 3.20 m. të gjatë; ndërsa më e madhja ka një gjerësi prej 4.10 te hyrja dhe një gjatësi korridori prej 9.60 m. Për lehtësi orientimi hyrjet i kemi emërtuar si më poshtë: 1) Porta e Gaviarit (TAB. I, 1) në qoshen juglindore të sistemit mbrojtës të qytetit; 2) Porta e vogël (TAB. I, 3) në murin perëndimor; 3) Porta jugperëndimore (TAB, I, 2); 4) Porta e burimit (TAB. II, 1) në anën veriore; 5) Porta e madhe (TAB. III, 2) në murin verilindor dhe 6) Porta e brendshme (TAB. III, 1) në murin ndarës të qytetit. Me përjashtim të portës jugperëndimore, në të gjitha hyrjet e tjera të zbuluara, dyert kanë qenë të vendosura brënda korridorit. Pragjet e tyre janë të sajuara nga tre bloqe gurësh të vendosur nga të dy anët ngjitur me faqet anësore të korridorit, mbi të cilët fiksoheshin kasat dhe kanatat e drunjta të dyerve, dhe i treti, më i vogli është vendosur në mes, i ngulur vertikalisht për të formuar mbështetsen e kanatave gjatë mbylljes së tyre (TAB. II, 2). Zakonisht hapësira midis këtyre bloqeve fiksuese dhe mbështetëse, është e mbyllur me një ose dy rreshta të shkallëzuar gurësh.

Në qoftë se ne sot njohim shumë mirë pragjet e këtyre portave dhe përafërsisht mënyrën e ndërtimit të dyerve të drunjëta, deri në mekanizmat lëvizëse metalike të tyre (fig. 14), nuk dimë ende se çfarë zgjidhje konstruktive dhe formë arkitektonike mund t'i kenë dhënë ndërtuesit mbulesës së këtyre hyrjeve, pasi gjatë gërmimeve nuk u gjet asnjë element që të na ndihmonte në këtë drejtim.

Portat kanë qenë të mbrojtura me nga një kullë anësore, e cila, me sa duket, për arësye taktike vendosej në të djathtë të hyrjes; bën përjashtim vetëm kulla e portës së brendshme. Porta e madhe, si më e rëndësishmja që mund të ketë qenë, ishte e mbrojtur me dy kulla anësore. Shtojmë se kullat, në këtë sistem fortifikimi, përforconin jo vetëm hyrjet, por edhe muret rrethuese, në pjesët e tyre më të ekspozuara sulmeve të armikut. Këto u jepnin mundësi mbrojtësve nga njëra anë, për të kontrolluar një zonë sa më të madhe shikimi dhe, nga ana tjetër për t'i drejtuar shtizat e



Fig. 6



Fig. 7

tyre në pjesët e pambrojtura të trupit të kundërshtarit që përpiqej të çante rrugën përmes portave të qytetit.

Me përjashtim të njerës kullë që është gjysmërrethore, që të gjitha të tjerat janë katërkëndëshe. Ndryshojnë vetëm në përmasa dhe në daljen e tyre jo të barabartë nga faqet e mureve. Ngjitja në këto kulla të larta bëhej me anë të shkallëve të gurta të ndërtuara në anën e brendshme të tyre (fig. 15).

* *
*

Paraqitja e këtyre veçorive konstruktive arkitektonike dhe stilistike të sistemit rrethues të Lisit, që posa i analizuam shkurtimisht në këtë punim, nuk do të ishte

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY

e plotë, po të mos shtrohej edhe çështja e kohës së ndërtimit të këtij rrethimi, aq më tepër kur dihet se për datimin e tij janë shprehur mendime të ndryshme. Kështu p.sh. disa studjues të cilët e quajtën Lisin krijesë të veprimtarisë kolonizuese të Dionisit të Sirakuzës në Adriatik, caktuan si kohë të ngritjes së mureve rrethuese të tij fillimin e shek. IV para e. sonë [16]). Prashniker e Shober madje i morën këto mure si një burim të sigurtë datimi edhe për konstruksionet e tjera fortifikuese të ngjashme tipologjikisht me ato të Lisit, kurse Bomo në këtë drejtim shkoi edhe më larg, duke i vlerësuar këto si një bazë kryesore për vendosjen e një kronologjie absolute të mureve iliro-epirote [17]).

Përkundrazi Novaku dhe tani së fundi Garashanin, të cilët në kundërshtim me të parët e çmuan Lisin si një qytet thjesht ilir, duke u nisur nga burime të tërthorta historike dhe krahasime tipologjike, i datuan këto mure, i pari në fundin e shek IV ose në fillimin e shek. III [18]) para e. sonë, ndërsa i dyti si të kohës së sundimit të Agronit. [19]).

Duke lënë më një anë burimet historike të dyshimta për çështjen që na intereson, si edhe ngjashmëritë tipologjike për të cilat jemi të bindur se jo gjithmonë të shpien në përfundime të sakta kronologjike, ne jemi mbështetur për datimin e themelimit të qytetit, rrjedhimisht dhe të mureve rrethuese të tij, kryesisht në përfundimet e gërmimeve të këtyre dy vjetëve të fundit.

Duhet thënë që në fillim se, gjatë zbulimit të portave ku ne përqendruam gërmimet tona, nuk hasëm në asnjë vend depozitime të rregullta kulturale dhe ky fenomen ka shpjegimin e vet. Portat, siç e treguan edhe gërmimet, funksionuan për një periudhë shumë të gjatë deri në kohën e vonë antike apo mesjetare, kohë në të cilën ato qenë mbyllur. Në këto rrethana mbushja e tyre u bë vonë dhe pak a shumë e shpejtë me dyndjen e dherave nga lart, të për-

16) Praschniker-Schober, në vep. cit. f. 14 marrin si datë të themelimit të Lisit dhe të ndërtimit të mureve vitin 385 para e. sonë ndërsa Fluss në Pauly Wisowa, **Realenzyclopaedie** s. v. **Lissos,** duke e quajtur si gabim datimin e arkeologëve austriakë, shënon si kohë të themelimit të qytetit vitin 390 para e. sonë.

17) R.L. Beaumont, **Corinth, Ambracia, Apollonia** f. 69.

18) G. Novak, **vep. cit.** f. 115. Autori, duke dashur të përcaktojë kohën e themelimit të qytetit ilir të Lisit dhe të fortifikimit të tij, merr si terminus post quem vitin 335 para e. sonë, kohë kur Pseudo-Skylaksi shkroi Periplusin e tij **(Scylacis Caryandensis Periplus,** GGM ed. Müller, Parisiis, 1855 f. 31, 32), në të cilin nuk përmendet fare Lisi si qytet, kurse si terminus ante quem, kohën e sulmit maqedon mbi Lisin dhe Akrolisin të përshkruar me aq vërtetësi nga Polybi (Polyb. VIII 13, 1 vv.; 14, 1 vv.). «Kështu Lisi, përfundon Novaku, nuk ka qenë i fortifikuar para vitit 335 para e. sonë, por ka qenë para vitit 213 para e. sonë... pra ose në fund të shek. IV ose në fillim të shek. III para e. sonë

19) M. Garašanin: **Moejna Aeacia,** Starinar, N.S. XVII 1966, Beograd 1967, f. 33-34.

ziera edhe me hedhurina të ndryshme. Rëndësi ka të shënohet fakti se në këto depozitime të parregullta kulturale, të përfaqësuara nga fragmente të shumta keramike dhe metalike me karakter, destinacion dhe moshë të ndryshme, si edhe nga mjaft monedha helenistike, romake dhe bizantine etj., materialet më të hershme nuk shtyhen kurrë përtej fundit të shek. IV dhe fillimit të shek. III para e. sonë. Kësaj kohe i përkasin edhe fragmentet e keramikës, të datuara mirë, të tipit apul.

Datimit të këtyre mureve rrethuese të qytetit, i shërbyen edhe dy gërmime të vogla kontrolli që u bënë, njëri në majën e kodrës së kalasë dhe tjetri, në afërsi të bregut të Drinit. Edhe në këto dy pika sondazhi (kësaj rradhe me stratifikim deri diku të rregullt kulturash: mesjetare dhe romake me përzierje objektesh helenistike në kala, dhe romako-helenistike buzë Drinit), elementet më të hershme i përkasin gjithashtu fillimit të shek. III ose fundit të shek. IV para e. sonë. Janë pikërisht këto të dhëna arkeologjike stratigrafike të përfituara nga gërmimet e deritanishme që na shtyjnë të mendojmë se, fundi i shek. IV para e. sonë duhet të shënojë kohën e themelimit të qytetit dhe të ngritjes së mureve mbrojtëse të tij.

Kjo është gjithashtu edhe periudha e formimit të një numri qytetesh të tjera të fortifikuara ilire, jo shumë larg Lisit, si e kanë treguar gërmimet arkeologjike që u zhvilluan në këto vjetët e fundit, në Zgërdhesh të Krujës [20]) dhe në Xibër të Matit [21]). Megjithë se ende në fillim, ato na kanë dhënë materiale të shumta që e lidhin qartë këtë trekëndësh qëndrash ilire jo vetëm nga pikëpamja kronologjike, por edhe ekonomiko-kulturale. Ajo që na çudit në këtë mes, është vetëm ndryshimi stilistik midis mureve rrethuese të tyre. Sidoqoftë ky është një problem që nuk përfshihet në sferën e temës sonë dhe që kërkon një studim të veçantë.

Në dritën e këtyre të dhënave të reja kronologjike, natyrisht nuk mund të qëndrojë më datimi tradicional i themelimit të Lisit në vitin 390 ose 385 para e. sonë dhe aq më pak teza që e lidh themelimin e tij me veprimtarinë kolonizuese të Dionisit plak të Sirakuzës.

Në përforcim të këtij mendimi, do të ishte me interes, të përmendet edhe fakti se, të paktën deri tani, në asnjë vend të zonës së qytetit antik nuk është gjetur, qoftë edhe rastësisht, ndonjë mbishkrim greqisht apo monedhë para helenistike, që të tregojë tërthorazi për qenjen e Lisit koloni helene; asnjë fragment arkitekture dhe keramike të prodhimit klasik të shek IV para e. sonë që të flasë për zhvillimin e veprimtarisë qytetare në këtë kohë. Të gjitha këto, për mendimin tonë, dëshmojnë «ex i(silentio)» për fillimin e jetës qytetare në Lis jo përpara fundit të shek. IV para e. sonë. Natyrisht ky qytet nuk u ngrit në një vend të zbrazët, por, si e pamë edhe më lart, të banuar që më përpara nga popullsia ilire, e cila mbrohej nga qendra e saj e fortifikuar mbi majën e kodrës së kalasë. Ishte si duket, ky vendbanim i fortifikuar ilir, i cili, në procesin e zhvillimit të pandërprerë ekonomiko-shoqëror, u transformua në një qe-



Fig. 10



Fig. 11

DO NOT COPY

20) S. Islami, qyteti ilir në Zgërdhesh, «Monumentet» I, 1971, f. 23-33

21) S. Islami, **Kalaja e Xibrit, Konferenca e II-të e Studimeve Albanologjike** (12-18 janar 1968) vëll. II, Tiranë 1969, fq. 315-319.

ndër të madhe me ekonomi e kulturë qytetare ilire, të mbrojtur nga një sistem tjetër i ri fortifikimi, më i ndërlikuar dhe më i fuqishëm se ai i banimit pararendës, me një konstruksion të përsosur për atë kohë dhe me një stil ndërtimi karakteristik për shumë qendra të fortifikuara të arealit iliro-epirot të epokës helenistike ndoshta dhe protohelenistike. Këto mure të sistemit mbrojtës të qytetit, sa të bukura aq edhe madhështore, janë padyshim, vepër e mjeshtërve vendas



Fig. 12

ilirë, të cilët i ndërtuan sipas stilit të kohës, por duke pasë si bazë përvojën e tyre shumëshekullore dhe nuk janë vepër e konstruktorëve helenë, siç e quajtën pa të drejtë Prashnikeri e Shoberi.

Për datimin e mureve të periudhës së dytë të ndërtimit, në sistemin e fortifikimit të Lisit, ne jemi mbështetur në fragmentet e qeramikës së shek. II-I p.e. sonë të zbuluara në mbushjen e murit të brëndëshëm, si edhe në dy mbishkrime latine të zbuluara në vitin 1968 ku bëhet fjalë për ripërtëritjen e mureve, të një kulle dhe të një porte, me vendim të këshillit të qytetit dhe nën përkujdesjen e magistratëve ekzekutivë të tij, Gaviarit dhe Meges. Mbishkrimet i përkasin mesit të shek. I para e. sonë. Për një riforcim të tillë të sistemit mbrojtës të qytetit, flet edhe vetë tradita e shkruar historike. Jul Cezari nën vartësinë e të cilit gjendej në atë kohë Lisi, në veprën e tij «Mbi luftat civile», shkruante se: «këshilli i qytetarëve romakë që kishte në dorë Lisin, qytet të cilin ua kishte besuar më parë Cezari, . . . *ishte përkujdesë ta fortifikonte. . .*» (B. Civ. III, 29, 1). Pra si shihet, këtu kemi të bëjmë me një përputhje të përsosur të burimeve historike me ato epigrafike, për çështjen e kohës së përforcimit të mureve rrethuese të qytetit, që do të ishte mesi i shek. I para e. sonë.

Meqë ra rasti duhet thënë se mbishkrimet e sipërpërmendura, të murosura, dikur në pika të ndryshme të sistemit fortifikues të Lisit, për të përkujtuar magistratët që u përkujdesën për riforcimin e tij dhe bashkësinë qytetare, me shpenzimet e së cilës u kryen punimet, nuk janë të parat që zbulohen në truallin e këtij qyteti të lashtë. Që në vitin 1436, Qiriaku i Ankonës pat parë dhe lexuar mbi mur një epigram të tillë të ngjashëm për nga përmbajtja [22]) që u datua si i periudhës së hershme perandorake [23]) dhe që u shërbeu studjuesve si dokument për të provuar një rindërtim të dytë të mureve rrethuese pas atij të shek. I p.e. sonë.

Mirëpo në dritën e mbishkrimeve të reja, ne kemi bindjen se ky epigram, sot i zhdukur i Qiriakut, i cili mund të këtë qenë i murosur te porta e burimit, ku ne diktuam gjurmët e një «tabula ansata» me tekst fare të fshirë, është lexuar gabim në rreshtin e parë dhe datuar gjithashtu gabim. Kështu fjala ARNN që vjen fillë mbas emrit gjentilik GAVI dhe të cilin Momzen e quajti, si një patronim apo emër tribuje [24]) të plotësuar më vonë me pikëpyetje ARNNENSIS [25]), sipas mendimit tonë duhet lexuar ARIUS, duke e quajtur këtë si mbaresë të emrit gjentilik të GAVI-ARIUS. Kështu në rreshtin e parë, në vend të LUCI GAVI/ARNN AUGUR, do të kemi LUCIUS GAVIARIUS AUGUR. . . që do të ishte në rastin tonë po ai Gaviarius augur, për të cilin bëjnë fjalë mbishkrimet tona të shek. I p.e. sonë. Me këtë korrigjim leximi dhe datimi, privohet nga baza dokumentare mendimi i Prashnikerit e i Shoberit për një rindërtim të dytë të Lisit në periudhën e hershme perandorake [26]). Natyrisht riforcime

22) Th. Mommsen, CIL III, nr. 1704; J. W. Kubitschek, **Imperium Romanum, tributim discriptum,** Lipsiae 1889, 235; Th. Ippen, **vep. cit.** f. 57; P. C. Sestieri, **Nënshkrime latine të Shqipnis,** në «Studime e tekste» dega II, arkeologjike, nr. 1, Tiranë 1943, f. 49.

23) Praschniker-Schober, **vep. cit.** f. 20; P. C. Sestieri, **vep. cit.** f. 49.

24) CIL, III, u. 1704.

25) Shih Th. A. Ippen. **vep. cit.** f. 57; P. C. Sestieri, **vep , cit,** f, 49,

26) Praschniker-Schober, **vep. cit.** f. 20.

DO NOT COPY



fig. 13

DO NOT COPY

në sistemin e fortifikimit të qytetit ka pasur edhe më vonë, por jo në periudhën e hershme perandorake. Shumë-shumë, ato mund të lidhen me periudhën e vonë antike. Janë riforcime të pjesshme që dallojnë nga ato të parat, për karakterin e tyre të shpejtë dhe shkel e shko duke vendosur në një mënyrë të parregullt njeri mbi tjetrin bloqet e rrëzuara dhe duke reduktuar trashësinë e murit fillestar perimetral nga 3.20 m. që ishte në 2 m.

Si përfundim, përsa u tha më sipër, dalin këto:

I) Lisi nuk ka qenë asnjëherë koloni sirakuziane, por, përkundrazi, një qytet i madh dhe i fuqishëm ilir buzë Adriatikut. Fjala Lis në tekstin e Diodorit të Siqelisë, duhet lexuar ose, të paktën duhet nënkuptuar Issa. Këtë mendim e kanë shprehur shumë studjonjës duke u nisur që nga gjysma e dytë e shek. XVII. Kështu jo Lisi, por Issa ka qenë themeluar në fillim të shek. IV para e. sonë nga Dionisi i parë i Sirakuzës.

II) Si qendër urbane Lisi u formua nga fundi i shek. IV para e. sonë. Pasi shpërtheu kufitë e ngushtë të vendbanimit pararendës me një ekonomi e kulturë paraqytetare, qyteti zgjerohet tatëpjetë shpatit të kodrës së kalasë, deri në breg të lumit Drin dhe rrethohet me një sistem të fuqishëm fortifikimi, ku bashkekzistojnë në një thurje mjeshtërore dhe harmonike, të dy stilet e njohur të kohës: trapezoidali i parregullt dhe poligonali.

III) Në periudhën e hershme të pushtimit romak, muret e rrethimit të qytetit kishin pësuar dëmtime të rënda, fuqia mbrojtëse e tyre ishte dobësuar. Ndërkaq Lisi rrezikohej me sa duket nga lëvizja kryengritëse e pirustëve. Ishin ndoshta këto rrethana pasigurie që e detyruan këshillin e dekurionëve të qytetit për të marrë masa urgjente për riforcimin e sistemit mbrojtës të tij.

IV) Dy vendbanimet e fortifikuara ilire mbi malin e Shelbuemit dhe mbi kodrën e kalasë, paraqesin dy faza suksesive pararendëse, në procesin e ngadalshëm, por të pandërprerë të formimit të qytetit antik. Kjo ecuri shkallëzore në rrugën e formimit të kësaj qendre të rëndësishme ekonomike dhe politike ilire, ndiqet jo vetëm në zgjerimin progresiv të sipërfaqes së banimeve të përshkruara, por edhe në përmirësimin gjithmonë e më të madh të teknikës së ndër-





fig. 15

timit të mureve rrethuese të tyre, i arritur si rrjedhim i zhvillimit në vijë rritëse të forcave prodhuese të ilirëve të kësaj krahine bregdetare.

Zhvillimi progresiv tekniko-stilistik i mureve të ndryshme në zonën e qytetit antik të Lisit, gjatë mijëvjeçarit të fundit para erës sonë, mund të paraqitet në mënyrë të përmbledhur në këtë stratifikim kronologjik – relativ:

LIS I – Muret rrethuese mbi majën e Shelbuemit (fig. 1).

LIS II – Muret rrethuese mbi kodrën e kalasë (fig. 3).

LIS IIIa – Muret rrethuese të qytetit të Lisit (Tab. II, 3)

LIS IIIb – Muret e periudhës së rindërtimit të Lisit (fig. 11, 12).

Së fundi, shprehim bindjen se gërmimet dhe punimet restauruese në vitet e ardhshme, do të hedhin më shumë dritë si mbi problemet e trajtuara, shkurtimisht në këtë punim, ashtu edhe mbi çështjet e tjera shumë të rëndësishme por që nuk u trajtuan këtu të karakterit ekonomik e kultural të Lisit, të kësaj qendre të madhe prodhimi zejtaro - agrar me një tregëti e kulturë të zhvilluar qytetare, të kësaj qendre politiko-administrative, e cila, për shkak të pozicionit të saj gjeografik, luajti një rol të rëndësishëm në ngjarjet historike të shekujve të fundit të mbretërisë ilire.

DO NOT COPY

DO NOT COPY


1


2


3

TAB II







DO NOT COPY



1



2

DO NOT COPY

DO NOT COPY

F. PRENDI, K. ZHEKU

LISSVS A LA LUMIERE DES PLUS RECENTES DONNEES ARCHEOLOGIQUES

RESUME

On rencontre, dans la littérature historique et archéologique, des points de vue différents quant à la fondation de la cité antique de Lis (Lissos-Lissus) par Denys de Syracuse, au début du IVe siècle avant notre ère. Rassemblant les arguments à l'appui de ces points de vue, G. Novak, dans son étude sur l'activité colonisatrice de Denys de Syracuse dans l'Adriatique, a démontré de façon convaincante, selon l'opinion des auteurs, l'inexactitude de l'indication de Diodore de Sicile sur la fondation de Lis, indication qui fait erronément état de Lisson *au lieu de* Issa.

Cette étude a pour objet, à la lumière des nouvelles sources archéologiques recueillies ces deux dernières années à la suite des travaux systématiques entrepris, d'apporter de nouveaux arguments encore plus probants à l'appui de la thèse de la genèse autochtone illyrienne de Lis, et de définir avec plus de précision les particularités de la construction et les caractéristiques architectoniques de son système de défense.

Au cours de ces travaux, il a été effectué une reconnaissance topographique détaillée de la zone de la cité antique, y compris sa citadelle située au sommet du mont Shelbum, et connue dans la tradition écrite antique sous le nom d'Acrolis (Acrolissos).

Ce travail a permis de déterminer clairement certaines ruines de murs d'enceinte, jusqu'alors inconnus et qui, du point de vue technique et stylistique, diffèrent considérablement, non seulement entre eux, mais encore des murs d'enceinte de Lis connus jusqu'ici.

Les vestiges des murs les plus anciens, qui ont, sans aucun doute, fait partie intégrante du système de fortifications d'une agglomération illyrienne préhistorique, ont été relevés au sommet du mont Shelbum, où, comme on sait, Praschniker et Schober situèrent, les premiers, les ruines de l'antique Acrolis. Les murs de l'agglomération illyrienne au sommet du Shelbum sont construits en pierres non taillées de grosses et de moyennes dimensions, et assemblées sans mortier, selon le type de Gajtan.

Les ruines des remparts que les auteurs ont découvertes au sommet de la colline de la citadelle présentent également un intérêt particulier. Par rapport aux murs d'enceinte de la première agglomération située au sommet du Shelbum, les murs de la seconde indiquent un stade plus avancé de maîtrise dans le travail de la pierre et dans la maçonnerie, alors que si on les compare aux murs déjà connus du système défensif de Lis, on note d'étroits rapports entre eux, ce qui porte à considérer les murs de la seconde agglomération comme appartenant à un stade immédiatement antérieur au système fortifié de Lis.

Ainsi donc, si les murs du système défensif de Lis sont décrits de façon détaillée par Praschniker-Schober, il en va différemment des deux agglomérations illyriennes précitées, dont il est traité pour la première fois dans cette communication. En même temps que la description des monuments découverts, murs, tours, portes, etc., il y est fait une révision et une réappréciation générale du système de fortifications de la ville, dont la

DO NOT COPY

construction, sur la base des données archéologiques recueillies jusqu'à ce jour, est datée à la fin du IVe siècle.

Les conclusions dégagées sont les suivantes:

1) Lis n'a jamais été une colonie de Syracuse, mais au contraire une grande et puissante cité illyrienne, riveraine de l'Adriatique. Le nom de Lis cité dans le texte de Diodore de Sicile, doit être rectifié pour celui de Issa. Cette opinion a été soutenue par de nombreux chercheurs à partir de la seconde moitié du XVIIIe siècle. Ainsi ce n'est pas Lis, mais Issa qui a été fondée au début du IVe siècle avant notre ère, par Denys Ier de Syracuse.

2) Lis devint un centre urbain à la fin du IVe siècle avant notre ère. Après avoir déborde les étroites limites de la première agglomération dotée d'une économie et d'une culture précitadine, la ville s'étend vers le bas sur le flanc de la colline jusqu'à la rive du Drin et est enceinte d'un puissant système de fortifications, où les deux styles connus de l'époque, polygonal et trapézoïdal irregulier, s'allient de façon magistrale et harmonieuse.

3) Dans la première période de l'occupation romaine, les murs d'enceinte de la ville furent gravement endommagés et leur capacité défensive affaiblie. En même temps, Lis était sérieusement menacée par le mouvement insurrectionnel des Pirustes; ce furent donc, semble-t-il, ces circonstances d'insécurité qui contraignirent le conseil des décurions de la ville à prendre des mesures urgentes pour en renforcer le système défensif.

4) Les deux agglomérations fortifiées illyriennnes, sur le mont Shelbum, et sur la colline de la citadelle, appartiennent à deux phases successives, les premières, du processus, lent mais continu, de fortification de la cité antique. Cette marche graduelle dans la voie de la formation de cet important centre économique et politique illyrien, est attestée non seulement par l'extension progressive de la superficie des habitations décrites, mais aussi par l'amélioration continue de la technique de construction des murs d'enceinte, suscitée par le développement ascensionnel des forces productives des Illyriens de cette région littorale.

L'évolution progressive technique et stylistique des divers murs dans la zone de la cité antique de Lis, au cours du dernier millénaire avant notre ère, peut être ramenée en gros à la stratification chronologique relative suivante:

Lis I – Murs d'enceinte au sommet du Shelbum.

Lis II – Murs d'enceinte sur la colline de la colline.

Lis III – Murs d'enceinte de la cité de Lis.

Lis IV – Murs de renforcement de la cité de Lis.

Pour conclure, les auteurs expriment leur conviction que les fouilles et les travaux de restauration des années à venir, jetteront un meilleur jour sur les problèmes traités, fût-ce brièvement, dans cette étude, ainsi que sur d'autres questions très importantes de caractère économique et culturel relatives à Lis, ce grand centre de production artisanale et agraire, dont le commerce et la culture urbaine étaient développés, et qui, étant à la fois un chef-lieu politique et administratif, joua, du fait aussi de sa position géographique, un rôle important dans les événements historiques des derniers siècles du royaume Illyrien.

DO NOT COPY

Hasan CEKA

DEGA JUGORE E RRUGËS EGNATIA

DO NOT COPY

Në vitin 1962 në fshatin Mbrostar (rrethi i Fierit); në lagjen Mbrostar-Ura, u gjetën dy trungje shtyllash që mbanin mbishkrime latine. Si përmbajtja e mbishkrimeve, ashtu edhe trajta e gurëve, lenë të kuptohet se kemi të bëjmë me gurë rrugorë (gurë milesh), që shërbenin për t'u treguar udhëtarëve e transportuesve të mallrave, largësinë në mijë-këmbë (mile), prej një qyteti apo stacioni rrugor, në tjetrin. Zbulimi i shtyllave në fjalë nuk u detyrohet gërmimeve arkeologjike, por punimeve bujqësore. Nga një vëzhgim i sipërfaqshëm që ju bë terrenit të zbulimit, doli se faqja e kodrës, të cilën fshatarët e quajnë Bregu i Madh, ishte mbuluar në shumë pika me copërina jo të pakta tjegullash e tullash antike, kështu që, nuk ka pse të dyshojmë se mos gurët janë sjellë këtu nga një vënd tjetër, më i largët. Më e pasur në copërina antike është çuka e Bregut të Madh. Në drejtim të Ardenicës, në vendin e quajtur Shqipe po të këtij vargu kodrash, ishin gjetur edhe varre të vjetra të mbuluara me tjegulla. Nga të gjitha këto të dhëna del se, në këtë pikë duhet të ketë qenë një vendbanim, me sa na e thonë të dy mbishkrimet. një stacion rrugor i udhës antike.

Bregu i Madh përbën pikën më jugore të vargut të kodrave që shtrihet, nga veriu në jugë, ndërmjet lumenjve Shkumbin e Seman. I përçarë nga shtrati i vjetër i Semanit, te katundi Gradishtë, ky varg e ndan fushën e Myzeqesë në një pjesë lindore dhe në një perëndimore, apo bregdetare. Pozita dhe formacioni gjeologjik lejuan që vargu i kodrave të ishte në çdo stinë të motit i hapur për komunikacionin; prandaj ai luajti rolin e një ure ndërlidhëse ndërmjet krahinave bregdetare të vendit tonë qysh nga kohët më të lashta, e deri në vitet e para të shekullit tonë, para se të ndërtohej rrjeti automobilistik i cili, për arësye thjesht ekonomike mori një drejtim tjetër. Të dy shtyllat rrugore të Mbrostarit dhe një trung shtylle i po këtij tipi, i zbuluar në vitet tridhjetë në katundin Sulzotaj të Lushnjes, në pikën e përkundërt më veriore të vargut të kodrave, na japin një ide të qartë rreth vijës së trasesë, që duhet të ketë ndjekur kjo rrugë, edhe pse nga traseja e saj, sot nuk ka mbetur mbi tokë asnjë mbeturinë. Pajisja e saj me shtylla rrugore dëshmon qartë se rruga që përshkonte fushën e Myzeqesë nga veriu në jug, nuk ka qenë vetëm një vijë komunikacioni ndërkrahinor, për trafikun ndërmjet dy qyteteve të mëdha të Adriatikut, Dyrrahut e Apollonisë, por edhe pjesë e rëndësishme e një arteri rrugor me rëndësi, që lidhte bregdetin e Ilirisë me Thesalinë e krahinat kufitare të Greqisë Veriore. Nëpërmjet saj kryheshin edhe lëvizjet e njerëzve e të mallrave midis trevave ilire në jug të Shkumbinit, me Maqedoninë e me krahinat e tjera të Ballkanit Jugor dhe të Orientit në përgjithësi. Për këtë arësye mendojmë se e vlen të merret në këtë rast edhe një herë në shqyrtim, problemi i degës jugore të rrugës Egnatia, për të cilën bëjnë fjalë edhe burimet e shkruara. Por më parë t'i hedhim një vështrim përmbajtjes së mbishkrimeve.

I

Fragment shtylle prej guri gëlqeror. Mungon pjesa e poshtme. Pjesa e sipërme e shtyllës është rrumbullakuar në trajtë kalote (gjysëm rruzulli). Në majë të kalotës është zgavruar një vrimë katërkëndëshe 0.16 m. e gjatë dhe 0.03 m. e gjerë dhe e thellë. Lartësia e ruajtur e shtyllës është 0.70 m., diametri 0.38 m.

Përreth shtyllës janë skalitur tre mbishkrime latine të kohëve të ndryshme perandorake. Mbishkrimi më



DO NOT COPY

i lashtë i përket fillimit të shek. III ndërsa më i riu, viteve të para të shek. IV.

a) IMP. CAES.	Imp(erator) Caes(ar)
M. AVRELIVS ANTONINVS	Marcus Aurelius Antoninus
PIVS. FELIX. AVG	Pius Felix Aug(ustus)
SACERDOS AMPLISSIMVS	Sacerdos amplissimus
DEI SOLIS INVICTI ELEGABALI	Dei Solis invicti Elegabali
PONTIF. MAX.	Pontif(ex) Max(imus)
TRIB. POT. III.	Trib(unitiae) pot(estate) III.
COS. III.	Co(n)s(ul) III
P. P.	P(ater) p(atriae)
RESTITVIT	restituit

Ky mbishkrim dhjetë rreshtash (Tab. I a, b) dallon nga dy të tjerët e po kësaj shtylle, për rregullshmërinë e rreshtave të tij dhe për bukurinë e germave. Shkronjat e rradhës së parë janë më të mëdha; ato arrijnë të kenë një lartësi prej 0.07 m., ndërsa germat e rreshtave pasuese arrijnë vetëm gjysmën e lartësisë e nuk shkojnë përtej 0,03-0.04 m.

Shtylla rrugore është e kohës së perandorit romak Elegabalit, që sundoi gjatë viteve 218-222. Ajo u ngrit në vitin 220-21 për të zëvendësuar një gur rrugor më të lashtë, të dalë jashtë përdorimit. Data në të cilën u ngulit mbishkrimi na jep një terminus ante quem edhe për rrugën vet, e cila del disa dhjetra vjet më e lashtë se sa koha në të cilën u përtëri shtylla. Shprehja *restituit* lejon të supozohet gjithashtu, se rindërtimit nuk ju nënshtrua vetëm shtylla rrugore, por pjesërisht apo tërësisht edhe trakti i rrugës që lidhte Apollonin me Dyrrahun.

b) Në anën e përkundërt të mbishkrimit të sipërm, është skalitur një mbishkrim tjetër, vija e parë e të cilit fillon pikërisht aty ku trungu i shtyllës fillon e rrumbullakohet (Tab. I, c); kjo tregon se trajta e kalotës ju dha majës së shtyllës që në skalitjen e mbishkrimit të parë.

DOMINO NO(STRO) GALERIO VALERIO MAXIMINO NOBILISSIMO CAESARI
Domino No(stro) Galerio Valerio Maximino Nobilissimo Caesari

Të katër rreshtat e mbishkrimit nuk janë as të drejta as kanë gjatësi të rregullta. Një pakujdesi jo më e vogël vihet re edhe në trajtimin e germave, të cilat paraqiten shumë të dobëta, pa asnjë bukurshkrim. Lartësia e tyre lëviz nga 0.03-0.06 m. Për t'u shënuar janë germat L, M dhe S që jepen në trajtën ⌊, M ∫.

Mbishkrimi përmend emrin e perandorit me origjinë ilire Galer Valer Maksiminit, të mbiquajtur Daza. [1]) Ai është thadruar mbi shtyllën rrugore të vitit 220-21 jo më parë se në vitin 305, në të cilin Daza emrohet Cezar.

c) Nën mbishkrimin e përshkruar, me shkronja po aq të dobëta dhe rreshta po aq të shtrembëta e të parregullta, u thadrua një vit më vonë, në vitin 306, mbishkrimi tri rreshtash (Tab. I, c) që përmend emrin e cezarit Flav Valer Kostandinit, i cili njihet në historinë e Romës me emrin Kostandini i Madh. Germat e mbishkrimit janë të përngjashme me ato të mbishkrimit të mësipërm, por janë skalitur nga një dorë tjetër. Përmasat e tyre lëvizin nga 0.03-0.04 m. Në rreshtin e parë dhe të tretë ka shenja pikëzimi.

DN. FL. VAL. CONSTANTINO NOB. CAES
D(omino) N(ostro) Fl(avio) Val(erio) Constantino nob(ilissimo) Caes(ari)

Megjithëse kronologjikisht të dy mbishkrimet nuk i ndan veçse një vit, edhe këtu nuk mungojnë dallimet në trajtat e germave: Λ për A, Ɒ për D, ⌊ për L dhe ∫ për S.

II.

Pjesa e sipërme e një shtylle prej guri gëlqeror (tabela I d). Lart e ruajtur, 0.70 m.; diam. i sipërm 0.33 m., i poshtmi 0.35 m. Lartësia e shkronjave, 0.05-0.07 m. Mban këtë mbishkrim katër rreshtash:

DN IVLIANO A GBRN III M P
D(omino) N(ostro) Juliano a G(a)br(aio)n III m(ilia) p(assuum)

Ky është mbishkrimi latin më i ri i datueshëm, i zbuluar në truallin e vëndit tonë. Ai mban emrin e perandorit romak Julianit (361-363).

Mbishkrimi është ngulitur me kujdes; dallon nga dy mbishkrimet e mësipërme nga rregullshmëria e rreshtave dhe bukuria e germave. Por ajo që ka më rëndësi për ne, është emri i stacionit rrugor që na përmendet këtu për herë të parë. Ai na është dhënë në formën e shkurtuar, vetëm me bashkëtingëlloret. Mendojmë se mund të plotësohet me Gabraion, një kështjellë e Epirit të Ri, që përmendet nga Prokopi i Cezaresë (De aed. IV, 4).

1) Emri ilir Daza, emri i vërtetë i këtij perandori, është një nga emrat e rendomtë që i hasim në truallin tonë si mbi drahmet e dorës tretë të Dyrrahut (150-37 para e. sonë), ashtu edhe mbi mbishkrimet mortore po të kësaj periudhe të këtij qyteti.

DO NOT COPY

III

Në vitin 1933, në katundin Sulzotaj të Lushnjes u zbulua një trung shtylle prej guri gëlqeror, i thyer sipër e poshtë. Lart i ruajtur 0.35 m., diametri 0.31 m. Shtylla mban këtë mbishkrim tre rreshtash me germa që kanë një madhësi prej 0.04 m.

DN CRISPO ET CONSTANTINO CAES

D(ominis) N(ostris) Crispo et Constantio Caes (aribus)

Mbishkrimi vuan si nga ana e bukurshkrimit, ashtu edhe nga kujdesi me të cilin janë hequr vijat e tre rreshtave të tij. E njëjta vërejtje vlen edhe për germat, që janë skalitur mjaft cekët.

Mbi shtyllën rrugore lexojmë emrat e dy djemve të perandorit romak Kostandinit, të djalit të madh Flav Jul Krispit dhe të djalit të dytë Flav Klaud Kostandinit, i njohur në histori me emrin Konstandini II. Mbishkrimi është thadruar jo më parë se në vitin 317, në të cilin të dy djemtë emërohen cezarë, por edhe jo më vonë se në vitin 326, kur Krispi nuk rron më.

Të dy shtyllat rrugore nuk ka dyshim se i përkasin trungut jugor të rrugës Egnatia, që nisej nga Apollonia. Kjo degë, sipas dëshmisë së Strabonit (VII, 323), kishte afërsisht të njejtën gjatësi si edhe trungu verior, që e merrte fillin nga Dyrrahu. Megjithkëtë hulum-

DO NOT COPY

TAB. II



tuesit, që janë marrë me këtë problem [2]) për arësye të ndryshme, kanë propozuar për degën jugore drejtime që nuk përputhen, as me pohimin e sipërm të Strabonit, as me të dhënat e tjera burimore, as edhe me vetë relievin e terrenit. Pikërisht në këtë drejtim të dy shtyllat rrugore hedhin një dritë të re.

Sipas Tabula Peutingeriana-s (Tab. II) nga Dyrrahu niseshin dy rrugë krahas njëra tjetrës, nga të cilat, njëra zbriste gjatë bregdetit për në Apolloni, kurse tjetra, e përshkonte Ballkanin nga perëndimi në lindje për të përfunduar në Bizant. Si stacion i parë mbi rrugën Dyrrah-Apolloni, e cila, sikurse do të përpiqemi ta vërtetojmë edhe me të dhëna të tjera, nuk është tjetër veçse dega jugore e rrugës Egnatia, figuron Genesis flumen, lumi i Shkumbinit; por mbi vijën përkatëse ka qenë harruar të shënohet largësia përkatëse në mile, ndërsa për largësinë ndërmjet Genesis flumen e Klodianës (Peqinit) janë dhënë dy numra XV e XXVI. Të marrura së bashku, largësia Dyrrah-Klodiana paraqitet kështu afërsisht tetë mile më e gjatë se sa është në të vërtetë. Ka qënë menduar se numri i parë 15 i përket largësisë Dyrrah-Genesis flumen; por meqenëse Shkumbini, nga do që ta marrish, është shumë më larg se 15 mile (rreth 23 km) nga Dyrrahu, për ta mënjanuar këtë mospërputhje, ka qenë menduar që në kohë antike Shkumbini të ketë pasur një shtrat të vjetër, që e çante përmes fushën e Kavajës [3]). Për numrin e dytë hulumtuesit kanë qenë të mendimit se, kopjuesi i Tabulës ka shënuar gabimisht XXVI në vend të XVI [4]). Me këtë korrigjim të dy numrat së bashku, të zbatuar mbi rrugën Dyrrah-Klodiana, do të na jepnin një largësi prej 31 milesh, dy mile më pak se sa itinerari i Antoninit, që është më i saktë në këtë pikë. Një zgjidhje e tillë, për shumë arësye, nuk i qëndron kritikës.

Si Vjosa (Aous) [5]) ashtu edhe Semani (Apsus) [6]) edhe pse nuk kemi shënime të shkruara që ta kenë ndryshuar dikur drejtimin e rrjedhjes, kanë lënë gjurmë të dukëshme të shtretërve të tyre të vjetër. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për Shkumbinin, pasi fusha e Kavajës nuk ruan mbeturina të tilla, që mund të përligjnin qenjen e shtratit të tij antik më në veri. Prandaj nuk kemi as arësye që vetëm për hir të numrit XV të tabulas, ta vendosim vaun e Shkumbinit (Genesis flumen) aty nga Luzi Vogël [7]). Këtu ka një rrugë tjetër zgjidhjeje. Po të ndryshojmë rreshtimin e numrave të tabulas dhe të 26 milet t'ja japim pjesës rrugore Dyrrah-Genesis flumen, shifra në fjalë do t'i përgjigjej plotësisht largësisë Durrës-Ballaj, katund buzë Shkumbinit, në bishtin jugor të kodrave bregdetare të Kavajës. Në trevën e këtij katundi duhet ta kërkojmë edhe stacionin Genesis flumen. Në të mirë të këtij indentifikimi flet edhe katundi përballë, Nova, në bregun tjetër të Shkumbinit, i cili të kujton jo vetëm stacionin ad Novas, mbi rrugën Apolloni-Klodiana, por ruan në truallin e tij edhe mbeturinat e një ure të kohës së vonë antike [8]). Nga ana tjetër kjo dëshmi nuk është aspak në të mirë të supozimit që Shkumbini të ketë rrjedhur në kohën antike në fushën e Kavajës. Nga Sulzotaj pranë Novës vjen edhe guri i gjysmës së parë të shek. IV të erës sonë (shih më sipër).

Largësia e dytë prej 15 milesh i përshtatet largësisë Ballaj-Peqin (Genesis flumen – Klodiana), kështu që të 41 milet, afërsisht 63 km., të dhëna nga tabula në dy numra (XV + XXVI) prej Dyrrahu në Klodiana i përgjigjen largësisë së vërtetë Durrës-Ballaj-Peqin. Megjithkëtë na mbetet për të sqaruar një problem tjetër. Përse degëzimi i dy rrugëve nuk bëhet pak kilometra përtej Kavajës, sikurse duhej të pritej (sipas tabulas, të dy vijat rrugore nisen paralel njëra me tjetrën që nga Dyrrahu, gjë që nuk është e besueshme), por bëhet në vaun e Shkumbinit, (Genesis flumen) duke i shkaktuar degës kryesore të rrugës Egnatia një rënie vërdallë prej 2 milesh (12 km)? Me sa shihet, tabula na jep një gjëndje rrugore më të lashtë, një trakt rruge që ekzistonte më përpara se sa

2) G. Veith, **Der Feldzug von Dyrrhachium zwischen Caesar und Pompejus.** Wien 1920, f. 56 vv. dhe C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** Wien 1920, kol. 105-126.

3) K. Miller, **Itineraria Romana.** Stuttgart 1916, kol. 517; Praschniker, **po aty,** kol. 108.

4) G. Veith, **po aty,** f. 60; Praschniker, **po aty,** kol. 126.

5) Siç dihet Vjosa në kohën antike, rridhte pranë Apollonisë, ndërsa sot është rreth 15 km më në jug. Në sinorin e fshatit Baçovë, para se të bonifikohej fusha moçalore që shtrihej ndërmjet tij dhe fshatit Sop pranë Apollonisë, shihej ende një shtrat i vjetër lumi, pa dyshim ishte ai i Vjosës.

6) Mbi shtratin e vjetër të Semanit, të quajtur Dellë, shif Praschniker, **po aty,** kol. 15.

7) Veith, **po aty,** f. 60. Për ndarjen e rrugës Dyrrah-Apolloni nga trungu kryesor, që përçante Ballkanin, Prashnikeri **(po aty,** kol. 124) është i një mendimi me Fajtin; për të dy degëzimi bëhet në të dalë të Kavajës, në katundin Harizaj.

8) C. Praschniker, **po aty,** kol. 126.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

rruga Egnatia të shtrohej me gur e zhavorr, të kalonte nëpër trasenë e shkurtuar, që ndjek afërsisht edhe sot rruga automobilistike, e të kthehej në një arter kryesisht ushtarak, i përshkueshëm edhe nga mjete me rrota, cilësi këto që i mori vetëm në fillimin e kohës së re. Deri në këtë periudhë rruga Egnatia nuk e mbante këtë emër tipik romak dhe luante ende një rol të dorës së dytë në krahasim me rrugën Dyrrah-Apolloni, traktin e së cilës qe detyruar ta përdorte deri te Shkumbini (Genesis flumen).

Duke pranuar këtë zgjidhje, d.m.th. katundin Ballaj në breg të Shkumbinit si pikë takimi të dy degëve të rrugës Egnatia, vërtetohet pohimi i Strabonit se të dy degët e rrugës Egnatia ishin të gjata barabar.

Sipas Fajtit, rruga që zbret për nga jugu, në drejtim të Apollonisë, nuk qenka më e vjetër se e kohës perandorake dhe veç kësaj nuk paska pasur as jetë të gjatë [9]). Ndërtimi, veçanërisht funksionimi i saj i rregullt ishte një domosdoshmëri, një nevojë e dorës së parë për të dy qytetet e mëdha të Adriatikut Lindor, të cilat, sikurse na e dëshmojnë burimet e shkrura e të dhënat arkeologjike, ishin të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, si në fushën ekonomike, ashtu edhe në atë politike e kulturale. Për mbajtjen e forcimin e këtyre marrëdhënjeve dhe për sigurimin e autonomisë së tyre, të kërcënuar sa e sa herë, funksionimi i rrugës tokësore ishte shumë më dobiprurës dhe më i nevojshëm se sa rruga e detit. Për rrafjen e kësaj rruge që nga gjysma e dytë e shek. V para e. sonë, flasin jo vetëm burimet e shkruara (Thuk. I, 26), por edhe vetë relievi i terrenit, të cilin ka qenë i detyruar ta ndiqte komunikacioni tokësor bregdetar, që nga kohët më të lashta, e deri në dhjetë vjetët e para të shekullit tonë.

Një përforcim të dëshëruar u japin të dhënave të sipërme edhe gjetjet arkeologjike. Gjetjet prehistorike, ndër të cilat dy sopata neolitike të zbuluara në Petovë në vitin 1968, me rastin e ndërtimit të hekurudhës Rrogozhinë-Fier, janë ende të pakta, kurse nga periudha klasike kemi një grumbull materialesh të datueshme nga shek. IV para e. sonë e poshtë, që të gjitha të zbuluara gjatë kësaj rruge, rrëzës perëndimore të vargut të kodrave, që nisin bregut të majtë të Shkumbinit, e mbarojnë në Mbrostar të Fierit: në Divjakë Babunjë të Re e Libofshë. Në Babunjë të Re dolën në dritë veç kësaj edhe gërmadhat e një qyteze të fortifikuar, të ngritur mbi një lartësi të vogël, në bregun e djathtë të shtratit të vjetër të lumit Aps. Kjo qytezë ilire, të cilën Tabula nuk e shënon me emër, por vetëm si Apsus flumen, ja detyron jetën e lulëzimin e saj këtij arteri rrugor, që lidhte jo vetëm të dy qytetet vëllezër, Dyrrahun e Apolloninë, por edhe krejt krahinat bregdetare të Ilirisë së Jugut.

Një dëshmi tjetër që vërteton se rruga Dyrrah-Apolloni nuk i përket periudhës perandorake romake, por ka qenë rrahur të paktën dy shekuj para e. sonë, na e japin ngjarjet e vitit 200 para e. sonë. Në librin XXXI, 27 të Tit Livit thuhet se konsuli romak Sulpici «e kishte vendosur kampin e tij ndërmjet Apollonisë e Dyrrahut, te lumi Aps». Përshkrimi është i qartë, vau i Apsit, për të cilin na flet Livi, nuk mund të ketë qenë në Kuç të Beratit [10]), pasi për këtë pikë të lumit Seman nuk mund të thuhet kurrsesi se ndodhet në mes të Dyrrahut e Apollonisë edhe sikur të pranonim se dega jugore e rrugës Egnatia të ketë kaluar këtej. Pika e Apsit ku u përqëndrua ushtria romake për të shkretuar tokat ilire, është e njejtë me stacionin Apsus flumen të Tabula Peutingerianas dhe prandaj duhet kërkuar në shtratin e vjetër të Semanit, pikërisht në Babunjë të Re, në bishtin më jugperëndimor të kodrave të Çokut.

Edhe arësyeja tjetër e pozitës strategjike, që e detyronte Fajtin të shprehej për Kuçin [11]), nuk është bindëse, përderisa ne nuk e dimë me siguri se ku ndodhen të gjithë ato qytete, sinorin e të cilëve i ve për detyrë vetes ta shkretojë konsuli romak. Mallakastra verilindore, sikurse mendon Fajti, përjashtohet, pasi në këtë rast do të ishte përmendur edhe qyteti kryesor, me pozitë të fortë strategjike i kësaj zone, Dimali [12]). Por edhe sikur pikësynimi i romakëve të ketë qenë kjo krahinë, prapëseprapë nuk kishte asnjë arësye që ushtria të grumbullohej në Kuç; për këtë fu-

9) Veith, **po aty,** f. 62 e 64.
10) I këtij mendimi janë si Veith **(po aty,** f. 62 e 98), ashtu edhe Praschniker **(po aty,** kol 120).
11) Veith, **po aty,** f. 63.
12) Veith, po aty, f. 62.

shatë asaj i binte më për mbarë të nisej drejtpërdrejt nga Apollonia apo nga Margëlliçi.

Ka shumë të ngjarë që viset, të cilat romakët i kishin vënë në shënjë për t'i grabitur e për t'i shfarosur (depopulandos) duhet të kenë qenë më të pasura, me popullsi më të dendur, me sa duket pellgu fushor e kodrinor, që shtrihet ndërmjet brigjeve të lumenjve Shkumbin e Seman (duke përfshirë këtu edhe rrjedhjet e poshtme të Devollit e të Osumit), pra duhet të kenë qenë krahinat e Darsisë, Dumresë, Sulovës e Tomoricës. Në dobi të këtij mendimi flet si numri i madh i qyteteve të pushtuara nga romakët në këtë fushatë (7 qytete), ashtu edhe plaçka e madhe e grabitur prej tyre.

Për zgjedhjen e vaut të Apsit si pikënisje për operacionet ushtarake, krahas pozitës së volitëshme, një rol të dorës së parë luajti padyshim edhe rruga që kalonte këtej. Kjo rrugë u shkel përsëri nga legjionet romake në vitet 49-48 para e. sonë, kur epiqendra e luftës civile, e shpërthyer nga krerët më të njohur të aristokracisë romake, u bë Iliria e Jugut. Pas dorëzimit të Apollonisë, Cezari vrapoi të kapi Dyrrahun, para se të arrinte atje Pompeu, por u ndal në Aps ku e pa se plani i dështoi. Kuptohet vetiu, por edhe nga përshkrimi i Cezarit del, se ky ndjek rrugën më të shkurtër për t'ja arritur synimit të vet; prandaj edhe këtu pika e Apsit, ku të dy ushtritë kundërshtare zenë pozicione përballë njera-tjetrës në të dy brigjet e Semanit, nuk duhet kërkuar në Kuç të Beratit prej nga Cezarit do t'i duhej afërsisht një rrugë dy herë më e gjatë për të arritur para portave të Dyrrahut, por aty ku shënon stacionin Apsus flumen, Tabula Peutingeriana, në Babunjë të Re (ku e ngre kampin Pompeu) dhe në bregun e majtë të lumit (ku ngul çadrat Cezari). Me këtë lokalizim përputhet mjaft mirë edhe citati i Cezarit (Bell. Civ. 13, 5), ku thuhet se Apsi në të cilin ngriti kampin ushtria e tij ndodhej në kufirin e Apollonisë. Për Kuçin nuk mund të thuhet se ishte brenda territorit të Apollonisë; tokat e këtij katundi ndodhen shumë më afër qyteteve ilire të Dimalit (Krotinës) e Antipatreas (Beratit).

Gjatë lëvizjeve të tyre në trevën ndërmjet Apollonisë e Dyrrahut, të dy ushtritë kundërshtare vihen përballë njera-tjetrës në të dy brigjet e Shkumbinit. Këtë radhë na përmendet për emër edhe një Asparag i Dyrrahut (Asparagium Dyrrhachinorum), lokalitet i cili, duke u nisur gjithmonë nga mendimi, se dega apolloniate e rrugës Egnatia kalonte nëpër Roskovec (Fier), Kuç (Berat) e Golem (Lushnje), ka qenë identifikuar me Rrogozhinën. Por nga sa u tha më sipër del qartë, se edhe Asparagu nuk ka si të unjisohet me një vend tjetër veçse me Genesis flumen të Tabulës, pra duhet kërkuar diku në tokat e katundit Ballaj. Ngritja e kampit ushtarak të Pompeut në Asparag-Ballaj ishte nga pikëpamja ushtarake shumë më e përshtatshme se Rrogozhina, pasi, sikurse u përpoqëm ta faktojmë edhe më sipër, kjo pikë e Shkumbinit formonte në këtë periudhë një kyç rrugor me rëndësi, ku takoheshin si rruga që lidhte Dyrrahun me Apolloninë, ashtu edhe ajo që shpinte në thellësi të Ballkanit. Edhe përshkrimi që na jepet për trapet e Shkumbinit si shumë të thepisura (Bell. civ. 75, 4), nuk i përgjigjet brigjeve të Shkumbinit në Rrogozhinë, ku ka mjaft pika vau, por pjesës fushore që përshkon lumi në perëndim të këtij katundi.

Qënjen e kësaj rruge nuk e mohojnë as hulumtuesit e pjesës perëndimore të rrugës Egnatia, por ata ngurojnë ta quajnë atë, degë të këtij arteri nga më të rëndësishmit të kohës antike. Duke u nisur nga gjatësia prej 57 milesh (rreth 86 km.) që shënon itinerari i Burdigalit për trungun e rrugës Apolloni-Klodiana (Peqin), Prashnikeri mendon se kjo degë rrugore kalonte në vijën Roskovec, Kuç, Golem, që përmendëm pak më sipër. Në këtë përfundim e shpien atë edhe dy të dhëna të rëndësishme arkeologjike: mbeturinat e një traseje antike në të dalë të Fierit afër fshatit Portëz dhe këmbët e një ure po të kësaj periudhe mbi lumin Seman në sinorin e Kuçit, në pikën ku është ngritur edhe ura e sotme e rrugës automobilistike. Të dy konstatimet e arkeologut austriak janë prova bindëse për kalimin në këtë vijë të një rruge. Por a është e domosdoshme që kjo rrugë të unjisohet pa tjetër me degën jugore të rrugës Egnatia? Qyteti i Belshit (Gradishta e sotme) në zemër të Dumresë, urat antike të Muriqanit dhe të Shkumbinit [13]) pranë Topçiasit (afër Elbasanit), lejojnë të mendohet se kemi

13) Shih C. Praschniker — A. Schober, **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro.** Wien 1919, f. 55 vv.

DO NOT COPY

TAB. III



të bëjmë me nji arter tjetër rrugor, që lidhte këtë pellg të pasur bujqësor me Apolloninë e Vlorës (Aulon) dhe përfundonte në Skampin (Elbasan), ku takohej rishtas me rrugën Egnatia.

Me gjetjen e shtyllave rrugore të Mbrostarit e të Sulzotajt, e humb vleftën edhe një supozim i Praschnikerit, i mbështetur këtë herë te itinerari i Antoninit, sipas të cilit rruga Apolloni-Klodiana është vetëm 49 mile (75 km.) e gjatë. Nuk ka asnjë arësye që të mendojmë për një degë të dytë më të shkurtër te trungut rrugor Apolloni-Klodiana, e cila të ketë kaluar nga Kolonja e Bishqethmi, për t'u takuar me degën më të gjatë aty nga Lushnja. [14]) Megjithëse të tre itinerarët kanë ndërmjet tyre diferenca jo të vogla largësish, që duhet t'u vishen të dhënave jo të plota të autorëve të tyre, apo punës së përciptë të kopjuesve të itinerarëve, që trajtojnë degën jugore të rrugës Egnatia, nuk ka pse të dyshojmë se Tabula bën një përjashtim e na jep një rrugë të veçantë Dyrrah-Apolloni. As emrat e ndryshëm të stacioneve që figurojnë në të tre itinerarët, nuk mund të merren si bazë për të nxjerrë përfundimin se kemi të bëjmë me tri rrugë të ndryshme. Sidoqoftë trajtimi me hollësi i këtij problemi mund të bëhet në kuadrin e një studimi më të gjërë, që do të ketë si cak trajtimin e krejt rrugëve që përshkonin në kohën antike territorin e Republikës Popullore të Shqipërisë.

14) Praschniker, **po aty,** kol. 123/4.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

H. CEKA

LA BRANCHE SUD DE LA VOIE EGNATIA

RESUME

En 1962, dans le village de Mbrostar, (région de Fier), ont été découvertes deux bornes milliaires qui portent les noms des empereurs Elagabal, Maximin Daza, Crispus, Constantin II et de Julien l'Apostat. Leur apparition dans une localité ne se trouvant pas sur l'itinéraire présumé de la branche sud de la voie Egnatia, a rendu nécessaire un nouvel examen de ce problème.

I

La première colonne porte trois inscriptions latines d'époques diverses. La plus ancienne date du début du IIIe siècle, la plus récente des premières années du IVe siècle de notre ère.

a) La première inscription de dix lignes se distingue des deux autres de la même colonne par la régularité de leur alignement et par la perfection des caractères qui sont de l'époque de l'empereur Elagabal, sous le règne duquel la colonne a été dressée. Le terme restituit permet de supposer que la colonne ne fut pas seule à être relevée, mais qu'à cette époque le tronçon de la route qui reliait Apollonie à Dyrrah fut reconstruit en totalité ou en partie. De même, cette époque peut être considérée comme un terminus ad quem pour l'époque de service de la route également.

b) La deuxième inscription a pour particularité l'irrégularité des caractères et leur alignement peu soigné. Elle fait mention du nom de l'empereur d'origine illyrienne Galère Valer Maximin, surnommé Daza et, elle ne peut donc avoir été ajoutée à la colonne milliaire avant l'an 305, date à laquelle Daza fut élu empereur.

c) La troisième inscription, tracée aussi plutôt grossièrement mentionne le nom de l'empereur Flavius Valerius Constantinus et date de 306.

II

La partie supérieure d'une colonne en pierres calcaires porte une inscription travaillée avec soin et portant le nom de l'empereur romain Julien (361-363). On peut considérer comme importante la mention qui y est faite du nom d'une station qu'on n'avait jamais trouvé cité jusqu'alors. Le nom est transcrit sous une forme abrégée, avec les seules voyelles, et nous pensons qu'il peut être complété pour donner le nom de Gabraion, une forteresse du Nouvel Epire, citée par Procope de Césarée.

DO NOT COPY

III

Une colonne milliaire découverte en 1933 dans le village de Sulzotaj porte une inscription de trois lignes, sur laquelle on lit les noms de Flavius Julius Crispus et de Flavius Claudius Constantin. Cela nous permet de dater l'inscription à une époque postérieure à 317, années où ils furent élus empereurs, et antérieure à 326, date de la mort de Crispus.

* * *

Il ne fait aucun doute que ces colonnes appartiennent à la branche sud de la voie Egnatia qui partait d'Apollonie. Selon la Tabula Peutingeriana, de Dyrrah partaient deux routes, l'une qui longeait le littoral en direction d'Apollonie, et l'autre qui, se dirigeant vers l'est, conduisait à Byzance. Sur la route Dyrrah-Apollonie, qui, comme nous nous efforcerons de le démontrer, était la branche sud de la voie Egnatia, la première station figurant sur la table est Genesis flumen, mais aucune distance en milles ne figure sur la ligne représentant cette voie. D'autre part, pour la distance Genesis flumen – Clodiana, on lit deux chiffres XV et XXVI, qui, ajoutés, donnent pour la route Dyrrah-Clodiana un chiffre de 8 milles plus long que la distance réelle séparant ces deux agglomérations. On a donc pensé que la distance de XV milles est celle qui séparait Dyrrah de Genesis, en supposant que le Shkumbin doit avoir en un ancien lit qui a traversé la plaine de Kavaja. Quant à la distance de XXVI milles, elle a été considérée comme une erreur et rectifiée pour XVI. Cette hypothèse est toutefois privée de solides fondements, car il n'existe aucune donnée historique ni aucune trace sur le terrain, témoignant que le lit du Shkumbin se soit trouvé, à l'époque antique, plus au nord. Une autre solution s'offre à l'esprit. Si l'on intervertit l'ordre des chiffres sur la table, et que l'on attribue les 26 milles au tronçon Dyrrah-Genesis flumen de la route, le chiffre correspond à la distance Durrës-Ballaj, un village bordant le Shkumbin, à l'extrémité sud des collines littorales de Kavaje. C'est dans cette région qu'il faut rechercher la station Genesis flumen. La seconde distance de 15 milles coïncide avec celle de Ballaj à Peqin, le total de 41 milles représentant la distance de Durrës à Peqin en passant par Ballaj. A ce propos, il reste à éclaircir pourquoi l'embranchement des routes se fait au gué du Shkumbini et non pas, comme il aurait été plus naturel, quelques kilomètres avant Kavaje, prolongeant ainsi de 8 milles l'itinéraire des voyageurs se rendant à Clodiana. Apparemment, la table reproduit la situation des routes telle qu'elle était avant le revêtement de la voie Egnatia et avant que celle-ci n'eût pris l'importance qu'elle devait connaître au début de l'ère nouvelle. Jusqu'à cette époque, elle ne joua qu'un rôle de second ordre par rapport à la route Dyrrah-Apollonie, dont elle était obligée de suivre un tronçon jusqu'au Shkumbin (Genesis flumen). Cette explication confirmerait l'indication de Strabon, selon laquelle les deux branches de la voie Egnatia étaient d'égale longueur.

La construction d'une route reliant Dyrrah et Apollonie et longeant le littoral, était une nécessité pour les deux cités que rattachaient d'étroits liens économiques, politiques et culturels. Le relief même a déterminé la direction de la route longeant le pied des collines côtières. On trouve des indications sur la fréquentation de cette route dès la seconde moitié du Ve siècle avant notre ère, chez Thucydide (V-26), ce qui est en outre confirmé par la présence des agglomérations qui s'égrènent sur la chaine des collines littorales. On distingue, à Babunje e Re, sur la rive droite de l'ancien lit de l'Aps, les ruines d'une cité fortifiée, dont l'existence était conditionnée par la route Apollonie-Dyrrah.

Ces éléments viennent démontrer que cette route est assez plus ancienne que ne le pense Veith, pour qui elle n'aurait été que peu de temps en service sous l'empire ro-

DO NOT COPY

main. Une série d'autres données historiques attestent indirectement que la route a été constamment en service à l'époque antique.

Le gué de l'Aps, où selon Tite-Live (XXXI, 27), le consul Sulpicius aurait fixé son camp en 200, ne peut s'être situé à Kuç (région de Berat), car, dans cette hypothèse, Tite-Live n'aurait pas décrit cet endroit comme étant situé «entre Apollonie et Dyrrah». Aussi a-t-on lieu de penser que le point du cours de l'Aps où se concentrèrent les troupes romaines doit avoir été Babunje e Re. Du point de vue stratégique également, Kuç ne se prête guère comme point d'appui pour attaquer le nord-est de la Mallakastër, comme le suppose Veith. En cette circonstance, on se serait attendu à voir citer Dimal, la ville principale et la plus puissante de cette zone. Il est fort probable que les zones attaquées par les Romains, devaient être fixées entre le Seman et le Shkumbin ou sur leur rives, comme l'indique le grand nombre de villes dont les Romains s'emparèrent par la suite dans cette région. Le choix du gué de l'Aps comme point de départ des opérations fut sans aucun doute déterminé, outre par sa situation favorable, par les facilités que créait la route qui desservait ces parages.

A l'époque de la guerre civile, après la reddition d'Apollonie, César tenta de devancer Pompée et de s'emparer rapidement de Dyrrah, mais, n'y réussissant pas, il s'arrêta en chemin. Il est évident, comme cela apparaît également de la description de César, que Pompée emprunta le chemin le plus court pour atteindre son objectif. De ce fait également, il ressort que le point de l'Aps où les deux armées adverses ont dû se trouver face à face, devait se situer à Babunje e Re. Au point correspondant à cette localité, la Tabula Peutingariana fait en effet figurer la station Apsus flumen. A la suite de mouvements ultérieurs dans la zone comprise entre Apollonie et Dyrrah, les deux armées se trouvent à nouveau face à face sur les deux rives du Shkumbini. Cette fois, il est fait mention de la localité d'Asparagium Dyrrachinorum, que l'on identifie à Rogozhine, en considérant erronément qu'une seule route passant par Roskovec (Fier), Kuç (Berat) et Golem (Lushnje) reliait Apollonie et Dyrrah. Asparagium ne peut être assimilée qu'à Genesis flumen figurant sur la Tabula; aussi convient-il de la rechercher dans la zone proche de Ballaj. Du point de vue stratégique, Pompée a dû y trouver, le lieu le plus approprié pour y établir son camp. C'était là en effet que se faisait l'embranchement de la route Dyrrah-Apollonie avec celle qui conduisait à l'intérieur des Balkans. De même, la description des berges très escarpées correspond pleinement à Ballaj et non pas à Rogozhine. Quant à la route Apollonie-Roskovec-Kuç-Golem-Rogozhine, les données archéologiques en retracent l'existence jusqu'à Kuç, et elle devait vraisemblablement se poursuivre par Dumre, Belsh, Muriqan et franchir le Shkumbin à l'antique pont de Topçias. Il s'ensuit qu'il ne saurait s'agir d'une route plus courte Apollonie-Clodiana, passant par Lushnje et Bishqethëm, comme le pense Praschniker. La diversité des distances et des noms de lieu qu'indiquent les itinéraires de la branche sud de la voie Egnatia ne doit pas être interprétée comme une preuve de l'existence de routes diverses. Au contraire, cette diversité peut très bien s'expliquer dans le cadre d'une route unique. Quoi qu'il en soit, l'examen détaillé de ce problème mérite d'être l'objet d'une plus vaste étude, qui portera sur l'ensemble des routes ayant parcouru à l'époque antique le territoire actuel de la République Populaire d'Albanie.

DO NOT COPY

Vangjel TOÇI

AMFITEATRI I DYRRAHIT

Për bukurinë dhe madhështinë e Dyrrahit, skelës më të madhe të bregdetit lindor të Adriatikut dhe «qytetit të mrekullueshëm», sikurse e quante Ciceroni, dëshmojnë, ndër të tjera, edhe shumë ndërtime e objekte arti të zbuluara pas çlirimit: godina publike, kulti e private, rrugë e parqe, skulptura, mozaikë, etj. Megjithatë vepra më monumentale që spikat me përmasat e veta gjigande, është amfiteatri që ka filluar të zbulohet vitet e fundit.

Të dhëna të tërthorta për qënjen e një amfiteatri në Durrës, kemi pasur përpara zbulimit të tij, nga një mbishkrim që gjëndej i puthitur në murin e kalasë nga perëndimi i portës së madhe. Sipas mbishkrimit del se një farë L. Flav Telur Getuli që kishte qenë nderuar me një sërë titujsh e grada në kohën e perandorit Trajan, ndihmoi me një sasi të hollash për ngritjen e një biblioteke në qytet dhe me këtë rast organizoi lojra ku u ndeshën 12 çifte gladiatorësh [1]). Mbishkrimi që mjerisht tani ka humbur, dëshmonte tërthorazi praninë e një ndërtimi të tillë në Dyrrah, për të cilin hedhin dritë dhe dy relievet e gladiatorëve që kanë qenë ngulur po në portën e madhe të kalasë [2]). Barleti nga ana e tij na jep një dëshmi të qartë për qënjen e amfiteatrit në librin e tij «Historia e Skënderbeut». Ai tregon se në Durrës ishte një «arenë ose amfiteatër, i ndërtuar me zgjuarësi dhe me mjeshtëri të admirueshme» [3]).

Me gjithë këto të dhëna është interesant fakti se arkeologët që kanë ardhur në Durrës dhe kanë vënë në dukje antikitetet e këtij qyteti nuk kanë venë re gjurmët e këtij monumenti; për më tepër edhe harkun e thyer të një galerie të amfiteatrit që anonte te një faqe muri e kalasë së ndërtuar më vonë, disa metra më poshtë kullës. L. Rey e ka quajtur këtë si një pjesë përbërëse të fortifikimit, si një këmbë harku brënda zonës së mbrojtur të qytetit[4]).

* * *

Amfiteatri i Dyrrahit është ndërtuar në faqen lindore të kodrës me kuotë 59 m. në pjesën juglindore të kështjellës, në mes harkut verior dhe jugperëndimor të mureve të kalasë. Arësyeja që ka shtyrë projektuesit dhe konstruktorët që ta ndërtojnë atë jo në fushë si zakonisht, por në një faqe kodre, ka qenë si duket tërheqja dalëngadalë e qytetit nga ana e jugperëndimit drejt kuotave më të larta, për shkak të lëkundjeve të shpeshta të tokës që shpejtuan mbylljen e rrjedhës së kënetës dhe shtimin e ujërave të saj, duke bërë që të braktisen disa pjesë të zonës më të ulët të vendbanimit. Në ndërtimin e objektit ka qenë mbajtur parasysh relievi i kodrës me përmbajtje ranore-argjilore, të përshkuar vende-vende nga breza të fortë shtufi.

Gërmimet arkeologjike filluan nga punonjësit e muzeut të qytetit në një terren të vështirë të zënë me shtëpi, pemë, gardhe e ferra dhe po vazhdojnë po

1) P. C. Sestieri, **Shkrime latine të Shqipnis** – Tiranë 1943 Nr. 25.
2) Për dy relievet shih Heuzey-Daumet – **Mission archéologique de Macédoine** – – Paris 1876 f. 384 Nr. 157.
3) Barleti – **Historia e Skënderbeut** – f. 482.
4) L. Rey – **Les remparts de Durrazzo** – «Albania» 1925 f. 39. fig. 18.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1 – Galeria Nr. 2 e sektorit «A».

ndërprerje për më se tre vjet me radhë. Nga muaji maj i vitit 1966 kur filluan gërmimet, e deri tani është zbuluar një pjesë e rëndësishme e amfiteatrit. Kjo ndodhet në perëndim nga ana e krahut më të madh e më të ruajtur të monumentit, që vjen prapa portës me hark të thyer të kullës «E» të kalasë dhe poshtë kështjellës. Zona e gërmuar përfshin një pjesë të kaveas pa murin kufizues të fasadës si dhe një pjesë të arenës afër murit para podiumit. (TAB I, 1)

Shkallarja (kavea) u gjet e zhveshur nga shkallët që shërbenin për t'u ulur spektatorët. Vetëm nga ana e sipërme e saj shihen disa rrypa shkalle (*cuneus* ose *scalaria*), që shkojnë në trajtë rreze drejt arenës. Këto shërbenin për të lehtësuar lëvizjen e shikuesve. Në syprinën e shkallares dallohen gjurmët e ndarjeve: podiumi, meniani i parë dhe i dytë, një *praecinctium* ose shesh i ngushtë kalues në mes të këtyre të dyve, si dhe portat e daljes nga galeritë për në shkallare (vomitoria). Tabani i syprinës përbëhet kudo nga një përzierje llaçi me gurë të vegjël më tepër gëlqerorë. Me të njejtin material mbushen edhe syprinat e harkuara ose soletat e ambienteve që ndodhen nën të. Për shkak të çveshjeve, tabani është holluar vende-vende dhe në disa pika është thyer. Këto çarje, nganjëherë të mëdha, kanë lënë të duken disa pjesë të ambienteve të nëndheshme, të cilat shërbenin për qarkullimin e brendshëm të spektatorëve d.m.th. nga fasada, në shkallaren e amfiteatrit dhe anasjelltas.

Ambientet që ndodhen nën shkallare përfundojnë sipër me harqe ose soleta llaçi me copa gurësh. Muret e tyre, të trashë 0,80 m-1 m., në dy faqet e dukshme janë veshur me breza prej 3-4 a më shumë rreshta tullash të puqura me llaç dhe të bashkërenditura me breza gurësh shkëmborë. (Fig. 1) Ky lloj muri, i quajtur *opus incertum*, është i vetmi që përdoret në pjesën e amfiteatrit të zbuluar deri tani.

Zonën e gërmuar nën tabanin e syprinës së shkallares, e cila është e gjerë nga perëndimi dhe më e ngushtë nga lindja sipas trajtës së monumentit, e kemi ndarë në sektorë që kufizohen secili anash nga dy shkallë të brendshme, të cilat zbresin si rreze drejt arenës.

Sektori A shtrihet midis shkallës 1 dhe 2. Sektori përfshin tri galeri që shkojnë paralel me elipsin e arenës dhe pesë ambiente të tamponuara:

Galeria e parë, më afër arenës, është më e lakuar dhe më e shkurtër se të tjerat (12,35 m.); ka pesë harqe që ndjekin njëri-tjetrin sipas drejtimit të saj. Nga krahu i fasadës së amfiteatrit, ajo zgjerohet me katër kamare ose xhepa, kurse nga ana e kundërt, komunikon me arenën me anë të një porte me hark. Kjo galeri që është më e ruajtura dhe më interesantja për larminë e ambienteve që lidhen me të, ka vetëm një dalje (*vomitorium*) me gjashtë këmbë shkallë, e cila të shpie në *podium*.

Galeria e dytë, e gjatë 15,10 m., e gjerë 2,10 m. dhe e lartë 4 m., mbaron sipër me një tavan gjysmë të harkuar që vjen duke zbritur nga drejtimi i arenës. Edhe kjo galeri është e kufizuar si të tjerat me mure të veshur me breza gurësh e tullash. Ajo ka dy dalje për në shkallare.

DO NOT COPY



Fig. 2 — Galeria Nr. 1 në sektorin «A».

Galeria e tretë ka mbetur pothuaj krejt e zbuluar, pasi një pjesë e madhe e tavanit është hequr. Ajo ka vetëm gjashtë shkallë prej tulle të një *vomitoriumi* që çonte në menianin e dytë të shkallares.

Shkalla Nr. 1 është e gjatë 9,55 m dhe ka tetë këmbë prej tullash dhe katërmbëdhjetë prej bloqesh guri gëlqeror. Shkalla nr. 2, e gjatë 5.90 m. përbëhet nga gjashtëmbëdhjetë këmbë, nga të cilat vetëm tri të fundit janë prej bloqesh guri.

Sektori B, më i ngushtë se i pari, ndodhet në mes të shkallëve nr. 1 dhe nr. 3. Ai përfshin një galerizë që ndodhet ngjitur me arenën, vijimin e galerisë së parë të sektorit A, (Fig. 2) dy ambiente të tamponuara me soletë sipër, të ndara në mes tyre nga një hark i madh dhe të ruajtura shumë mirë, si dhe disa kalime që shpinin në hyrjet e fasadës.

Sektori C vjen pas shkallës nr. 3 që është e gjatë 11,50 m. Në këtë sektor kemi zbuluar vetëm një ambient të mbyllur në formë trapezi (të gjatë 11,45 m.), baza e të cilit përbëhet nga relievi ranor i kodrës. Lartësia e soletës së ambientit nga kjo bazë i kalon të shtatë metrat.

Ambientet e përshkruara fare shkurtazi kanë dalë në dritë në tre sektorët e një zone që ndodhet, nën shkallaren e amfiteatrit. Në sipërfaqen e shkallares gërmimet janë shtyrë shumë nga veriu dhe përfshijnë një hapësirë prej gjashtë sektorësh duke ardhur deri në krahun e ngushtë verior të monumentit.

Gjetjet e imta të bëra gjatë gërmimit i përkasin kohës kur ka funksionuar amfiteatri dhe kur janë përdorur disa ambiente të *kave*-së pas braktisjes së tij. Në shtresa më të thella të depozituara mbi dyshemetë e ambienteve, u gjënden mbi 100 kandila vaji dore që shërbenin për t'u ndriçuar udhën spektatorëve në ambiente të errëta të *kave*-së, mjaft enë aretine e qelqi, shumë monedha bronxi perandorake romake dhe një mori fragmentesh të ndryshme. Në shtresat më të sipërme, në të gjithë zonën e gërmuar, u nxorën poçe të lyera me zmalt, enë dhe pjesë enësh të thjeshta dhe shumë monedha bronxi e argjendi që u përkasin perandorëve bizantinë. Përveç këtyre, në galerinë dhe kalimet e tjera të shkallares u zbuluan dhe materiale të rënda si kapitele, bazamente dhe pjesë shtyllash, një krah froni zbukuruar me figurën e kokës së një luani, i cili ka qenë vendosur në shkallët e gjëra të podiumit si dhe mjaft fragmente arkitekture.

Pas braktisjes së amfiteatrit për disa shekuj, e gjithë sipërfaqja e arenës, që është gërmuar deri tani, si dhe ajo e galerisë ngjitur me të, kanë qenë përdorur si varrezë. Kufomat, të vendosura përgjithësisht me kokë nga lindja dhe të zhveshura nga çdo stolisje, janë varrosur thjeshtë mbi disa copa tjegulla të përdorura si taban a jastëk, ose janë mbuluar me tjegulla katërkëndëshe të puqura sipër si kulm çatije apo të vendosura në trajtë arke.

Në varrezën e improvizuar janë futur persona të moshave dhe profesioneve të ndryshme. Varrimet në arenë kanë qenë ndërprerë përgjithësisht ndoshta nga një tërmet që ka shkaktuar ngjitjen e nivelit të ujit. Pas kësaj është ngritur një faltore e vogël ose kapelë mortore, dhe janë sajuar dy dhomëza-varr *(colombarium)*, që kanë zënë vend në dy kamaret e galerisë së parë.

Kapela është ndërtuar pas prishjes së pjesshme të *kamares* Nr. 4 dhe daljes për në arenë që ndodhet përballë (TAB I, 2). Muret e saj janë punuar me materialin e monumentit, por me një cilësi më të dobët sesa muret origjinalë. Të gjitha elementet kryesore që e përbëjnë kapelën: bema me altarin, naosi dhe narteksi; duke marrë parasysh gjatësinë e vogël të saj, janë shkrirë në një.

Në kohën e funksionimit faltorja ka qenë suvatuar nga jashtë dhe brënda dhe është zbukuruar me afreske dhe dy mozaikë murale të punuar me mjeshtëri, me gurë kubikë shumë ngjyrësh. Këta ndodhen në pjesën perëndimore të saj. Mozaiku i parë 1,63 m. i gjatë dhe 1,25 m. i lartë, i ruajtur mirë, është ndarë në dy fusha: e para paraqet shën Stefanin, të cilit i kushtohet kapela, ndërsa e dyta perandorin Aleksandër, rrethuar, sipas konceptit fetar, nga dy engjëj mbrojtës dhe nga dy oborrtarë (TAB. I, 3). Aleksandri, emri i të cilit lexohet në mbishkrimin që ndodhet në pjesën e sipërme të mozaikut, ka qenë i vetmi monark i Bizantit me këtë emër. Ai ishte i biri i Vasilit I Maqedonas (867-886), dhe vëllai i Leonit VI, pas vdekjes të së cilit qëndroi i vetëm në fron nga viti 912 deri në vitin 913. Nga kjo kuptojmë se kapela mortore ka qenë ndërtuar jo më vonë se në këto vite, gjë që vërtetohet dhe nga një monedhë bronxi e Janit I (969-976), që u gjet në skeletin e një varri të vendosur në qendër të konstruksionit. Mozaiku i dytë është më i madh se i pari (2,25 m. i gjërë 1,05 m. i lartë), por i dëmtuar rëndë. Ai paraqet midis të tjerave, në qendër, figurën e perandoreshës.

Sipas stilit dhe teknikës së punimit, këta mozaikë i përshtaten asaj periudhe lulëzimi të artit bizantin që lidhet, duke gjykuar nga qëndrimi dhe nga sytë e mëdhenj dhe ekspresive të figurave, me artin e shkollës së Selanikut.

Sheshi para dhe anash faltores në arenë ka vazhduar të përdoret si varrezë për disa shekuj me radhë, derisa shtresa më e sipërme e saj që paraqet një skenë masakri, ka mbuluar hapësirën rreth kapeles deri afër kubes së absidës, si dhe një pjesë të shkallares. Ndërkaq, me kalimin e kohës, vendi sipër varreve është përdorur gjatë pushtimit turk për banesa, mbeturinat e të cilave kanë ardhur duke u depozituar njëra mbi tjetrën deri në ndërtimin e shtëpijave më të reja, të ngritura këtu e pesëdhjetë vjet më parë.

*
* *

Gërmimet në amfiteatër na japin mundësi të sqarojmë disa çështje që lidhen me të, në radhë të parë atë të datimit.

Tipi i murit *opus incertum* që ndjek tërë konstruksionin, karakteri i monumentit dhe objektet e shumta (kandilat e vajit, enët aretine dhe monedhat, të gjetura në shtresat më të thella, na bëjnë të mendojmë se amfiteatri u ndërtua në fillim të shekullit II të erës sonë, ndoshta në kohën e perandorit Adrian, gjatë të cilit në Dyrrah u përfunduan dhe një sërë veprash të mëdha si ujësjellësi, etj. Kjo datë përkon dhe me kohën e mbishkrimit që bën fjalë për ngritjen e bibliotekës në qytet dhe për organizimin me këtë rast të lojrave gladiatore. Nga ana tjetër, depozitimi i shtresave të gurëve të rënë nga tavanet e ambienteve të shkallares, e sidomos i atyreve në galerinë e parë, tregon se godina u dëmtua mjaft nga tërmeti e sidomos nga ai i vitit 345. Sikurse e dëshmojnë disa përforcime dhe plotësime jo të vona në ambientet e tij, këto ngjarje duket se shkaktuan për një farë kohe pezullimin e shfaqjeve. Në vitet e para të shekullit VI, amfiteatri u braktis përfundimisht, pikërisht në kohën kur, me triumfin e krishtërimit, lojrat gladiatore u ndaluan dhe mbetën në fuqi vetëm venacionet.

Përveç termeteve, një dëm të madh i ka sjellë amfiteatrit dhe ndërtimi i mureve të kalasë që ndodhen pranë të cilat u ngritën në kohën e perandorit Anastas I dhe koinçiduan me braktisjen e monumentit. Në këtë kohë duket se u hoqën shkallët e sipërme dhe ambientet u mbushën pjesërisht me dheun e verdhë ranor që doli nga gërmimi për hapjen e themeleve të mureve dhe të hendekut të thellë mbrojtës para këtyre.

Pas braktisjes, monumenti u përdor gjatë shekujve për qëllime të ndryshme. Arena e tij, sikurse e pamë, u shndrrua në varrezë, u ngrit kapela bizantine, u ndërtua një furrë buke, u sajua një furrë për pjekjen e gëlqeres, etj.

Amfiteatri i Dyrrahit është monumenti më i madh i lashtësisë, për zbulimin e të cilit partia dhe pushteti kanë treguar dhe po tregojnë gjithnjë e më tepër kujdes të veçantë. Dalja në dritë e tij ka një rëndësi të madhe dokumentare. Një konstruksion i tillë me gjatësi mbi 150 m. dhe lartësi mbi 20 m. duket se i përshtatej famës së një qyteti të njohur si Dyrrahi. Për ta ngritur atë është dashur një mobilizim i madh forcash: projektues, ndërtues, skulptorë, dekoratorë, si dhe një grumbullim shumë i madh materialesh dhe mjetesh transporti. Është kjo arësyeja që ai mund të quhet si një tregues i mirë i dëndësisë së popullsisë. i fuqisë ekonomike dhe i nivelit kultural e artistik të qytetit të Dyrrahit.

POST COPY



1 — Pamje e amfiteatrit në gjendjen e sotme të gërmimeve.



2 — Faltorja bizantine.



3 — Mozaik shumë ngjyrshëm i shek. X, në faltoren bizantine.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

V. TOÇI

L'AMPHITHEATRE DE DYRRAH

RESUME

Une inscription gravée sur un mur de la citadelle de Durrës nous fournit indirectement des indications sur l'existence d'un amphithéâtre dans cette ville. Barletius également nous donne un clair témoignage de la présence de ce monument à son époque, mais avec le temps, celui-ci avait été enseveli, et il n'en apparaissait aucune trace jusqu'à récemment encore. Les fouilles archéologiques sur ce site ont été entreprises en mai 1966 et elles se poursuivent encore aujourd'hui. On a mis au jour jusqu'à présent une importante partie de l'amphithéâtre. La zone déblayée comprend une partie de la cavea sans le mur de la façade ainsi qu'une partie de l'arène proche du podium. La partie supérieure de la cavea mise au jour est dépouillée des gradins.

L'amphithéâtre est parcouru de trois galeries. La première, plus proche de l'arène, est plus sinueuse et plus courte que les autres (12,35 m.); du côté de la façade, elle s'élargit pour former quatre niches ou poches, alors que du côté opposé, elle communique avec l'arène par une porte à arc. La deuxième galerie, longue de 15,10 m. large de 2,10 m. et haute de 4 m. est surmontée d'un plafond arqué qui va s'abaissant en direction de l'arène. Cette galerie a deux accès sur la cavea. La troisième est pour ainsi dire demeurée complètement découverte, une bonne partie du plafond en ayant été enlevée. Elle ne comporte que six marches en briques d'un vomitoire qui conduisait à la deuxième travée de la cavea.

Les menues trouvailles faites au cours de fouilles appartiennent à l'époque où l'amphithéâtre remplissait sa fonction et à l'époque postérieure où, après son abandon, certaines parties de la cavea furent affectées à divers usages.

Après l'abandon de l'amphithéâtre, pendant plusieurs siècles, toute la superficie de l'arène fouillée jusqu'à présent, ainsi que celle des galeries qui y donnaient accès furent utilisées comme cimetière. Par la suite, sur cet emplacement, fut construite une chapelle mortuaire et on y aménagea deux caveaux funéraires (colombaria) qui ont trouvé place dans les deux niches de la première galerie. A l'intérieur, la chapelle est décorée de fresques et de deux mosaïques murales exécutées avec goût. L'une représente Saint Etienne à qui la chapelle est consacrée, et la seconde l'empereur Alexandre. Un seul monarque de ce nom ayant régné à Byzance de 912 à 913 de notre ère, la chapelle, selon toute vraisemblance, doit dater de cette époque.

Par leur style et leur technique d'exécution ces mosaïques semblent appartenir à l'école de Salonique.

Les fouilles effectuées jusqu'ici dans l'amphithéâtre permettent déjà d'élucider par anticipation certaines questions qui se rattachent principalement à la date de construction de ce monument.

Le type de mur «opus incertum», le caractère du monument et les nombreux objets trouvés dans les couches les plus profondes conduisent à la conclusion que l'amphithéâtre a été élevé au début du IIe siècle de notre ère, peut-être à l'époque de l'empereur Hadrien, sous le règne duquel toute une série de grands ouvrages furent construits à Durrës.

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

QYTETI I FORTIFIKUAR I BERATIT

Qyteti i Beratit gjëndet në buzë të fushës pjellore të Myzeqesë dhe në skajin perëndimor të luginës së Osumit në vendin ku lumi, duke çarë pengesën e fundit të zonës malore, krijon një grykë të ngushtë. I njohur si «kreu i Myzeqesë» [1]), qyteti administronte krahinën dhe kontrollonte kalimin për gjatë luginës së Osumit njëra nga rrugët kryesore që lidhte ultësirën bregdetare me zonën e brendshme malore.

Rrethimi i qytetit kurorëzon kodrën në të djathtë të Osumit, 187 m. të lartë nga niveli i lumit (fig. 1.). Kodra ka një reliev të përshtatshëm për mbrojtje: në jugë bie pothuajse thikë mbi Osumin, nga lindja dhe perëndimi ka një pjerrësi 40-45° dhe vetëm pjesa e veriut (fig. 2), ku gjëndet një qafë që e lidh me kodrën tjetër, paraqitet më e dobët për mbrojtje. Faktor pozitiv që ka ndikuar për ngulimin në këtë vend, është dhe përbërja e kodrës nga formacione të shtresëzuara guri gëlqeror, që gjënden në sipërfaqe dhe nxirren me lehtësi.

Muret rrethuese i janë përshtatur terrenit, kështu që planimetria e fortifikimit (TAB. I) ripërsërit formën e kodrës duke krijuar një trekëndësh të çrregullt me brinjë të lakuara; prej tyre lindorja ka 600 m. gjatësi, ndërsa veriperëndimorja dhe jugperëndimorja nga 400 m. Muret përforcohen prej 24 kullash me forma e përmasa të ndryshme, të shpërndara në mënyrë jo të njëllojtë sipas terrenit, dhe prej një oborri të fortifikuar (fig. 2) ku gjëndet hyrja kryesore. [2]) Rruga për një hyrje në mesjetë, siç duket nga gjurmë të shkëputura, përshkonte faqen veriperëndimore, duke ruajtur traditën e kalimit me anën e djathtë të pambuluar nga mbrojtësi. Veç hyrjes së mësipërme, për komunikimin me ambientin e jashtëm shërbenin dhe tri hyrje sekondare: në anën lindore, veriperëndimore dhe jugperëndimore. Paralel me murin rrethues në faqen veriperëndimore, gjënden dhe gjurmët e një muri skarpatë, 10 m. larg të parit. [3]) Në brendësinë e territorit të rrethuar që ka një sipërfaqe afro 10 ha., shtrihet lagja «Kala» me tipare arkitektonike të krijuara në shek. XVIII-XIX [4]) dhe një sërë monumentesh të tjerë. Në pjesën më të lartë të territorit gjëndet kështjella e përforcuar prej 5 kullash. Komunikimi i saj me ambientin e jashtëm kryhej nepërmjet hyrjes jugperëndimore, kurse me ambientin e brëndshëm nëpërmjet hyrjes perëndimore. Kështjella ndahet në dy pjesë me anë të një muri të përforcuar me dy kulla, prej të cilave pjesa e brendshme shërbente si seli për krerët. Veç ndërtimeve të mësipërme, në faqen jugore duken gjurmët e një sistemi muresh e kullash dhe të një galerie, që e bashkonin qytetin e sipërm me lumin, duke arritur

---

1) C. Hopf — **Chroniques Greco-Romanes, inédites ou peu connues,** Berlin, 1873 (gjeneallogjia e familjes Muzakaj) f. 275.

2) Sipas Çelebiut **(«Shqipnia para dy shekujsh»,** Tiranë, 1930, f. 55) hyrja përbëhej nga tre porta 100 hapa larg nga njëra tjetra; kjo të bën të mendosh se kish një paraoborr, që vërtetohet nga disa gjurmë muresh, Pukëvil **(Voyage de la Grece,** Paris, 1820, Vol. I. f. 299) vë në dukje se njëra prej portave ka qënë portëurë. Në bazë të gjurmëve, mendojmë se e tillë ka qenë porta e jashtme e kullës së hyrjes.

3) Muri që ka një lartësi rreth 2,5 m. duhet të jetë ndërtuar për evitimin e shkarjes së murit rrethues dhe si pengesë e parë për sulmuesit; vetëm në afërsi të hyrjes veriore muri ngrihej në lartësi duke krijuar paraoborrin. H. F. Tozer **(Researches in the Highlands of Turkey,** London, 1869, Vol. I ,f. 218) vë në dukje se «kalaja është e mbrojtur nga dy rradhë muresh tani të rrënuar». Relacioni anonim i 1570, Çelebiu, Liku, Pukëvili që janë më të hershëm, nuk përmëndin qënjen e një muri të dytë. Me sa duket Tozer do të jetë ngatërruar nga gjurmët e murit të mësipërm.

4) G. Strazimiri — «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», **Disa tipare të arkitekturës së Beratit,** f. 556-557.



Fig. 1

kështu terreni i rrethuar një sipërfaqe prej 16 ha.

Megjithëse fortifikimi i qytetit ka tërhequr vëmëndjen e udhëtarëve e studionjësve, deri më sot me studimin e tij të hollësishëm nuk është marrë askush, por vetëm se është prekur shkarazi nga Pukëvil, Lik, Aleksudhis, Tozer, Rei, G. Strazimiri, etj. I vetmi studim arkeologjik i përket Prashnikerit, por dhe ky kufizohet me një përshkrim dhe analizë të shkurtër të një pjese të substruksioneve ilire, duke mos i prekur ndërtimet e mëvonshme që zënë volumin kryesor. Mungesa e një punimi më të plotë dhe vlera që ka monumenti, qenë arësyet që i hymë këtij studimi i cili është një sprovë për ta parë problemin në një plan më të gjërë historiko-arkeologjik, por jo një studim rrënjësor, që nuk mund të mendohet pa gërmimet përkatëse dhe një punë intensive disavjeçare.

Për shkak të periudhës së gjatë të ekzistencës dhe përdorimit të vazhdueshëm për mbrojtje, rrethimi paraqet një përzierje të çrregullt duarsh të ndryshme, të cilat jemi munduar t'i veçojmë për të kryer rikonstruksionin e rrethimit për periudhat përkatëse. Kjo do të vinte në dukje rolin e qytetit në kohë dhe do ndihmonte për vënjen e projektit të restaurimit mbi baza shkencore. Periudhat e ndërtimit i kemi grupuar në këtë mënyrë:

I. Periudha Ilire;
II. » Bizantine;
III. » e principatave feudale shqiptare;
IV. Periudha e hershme e pushtimit turk;
V. » e pashallëkeve të mëdha.

I. – Periudha Ilire

Ndërtimet e para që i përkasin periudhës ilire janë disa fragmente muresh e kullash prej bloqesh guri me gjatësi 60-250 cm., lartësi 40-50 cm. dhe gjërësi 50--60 cm.; shumica prej tyre ka formë të rregullt kuadratike dhe vetëm nji pakicë formë trapezoidale. Bloqet janë punuar në pesë faqe e ndahen: në bloqe gëlqerori me pjesën e jashtme punuar vrazhdë me konveksitet rreth 10 cm. dhe bloqe konglomerati me faqe të drejta. – Ndërsa bloqet prej gëlqerori janë të shumtë dhe gjenden kudo (fig. 3, 4, Tab. II, 2), ato prej konglomerati janë mjaft të pakët dhe i hasim vetëm në pjesën e hyrjes, të vendosura mbi bloqet prej gëlqerori (ana e djathtë fig. 4 Tab. II, 2). Ky fakt dhe, ndryshimi në teknikën e punimit na shpien në përfundimin se këtu kemi të bëjmë me një fazë të dytë ndërtimi, që kufizohet me meremetimin e pjesshëm të hyrjes, e cila ka qënë më e ekspozuar ndaj goditjeve. Bloqet janë vendosur në të thatë në rreshta horizontalë, me puthitje të përsosur dhe vetëm rrallë është përdorur shkallëzimi.

DO NOT COPY

Traktet e ruajtura të këtyre mureve na japin mundësi të rikonstruktojmë në një farë mase planimetrinë antike dhe sistemet e mbrojtjes (Tab II 1). Nga fragmentet «in situ», të përmendura prej Prashnikerit [5]), duken vetëm fragmentet në pjesën e hyrjes, ndërsa ato në murin lindor ndofta janë mbuluar nga mbeturinat e hedhura prej mureve. Veç tyre, gjatë punimeve të pastrimit, të ndërmarra në vitin 1967 prej Institutit të Monumenteve të Kulturës, në faqen veriperëndimore u zbuluan dy fragmente muresh dhe kullash, ndërsa në faqen jugore vumë re një fragment me bloqe të ripërdorura, por të marra në afërsi, gjë që kuptohet nga riputhitja e kllapave. Siç shihet nga planimetria, të tre brinjët e trekëndëshit mbyllen, rrjedhimisht hipoteza e Prashnikerit se «muret mesjetare me sa duket ndjekin konturin antik» [6]), është e drejtë. Po kështu, nga gdhëndja e shkëmbit para faqes perëndimore dhe ripërdorimi i bloqeve antike në kullat e kështjellës, na vërtetohet dhe qënja e Akropolit, por konturet e tij nuk përcaktohen dot për shkak të kuotës së lartë të rrënimeve dhe dherave të hedhur.

Më qartë ndërtimet antike duken në afërsi të hyrjes



Fig. 2

5) C. Praschniker – A. Schober – **Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien, 1919, f. 61.

6) Po aty f. 61.

DO NOT COPY



Fig. 3

kryesore (fig. 4). Fragmenti majtas saj, i ruajtur në 9 m. gjatësi, ndryshon nga një në tre rreshta dhe formon një kënd 20° me pjesën ballore të hyrjes, ndërsa fragmenti djathtas, i ruajtur në 5 m., formon një kënd 40°. Vetë hyrja (Tab. II, 2) ka një gjerësi 9,8 metrash. Në brendësi të saj muri antik ngrihet në 2 deri 4 rreshta lartësi, duke na dhënë mundësinë të rikonstruktojmë planimetrinë. Siç e vë në dukje Prashnikeri [7]), hyrja ndahej në dy pjesë: një korridor i parë për zvogëlimin e numrit të sulmuesve dhe një korridor i dytë i pajisur me dy porta; qënja e portës së parë vërtetohet nga dy bloqe bazamente në pjesën e mesit dhe nga gdhëndja e bloqeve mbi ta për vendosjen e kasës së portës, ndërsa qënja e portës së dytë vërtetohet nga gjurmët e pilastrës së djathtë në dalje: dy bloqe mbi njeri-tjetrin të pajisur me vijë peshimi. Nuk jemi të një mendimi me Prashnikerin se porta e tretë, në hyrje, është mesjetare, mendojmë se ajo i përket kohës antike, kur u krye riparimi i hyrjes. Në sondazhin që bëmë në faqen e djathtë të jashtme të kullës së sotme, zbuluam se edhe këtu muri i mëvonshëm ngrihet mbi substruksionin antik, gjë e cila vërtetoi se kemi të bëjmë me një kullë hyrje. Në murin B *) (fig. 3), fragmenti i ruajtur, që ndryshon nga dy në pesë rreshta lartësi, përfundon në kullën «3». Kjo e fundit ka formë katërkëndshe dhe ruan gjurmë të faqeve anësore, prej të cilave faqja e majtë që ruhet në 8 rreshta arrin një lartësi 5 m. nga bazamenti i kullës. Largësia midis këtyre dy faqeve 7,5 m. na jep gjerësinë e kullës së kësaj kohe, ndofta standarte nga që një pjesë e mirë e kullave të mëvonshme, për të cilat dyshojmë se janë ngritur mbi antiket, kanë po këtë gjërësi. Para një pjese të kullave, në këtë anë, duken gjurmë tarracimi në formë shkallëzimi prej bloqesh kuadratike, punuar pa kujdes, që shërbejnë për mënjanimin e shkarjes.

Nga ana tipologjike Prashnikeri (i cili nuk përmend qënjen e dy teknikave të ndryshme), muret antikë të Beratit i krahason me muret e Lisit dhe të Zgërdheshit. [8]) Ne fazën e I e shohim të ngjashme me muret e Lisit IIIa [9]), me një pjesë të mureve të Butrintit [10]) dhe

7) **Po aty,** f. 61.

*) Për lehtësi orientimi kullat do t'i shënojmë me numra duke marrë si fillim kullën veriore dhe duke lëvizur në të kundërt të akrepave të sahatit, ndërsa muret me gërma kapitale.

8) C. Praschniker — A. Schober, **Vep. e cit.,** f. 61.

9) F. Prendi — K. Zheku. **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike** (Në po këtë botim).

10) L. M. Ugolini — **Albania antica. L'Acropoli di Butrinto,** Roma, 1937.

DO NOT COPY

me muret e qytezës së shën Iliut në Elbasan [11]), ndërtime të datuara nga fundi i shek. IV; ndërsa fazën II të ngjashme me fazën II të mureve të Zgërdheshit, të datuara në fundin e shek. IV dhe fillimin e shek. III. [12])

I pari, Liku, i pasuar nga Batifoli, Prashnikeri, Tomasheku [13]) etj., ka shprehur mendimin, me të cilin bashkohemi edhe ne, se Berati i sotëm është Antipatrea e përmendur në ngjarjet e vitit 216 nga Polibi [14]) dhe të vitit 200 nga Tit Livi [15]). Sipërfaqja e madhe prej

nga mbeturinat e keramikës «pseudoterrasigillata» që datohet në shek. I.

II. Periudha Bizantine

Në periudhën bizantine emrin e qytetit e rigjejmë në listën e fortifikimeve të ndërtuara prej Justinianit, por të deformuar nga Prokopi i Qezaresë në trajtën



Fig. 4

10 ha, qënja e një suaze fortifikatash rreth e qark, pozita qendrore dhe dallimi që i bën Livi nga qendrat e tjera përreth, duke e quajtur qytet, dëshmojnë se Antipatrea ka qenë një qendër e rëndësishme jetike.

Gjatë periudhës së pushtimit romak Antipatrea bie në heshtje, megjithëse ekzistenca e jetës dëshmohet

«Antipagrai». [16]) Shuflai, duke u mbështetur te Jeliç, e identifikon Antipagrain me Antipatrean [17]). Afërsia më e madhe Antipagrai – Antipatrea, domosdoshmëria e fortifikimit të kësaj pike nevralgjike për kontrollin e rrugës së Osumit dhe pohimi i Prokopit se kemi të bëjmë me një rindërtim, na shpien në përfundimin

11) N. Ceka – **Materiale të sesionit arkeologjik,** Tiranë, 1968; gjurmime arkeologjike në krahinën e Elbasanit, f. 110-111.
12) S. Islami – **Monumentet Nr. 1.** Qyteti Ilir në Zgërdhesh.
13) W. M. Leake – **Travels in Northern Greece,** London, 1835, f. 361. B. Battifol – **Les manuscrits grecs de Berat d'Albanie et les codex purpurens,** Paris, 1886, f. 7. C .Praschniker – A. Schober – **Vep. cit.,** f. 62. Tomashek-Pauly-Wissowa – **Real Encyclopädie der classischen altertumswissenschaft,** Stuttgart 1894-1898 s.v. Antipatrea.
14) Polyb V, 108, 2.
15) Livi XXXI 27,2. . .
16) Proc. **De aed.** lib. IV.
17) M. Šufflay – **Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des mittelalters.** Wien und Leipzig 1924, f. 24

DO NOT COPY

se Antipagrai është Antipatrea. Pas Prokopit qyteti identifikohet me Pulheriopolisin e përmendur në shek. VI, ndofta në mënyrë të deformuar nga Hierokli [18]) dhe në të IX nga Porfirogjeneti. [19]) Për herë të parë këtë tezë e gjejmë te Farlati, i cili citon Veselingun [20]). Sipas tij, qyteti mund të jetë ndërtuar nga Pulheria, motra e Teodosit II, hipotezë që Rikaqis [21]) mundohet ta vërtetojë duke cituar pa baza Sozomenin. Nuk na duket e pranueshme dhe teza tjetër, e Shuflait, se emri i Pulheriopolisit vjen nga deformimi i Bulgaropolisit [22]), nga që qyteti përmendet që në shek. VI, para se bullgarët të shtriheshin në këto treva. Me sa dimë, në kohën e Teodosit në Epir, nuk u ndërmorën punime fortifikimi; kjo dhe fakti se qyteti përmendet në listën e rindërtimeve të Justinianit me emrin e parë, na shpien në përfundimin se emrin Pulheriopolis, qyteti e mori më vonë.

Gjurmët e periudhës së hershme bizantine në gjendjen e sotme nuk i përcaktojmë dot. Ndërtimet e mëvonshme përfaqësohen nga një muraturë e çrregullt, me gurë gëlqerorë të papunuar, që për nivelim, lidhje dhe ruajtje nga uljet e çrregullta, përshkohet prej brezash tulle. Këto ndërtime i përkasin katër fazave të ndryshme, të cilat mund t'i ndajmë në kullat «7», «9», «23» dhe në muret e kullat e kështjellës.

Kulla «7» (Tab. III, 4) ka formë prizmi pesëkëndësh dhe është e ndërtuar me një muraturë me gurë të vegjël, që përshkohet prej një brezi katër rreshtash tulle *).

Kulla «9» (Tab. III, 1) është një kullë e fuqishme katërkëndëshe, e ndërtuar në pjesën e poshtme me bloqe antike të ripërdorura, ndërsa në pjesën tjetër me gurë mesatarë e të vegjël, të lidhur me një llaç të hirtë, stukuar në fugat me llaç shamot. Kulla përshkohet nga 3 breza pesë rreshtash tulle.

Kulla «23» prej kësaj periudhe ruan gjysmën veriore. Në faqet e ruajtura ka një muraturë prej gurësh të vegjël, që përshkohet vetëm në sipërfaqe dhe jo në thellësi nga dy breza me pesë rreshta tullash, në të cilët tullat e brezit të parë ndryshojnë në përmasa nga ato të brezit të dytë. Kulla është e zbrazët dhe ka përmasa të brendshme 4,3 x 3,9 m. Në lartësinë 1 m. në faqen e saj të brendshme duken gjurmë trarësh, që dëshmojnë se kullat e kësaj periudhe ishin të ndara prej dyshemesh druri në kate, që përdoreshin për ambiente të ndryshme.

Faza e katërt përfaqësohet nga muri rrethues i kështjellës; rreth 500 m. i gjatë, që përforcohet nga 3 kulla: «1a» (Tab. III, 2) dhe «3a» 6 dhe 7 këndëshe në anën e brendshme dhe kulla «12» me formë katërkëndëshe, gjysmë e rindërtuar, në anën e jashtme. Rrethimi paraqet një ndërtim unik të meremetuar më vonë; me sa mund të gjykojmë nga pjesët e ruajtura, lartësia minimale e mureve të tij ka qenë 8 m., ndërsa e kullave 12 m. Muratura e kështjellës prej bloqesh antike të ripërdorura në pjesën e poshtme të kullave dhe prej gurësh të vegjël e mesatarë në pjesët e tjera, përshkohet në sipërfaqe prej brezash tulle: në kullat dy breza, ndërsa në muret një. Në disa vende gurët rrethohen prej kornizash me tulla ose tjegulla, duke të dhënë përshtypjen e një «cloisonnage» primitive, karakteristikë për ndërtimet pas shek. IX. Komunikimi i kështjellës me pjesën e brendshme, sipas Çelebiut [23]), kryhej me anën e një porte që ndodhej në lindje. Veç asaj, në kullën «3a» gjendet një portë e vogël shërbimi.

Mendojmë se ndërtimet e mësipërme i përkasin periudhës pas shek. IX. Këtë e provojmë me largësinë e madhe dhe të parregullt midis brezave, me numrin e ndryshëm të rreshtave në po të njejtën kullë dhe me mospërshkimin e tërë trashësisë së murit prej brezit të tullës, karakteristika këto për periudhën pas shek. IX, kur teknika «opus mixtum» fillon të humbasë rregullsinë. Ngjarjet e njohura, që na lejojnë një farë supozimi për ndërtime në këtë periudhë janë: marrja e qytetit nga bullgarët në gjysmën e parë të shek. IX, që vërtetohet nga letra e Papës Joan XIII dërguar Borisit mbretit të bullgarëve, në të cilën qyteti del si seli peshkopale dhe përmendet për herë të parë me

18) Hierocl. 8-XIII... 6 — Polyheriupolis.

19) Porphyrog. De themat. ox. Tema IX... Pulheriopolis.

20) D. Farlati — **Illyricum Sacrum** — Jacopo Coleti — Venetiae 1817, vol. VII, f. 436.

21) R. Rikaqis — **Istoriqi arheilogiqi qe laografiqi pragmateai ten tematon Beration.** Athene, 1911, f. 6.

22) M. Šufflay — **vep. cit.,** f. 32.

*) Për ndërtimet me «muraturë të përzier» shih tabelën përmbledhëse 1.

23) E. Çelebiu, **Vep. cit.,** f. 56.

DO NOT COPY



Fig. 5

emrin Belegrad [24]); si dhe rritja e rolit social të qytetit në gjysmën e parë të shek. XI [25]).

Në fillim të shek. XIII rrethimi rimëkëmbet prej Mihal Komnenit. Kjo vërtetohet nga monogrami i tij në murin verior të oborrit të fortifikuar (Fig. 5). E një kohe me këtë pjesë të murit, është edhe kulla «1» (Tab III, 3; fig. 3) dhe një pjesë e mirë e mureve dhe e kullave të tjera.

Nga ana strukturale muri i kullës përbëhet, nga dy këmishë prej bloqesh antike të ripërdorura, midis të cilave është derdhur mbushja prej llaçi e gurësh me përmasa të ndryshme. Bloqet janë vendosur me faqen e puthitjes nga ana e jashtme, kështu që rreshtat kanë njëfarë horizontaliteti dhe muret një sipërfaqe të rrafshtë. Bloqet nuk puqen mirë anash me njeritjetrin dhe krijojnë boshllëqe deri 20 cm., të mbushur me copa tullash e rrallë tjegullash. Lidhja e tyre është kryer me llaç të dobët, me gëlqere të pashuar mirë, përzier me zhavor lumi. Për ruajtje dhe hidrolizim, fugat janë stukuar me llaç shamot. Kulla përshkohet prej 3 brezash me pesë rreshta tulle; të cilët nuk kalojnë në tërë masën e murit, por gjenden vetëm në sipërfaqe. Rreshtat ndërmjetës në brezat janë të tërhequr në thellësi dhe të mbuluar me llaç. Kështu që, në shikimin e parë, të japin përshtypjen sikur brezi përbëhet prej 3 rreshtash (shih tab. 1); teknikë që datohet në shek. XII [26]). Rrjedhimisht mendimi i Leon Reit se këto ndërtime janë të periudhës së hershme bizantine [27]) nuk është i drejtë. Kulla lidhet me murin «A» të ruajtur në lartësinë maksimale 10 m. Muri është ndërtuar me të njejtën teknikë si kullat me ndryshimin, që rreshtat e humbasin krejtësisht horizontalitetin dhe brezat e tullës ndërpriten 1 m. pas kullës.

Si kuptohet dhe nga gjurmët e shumta, Mihal Komneni i bëri një rindërtim të madh rrethimit, kështu që ngjarjet e mëvonshme, në të cilat duhet të jenë kryer luftimet: si pushtimi prej bullgarëve më 1230 [28]), pushtimi prej anzhuinëve më 1271 [29]), si dhe rimarrja prej bizantinëve, duhet të jenë reflektuar nëpërmjet meremetimeve të pjesshme.

24) **Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia** — Vindobona (më tej A. Alb.) 1913, vol. I, dok. 55, viti 878, 16 prill.

25) Kjo evidencohet nga kryesimi i parisë vëndase gjatë dorëzimit të kurorës perandorit bizantin, Vasilit II, prej të parit të Belgradit (G. Cedrenos. **Joanis Scylitzae** — — Bonnae 1838 f. 476) dhe nga diploma e Vasilit II kryepeshkopit të Ohrit ku Beligradit i jepen nën vartësi peshkopale Gradeci, Omca, Glaventina e numri më i madh i parikëve (I. Ivanov, **Bëllgarski Starine iz mekodoni** v. 1019, f. 550-555).

26) A. M. Schneider — W. Karnaap. **Istambuler Forschungen, Byzanz,** Berlin 1936, f. 13.

27) L. Rey — **Guide d'Albanie,** 1930, f. 102.

28) **Historia e Shqipërisë,** Tiranë 1959, vol. I, f. 199.

29) K. Roth — **Geschichte Albaniens,** Leipzig 1914, f. 45.

Rreth viteve 80 të shek. XIII, në saje të planeve të anzhuinëve për të hyrë në thellësi të Ballkanit, qyteti fiton një rëndësi të dorës së parë. Kjo kuptohet lehtë nga rëndësia që i japin bizantinët [30]) dhe anzhuinët [31]) marrjes së qytetit. Nga përshkrimi i Pahymeresit kuptojmë se qyteti në këtë kohë ishte bashkuar me lumin nëpërmjet një ledhi dheu, ndofta të pajisur me palisadë [32]). Veç kësaj, në vitin 1280, përmendet për herë të parë Varoshi [33]), por ai nuk gjëndet në anën jugore, si mendon Shuflai [34]), por në veriperëndimoren, jashtë rrethimit të qytetit. Arrimë në këtë përfundim duke u mbështetur në gjurmë ndërtimesh, që i përkasin mesjetës së mesme dhe në faktin se, ndërsa në përshkrimin e Pahymeresit vihet në dukje se ana jugore ka qenë vazhdimisht në duart e bizantinëve [35]), në letrën e tij Karli Anzhu falënderon mëkëmbësin për marrjen e Varoshit [36]). Zhvillimi i Varoshit mendojmë se është rrjedhim i rritjes së madhe të popullsisë me banorët e Durrësit, shumica e të cilëve, siç del nga dokumentat anzhuine, pas tërmetit të vitit 1276 u shpërngulën për në Berat [37]).

III. **Periudha e principatave feodale shqiptare**

Faza e tretë e ndërtimit i përket periudhës së principatave feudale shqiptare. Arësyet që na shpien në këtë përfundim janë: qënja e ndërtimeve të mëdha që kufizohen midis ndërtimeve të vona bizantine dhe të hershme turke; mungesa e ngjarjeve me rëndësi për një rindërtim kapital në intervalin 1280 – fillimi i shek. XIV dhe rëndësia që fiton qyteti në shek. XIV kur kthehet në pronë dhe qendër të familjes së Muzakajve [38]).

Siç shihet nga planimetria (Tab. IV), në këtë periudhë u rindërtuan pothuajse të gjitha muret, u ndërtuan një sërë kullash; u bë rrethimi i selisë në brendësi të kështjellës dhe muret e bashkimit të rrethimit të sipërm me lumin.

Pas ndërtimit të parë të periudhës ilire, ky është ndërtimi më i madh, që dëshmon se gjatë periudhës së principatave feudale shqiptare kemi një rritje të rolit të qyteteve, të cilët marrin tiparet e plota të qytetit mesjetar.

Ndërtimet e mësipërme janë kryer me një muraturë të «derdhur»: midis dy pareteve prej gurësh të vegjël të papunuar dhe coprash tjegulle lidhur me llaç gëlqereje (Tab. IV, 1), teknikë që hasim në kishat në brendësi të rrethimit, të datuara në shek. XIII-XIV, është hedhur një përzierje çakëlli dhe gurësh me llaç. Muratura për forcimin dhe për shpërndarjen e ngarkesave e të goditjeve, përshkohet nga një rrjetë trarësh horizontalë. Rrjeta përbëhet prej trarëve gjatësorë me seksion 14 x 14 cm., të vendosur në breza tre trarësh çdo 70 cm. lartësi, që ndërlidhen me anë kllapash me trarët transversalë.

Muret kanë trashësi rreth 1,70 m. dhe ndahen në trapin e kalimit 90 cm. dhe në parapetin 80 cm. të pajisur me bedena 100 cm. të gjerë. Kullat kanë formë katërkëndëshe, me përmasa bazë rreth 5 x 7 m. dhe,

30) G. Pachymeres. **De Michaele et Andronico Paleologis,** VI. 32. Fama e këtyre me shpejtësi të rrufeshme arriti gjer në veshët e perandorit të cilit ja turbulloi mendjen dhe e bëri të tronditet për gjithshka.

31) A. Alb. Nr. 41; 414-427; 438; 440; 441; 443; 448-451. Veç korrespondencës së botuar, autorët vënë në dukje (431c) se «Karli rrethimin e Beratit e kishte për zemër, siç duket nga mjaft diploma që nuk po botohen, po ruhen për një botim tjetër».

32) G. Pachymeres VI, 32. (Anzhuinët) u lëshuan së pari kundër Belagradit me qëllim që ta pushtonin. Kjo kështjellë që ka përpara lumin e quajtur Asum... ndodhet e varur mbi një kodër nën të cilën rrjedh lumi. Prej këndej, të siguruar me anë të një pende dheu të ndërtuar nga jashtë, me qëllim që të mos pengoheshin nga sulmuesit, të cilët do të qëndronin si pengesë, marrin ujë dhe pinë çdo ditë nga lumi. Dhe lumi ishte aq afër kështjellës sa që në pikshikimin më të afërt t'i sprapsin me sarisa (ushta të gjata) ata që pengonin, kështu që ata që lëshoheshin drejt lumit, përdornin mburojat si mbulesë... Vendosën pra të dërgonin ata që do të provonin të furnizonin me ushqime të rrethuarit që vuanin nga uria. Për këtë mendohej se do t'i ndihmonte shumë dhe lumi që rridhte pranë kështjellës, sepse atë pendën prej dheu, të ngritur për nevojë të ujit do t'a përdornin për të shpënë, me siguri, ngarkesat e caktuara në kështjellë.

33) **A. Alb.** 441, 1280, 6. XI (Suburbia Castri Bellogradi).

34) Sufflay, **Städte und Burgen...,** f. 32; Serbët e Shqiptarët – Tiranë 1926, f. 37.

35) Shih shënimin 32.

36) Shih shënimin 33.

37) **A. Alb.** 380. 10 Mars 1278.

38) C. Hopf. **Vep.cit.,** f. 280. Zoti Andrea Muzaka posedonte dhe zotëronte qytetet e mëposhtme. Qytetin e Beratit; A. Gegaj – **L'Albanie et l'invasion turque au XV-e siècle,** Paris 1937, f. 25. Andrea Muzakaj i pari i njohur nga familja Muzakajve (1280-1319) ishte zotërues i Beratit; **A. Alb.** 309, 445, 648. C. Hopf, po aty... në vitin 1402 Berati ishte pronë e Teodorit II Muzaka.

PDF TO COPY

siç kuptohet, nga ngushtimi i seksionit të murit në një lartësi 6 m. nga baza dhe gjurmë të tjera kanë qenë ndarë me dysheme dërrase në tre kate. Në kullën «3» (Tab II, 1) (fig. 14) që ruhet deri në gjysmën e katit II, në 10 m. lartësi, gjenden dy frengji për arbaleta që fillojnë me seksion gjysmë rrethor me diametër 100 cm. dhe përfundojnë me seksion katërkëndësh 100 x 20 cm.

Në murin e rrethimit gjendet një kullë e brendshme e mbuluar prej dheu, e cila në anën e jashtme ka një portë (Tab IV, 2), 2,20 m të gjerë dhe 2,60 m të lartë, për komunikimin drejtpërdrejtë të kështjellës me ambientin e jashtëm. Porta mbulohet nga një hark i ulët prej tullash me përmasa 50 x 25 x 5 cm. lidhur me llaç shamot, mbi të cilin gjendet një hark karakteristik për ndërtimet e shek. XIV me fushën të zbukuruar me dekor «cloisennage». Këtë lloj harku dhe dekori e hasim dhe në ambientin nëntokësor brenda rrethimit të selisë.

Rrethimi i selisë gjendet brenda kështjellës dhe shfrytëzon një pjesë të murit jugor dhe lindor të saj. Rrethimi përforcohet në anën veriore prej dy kullash (Tab V, 3) njëra pesëkëndëshe dhe tjetra e përbërë prej dy kullash drejtkëndëshe prej të cilave kulla verilindore lidhet me murin lindor të kështjellës, ndërsa kulla juglindore shërbente si kullë hyrje. Në pjesën e saj të përparme gjendet porta 1,80 m. e gjerë, me formë katërkëndëshe, që mbulohej me një arkitra prej trarësh 14 x 14 cm. Ngarkesa e mureve mbi portën shkarkohet anash, me anë të një harku të përzgjatur prej tullash të ngjashëm me harqet e kishave të shek. XIII-XIV.

Kësaj periudhe i përkasin dhe muret e bashkimit të rrethimit të sipërm me lumin, pasi në betejën e vitit 1280 bëhet fjalë vetëm për një ledh dheu dhe jo për mure [39]). Gjurmët e këtij bashkimi i shohim në anën lindore të faqes jugore: një copë muri nën kreshtën shkëmbore dhe një kullë në lumë (Tab. V, 2), e cila në pjesën e poshtme ka formë katërkëndëshe dhe një shkallë që shërbente si vend për akostimin e barkave.

Po kështu, në anën perëndimore duken gjurmët e një muri midis kullave mbi lumë dhe portës jugore, një fragment muri në buzë të rrugës dhe një kullë e rrënuar në lumë. Në këtë faqe gjendet dhe kisha e shën Mëhillit që datohet po e shekujve XIII-XIV dhe që vërteton shtrirjen e qytetit në këtë pjesë.

IV. **Periudha e hershme e sundimit turk.**

Berati u muar nga turqit në befasi, në qershor të 1417 [40]). Kështu që fortifikimi i posa rindërtuar prej Muzakajve nuk pësoi dëmtime, rrjedhimisht në të nuk u kryen punime të reja. Ndërtimet e periudhës së pushtimit turk, mendojmë se i përkasin kohës pas rrethimit të qytetit prej Skënderbeut, gjatë të cilit muret u dëmtuan nga bombardimet. [41]) I datojmë në këtë kohë pasi i gjejmë mbi ndërtimet e periudhës së principatave dhe kanë ngjashmëri me ndërtimet e tjera të kësaj periudhe nga që përmenden prej Çelebiut në vitin 1670 [42]) dhe se pas shek. XV ndërtimet mbrojtëse lihen pas dore. [43])

Muratura e kësaj kohe është e ngjashme me atë të periudhës së principatave feudale dhe ndryshon prej saj vetëm nga mungesa e copave të tjegullave. Veç pjesëve të meremetuara të mureve, kësaj kohe i përkasin kullat «13» dhe «15»; galeria që bashkon kullën «13» me lumin, muri skarpatë i faqes veriperëndimore dhe porta lindore. Kulla «13» (fig. 6) ka një muraturë të çrregullt, me gurë të vegjël të niveluar në lartësinë ku duken gjurmët e rrumbullakta të skelave, me një rresht pllakash 10 cm. Në qoshe të kullës gjendet një portë, që shërbente për lidhjen e galerisë me ambientin e brendshëm (e njëjtë me portën lindore), e mbuluar nga një hark guri paksa i thelluar, që haset në ndërtimet e periudhës së sundimit turk. Galeria (fig. 7) përbëhet prej dy muresh me trashësi 70 cm. që mbështeten njeri në kullën «13», tjetri në murin përbrinjë. Në pjesën e brendëshme galeria ka një gjerësi 120 cm. dhe është e pajisur me shkallë të gurta, (sipas Çelebiut 1600 [44]) dhe frengji të ngushta. Galeria mbulohet prej një sistemi qemeresh të shkallëzuar, në përshtatje me terrenin dhe në pjesën e sipërme duhet të ketë qenë pajisur me bedenë.

39) Shih shënimin 32.

40) N. Jorga. **«Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au XVe siècle;** seconde série, Paris 1899, f. 160-161.

41) M. Barleti — **Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut,** Tiranë 1967, f. 322.

42) E. Çetebiu. **Vep. cit** 55-59.

43) **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** Tiranë 1962, Vol. II, Relacion anonim mbi Shqipërinë. Starine V. XII, f. 193-200. E. Çelebi, **Vep.cit.,** f. 55, **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** Tiranë 1962, vol. III. A. Q. H. Sherija e Beratit, dosja B, lib. 42.

44) E. Çelebiu. **Vep. cit.,** f. 57.

FOTO-PDF



Fig. 6



Fig. 7

V. Periudha e pashallëkeve të mëdha.

Lulëzimi i fundit i fortifikimit i përket periudhës së pashallëkeve në shek. XVIII. Kjo faktohet nga kronika e Kostandin Beratasit, nga e cila mësojmë se Ahmet Kurt Pasha e rindërton kalanë më 1768, duke vënë të punojnë mbi 5 muaj 450 ustallarë [45]), dhe nga shkrimet e Likut, i cili vë në dukje rindërtimin e saj prej Ali Pashës dhe ngritjen e kalasë së vogël të Biftës në kodrën verilindore [46]), që sot është zhdukur.

Teknika e ndërtimit e kësaj periudhe në muret dallohet me vështirësi nga ato të periudhës së sundimit turk; ndërsa në kullat del në pah më qartë. Këto të fundit janë ndërtuar prej gurësh të vegjël gjysmë të punuar, ndërsa në qoshet gurët janë të latuar me kujdes, veç kësaj, brezat transversale kanë përmasa mjaft të vogla, rreth 4 x 6 cm., dhe mbërthehen me gozhdë kovaçi.

Veç rindërtimeve, kësaj kohe i përkasin kullat «10», «14», «2b», të cilat gjënden në faqen jugore, në pikat mbizotëruese që kontrollojnë rrugën përgjatë luginës. Vendosja e tyre dhe përshtatja e kullave të vjetra për artileri është kryer duke llogaritur mbulimin e çdo zone me zjarr të shkallëzuar e të kryqëzuar. Frëngjitë e topave kanë formë gjysmë trungu koni 45 gradësh, me përmasë të jashtme 1 deri 2,8 m., që dëshmojnë për qenjen e kalibrave të ndryshëm të topave. Kullat e kësaj kohe, të njejta me ato të kalave të ndërtuara prej Ali Pashës, kanë formë poligonale për rikoshetimin e predhave. Për të qenë më të qëndrueshme ndaj artilerisë, kullat e kanë trashësinë e mureve 2-3 m. dhe janë mbushur në pjesën e brendshme me dhe. Për të përballuar presionin e tij, kullave u është dhënë një pjerrësi rreth 15° nga ana e jashtme. Më mirë prej tyre ruhet kulla «2b» (fig. 7) që ka formë trungu piramide 6 këndëshe, e pajisur me tre frengji topash: 1 m. nga brenda dhe 2,8 m. nga jashtë; që dëshmon për vendosjen e topave të rëndë. Siç kuptohet nga gjurmët, kullat qenë mbuluar me çati.

Pas rënies së pashallëkeve, rrethimi fillon të rrenohet dhe në vitin 1834, pas kryengritjes së Tafil Buzit e Zenel Gjolekës, shëmbet prej vet turqve, duke u kthyer në një relikt historik, që vazhdoi të dëmtohet deri në pragun e çlirimit. Në pushtetin popullor ky monument i rëndësishëm u vlerësua drejt që në fillim, duke u futur në listën e parë të monumenteve të mbrojtura nga ligji.

45) S. Naçi — Shënimet kronikale të Kostandin Beratasit. «Studime historike», 1964, nr. 3, f. 53 e origjinalit — 1768, nëndor.
46) Leake, **Vep.cit.,** f. 353.

DO NOT COPY

Tabela përmbledhëse 1

Tab. 1

Të dhënat teknike për ndërtimet me muraturë të përzier
Caractéristiques techniques des constructions en maçonnerie mixte

Nr	Objekti Ouvrage	Sasia e brezave. Nombrex des ceintures	Nr. i rreshtave për brez. Nombre des rangées par cintures	Gjerësia e brezave cm. Largeur des ceintures cm.	Distanca midis brezave: m. Distance entre les ceintures	Dimensionet e tullave: cm. Dimensions des briques	Trashësia e llacit: cm Epaisseur du mortier cm	Datimi Datation	Vërejtje Notes
1.	Kulla «7» Tcur «7»	1	4	35	3,5	36×27×4	4	IX-XII	
2.	Kulla «9» Tour «9»	3	I-II-5 III-6	I-II-35 III-45	4,5; 2,80; 2,7	30×22×4	4	»	
3.	Kulla «12» Tour «12»	1	5	46	—	30×20, 5×27× ×20×4	4,5	»	Tullat kanë formë trapezi këndrejtë Les briques ont deux faces parallèles en forme de trapèze rectangle
4.	Kulla «1a» Tour «1a»	2	6	47-52	2,50; 2,40	»	4,5-6	»	»
5.	Kulla «3a» Tour «3a»	1	6	»	—	»	»	»	»
6.	Muri i kështjellës Mur du château fort	1	5	»	—	»	»	»	»
7.	Kulla «23» Tour «23»	2	5	45		I. 34×24×4	6	»	»
8.	Kulla «1» Tour «1»	3	5	35	2,30; 2,80; 3,30	32×28×4,5	5	1205	dy rrjeshtat e mesit janë tërhequr në thellësi, e të mbuluar me llaç. les deux rangées du milieu sont en renfoncement et couvertes de mortier.

DO NOT COPY

TAB. I



DO NOT COPY

DO NOT COPY


NDERTIME TE PERIUDHES Ilire
KULLA E HYRJES KRYESORE (24)
Sondazhi
Muri ilir i parë
prej Prashnikerit
Mure ilire
Mure mesjetare me ripërdorim bllogesh antike
Mure mesjetare
0 2 4
PAMJE E BRENDESHME E HYRJES
Krahu i djathtë
0 1 2 3
Krahu i majtë

TAB. III









DO NOT COPY


NDERTIMET E PERIUDHES SE
PRINCIPATAVE FEUDALE
V
Kisha e shen-Mehillit
0 50 100m
Muret e periudhës se principatave
Trasejа e supozuar
Mure të mevonshme


1


2

DO NOT COPY

TAB. V







DO NOT COPY

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

LA VILLE FORTIFIEE DE BERAT

RESUME

La ville fortifiée de Berat (fig. 1) se dresse sur une colline qui domine la région environnante, au bord de la plaine fertile de la Myzeqe et à l'extrémité occidentale de la vallée de l'Osum. Connue comme chef-lieu de la Myzeqe, cette ville était le centre administratif de la région et commandait le passage longeant le lit de l'Osum, l'une des principales routes qui reliaient la dépression côtière à la région montagneuse intérieure.

La colline, haute de 187 m. au-dessus du niveau du lit du fleuve, a des versants très escarpés qui en facilitent la défense. Les murs d'enceinte qui épousent le relief du terrain forment un triangle scalène aux côtés courbes, d'un périmètre de 1400 m. et d'une superficie de 10 ha (Tab. I) garni de 24 tours et d'une barbacane (fig. 2) dans laquelle s'ouvre l'entrée principale. A l'intérieur de ce territoire, s'étend le quartier de la kala (citadelle) dont les principaux éléments architectoniques datent des XVIIIe et XIXe siècles. Sur la portion la plus élevée de cette surface, se dresse le château fort, pourvu de cinq tours et qui se divise en deux parties, la plus avancée servant de résidence pour les chefs. Outre les fortifications susmentionnées, sur la face sud se remarquent les traces d'un système de murs et de tours, qui réunissaient la ville haute au lit du fleuve.

Du fait de la diversité des époques qu'ils ont traversées et de leur usage continu à des fins défensives, les murs d'enceinte constituent un assemblage de couches diverses, qui peuvent se diviser en grandes périodes constructives, à savoir:

1. *La période illyrienne*
2. *La période byzantine*
3. *La période des principautés féodales albanaises*
4. *La haute période d'occupation ottomane*
5. *La période des grands pachaliks.*

Période illyrienne

Leake, le premier, a exprimé l'opinion que le Berat actuel est l'Antipatrea citée par Polybe et Tite-Live. La grande superficie du territoire enceint, l'existence d'un collier d'ouvrages fortifiés qui s'égrènent autour de la ville sa situation centrale, ainsi que le fait que Tite-Live la distingue des autres forteresses, la définissant comme une ville, attestent qu'Antipatrea a été un grand centre habité.

Les murs de cette période sont construits de blocs de 60 à 250 cm. de long, de

DO NOT COPY

40 à 50 cm de haut et de 50 à 60 cm. d'épaisseur. La plupart d'entre eux sont de forme rectangulaire et un petit nombre seulement de forme trapézoidale. Les blocs, parallélépipèdes rectangles, sont taillés sur cinq de leurs faces, et se divisent en blocs calcaires (fig. 3, 4 à gauche, Tab. II, 2) à la face externe grossièrement travaillée, et d'une convexité de 10 cm. et, pour une petite part, en blocs de conglomérat (fig. 4 à droite, Tab. II, 2) aux parois externes planes et que l'on rencontre seulement dans la zone de l'entrée, au-dessus des blocs calcaires. Apparemment, il s'agit là d'un réaménagement partiel de l'entrée. Les blocs sont disposés en rangées horizontales, étroitement assemblés, et, rarement, en emboitement.

Le procédé précité est, typologiquement, semblable à celui que l'on rencontre dans une partie des murs de Butrint, Lissos et, généralement, dans les murs datant du IVe siècle.

Les vestiges de murs en particulier permettent de constater que ceux de l'époque médiévale suivent le même contour que les murs antiques (Tab. II, 1). La partie la mieux conservee de cette période est la tour d'entrée (Tab. II, 2) et un pan de mur et de tour de 7,5 m. de large (fig. 3).

Au cours de la période d'occupation romaine, le nom d'Antipatrea tombe dans l'oubli, bien que la continuation de la vie dans cette ville nous soit attestée par des débris de céramique «pseudoterrasigillata» du Ier siècle.

Période byzantine

Pendant la période byzantine, Procope, dans sa liste des constructions entreprises par Justinien en Nouvel Epire, cite cette ville sous la forme altérée d'«Antipagrai», alors que pour la période postérieure, elle s'identifie à Pulchéropolis, citée par Hierocle et Porphyrogenète.

Il n'existe pas aujourd'hui, dans l'état actuel des fouilles, de vestiges de la période du haut empire byzantin. Les constructions postérieures sont caractérisées par une maçonnerie du type «opus mixtum», composée de petites pierres calcaires non taillées, et traversée, à intervalles, par des ceintures de briques. Ces constructions appartiennent à quatre phases diverses auxquelles correspondent les tours 7 (Tab. III, 4) 9 (Tab. III, 1), 23 et les murs et la tour du château fort (Tab. III, 2) (pour les données techniques voir le tableau 1). Les constructions susmentionnées appartiennent à la période postérieure au IXe siècle, ce qui ressort de la grande largeur et de l'irrégularité de l'intevalle compris entre les ceintures, de la diversité du nombre des rangées dans la même tour, et du fait que la ceinture de briques ne pénètre pas toute l'épaisseur du mur, ces caractéristiques étant celles de la période postérieure au IXe siècle, lorsque le procédé «opus mixtum» commença à s'altérer.

La nouvelle enceinte a été élevée en 1205 par Michel Comnène, despote de l'Epire, ce qui est attesté par son monogramme en briques sur le mur nord de la barbacane (fig. 5). C'est à cette période qu'appartiennent la tour 1 (Tob. III, 3; fig. 2) et une grande partie des murs des autres tours. Ceux de la tour 1 sont parcourus en longueur par trois bandes de 5 rangées de briques chacune (voir tabl. 1), où celles du milieu sont en renfoncement et couvertes de mortier, procédé que Schneider et Carnap ont retrouvé sur les murs du XIIe siècle à Constantinople.

Dans les années 80 du XIIIe siècle, les tentatives des Anjou de pénétrer profondément à l'intérieur des Balkans confèrent à le ville un importance partciulière. A cette époques, elle est reliée au fleuve par un cordon de terre en remblai. Un faubourg (suburbia castri) dont les vestiges se retrouvent en dehors de l'enceinte, vit le jour sur le versant nord-ouest de la colline.

DO NOT COPY

Période des principautés albanaises

La troisième phase embrasse la période des principautés féodales albanaises (Tab. IV). A cette époque, presque tous les murs furent remis en état, et un certain nombre de nouvelles tours furent construites. A part la première construction de la période illyrienne, ces travaux sont les plus importants qui aient été faits sur l'ouvrage, ce qui atteste la croissance, au cours de cette période, du rôle des villes, qui revêtent maintenant tous les traits de la ville médiévale.

Du point de vue technique, les murailles sont faites d'une maçonnerie «coulée» dans l'intervalle formé par deux murs parallèles de petites pierres en appareil irrégulier (Tab. IV, 1), traversés longitudinalement de bandes de bois. Les tours sont à base rectangulaire (Tab. V, 1), de 5 m. sur 7 m., avec des murs de 1,70 m d'épaisseur, et divisées, à l'intérieur, en trois étages par des planchers de bois.

La seconde enceinte de la citadelle servait de lieu de défense aux chefs féodaux. Dans cette partie, se trouve, entre autres, un souterrain de 8 m sur 12 m, qui devait être la cave de l'édifice d'habitation. L'enceinte était renforcée d'une tour à base pentagonale et de deux autres, carrées, accolées en coin, l'une empiétant sur l'autre et servant de tour d'entrée. (Tab. V, 3). A cette période appartiennent les murs qui relient l'enceinte de la ville haute à la rive du fleuve. Les murs et les tours de cette enceinte apparaissent sur le versant sud de la colline et sur la rive du fleuve (Tab. V, 2).

Sur ce même versant se dresse aussi l'église de Saint-Michel, qui date des XIIIe et XIVe siècles et confirme l'extension de la ville dans cette direction.

IV. Haute période de l'occupation ottomane

Berat tomba par surprise aux mains des Turcs en juin 1417, en sorte que ceux-ci, trouvant la ville récemment reconstruite, n'eurent pas besoin d'y entreprendre de nouvelles constructions. Les travaux de la période d'occupation turque datent de l'époque qui suivit le siège de la ville par Skanderbeg, les murailles ayant été alors démolies par des blocs de pierre catapultés. Ces constructions, qui consistent dans le mur-galerie reliant cette tour au fleuve (fig. 7), dans le mur en talus, parallèle à celui de la face ouest, ainsi que dans certaines réparations, sont édifiées en maçonnerie en appareil irregulier de pierres de petites dimensions, sans remplissage de céramique.

V. Période des grands pachaliks

Les fortifications les plus récentes appartiennent à la période des pachaliks (XVIIIe s.) Ces constructions consistent principalement dans de nouveaux aménagements et de nouvelles tours destinées à l'artillerie, ménagées de façon à offrir le plus vaste champ de tir possible. On trouve surtout ces tours sur la face sud, à des positions-clés, qui commandent la route longeant la vallée. Les tours de cette époque, identiques à celles des forteresses construites par Ali pacha de Tépélène, ont, afin de favoriser le ricochet des projectiles, une base polygonale, des murs de 2 à 3 mètres d'épaisseur et une paroi extérieure inclinée de 15°. Elles sont remplies de terre à l'intérieur.

La mieux conservée est la tour «1b» (fig. 7) qui a la forme d'un tronc de pyramide et qui est percée de trois grandes meurtrières, servant aux canons, larges de 1 m à leur ouverture intérieure et de 2.80 à l'extérieur. Les murs de la tour sont doubles, à

maçonnerie fait de pierres taillées en parallélépipèdes de petites dimensions, remplis, dans l'intervalle, de cailloux et de mortier et renforcés par des ceintures de poutres. Les vestiges subsistant donnent à penser que les tours furent autrefois couvertes de toitures.

Après la chute des pachaliks, l'enceinte se dégrade. En 1832, elle est démolie par les Turcs eux-mêmes et n'est plus dès lors, qu'un vestige historique qui n'a cessé de s'altérer jusqu'à la veille de la libération. A l'avènement du pouvoir populaire, cet ouvrage important a été aussitôt apprécié à sa juste valeur et inscrit sur la première liste des monuments protégés par la loi.

DO NOT COPY

Dhorka DHAMO

DO NOT COPY

MBI DISA VEPRA TË PANJOHURA TË PIKTORIT SHQIPTAR TË SHEK. XVI NIKOLLËS

Disa vjet më parë, duke vizituar muzeun e monumenteve mesjetare në Sofie, na tërhoqën vëmendjen disa ikona që na kujtonin pikturat tona më të mira të shek. XVI. Veprat në fjalë, ishin sjellë nga një qendër e rëndësishme e kulturës mesjetare, Arbanasi, që siç dihet, prej kohësh ka qenë banuar nga shqiptarë. Këtej na lindi mendimi: mos vallë edhe në Arbanas ka punuar ndonjë nga mjeshtrit tanë të dëgjuar, ashtu si Onufri në Kostur të Greqisë e, sipas të dhënave të fundit, edhe në afërsi të Shkupit? Në pamundësi gjurmimi ky mbeti vetëm një supozim, derisa kohët e fundit u njohëm me librin e D. Kostovit «Arbanasi» [1]). Mbi bazën e një materiali të çmuar mbishkrimor që na jep ky autor, e nga konsultimi me materiale letrare e figurative të autorëve të tjerë bullgarë, si dhe pas një krahasimi të imtë me pikturën tonë, arritëm në përfundim se një nga piktorët tanë më të talentuar siç qe Nikolla, ka lënë vepra të shquara edhe në Bullgari.

Më poshtë do të përpiqemi të arësyetojmë kryesisht se piktori ynë, Nikolla është autor i një pjese të pikturave të njerës prej kishave të Arbanasit, që gabimisht është cilësuar vepër e piktorëve bullgarë, si dhe të informojmë shkurtimisht për dy monumente të tjera brenda vendit tonë që i përkasin gjithashtu këtij piktori.

Në librin e cituar, D. Kostov për herë të parë njofton se, në altarin e kishës së vjetër të shën Gjergjit në Arbanas, ruhet një mbishkrim me emrat Nikolla Joani dhe një datë. Datën ai e lexon 1661, por duke mos qenë, me sa duket, i sigurtë në deshifrimin e saj, e shoqëron atë me një pikëpyetje. Mbasi e komenton mbishkrimin, autori arrin në përfundim se Nikolla Joani nuk është tjetër veçse emri i ktitorit, ndërsa viti 1661 shënon sipas tij kohën e ngritjes së tempullit. Përsa i përket pikturës, D. Kostov ripohon mendimin e shprehur më parë nga studjuesi Bogdan Filov, se kisha është pikturuar nga mjeshtrit bullgarë Kristo e Stoju në vitin 1710, që i bie kështu afro 50 vjet pas ndërtimit të saj. Këtë përfundim e mbështesin vetëm në një mbishkrim, që, në dallim nga ai që përmendëm pak përpara, ruhet në gjendje fare të mirë dhe lexohet qartë. Shënojmë gjithashtu se ky mbishkrim nuk ndodhet pranë mbishkrimit të sipërpërmendur në altar, po në pjesën e naosit, muret e të cilit gjithashtu janë të veshura me piktura.

Nga i tërë kompleksi i pikturave (fig. 1) vëmendjen e studionjësve e ka tërhequr qysh në fillim, e në mënyrë të veçantë, paraqitja e Platitores në apsidë, e cilësuar si një pikturë «që dallohet për madhështinë e konceptimit dhe thellësinë e shprehjes shpirtërore që artisti ka ditur të shtjerë në të» [2]).

Këto tipare, që me të drejtë hetohen në pikturën e mësipërme, i gjejmë edhe në pikturat e tjera të apsidës, por që studjuesit nuk i kanë vënë re, ashtu siç nuk kanë dalluar edhe ndryshimin e madh në mes të këtyre pikturave dhe të tjerave, që nuk ndodhen në apsidë. Për nga shkalla e realizimit artistik dhe e

1) Dimitr Kostov «*Arbanasi*», Sofia 1959, f. 90.
2) **Po aty.**



DO NOT COPY

fig. 1

nivelit mjeshtëror e, ç'është më kryesore, për nga fryma që i përshkon pikturat e kishës së shën Gjergjit, duhet thënë që në fillim se duhen ndarë në dy grupe që, për nga koha e ekzekutimit nuk lidhen me të njëjtën etapë.

Në pikturat e apsidës ruhen më mirë tiparet artistike që anojnë nga piktura bizantine e përkryer. Ato shquhen nga një botë e brendshme e pasur, nga spiritualizmi i mprehtë e deri diku misticizmi. Spikat në to stilizimi i ndjerë hollë, në forma të pastra, në siluetat e shënuara me linje që përmbyllin bukur figurat në pozicione të zgjedhura e me lëvizje e gjeste plot harmoni e butësi. Momentet e veçanta psikologjike të figurave, nënvizohen edhe nga palat e gjallëruara disi grafike e me detaje ornamentale të prira kurdoherë, për të krijuar një situatë mundësisht sa më dramatike.

Për këto veti, piktura e apsidës duhet përmbledhur më vete dhe cilësuar si një pikturë që nuk mund të përfshihet në artin e shek. XVIII jo vetëm të Bullgarisë, por edhe të vendeve të tjera të Ballkanit. Ekonomikisht të forcuara në këtë kohë, shtresat tregëtare borgjeze në lindje, nuk mund t'i kënaqte më përdëllimi shpirtëror tipik bizantin, devotshmëria e dikurshme dhe nënshtrimi prej skllavi ndaj dogmës fetare. Në përputhje me kërkesat e shijet e reja estetike, përmbajtja e njohur i nënshtrohet një përpunimi të ri që pasqyrohet përmes formash artistike ndjeshmërisht të ndryshuara. Në këtë periudhë veprimtaria artistike në një shkallë të madhe zhvishet nga impozanca, sugjestioni, spiritualizmi i thellë. Dhe sido që aureola e shenjtë e artit kishtar u ruajt, ajo, si të thuash, nuk mbeti dot aq e pacënuar sa edhe më parë.

Të gjitha këto ndryshime në interpretim, i vemë re në pjesën tjetër të pikturave (fig. 2), të cilat, edhe në mungesë të mbishkrimit të dytë me datë 1710, mund të përcaktohen si grupi më i vonë i ansamblit.

Për këtë do të ishte i mjaftueshëm ballafaqimi i vetë pikturave qofshin të riprodhuara edhe në bardhë e zi.

Nga riprodhimi shohim gjithashtu, se pikturën e apsidës nga fundi e përmbyllin dekoracione me motivin e rizave të varura e të vargëzuara njëra pas tjetrës në pjesën e xokolaturës. Me sa duket, kemi përpara një skemë dekorative tradicionale që u përhap gjerësisht te ne, si në kishat e fshatit edhe në ato të qytetit, veçanërisht në shek. XVI. Këtë skemë e ka parapëlqyer edhe piktori Nikolla. Po, nuk është vetëm shpalosja e pikturës nepër breza sipas një radhe të caktuar, por i tërë stili i saj që i lidh këto paraqitje në apsidë, me krijimet tona të shek. XVI e në mënyrë të veçantë me ato të Nikollës së Onufrit.

Dihet se piktori Nikolla ka mbuluar me freska muret e kishës së Kurjanit, pranë Fierit, së bashku me një tjetër të quajtur Joan dhe më 1578, në mënyrë të pavarur, kishën e Vllahernës në kalanë e Beratit. [3])

Karakteristikat kryesore që dallojnë krijimtarinë e tij në monumentet që përmendëm janë: përqendrimi i brendshëm i thelluar e disi melankolik i figurave me shprehje të përvuajtur e vështrim ëndërrimtar që tretet në hapësirë. Tipet e tij tradicionale dallohen mirë për nga portreti, pozicioni e gjestikulacioni në pleq të ngrysur mendimtarë dhe në të rinj plot hir, me lëvizje të gjallëruar po gjithnjë të butë dhe të harmonizuar. Kurdoherë figurat ruajnë përpjestime të zgjatura e gjymtyrë të zhvilluara. Këto veçori i gjejmë edhe në figurat e apsidës në Arbanas. Për hir të mendimit madhor e të rëndësishëm edhe aty figura të shkëputura, si, Platitera apo disaherë edhe etërit, konceptohen sipas kritereve të një monumentalizmi më të theksuar se sa skenat, me llogaritjen për t'u soditur nga larg, sido që piktura e mureve në këtë periudhë mund të thuhet se ishte ç'monumentalizuar në një masë të ndjeshme, duke rënë thellë e më thellë nën ndikimin e pikturës së kavaletit. Edhe delikatesa me të cilën figurat e apsidës mbajnë pergamenat me hijeshi shpalosur, mënyra se si bekojnë e nderen përpara apo anash mbi sipërfaqen e lakuar të gjysmëkubesë apsidale, duart, e imtësi të tjera, tregojnë për mjeshtërinë e piktorit Nikolla.

Do të përqendrohemi te grupi i djathtë i apostujve (fig. 3), skenë që ruhet në gjendje të mirë si në Arbanas, ashtu dhe në monumentet e këtushme. Si kompozim, varianti i Arbanasit është më afër me skenën e Kurjanit: në të dy rastet, figurat në hap jepen të ndërtuara në varg në formë rrizi, ndërsa në Vllahernë i gjejmë të grupuara mbi rrafshin e lakuar në një mënyrë më kompakte, duke shfrytëzuar kështu me mjeshtëri sipërfaqen e kufizuar ku mund të punonte piktori.

3. V. Puzanova. **«Mbi pikturat e piktor Nikollës në kishën Vllaherna»** (në kështjellën e Beratit). B.Sh.sh., 1957, nr. 1, Th. Popa, **Piktura të tjera të piktor Nikollës zbuluar në Kurjan të Fierit** B. ShSh 1960, nr. 4, f. 223-230; Dh. Dhamo **Mbi disa ikona të panjohura të piktor Nikollës dhe Onufër Kipriotit.** «Studime Historike, 1966, Nr. 1.

ZOTO COPY

DO NOT COPY



Fig. 2

Si në Kurjan, në Vllahernë ashtu edhe në Arbanas, të gjitha figurat shpejtohen përpara përveç njërës në skajin e majtë që kthen në drejtimin e kundërt dhe që përpiqet të dalë tej skenës. Kështu mendon ta paraqesë Nikolla figurën e Judës, të cilën e dallon nga të gjithë apostujt e tjerë edhe me anë të ngjyrës së errët që mbush brevoren. E errët është fusha e saj edhe në Arbanas. Dhamë një detal karakteristik për Nikollën, po kjo nuk mund të na thotë se arti i tij kanonik ishte fare i ngrirë e shabllon në mjetet shprehëse. Përkundrazi, Nikolla në vargun e gjatë të mjeshtërve mesjetarë shquhet si një artist që ecën duke përparuar e duke bërë ndryshime nga njëri monument në tjetrin. Për këtë dëshmon edhe vepra e tij e Arbanasit, te e cila ndjehen si lidhjet e ngushta me mënyrën e punës në Kurjan, ashtu edhe shkëputja prej saj në drejtim të një zhvillimi më cilësor që na paralajmëroi jo vetëm Vllahernën, po njëkohësisht dhe përpjekje të tilla që arrijnë realizimin e tyre të plotë në vepra që pasojnë edhe në një etapë më të vonë.

Për ta quajtur të Nikollës pikturën e apsidës të kishës së shën Gjergjit në Arbanas, nuk na jep të drejtë vetëm stili i saj, por edhe materiali epigrafik i altarit që përmend emrin e tij së bashku me atë të piktor Joanit. Në Arbanas emri i Nikollës përmendet i pari, ndërsa në Kurjan jo. Cili është shkaku, ne nuk e dimë, po kjo nuk duhet lidhur kurrsesi me rolin e rëndësishëm që mund t'i ketë takuar Joanit qoftë edhe në rastin e Kurjanit, meqenëse në të dy monumentet dallohet një dorë kryesore, ajo e Nikollës.

Duke krahasuar mbishkrimet, vëmë re se, si në monumentet e këtushme ashtu edhe në Arbanas, janë shkruar greqisht dhe se koha në to është llogaritur njësoj si në Vllahernë duke marrë për bazë lindjen e Krishtit dhe jo krijimin e botës.

Edhe të dhënat paleografike, që mund të nxirren nga forma dhe karakteri i germave, që shprehen më mirë sidomos pranë figurës së Platiterës dhe etërve, japin elegancën dhe kaligrafinë e zgjedhur të Nikollës, që i përngjan aq shumë asaj të Onufrit.

Leximi i datës 1661 që i ka ngjallur dyshim edhe vetë deshifruesit për shkak të gjendjes në të cilën ruhet mbishkrimi, duhet korrigjuar dhe zbritur 100 vjet. Duke u nisur nga analiza stilistike e veprës në radhë të parë, si dhe nga të dhënat mbishkrimore, mund të themi se pikturat e apsidës në monumentin e Arbanasit, janë padyshim vepra të Nikollës dhe Joanit tonë dhe si kohë e vërtetë kur ato u krijuan duhet pranuar vitit 1561. Lajthitja në leximin e datës është plotësisht e mundshme, po të mbajmë parasysh veç të tjerave edhe faktin, se data është shënuar me shifra arabe dhe se, 5 me 6 mund të mirren njëra për tjetrën për shkak të afërsisë së madhe që kanë nga forma e tyre.

Duke e parë veprën e Nikollës në Arbanas të lidhur me monumentet e tjera të tij të njohura te ne, mund të arrimë në përfundim se, nga të tri komplekset, veprat më të para, siç duket, kanë qënë freskat e Kurjanit, pastaj piktura e Arbanasit me datë 1561 dhe pastaj Vllaherna më 1578.

Në vazhdim të gjurmimit të mëtejshëm të veprave të tjera të Nikollës, që lidhen me të parat, doli se nga dora e tij janë mbuluar me freska dhe dy kisha të tjera në Dhërmi: Ipapandia (fig. 4) dhe shën Stefani [4]). Ndonëse materialet mbishkrimore për këto raste mungojnë, vrojtimi në vend i veprave, i koloritit dhe madje edhe i cilësive tekniko-profesionale na bindën plotësisht (duke përdorur edhe metodën atributive) se autor i tyre ishte Nikolla. Nga ana e realizimit, na duket se monumentet e Dhërmiut janë frut i pjekurisë më të lartë artistike të këtij piktori. Piktura e Kurjanit p.sh. përbën në një masë më të madhe kujdesin e piktorit për të siguruar në radhë të parë qartësinë, gjë që shprehet edhe nga inicialet e çdo figure të shënuara pranë brereoreve të apostujve, apo dhe nga të përfshirit e sinjaturave brenda rrathëve siç bënte dikur Onufri. Edhe si variant ikonografik, vepra e Kurjanit është më pranë asaj të Onufrit se sa e Arbanasit, ku gjesti i bekimit me të dyja duart (krishti) për herë të parë zgjidhet prej Nikollës së bashku me mënjanimin e medaljoneve përreth sinjaturave. Në etapën më të lartë në Ipapandi, ai shtyhet edhe më tej duke arritur deri atje, sa të mënjanojë nga paraqitja e medaljonit që përkufizon zakonisht anembanë figura kryesore, për të treguar me anë të këtij elementi pacënueshmërinë dhe hyjnitetin e tyre. Vepra e Dhërmiut e paraqet Nikollën si një mjeshtër të shquar me potencë koloristike të madhe që di të përçojë ndonëse tërthorazi, me mjete figurative, lidhjen e tij prej artisti, me gjendjen e përgjithshme shpirtërore të nderë të krijuar historikisht te ne në shek. XVI, sigurisht për aq sa mund ta lejonte kanuni e dogma kishtare, që e mbërthen në përgjithësi në çdo hap pikturën tonë mesjetare.

4) Dhorka Dhamo, **Vepra të reja të piktorëve të shekullit XVI,** Drita, 1967, 8 tetor.

DOKTORIA

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

Deri vonë, pikturat e Dhërmiut, megjithë sasinë e madhe, kishin mbetur jashtë pasurisë kulturale të vendit, ndofta më tepër nën ndikimin e një mendimi, se i gjithë bregdeti duhej lidhur me një shkollë, që nuk ishte as e Voskopojës, as e Shqipërisë së Mesme por diçka tjetër nga ana e Kretës [5]). Një mendim i tillë u rrënjos më tepër nga mungesa e studimeve përkatëse se sa nga prova shkencore.

Në mbështetje të këtij identifikimi dhe të të dhënave të tjera rreth pikturave të shek. XVI të krijuara nga piktorë, që kanë qënë lidhur ngushtësisht me shkollën e lulëzuar të Beratit të kësaj periudhe, arrimë edhe në një përfundim tjetër, se jehona e kësaj shkolle u ndje edhe përtej kufirit, deri në Kostur e Arbanas. Vlera të një cilësie të lartë artistike ruhet aty që nga ajo kohë kur, duke lënë pas prodhime të panumurta të dobta siç ishin pa përjashtim të gjitha pikturat e shkollës Kreto-Veneciane.

5. Th. Popa. **«Konsiderata të përgjithëshme rreth artit posbizantin»**, «Studime Historike», viti 1966, nr. 1.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dhorka DHAMO

A PROPOS DE CERTAINES OEUVRES JUSQU'ICI INCONNUES DE NICOLAS, PEINTRE ALBANAIS DU XVIe SIECLE

RESUME

Les peintures qui se trouvent dans une vieille église d'Arbanas, en Bulgarie, se classent, selon leurs particularités stylistiques, en deux groupes: les peintures datant de 1710 et qui en vérité se rattachent à la manière des maîtres bulgares Christo et Stoya, et un groupe de peintures antérieures, de meilleure facture artistique. On est induit à penser que ces dernières sont dues au pinceau de Nicolas, peintre albanais du XVIe siècle, du fait surtout qu'on y retrouve le style de ce dernier dans les traits généraux et particuliers, dans la composition, la draperie, l'expression et essentiellement, dans l'esprit qui les pénètre. Cela apparaît clairement de leur confrontation avec les oeuvres qui portent la signature de Nicolas, seule ou accompagnée du nom de Yoan, un maître moins connu, qui a collaboré avec lui pour la décoration de l'église de Kurjan, proche de Fier.

Outre les considérations artistiques qui militent en faveur de cette identification, il y a lieu de citer aussi l'inscription publiée pour la première fois par D. Kostov dans la brochure «Arbanasi», qui mentionne les noms de Yoan et de Nicolas et l'an 1661 — date mal conservée et qui, étant quasi illisible, s'est vu accoler un point d'interrogation par l'auteur même de la brochure. Néanmoins D. Kostov conclut qu'il s'agit là d'une seule personne et que Nicolas Yoan a dû être le donateur et l'année 1661 celle de la construction du temple.

L'inscription est en caractères grecs, la date en chiffres arabes. Ce fait et l'état de l'inscription citée autorisent à en rectifier la lecture, en défalquant un siècle de la première date supposée. Cette rectification semble justifiable en raison de la similitude des chiffres 5 et 6, d'autant plus que la peinture absidale correspond si bien à celle des oeuvres de Nicolas qui sont connues chez nous. L'identification aide à suivre à ses différentes étapes l'évolution systématique de Nicolas en tant que peintre et à mieux éclairer la voie qu'il a parcourue. Le point culminant de cette voie est représentée par l'oeuvre de Dhërmi, non pas tant toutefois dans les fragments de l'église de Shën Stefan (Saint Etienne), que dans la peinture d'Ipapandie.

L'oeuvre de Dhërmi révèle en Nicolas un maître remarquable doté d'une grande puissance de coloris et sachant traduire, encore qu'indirectement, par des moyens ti-

guratifs, sa communion d'artiste avec l'état général de tension spirituelle, historiquement créé dans l'Albanie du XVIe siècle; cela, certes, dans la mesure où le permettaient les canons et les dogmes de l'Eglise qui paralysaient notre peintre médiéval à chacun de ses pas. L'activité de Nicolas à Dhërmi s'inscrit en faux contre l'opinion de Th. Popa selon laquelle toute notre région côtière se rattachait soi-disant, à une école qui n'était ni celle de Voskopoje ni celle de l'Albanie centrale, mais une autre ayant son centre en Crète.

L'écho de la florissante école de Berat parvint aussi au-delà de nos frontières, jusqu'à Castoria et Arbanas, où sont conservées des oeuvres de qualité de Nicolas, qui datent d'une époque où, dans les Balkans, furent produites, selon V. Lazarjev, d'innombrables imitations, comme l'étaient, sans exception, toutes les peintures de l'école créto-vénitienne.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

RESTAURIMI I KISHËS SË MARMIROIT [1])

DO NOT COPY

Kisha e Marmiroit ndodhet mbi një çukë të vogël në afërsi të Orikut (Jerikosë mesjetare). Çuka ngrihet buzë kënetës dhe ka në shpinë fushën e Dukatit, kurse nga ana jugore, malin e Karaburunit. Sot fshati më i afërt është Dukati i Ri, i ndërtuar këto 10-vjeçarët e fundit, ndërsa më përpara kanë qenë Dukati dhe Radhima, dy-tri orë larg. Banorët e atyre anëve e njohin me emrin kisha e Marmiroit dhe nuk janë në gjendje të shpjegojnë se e cilit shënjti është dhe të japin ndonjë të dhënë tjetër për ndërtimin e saj.

Arkeologu austriak K. Paç që e vizitoi këtë kishë në vitin 1904, jep një përshkrim të sajin dhe disa mendime lidhur me të [2]). Ai mendon se nuk kemi të bëjmë me një kishë të zakonshme fshati dhe hedh hipotezën se mund të jetë qendra episkopale Gllavënica [3]), që sot mendohet se është Ballshi [4]).

Kisha ndodhet në majën e kodrës (fig. 1). Ajo gjëndet në këndin juglindor të një oborri, ku si mure rrethuese janë shfrytëzuar edhe vetë muret e saj. Nga ana perëndimore, aty ku sot ndodhet këneta e Orikut, dhe nga ana veriore, muret rrethuese shërbejnë si mure mbajtëse për krijimin e oborrit, që ka një nivel më të lartë se terreni i jashtëm. Brënda oborrit te i cili hyhet nëpërmjet një porte në anën jugore, gjënden mure të rrënuara, të cilat duhet të jenë pjesë ndërtesash të përdorura për banim. Për këto na shtyjnë të mendojmë disa kamare, një oxhak dhe një dritare. Me të dhënat që kemi, nuk mund të themi në se këto godina janë të njëkohshme apo jo me kishën.

Kisha ishte në gjëndje të keqe, por megjithatë ruante gjithshka. Nga jashtë ajo kishte formë kubike me kupolë dhe tambur, të cilët ishin pjesërisht të rrënuar; të çara të mëdha dalloheshin nga të katër anët. Disa prej tyre tregojnë menjëherë se janë vendtakimi, i mureve të vjetra me shtesat e reja. Në anën perëndimore ku dikur ndodhej narteksi, i cili është i njëkohshëm me naosin, sepse në faqen perëndimore të këtij të fundit duket lidhja e të dyve, gjendej një grumbull gurësh nga i cili mezi dalloheshin muret e ruajtura pak mbi tokë. Kisha ka tri hyrje, një nga perëndimi, që e lidh me narteksin dhe që në një kohë të dytë është zvogëluar duke u mbuluar me një hark të shtrirë, sot e zënë me mur guri të thatë; një nga jugu (fig. 2), po ashtu e zënë me mur dhe një nga veriu, e hapur. Në pjesën e sipërme muret anësore të kishës mbarojnë me një platformë thuajse horizontale, e cila zor se ka pasur mbulesë me tjegulla, me përjashtim të rastit që me kohë të jetë rrafshuar; gjë pak e mundshme.

Nga brenda, kisha ka formë kryqi me krahë jo të

1) Rilevimet janë kryer nga autori, Gj. Karaiskaj dhe V. Shtylla, vizatimet janë të F. Zarshatit, fotot të R. Veselit dhe të autorit. Punimet restauruese janë kryer nën drejtimin e autorit dhe L. Sulit.

2) C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** Wien 1904, f. 73.

3) **Po aty,** f. 75.

4) Th. Popa — **«Gllavenica e lashtë dhe Ballshi i sotëm»** në «Studime Historike», 1964, Nr. 2, ff. 255-261.



Fig. 1



Fig. 2

barabartë. Krahët perëndimorë dhe lindorë janë në madhësinë e mëparshme dhe më të gjatë se të tjerët, që sot janë pjesërisht të zënë me mure. Në fund të krahut lindor, në murin shtesë që ka mbyllur apsidën e dikurshme, ndodhet një konkavitet në rolin e bemës me një dritare të vogël si edhe dy kamare anash si protezis dhe diakonikon (Tab. II). Një tryezë altari është brënda këtij muri.

Mbi katër pilastrat e formuara ndërmjet krahëve të kryqit dhe që mbarojnë me nga një gur kornizë, ngrihen qemerët, të cilët mbulojnë krahët e kryqit dhe shërbejnë dhe si harqe mbajtës për tamburin e kupolës dhe trekëndshat sferikë (fig. 3). Qoshja e pilastrit ndërmjet krahëve të kryqit është ndërtuar me gurë të mëdhenj që, si pjesa më e madhe e materialit të përdorur, janë marrë nga rrënimet e ndërtesave antike të Orikut [5]). Duhet të shtojmë se si në mure, ashtu edhe në tambur, ruhen fragmente mjaft të dëmtuara të pikturës murale që ka patur kisha. Që suvaja e afreskut të ngjitej më mirë mbi këta gurë, janë bërë gërvishtje me ndonjë çekiç me dhëmbë, gjurmët e të cilit i gjetëm të njëllojta kudo, si në gurët ashtu edhe në tullat, që janë përdorur në mënyrë të çrregullt në muraturë. Qemeri është i ndërtuar me gurë të skuadruar vetëm në rreshtin që duket, i cili është në kontakt drejtpërdrejt me trekëndshin sferik të ndërtuar me tulla të holla. Meqenëse ky i fundit fillon menjëherë pas thembrës së qemerit, gurët e thembrës së harkut, pranë trekëndshit sferik, vinë duke u zvogëluar dhe ai mbështetet vetëm në disa centimetra. Sigurisht, që një gjë e tillë nuk influencon në qëndrueshmërinë e kupolës, nga që në trashësinë e tamburit hyjnë më shumë se një rradhë gurësh, nga qemeri i krahut të kryqit. Mbi trekëndëshin sferik dhe harqet kalon një kornizë e hollë e ndërtuar prej pllakash guri, mbi të cilat janë katër dritare të ngushta dhe të larta, që mbulohen me dy gjysma tjegullash për të krijuar mbulesën harkore.

Tamburi paraqitej i çarë në shumë vende, ndërsa kupola mjaft e dëmtuar dhe, në pjesën më të madhe, e rrëzuar (fig. 4). Me gjithkëtë parametrat e kupolës dhe të tamburit dalin mjaft qartë, sepse në anën perëndimore është ruajtur rreth 1 m. nga korniza horizontale e tamburit, mbi të cilin fillonte çatija e kupolës (fig. 5) Kjo kornizë është e formuar prej një rreshti tullash që dalin pak nga muri. Tamburi është ndërtuar me gurë, duke patur edhe copa tullash dhe tjegullash, të vendosura pa ndonjë rregull dhe disa drunj të vendosur tërthor pa ndonjë lidhje, (për ta kompaktësuar), ndërsa kupola gurët i kishte pak të gdhëndur dhe të vendosur në mënyrë radiale (fig. 6). Në vendet ku muri qe më i trashë se sa ky rresht, pjesa tjetër

5) C. Patsch, **Vep. cit.** f. 75.

DO NOT COPY

ishte mbushje me mur të zakonshëm. Nën shtytjen e kupolës dhe tamburit, muret veriore dhe jugore janë hapur, duke shkaktuar nga ana e tyre dëmtimin e kupolës. Ka të ngjarë që kjo të ketë ndodhur nga që krahët veriorë dhe jugorë janë më të shkurtër, prandaj, për të kufizuar dëmtimin, në një kohë të dytë, kanë ndërtuar muret brënda naosit.

Përpara restaurimit, materiali i rrëzuar i kupolës kishte rënë mbi dysheme dhe vetëm pasi e pastruam atë, doli dyshemeja e parë e ndërtuar me pllaka guri të çrregullta, në të cilën zbritej me disa shkallë nga porta. Po me pllaka ishte shtruar edhe narteksi. Mbi portën perëndimore të naosit dallojmë kurbëzimin e qemerit, që me sa duket mbulonte narteksin, gurët e të cilit i gjetëm të rrëzuar dhe me forma që tregonin qartë se janë gurë qemeri. Shumë prej tyre ruanin dhe gjurmë afresku.

Duke dalluar pjesët që janë shtuar për arësye konstruktive, mund të gjejmë se si ka qenë forma e parë e kishës.

Kemi të bëjmë me një kishë me planimetri në formë kryqi të lirë, të mbuluar me kupolë mbi tambur, pa mbështetje të brendshme (Tab. I). Themi kryq i lirë sepse, muret ndërmjet krahëve të kryqit në anën e jashtme duken që janë shtesa dhe në disa vende janë shkëputur nga muret e kishës. Këto shtesa vazhdojnë dhe mbi frontonet e krahëve të kryqit, duke krijuar platformën që përmendëm më lart. Kjo platformë duhet të jetë bërë bashkë me muret e brendshme shtesë, për të forcuar kishën që kishte rrezik të shëmbej nga hapja e mureve veriore dhe jugore. Nën këtë platformë duken, në murin jugor (Tab I) dhe pjesërisht në atë verior (Tab II), kontaktet e platformës, me pjesën e sipërme të mureve të krahëve të kryqit, që kanë pjerrësinë e çatisë me fronton. Nga muri lindor kjo gjë nuk duket, sepse shtesat janë mbi absidë dhe mbulojnë në këtë mënyrë krahun lindor. Shtojmë, se mbi platformën prej muri dalin në të katër anët pjesët e bazamentit të tamburit, që këtu, ndryshe nga kishat e tjera bizantine, janë elemente cilindrike dhe jo paralelopipedike.

Në këtë mënyrë jemi në gjendje për të bërë një rikonstruksion hipotetik të kishës dhe këtu e kemi fjalën për naosin, sepse për narteksin dimë planimetrinë dhe se ka qenë mbuluar me një qemer cilindrik me formuese veri-jug. Nëse narteksi ka pasur hyrje, ajo duhet të ketë qenë në anën perëndimore, ku muri mungonte, sepse në anët e tjera muri ishte i tëri mbi nivelin e dyshemesë, pa ndonjë gjurmë dere. Përsa i përket çatisë, ka shumë mundësi të ketë qënë vazhdimi i çatisë së krahut perëndimor, si e vetmja zgjidhje e rregullt (Tab III). Në këtë supozim na shtyn zgjidhja e çatisë së kishës së manastirit të shën Mërisë së Zvërnecit, e vetmja kishë bizantine e këtij tipi që ruhet te ne.

Teknika e ndërtimit të mureve është e zakonshme, me gurë të skuadruar vetëm në qoshet dhe me copa tjegullash apo tullash të vendosura pa ndonjë rregullshmëri. Vetëm në absidë ka disa breza tullash të përdorura për efekt estetik (Tab II). Dritarja në absidë është e ngushtë dhe e mbuluar me një gur horizontal i cili në pjesën e poshtme është gdhendur për të formuar një gjysmërrethi mbi dritare. Shpatullat e dyerve janë të ndërtuara me gurë të mëdhenj të skuadruar, me siguri nga të Orikut. Gurët më të mëdhenj janë përdorur edhe si pjatabanda edhe në pjesën e poshtme në tokë, ku janë hapur vrima për t'u rrotulluar kanatet e portës. Portat janë dykanatëshe, që të mos pengojnë kur rrinë të hapura. Muret e portës jugore janë punuar më mirë, me pjatabandë dhe një hark të verbër mbi të. Duket se dikur, kjo portë ka qenë në anën nga ku i afrohej kishës ndonjë rrugë.

Duke pasur parasysh se monumenti ishte në rrezik të shkatërrohej gjithnjë e më tepër, si nga dëmtimet në strukturat mbajtëse të tij, ashtu edhe sepse i ishte ekspozuar tërësisht veprimit shkatërrimtar të agjentëve atmosferikë, menduam se një ndërhyrje restauruese ishte e nevojshme dhe urgjente. Për këtë u bindëm duke parë dëmtimet e reja që ai ka pësuar që nga koha kur atë e vizitoi Paçi. Një ndërhyrje të tillë e zgjidhëm duke pasur parasysh disa aspekte. E para, të forcohej monumenti nga ana konstruktive në mënyrë të tillë, që të mos kishte dëmtime të mëtejshme. E dyta, duke pasur parasysh vlerën e shtesave, të çlirohej sa më tepër prej tyre, që të dilnin në dukje vlerat e tij të vërteta. Po të shohim më thellë, do të vërejmë se këto aspekte janë të lidhura njëra me tjetrën, sepse muret shtesë janë vënë për qëllime përforcimi; rrjedhimisht, vetëm një zgjidhje konstruktive me përforcime përbrenda mureve, do të na jepte mundësi të çlironim kishën nga shtesat duke garantuar njëkohësisht dhe qëndrueshmërinë e saj.

Sigurisht, që heqja e shtesave shtronte problemin a qëndronte kisha nga ana arkitekturale pa to, d.m.th. a ruheshin tërësisht format e vjetra. Nga një shikim i imët u pa se pjesa më e madhe e mureve të kishës nën shtesat, ruhej. Këtu duhet shtuar se në anët veriperëndimore dhe juglindore shtesat ndërmjet krahëve të kryqit, ruheshin vetëm pjesërisht. Duke bërë krahasimin e vlerave estetike të kishës para restaurimit dhe të atyre që ajo do të fitonte nga restaurimi, pamë se në gjendjen përpara restaurimit, nuk kishte mundësi t'i bëhej asaj ndonjë vlerësim estetik si për gradën e rrënimit, ashtu edhe për faktin që format e dikurshme të saj ishin mbuluar nën një mbulesë muresh të rinj. Sigurisht, gjatë restaurimit do të duhej të bënim;

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

përveç përforcimeve edhe disa plotësime, atje ku muret kishin rënë nën nivelin origjinal. Përveç këtyre, do të na duhej të bënim dhe ndërhyrje të mëdha; si kompletimi i tamburit dhe i kupolës forcimi i mureve, duke shfrytëzuar në të dy rastet pjesët ekzistuese. Bashkë me përforcimin e mureve, u mendua që të shtyhej muri verior i pjerrur nga jashtë rreth 10 cm. Kjo ishte e mundur, sepse u pa që kontakti i tij me murin e vjetër mungonte. Pas shtyrjes, ai duhej të lidhej me muret e tjera me një brez betonarmeje në lartësinë e frontoneve, që do të shërbente dhe për të marrë shtytjen e kupolës. Përsa i përket narteksit edhe sikur të pranonim si të drejtë rikonstruksionin që paraqesim, e quajtëm pavënd që atë ta ngrinim, duke u mjaftuar vetëm me sistemimin e mbeturinave në planimetri dhe në vendin e kontaktit me faqen perëndimore të naosit.

Për të kryer këto punime, në verën e vitit 1967, nga ana e Institutit të monumenteve të kulturës, u ndërmuar një ekspeditë restaurimi, që punoi në bazë të detyrave të mësipërme.

Pas pastrimit të dyshemesë, u përforcuan me shtylla drurë dhe pajanta muret veriore dhe jugore, si dhe qemerët e të katër krahëve të kryqit. U pat parasysh që pajantimi i murit verior të shërbente dhe për shtytjen e tij (fig. 8). Pas këtyre forcimeve u kalua menjëherë në heqjen e shtesave duke filluar nga ato që ishin mbi kishë. Heqja e tyre nxori formën e mëparëshme të mbulesës së kishës të ruajtur pak a shumë më mirë (fig. 7), natyrisht me të çarat atje ku muri ishte shkëputur. Edhe heqja e pjesëve ndërmjet katër krahëve të kryqit u bë lehtësisht dhe nxori të plota muret e vjetra. Këto mure nuk i prishëm deri në fund, por i lamë rreth 50 cm. nga toka, sepse menduam të ishin si dëshmi materiale të shtesave dhe, në një kohë të dytë të gjykonim për t'i hequr fare, ose jo. Tani vonë, duke parë se ato pengojnë në perceptimin e fragmentimit në ripa të fasadave, që thekson vertikalitetin, menduam t'i largojmë. Përfundimet na bindën për drejtësinë e një veprimi të tillë.

Menjëherë pas heqjes së shtesave jashtë kishës, filluam heqjen e tyre brënda kishës, duke nxjerrë të plota krahët veriorë dhe jugorë të kryqit dhe bemën, duke i dhënë naosit kështu madhësinë e tij të dikurshme (Tab. III). Me këto punime ne realizuam detyrën e parë të restaurimit, heqjen e shtesave që i ishin bërë kishës për arësye konstruktive.

Përpara nesh delte detyra e dytë, përforcimi i kishës dhe plotësimi i pjesëve që mungonin. Filluam duke bërë përforcimet nga poshtë-lart, nga muret me qemerë, në kupolë. Së pari tentuam të kthenim në pozicionin e parë murin verior; për këtë pastruam nga gjithë gurët e rrëzuar fugat ndërmjet dy mureve, që të mos pengonin në shtytje; dhe filluam me anë të një krikoje shtytjen e murit, i cili vajti në pozicionin thuajse vertikal.

Në këtë fazë të punimeve, gjykuam edhe një herë mbi mënyrën se si do të bënim përforcime për të ndërhyrë sa më pak në monumentin. Për forcimin e mureve d.m.th. për lidhjen e pjesëve që më parë ishin të shkëputura, vumë në përdorim shufra hekuri në beton të imët, që mund të zinin të çarat sipas formës së tyre. Këto përforcime i bëmë më shumë atje ku ishte vëndi më i përshtatshëm për një gjë të tillë dhe më tepër në murin verior, i cili ishte dëmtuar më shumë se të tjerët. Këto përforcime u bënë në mënyrë të tillë që të ishin të maskuara. Vetëm këto masa do të qenë të pamjaftueshme për të siguruar punën e përbashkët të të katër mureve dhe për të mbajtur kupolën mbi tambur. Prandaj në pjesën e sipërme të frontoneve, në tërë periferinë e kishës, hodhëm një brez betonarmeje në një thellësi rreth 30 cm. nga faqja e jashtme, për të mos lëvizur asnjë mur nga faqja e frontoneve, gjë që sigurisht e bëri më të vështirë punën. Përpara betonimit të këtij brezi kryem dhe meremetimet e qemerëve, kryesisht të perëndimorit që, në pjesën më të madhe, mungonte. Pas ndërtimit të këtij brezi betonarmeje dhe plotësimit të mureve deri në nivelin e tamburit, kaluam në plotësimin e tamburit dhe të kupolës. Përforcimin e bëmë te muret, duke përdorur lidhje me shufra hekuri në beton, të vendosura te të çarat. Kupolën e ndërtuam në bazë të teknikës së përdorur me gurë radialë, pak të punuar.

Në këtë mënyrë ne kishim plotësuar detyrat që i vumë vetes për restaurimin e kishës së Marmiroit.

Kisha e Marmiroit, nga një rrënojë e destinuar për të humbur, pas restaurimit zuri vëndin që i takon ndër monumentet e arkitekturës bizantine në vendin tonë, me tërë mundësitë për t'u vlerësuar.

E restauruar siç është sot, kisha e Marmiroit mund të vlerësohet në formën e saj të parë (fig. 9), duke përdorur këtu pa tjetër imagjinatën, sepse mungon narteksi, që i jepte një zgjatje duke zvogëluar thekësimin vertikal, që sot është më i ndieshëm se përpara.

Në siluetën e saj sot vërehet një farë kontrasti volumor ndërmjet kupolës dhe naosit, e cila i jep një pamje të rëndë, sepse kupola duket mjaft e madhe për kishën. Për një konstruksion të tillë ka luajtur rol vetë materiali i përdorur, gur i papunuar, që detyrimisht për të hequr shtytjen e kupo-

Photocopy



Fig. 7



Fig. 8

lës, do të shpinte në një tambur cilindrik dhe të trashë. Shënojmë se ky kontrast është dhe në anën statike, përderisa muret e naosit nuk qenë në gjëndje të mbanin peshën e tamburit me kupolën.

Edhe vetë trajtimi i godinës është i thjeshtë, mungon tërësisht dekoracioni, faqet janë të punuara thjesht dhe të rrafshta, të vetmet vija që perceptohen janë brinjët anësorë, të cilët vinë duke u përsëritur në krahët e kryqit, duke fragmentuar në rripa vertikale fasadën dhe, duke nënvizuar vertikalitetin.

Për vëndin shkëmbor mbi të cilin është ndërtuar për përmasat e vogla, për muret e punuara thjesht, kisha bën një efekt mjaft piktoresk dhe duket si një blok i vetëm (fig. 10).

Në trajtimin e hapësirës së brendshme duhet të shënojmë që forma qëndrore këtu është nxjerrë në plan të dytë, për shkak se mbizotëron jo vetëm aksi vertikal, por dhe aksi gjatësor, i cili theksohet nga që krahët veriorë dhe jugorë janë mjaft të shkurtër. Për shkak të faqeve të fragmentuara të ndijimit të një aksi gjatësor dhe, më tepër të atij vertikal, naosi s'duket aq i vogël sa është nga përmasat.

Pamë më lart, se ky tip kishe te ne, haset vetëm në zonën e Vlorës. Por duke pasur parasysh, se sot ne ruajmë vetëm një pjesë të vogël të kishave të periudhës para pushtimit turk, ky fakt duhet të mos na shpjerë në ndonjë përfundim më tepër se ai që në këtë zonë kemi një preferencë për këtë tip planimetrik. Në një kuadër të tillë është i vështirë edhe datimi, për vet faktin, se kishat e këtij tipi hasen në tërë kohën para pushtimit turk, prej shek. V deri te shek. XV. Për një datim në kufi me të ngushtë, na mbetet të mbështetemi vetëm në arkitekturën e vet monumentit. Formulimi pak a shumë rigoroz i fasadave dhe kupola e madhe e cilindrike (me rezervën që këto në një farë mase janë të kondicionuara dhe nga materialet e përdorura), në kishat e tjera bizantine të vëndit tonë të shek. XIII-XIV nuk hasen më, nga që ja kanë lënë vendin dekoracioneve me tulla dhe kupolave shumëfaqëshe dhe elegante. Duke krahasuar kishën e Marmiroit me atë të Zvërnecit, mendojmë se e para është më e vjetër, si për proporcione ashtu dhe për trajtimin e rrafshtë të fasadave, sepse në Zvërnec kemi nike në fasadat. Të tëra këto tregojnë për një përmirësim në trajtimin arkitektonik.

Krahasimi me kishat e vendeve fqinjë do të na ndihmonte për të preçizuar diçka, megjithëse këtu shtohet për së tepërmi shtrirja gjeografike. Në Bullgari dy kisha të tilla hasen në Boboshevo [6]) dhe në Separeva Banja [7]). Të dyja këto janë nga përmasat,

6) N. Mavrodinov — **Jednokorabnata i Krstovidnata crikva po Bollgarskata zemi do kraja na XIV V.,** Sofja 1931, f. 61-62, fig. 69-70.
K. Mijatev, **Arhitekturata i Srednevekovna Bllgarija,** Sofja 1965, f. 190-191, fig. 216-218.

7) N. Mavrodinov — **Vep.cit.,** f. 62, fig. 71-72.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

më të vogla dhe pa narteks. Nga planimetria ajo e Boboshevos i afrohet më tepër kishës së Marmiroit, për zgjatjen e krahëve në drejtim perëndim-lindje dhe për formën e absidës. Përsa i përket datimit për këto dy kisha është shprehur mendimi se i përkasin shek. XII dhe shek. XIII [8]). Edhe në Jugosllavi, ky tip haset pak a shumë rrallë; një kishë e tillë është ajo e shek. XII në Gjunie [9]), me kryq të rregullt dhe e ruajtur vetëm në themelet. Në Budivascin [10]) ruhet një kishë, pjesa e vjetër e së cilës mendohet të jetë e shek. XIV; ajo ka një ngritje vertikale më të theksuar se sa kisha jonë. Një tjetër kishë është ajo e shën Thanasit në Leshkë [11]), e datuar rreth shek. XIII, e cila ruhet vetëm në themelet. Nga sa pamë më sipër arrijmë në përfundimin se në shek. XII--XIII, kishat me kryq të lirë ndërtohen në Ballkan krye-sisht me përmasa të vogla si edhe kisha e Marmi-roit.

Nga të gjitha këto prova që sollëm, mendojmë se kisha e Marmiroit nuk mund të jetë më e vonë se e shek. XIII.

Kjo ishte në vija të përgjithshme arkitektura e kishës dhe restaurimi i saj. Duke përfunduar, dëshiroj-më të theksojmë se ky punim, është rrjedhim i ndër-hyrjes restauruese dhe tregon se është e mundur të restaurohen të ne edhe kishat e tjera bizantine, duke krijuar kështu kondita më të mira vlerësimi dhe stu-dimi.

8) Mavrodinov mendon për të parën shek XII, për të dytën shek. XIII, ndërsa Mijatev respektivisht shek XIII dhe shek. XII-XIII.

9) A. Deroko – **Monumentatna i dekorativna arkitektura u srednevekovnoi Srbi,** Beograd 1962, f. 39, fig. 18.

10) A. Deroko – **Vep. cit.,** f. 133, fig. 223.

11) A. Deroko – **Vep.cit.,** f. 151, fig. 253.

TAB. 1



PLANIMETRIA



PAMJE NGA JUGU

0 1 2 3 m

DO NOT COPY

DO NOT COPY



PLANIMETRIA MBAS RESTAURIMIT



PAMJE NGA VERIU - RIKONSTRUKSION

1 2 3M

TAB. III



PAMJE NGA VERIU



PAMJE NGA LINDJA

PREMJE TERTHORE

0 1 2 3 M

DO NOT COPY

DO NOT COPY

A. MEKSI

LA RESTAURATION DE L'EGLISE DE MARMIRO

RESUME

Dans son état antérieur à la restauration dont elle a été l'objet, l'église de Marmiro comportait des adjonctions postérieures à la construction initiale, au-dedans comme au-dehors. A l'intérieur, le choeur avait été clos et les ailes nord et sud raccourcies; au-dehors, des murs étaient venus combler les espaces compris entre les branches de la croix, transformant le périmètre de l'église en un carré. Les adjonctions extérieures s'étendaient aussi sur l'ancien toit à frontons, créant une plateforme qui ne devait très probablement pas avoir été couverte de tuiles. Sur le côté ouest, on retrouve des ruines des murs du narthex, qui était surmonté d'une voûte à berceau, orientée dans le sens sud-nord. Le narthex communiquait avec la nef par une porte surmontée d'une plate-bande. A l'intérieur, l'église a la forme d'une croix au bras droit allongé. Les quatre branches de la croix sont surmontées de voûtes cylindriques au-dessus desquelles, s'appuyant sur des pendentifs, s'élève une coupole reposant sur un tambour où s'ouvrent quatre petites lucarnes. L'église est construite principalement en pierres, mais les tuiles non plus ne se sont pas absentes. Une bonne quantité de matériaux paraissent avoir été recueillis sur les ruines d'Orik.

Afin de préserver ce monument de dégradations ultérieures, il fut décidé de le restaurer. Le projet de restauration prévoyait le renforcement des structures endommagées, la remise sur pied des parties écroulées et la suppression des adjonctions, jugées sans valeur, ce qui devait permettre de redonner à l'église son premier aspect. Au cours de la mise au point du projet comme durant la restauration, il fut constaté que les adjonctions avaient été faites afin d'étayer la construction, en sorte que le renforcement de la structure rendait les adjonctions superflues. Ce renforcement fut fait à l'aide d'une ceinture du béton armé au niveau des frontons, et de poutrelles de fer et de béton à gravier fin jeté dans les grandes lézardes des murs. Avant de couler la ceinture de béton-armé, on a redressé le mur nord qui accusait une inclinaison de 10 à 12 cm par rapport à la verticale.

La restauration de l'église de Marmiro fit de ses ruines vouées à disparaître, un monument qui, dans son nouvel état, peut être apprécié à maints égards. Construite en pierres, l'église apparaît comme un bloc, et sa façade rayée de bandes verticales, a un aspect assez pittoresque. Il convient de dire que, sans le narthex, que nous n'avons pas reconstruit, la coupole paraît assez vaste, et ce contraste esthétique s'est traduit aussi sur le plan de la statique, les murs latéraux n'ayant effectivement pas été en état de la soutenir.

En Albanie, la seule église du même type est celle du monastère de Zvernec, qui, par sa conception architecturale plus élaborée, nous paraît postérieure à celle de Marmiro. Des églises de petites dimensions du même type ont été construites en Bulgarie et en Yougoslavie dans les XIIIe et XIVe siècles. Ces éléments nous portent à croire que l'église de Marmiro ne doit pas être postérieure au XIIIe siècle.

DO NOT COPY

Gani STRAZIMIRI

GJIROKASTRA DHE VLERAT E SAJ KULTURALE

Qyteti i Gjirokastrës ruan në gjendje të mirë, një pasuri të madhe monumentesh të kulturës materiale, të krijuar gjatë shekujve të kaluar nga gjenia popullore. Ato përbëjnë një burim autentik për ndriçimin e historisë e veçanërisht të krijimtarisë popullore në lëmin e arkitekturës. Monumentet e gjinive të ndryshme ruajnë në vetvete vlera shumë të çmuara, por qenja pranë njëri-tjetrit, kompozimi në ansambël dhe trajtimi në një gjuhë të përbashkët arkitektonike, ua rrisin shumë më tepër vlerën (fig. 1). Gjirokastra ruan pothuaj të paprekur pamjen mesjetare, si e tillë, studimi i saj do t'u japë pa dyshim zgjidhje shumë problemeve që shtron qyteti mesjetar shqiptar, e tërthorazi dhe atyre që dalin në kuadrin ballkanik. Duke çmuar vlerat e rëndësishme që ruan Gjirokastra, Këshilli i Ministrave e shpalli atë, më 1961, qytet – muze.

Studimi në fjalë synon të japë një vlerësim të pasurive kulturale që ruhen në qytetin e Gjirokastrës dhe, në bazë të këtij vlerësimi, të përvizojë kufitë e zonifikimit të pjesës muze që do të përbëjë qendrën historike të qytetit.

* * *



Fig. 1 – Pamje e përgjithëshme e qytetit.

DO NOT COPY

Si qytet, Gjirokastra lindi nga nevoja për një qendër shkëmbimi në luginën bujqësore të Drinos dhe malësisë blegtorale të Kurveleshit dhe Zagorisë. Treva e Drinos ka qenë një zonë e banuar që nga koha e lashtë; këtë na e dëshmojnë dhe gjurmët e shumë qendrave të banuara antike, që ruhen sot në këtë luginë. Se kur u ndërtua kalaja dhe se kur lindi qyteti mesjetar nuk dihen, mbasi mungojnë njoftimet historike. Mendimet se në truallin ku shtrihet Gjirokastra ngrihej në kohën antike një qytet me emrin Argyreion – «minierë e argjendë» [1]), si dhe mendimi se kalaja e Gjirokastrës u ngrit në shek. VI [2]) nuk vërtetohen, mbasi deri më sot nuk është hasur asnjë gjurmë antike. Edhe gjatë mesjetës së hershme emri i Gjirokastrës nuk ndeshet në asnjë burim. Për të parën herë Gjirokastra përmendet me emrin Argyrokastron në shek. XIV nga kronisti bizantin J. Kantakuzeni [3]), kur bën fjalë për kryengritjen e arbëreshëve kundër Bizantit më 1336. Ai e quan një herë qytet e pastaj kështjellë.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV Gjirokastra si duket u bë selia e zotërve feudalë Zenevisë [4]). Por sundimi i tyre i pavarur u ndërpre disa herë deri sa, më 1419, Gjirokastra ra përfundimisht në duart e pushtuesve turq [5]) dhe u caktua kryeqendër e sanxhakut të Shqipërisë «Sanxhak i Arvanid». Caktimi i Gjirokastrës si kryeqendër i një njësie administrative që shtrihej nga krahina e Çamërisë deri në lumin e Matit flet për rëndësinë e madhe që kishte ky qytet. Që kalaja në këtë kohë ruhej në gjendje të mirë nuk vihet në dyshim, mbasi caktimi i Gjirokastrës si kryeqendër sanxhaku pa patur mure mbrojtëse për garnizonin turk nuk do të kishte kuptim. Veç kësaj, historiani bizantin i shek. XV Laonik Halkokondili, në përshkrimin që i bën kryengritjes që ndodhi në këtë zonë në vitet 1432-1435, e quan Gjirokastrën qytet dhe thotë qartë se ajo përfshihej brënda mureve rrethuese [6]). Si qendër ekonomike, në atë kohë Gjirokastra kishte një rëndësi të veçantë mbasi taksa e pazarit, që feudali turk nxirrte nga tregu i saj ishte, më 1432, më e lartë se taksa e qyteteve të tjera të këtij sanxhaku [7]).

Se sa banorë ka patur Gjirokastra në shek. XIV-XV, është vështirë të përcaktohet. Popullsia duhet të jetë rritur nga fundi i shek. XIV ose nga fillimi i shek. XV kur u bë qendër e zotërimeve të Zenevisëve. Më vonë, më 1419, kur qyteti u pushtua nga turqit [8]), popullsia duhet të ketë patur rënie ashtu si dhe qytetet e tjera të Shqipërisë. Më 1432 simbas defterit turk [9]) qyteti kishte 121 shtëpi të krishtere kryefamiljarësh (hanè). Deri në fillim të shek. XVI si shumica e qyteteve të Ballkanit, të pushtuara nga turqit, Gjirokastra nuk kishte bërë ndonjë hap të dukshëm përpara, kishte vetëm 143 shtëpi të tilla. [10]) Gjatë shek. XVI zhvillimi i Gjirokastrës ishte i ngadalshëm, kryesisht për shkak të karakterit natyror që sundonte në ekonominë fshatare [11]). Kështu në fund të shek. XVI qyteti kishte 380 banesa [12]). Rritjen më të shpejtë Gjirokastra e njohu gjatë shek. XVII, kur filloi shthurrja e ekonomisë natyrale të fshatrave dhe rritja e shpejtë e qyteteve [13]). Pikërisht këtij shekulli i takojnë njoftimet më të pasura që kemi për qytetin. Këto njoftime na i jep udhëtari i njohur turk Evlija Çelebiu, i cili e vizitoi qytetin më 1672 [14]). Sipas tij Gjirokastra mbasi kaloi në duart e shumë shteteve, u pushtua prej vetë Sulltan Bajazitit. Për kalanë, që ishte bërthama e qytetit, ai shkruan: «Fortesa është ndërtuar krejt prej guri të gdhendur në kohë shumë të moçme mbi një shkëmb që ka formën e kurrizit të peshkut... ka 600 hapa gjatësi dhe 100 hapa gjerësi, perimetrin e ka 1400 hapa. Kalaja shtrihet për së gjati nga lindja në perëndim, ka trajtën e një anieje. Në mes të fortesës është një rrugë e gjerë me drejtim nga lindja në perëndim. Në të dy anët e kësaj rruge ka 200 shtëpi të mbuluara me rasa të ndërtuara me gurë të gdhendur.... Brënda në fortesë ndodhet xhamia e Bajazit Hanit e mbuluar me rasa me një minare të stilit të vjetër.... Afër minares së kësaj xhamie ka një

1) P. Aravantinos. **Hronografia tis Epeiron.** Athinë 1856, f. 17. Encicloped. Ital. **Treccani.** S. V. Argirocastra. Vëll. IV, f. 267.
2) G. Valentini. **Contributi alla cronologia albanese.** Roma 1957.
3) J. Kantakuzemos II, 34.
4) L. Chalkokondiles II, f. 23-30.
5) Historia e Shqipërisë, Vol. I, Tiranë 1954, f. 244.
6) L. Chalkokondiles II 23, 24, 25, 29, 30.
7) H. Inalcik. **Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid.** Ancara 1954, Timari Nr. 1,
8) Shih shënimin Nr. 5.
9) Shih shënimin Nr. 7.
10) **The Encyclopedia of Islam** – London 1958, I, f. 656.
11) **Historia e Shqipërisë,** Vëll. I, Tiranë 1959, f. 344.
12) Po aty.
13) Po aty.
14) **«Shqipnija para dy shekujsh»** përkthim i «Evlija Çelebi Sejjahatnamesi». Tiranë 1930, f. 29 e vijim; F. Babinger **Ewlia Tschelebi's Reisewege in Albanien,** Berlin 1930.

Do not copy

saranxhë të madhe.... ku mblidhen ujrat e shiut që kullojnë nga rasat e pullazeve të fortesës, në të cilën pinë ujë të gjithë banorët e kalasë. Veç kësaj, çdo zotni ka në shtëpi të vet, një saranxhë të veçantë.... Fortesa ka dy porta.... Në portën nga lindja hypet me shkallë.... Porta nga perëndimi është përballë namazgjahut. Në këtë krah ndërmjet namazgjahut e fortesës, ka një hendek 100 hapa të gjatë dhe 20 hapa të gjerë. Tri anët e tjera nuk kanë nevojë për hendek sepse ka përroje natyrale». Nga sa u tha më sipër del qartë se kalaja, siç ruhej në çerekun e tretë të shek. XVII, i përkiste periudhës para pushtimit turk dhe se muret rrethuese ruheshin në gjëndje të mirë. Vetë udhëtari turk nuk bën fjalë për ndonjë rindërtim apo forcim të saj nga turqit.

Kur filloi të zgjerohej qyteti jashtë mureve rrethuese të qytezës mesjetare, fortesës, dhe cilat qenë lagjet e para që u ngritën dhe u zhvilluan pas këtij zgjerimi, në mungesë të të dhënave, mund të përcaktohen me rrugë të tërthorta. Po të marrim parasysh se në fund të shek. XVI, qyteti kishte 380 shtëpi dhe nga ana tjetër se Çelebiu në shek. XVII shkruan se «Brënda kësaj fortese ka 200 shtëpi, të mbuluara me rasa e të ndërtuara mbi bedenat e fortesës», del se brenda mureve rrethuese të kalasë mund të vendoseshin jo më shumë se 200 shtëpi. Pra, zgjerimi i qytetit jashtë mureve duhet të ketë ndodhur gjatë shek. XVI, gjë që përputhet me fillimin e një farë stabilizimi të pushtetit turk në vendin tonë.

Në çerekun e tretë të shek. XVII Gjirokastra kishte jashtë mureve rrethuese 2000 shtëpi. Çelebiu, i cili e vizitoi Gjirokastrën më 1672, shkruan: «Varoshi shtrihet mbi tetë kodrina e përroje rreth e qark fortesës... Përbëhet nga tetë lagje: Varoshi i Vogël, Palo, Vutosh, Manalat, Haxhi Beu, më e madhja e të gjithave, Dunavat, Memi Beu, më e zhvilluara». Tre prej këtyre dhe pikërisht Palorto, Manalat e Dunavat ruajnë edhe sot këto emra. Megjithëse emrat e lagjeve të tjera nuk ruhen, ato mund të identifikohen lehtë në bazë të orientimeve që jep Çelebiu. Lagjet Varosh i Vogël dhe Haxhi Bej njihen sot respektivisht me emrat Pllakë dhe Hazmurat, (Tab. II, 2) Varoshi i Poshtëm identifikohet me qendrën e qytetit (Tab. III, 1) dhe me lagjet Teqe e Meçite, ndërsa lagjja e shtatë me emrin Vutosh mendojmë se është lagjja e sotme Varosh. Lagjja e tetë, e cila nuk emërtohet, duhet të jetë lagjja Cfakë (Tab. II, 3). Të gjitha lagjet që ruhen sot në qytetin e Gjirokastrës me përjashtim të lagjes Pazari i Vjetër (Tab II, 1), e cila në atë kohë përbënte tregun pranë kalasë, ishin krijuar që në çerekun e tretë të shek. XVII. Kjo vërteton se Gjirokastra në fillim të gjysmës së dytë të këtij shekulli kishte pothuaj shtrirjen e sotme.

Me rëndësi është edhe njoftimi i Çelebiut për ekzistencën e pazarit të vjetër pranë kalasë. Ai shkruan: «Në veri të fortesës *) nën muret e saj është tregu i vjetër, që quhet pazari i kalasë me 40 dyqane të vogla. Ky treg, në të dy anët, ka dy porta druri si të bezistenit, të cilat çdo natë mbyllen». Tregu i vjetër, pazari i kalasë, për të cilin shkruan Çelebiu është tregu që përmendet për herë të parë më 1432 [15]). Nga këto të dhëna del se pazari pranë kalasë ekzistonte përpara pushtimit turk; mund të themi se ai lindi njëkohësisht me ngritjen e fortesës, në fillim, si qendër shkëmbimi i fshatrave përreth qytezës. Nga ana tjetër vendosja e këtij pazari pranë kalasë dhe ngjitur me të, vërteton në mënyrë bindëse se pikërisht mbi këtë kurriz kodrinor ishte ngritur që në fillim qyteza mesjetare e Gjirokastrës. Vetëkuptohet se edhe lagjet e para duhet të kenë qënë vendosur sa më afër qytezës dhe pazarit, në rrugët që vinin nga drejtime të ndryshme prej zonave fushore e malore përreth dhe që i lidhnin këto zona me kalanë dhe pazarin e dikurshëm pranë saj. Për përcaktimin e tyre, mund të na ndihmojnë dhe disa elemente të tjera siç janë emërtimet e lagjeve, lashtësia e ndërtimit të godinave të kultit, forma e terrenit dhe afërsia me qytezën dhe pazarin përbri saj. Nga këto të dhëna mund të arrijmë në përfundimin se shtrirja dhe zhvillimi i qytetit, pas zgjerimit të tij jashtë mureve rrethuese të qytezës, është kryer në formë radiale me epiqendër fortesën dhe pazarin përbri saj. Lagjja e parë që doli jashtë mureve rrethuese të qytezës duhet të ketë qenë lagjja Pllakë. Në dobi të këtij mendimi flasin vendosja e kësaj lagjeje në vijim të kurrizit kodrinor mbi të cilin ngrihet qyteza, shumë afër mureve rrethuese të kalasë; shtrirja e saj gjatë rrugës kryesore që të çonte nga kjo anë në sheshin përbri mureve rrethuese të kalasë, aty ku zhvillohej dhe pazari i fshatrave për rreth përpara zgjerimit të qytetit jashtë mureve rrethuese; përcaktimi i saj nga Çelebiu si lagje e të krishterëve dhe, së fundi, cilësimi i banesave si shtëpi të këqia d.m.th. të vjetra, në krahasim me ato të lagjeve të tjera të qytetit.

*) Kalaja në fakt gjëndet në pozicionin VL-JP.
15) Shih shënimin Nr. 7.

DOKTORATURA

DO NOT COPY

Fill pas kësaj lagjeje, para shek. XVII, duhet të jenë ngritur dhe zhvilluar me radhë lagjet Teqe, Meçitë, Hazmurat (tab. II, 2), Varosh, Palorto, Dunavat dhe Manalat. Në shek. XVII sipas njoftimeve që jep Çelebiu, kuptohet se poshtë mureve të kalasë, atje ku ndodhet sot qendra e qytetit (Tab III, 1) ishte ngritur një «treg i ri me 80 dyqane të reja dykatëshe» i cili quhej Pazari i Ri ose Pazari i Memi Beut. Rreth e rrotull tij ishin ndërtuar rreth 150 shtëpi të reja të bukura që përfshiheshin në lagjen Varosh i Poshtëm. Po në këtë lagje ndodhej dhe pallati qeveritar i Zyrës së Sheriatit. Nga kjo kuptohet se qyteza e vjetër mesjetare në këtë kohë kishte filluar të humbiste pjesërisht funksionin e saj shekullor dhe se pazari i ri e kishte dobësuar aq tepër fuqinë e pazarit të vjetër, sa që ky i fundit më vonë u zhduk krejtësisht duke u zëvendësuar me një lagje të banuar (Tab II, 1). Kjo duhet të jetë dhe lagjja më e re, që për mendimin tonë i takon fundit të shek. XVII dhe fillimit të shek. XVIII. Në bazë të këtyre të dhënave qendra e re u shpërngul nga kalaja mesjetare në Varoshin e Poshtëm, si rrjedhim, prej kësaj kohe nuk ishte më kalaja por qendra e re dhe pazari i ri që shërbenin si epiqendër për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit.

Interes të veçantë paraqesin dhe njoftimet për ndërtesat e banimit, për të cilat Çelebiu shkruan se «Shumë shtëpi të Gjirokastrës duket se janë themeluar nga venedikasit, sepse në to shihet figura e shën Markut... Shtëpitë e ndërtuara brënda fortesës mbi bedenat janë paisur me qoshke e shanishane për të soditur qytetin në të djathtë e në të majtë dhe të gjitha fushat e lulzuara... Shtëpitë janë të larta, të ndërtuara me gurë të gdhëndur, të mbuluara me rrasa dhe të rrethuara me vreshta e kopshte... Janë stolisur e zbukuruar me oborre të rrethuara me mure, të cilët janë ndërtuar me gurë të bardhë... të punuar me mjeshtri të hollë...». Këto të dhëna tregojnë qartë se në këtë shekull ruheshin ende ndërtesa të periudhës para pushtimit turk, se tradita e kompozimit, trajtimit dhe teknikës së ndërtimit vazhdoi dhe gjatë pushtimit turk, si brënda qytezës mesjetare në periudhën e parë, ashtu dhe jashtë saj mbasi qyteti u zgjerua dhe u zhvillua jashtë mureve të kalasë.

Duke marrë parasysh mungesën e gjurmëve të lashta në truallin e qytetit dhe të mospërmendurit e tij në burimet e shkruara para shek. XIV mund të arrijmë në përfundimin se Gjirokastra është një qytet që lindi gjatë mesjetës dhe se ashtu si shumica e qyteteve mesjetare shqiptare duhet të jetë themeluar gjatë shek. XII-XIII.

* *
*

Nga e kaluara ne nuk trashëgojmë ndonjë studim mbi Gjirokastrën. Të vetmet materiale dokumentare janë përshkrimi i Çelebiut dhe disa pasazhe të Hanit dhe Pukëvilit.

Punimin tonë e kemi mbështetur kryesisht në materialin e grumbulluar për disa vjet me radhë në terren, ku jemi munduar të njihemi nga afër me strukturën, kompozimin dhe zhvillimin e qytetit gjatë shekujve, me ansamblet, monumentet dhe ndërtimet e gjinive të ndryshme që e përbëjnë, me vlerën që përfaqësojnë dhe vendin që zenë në lindjen dhe zhvillimin e këtij qyteti gjatë shekujve.

Gjirokastra shtrihet në shpatin e malit të Gjerë mbi një sërë kurrizesh kodrinore, kreshtash shkëmbore e shpatesh, të ndërprera nga përrenj stinorë të rrëmbyer që përfundojnë në lumin e Drinos (fig. 1). Qyteti kufizohet nga jugperëndimi dhe verilindja respektivisht me lartësitë e Malit të Gjerë dhe fushën e Drinosit; ndërsa nga juglindja dhe veriperëndimi me përrenjtë stinorë të Bufames dhe Çullos.

Dëshmitë e kulturës materiale të së kaluarës në qytetin e Gjirokastrës janë: kalaja (Tab. I 1, 2), rrugët embrionale që lidhnin zonat përreth me qytezën dhe pazarin përbri; skema e rrjetit rrugor dhe e zhvillimit të qytetit pas zgjerimit të tij jashtë mureve rrethuese të qytezës, lagjet dhe tregu i qytetit, si dhe ansamble, monumente e ndërtime të gjinive të ndryshme.

Kalaja ngrihet në qendër të qytetit, në pikën më dominuese të tij (fig. 1), në kuotën 360 m. mbi nivelin e detit dhe rreth 200 m. mbi fushën e luginës së Drinos, që shtrihet përpara. Është e vendosur mbi një rrafsh shkëmbor që ngrihet thikë mbi kurrizin e stërgjatur kodrinor (fig. 2), i cili zbret nga mali i Gjerë dhe përshkon qytetin nga jugperëndimi në verilindje, duke e ndarë diagonalisht më dysh. Në krahasim me kalatë e tjera mesjetare të vendit tonë, kalaja e Gjirokastrës ruhet në tërësi në qjendje mjaft të mirë. Ajo ka një qjatësi prej 500 m. dhe gjerësi prej 75 m.; në pjesën jugperëndimore ngushtohet deri në 15 m. Muret rrethuese ruhen pothuaj të padëmtuar në tërë perimetrin e saj prej rreth 1300 m. Në pjesën më të madhe të tyre muret ngrihen mbi shkëmbin e thepisur e të pangjitshëm; ata ndjekin konfiguracionin e terrenit me vija të drejta, por herë pas here pësojnë thyerje për arësye konstruktive ose për qëllime mbrojtjeje. Kullat janë të rralla dhe janë përdorur kryesisht për të forcuar hyrjet apo ndonjë pikë tjetër të dobët; skaji jugperëndimor formon një kullë të madhe ose një bastion më vehte (Tab I, 2). Në kala hyhet nëpërmjet tre



Fig. 2

DO NOT COPY

portave: njëra në anën verilindore, kurse dy të tjerat që ndryshojnë nga përmasat e trajtimi nga e para, në anët gjatësore, pothuajse përballë njëra tjetrës.

Bërthamën e kalasë e përbën kalaja e periudhës para pushtimit turk, e cila zë pjesën verilindore dhe qendrore. Zgjerimi i kalasë ka ndodhur në drejtimin jugperëndimor të saj, gjë që kuptohet nga gjatësia më e madhe në krahasim me atë që na kumton Çelebiu, si dhe nga teknika dhe trajtimi i ndryshëm i mureve në këtë pjesë. Në këtë kohë është mbyllur porta jugperëndimore e kalasë dhe në vend të saj janë hapur dy portat anësore. Ky zgjerim duhet të ketë ndodhur në kohën e Ali Pashë Tepelenës në vitet 1813-1814 pasi ai pushtoi me forcë qytetin. Për këtë na njofton edhe Hani [16]), por në vend të termit rindërtim ai përdor termin ndërtim, që është bërë shkak për përhapjen e pikëpamjes së gabuar, sipas së cilës kalaja e Gjirokastrës është ndërtuar prej Ali Pashës. Ka shumë mundësi që edhe akuedukti që furnizonte me ujë kalanë (Fig. 3, 4) prej të cilit sot ruhen vetëm disa gjurmë të zbehta, të jetë ndërtuar në vitet 1813-1814. Megjithatë një dyshim lind për këtë nga një pasazh i Pukëvilit i cili duke përmendur luftën që bëri Ali Pasha për pushtimin e qytetit shkruan se «ushtritë e Vezirit ndër të tjera prenë ujësjellësat» [17]).

Pjesa verilindore e kalasë nuk ka pësuar transformime të rëndësishme. Në të ruhen: hyrja verilindore (Tab I, 3) dhe në të djathtë të saj nga ana e jashtme

16) I. G. Hahn. **Albanesische Studien** – Jena 1854, f. 53.
17) F.C.H.L. Pouqueville. **Voyage de la Grèce** Paris 1820, vol. I, lib. II; Kap. V,

DO NOT COPY



Fig. 3 — Kalaja dhe akuedukti gravurë shek. XIX.



Fig. 4 — Gjëndja e akueduktit para rënimit total që pësoj në vitin 1932.

disa ambiente për strehimin e rojeve, si dhe në vazhdim të tyre dy kulla katrore. Nga pastrimet dhe gërmimet e kryera vitet e fundit kanë dalë në dritë, një burg mesjetar dhe disa galeri e ambiente, destinacionin e të cilave nuk e përcaktojmë dot. Në këtë pjesë të kalasë ruhen gjurmë të rrugës gjatësore, si dhe mbeturina ndërtesash banimi që shtrihen deri në buzë të rrugës. Rindërtimit të kalasë në këtë pjesë i përkasin dy kulla poligonale të pajisura për qitje me artileri, të cilat nga trajtimi dhe teknika kanë ngjashmëri me kullat e fortifikimeve të njohura të Ali Pashë Tepelenës. Pjesa tjetër e kalasë pësoi rindërtime e transformime me rëndësi. Nga këto ruhen një sërë galerish (Tab I, 4) e ambientesh që mbulojnë tërë sipërfaqen. Megjithkëtë edhe në pjesën qëndrore ekzistojnë dëshmi të ndërtimit të parë, që, veç pjesëve të murit rrethues, janë rruga gjatësore dhe një furrë e hershme.

Qyteti, siç e pamë, u zgjerua jashtë mureve rrethuese në gjysmën e parë të shek. XVI, u zhvillua në çerekun e tretë të shek. XVII dhe arriti kulmin gjatë shek. XVIII. Ashtu siç trashëgohen sot, ndërtimet e gjinive të ndryshme që e përbëjnë i takojnë kryesisht shek. XVIII-XIX. Pas zgjerimit të saj, Gjirokastra u zhvillua në bazë të një skeme radiale. Këtë e vërteton rrjeti rrugor, i cili përqëndrohet në formë rrezesh në qendër të qytetit (fig. 7),. Si çdo skemë e zhvillimit të qyteteve mesjetare, dhe skema e Gjirokastrës nuk është rrjedhim i një dëshire ose studimi. Përkundrazi, rrjeti kryesor rrugor ishte krijuar disa shekuj para zgjerimit të qytezës mesjetare jashtë mureve rrethuese. Ai është dëshmi e gjallë që tregon se si qyteza e lashtë me pazarin përbri saj dhe rrugët që e ndërlidhnin me trevën përreth diktuan skemën koncentrike të shtrirjes dhe zhvillimit të tij. Megjithëqë gjatë shek. XVII qendra ekonomike kulturale dhe administrative e qytetit ishte shpërngulur nga kalaja në vendin e sotëm, skema dhe zhvillimi i tij nuk pësuan ndryshime thelbësore. Rrugët e vjetra që lidhnin kalanë me trevën përreth përbëjnë sot e kësaj dite arteret kryesorë të qytetit (fig. 5). Rrugët e Gjirokastrës thyhen e lakohen për të ndjekur relievin. Mjeshtrit popullorë shqiptarë që e ndërtuan gjatë shekujve dijtën që në përputhje me kushtet e jetës, konditat e terrenit dhe mundësitë teknike, t'u japin zgjidhje të drejtë problemeve të ndryshme dhe të vështira që shtronte qyteti.

Nga pazari i dikurshëm pranë kalasë nuk ruhet asnjë gjurmë. Të vetmet dëshmi janë emri i lagjes Pazari i Vjetër dhe rrugët e zonave përreth që drejtohen njëkohësisht edhe në këtë pikë të qytetit. Ndër këto, rrugët e zonës fushore janë rrugët kryesore të lagjeve Pllakë dhe Pazari i Vjetër si dhe rrugët e lagjeve Hazmurat, Meçite, Varosh dhe Palorto; rrugët e zonave të shpatit të malit të Gjerë janë rrugët kryesore të lagjes Palorto dhe lagjes Cfakë; ndërsa rrugët e zonës së malësisë janë rrugët kryesore të dy lagjeve Dunavat dhe dy lagjeve Manalat. Për rrugët e zonës fushore dëshmojnë gjithashtu edhe tre urat prej guri mbi lumin e Drinos në afërsi të qytetit.

Të gjitha lagjet e qytetit që lindën dhe u zhvilluan gjatë shekujve të kaluar trashëgohen në gjendje shumë të mirë. Ato ruajnë rrugët kryesore dhe sekondare si dhe ndërtimet që i përbëjnë. Kjo i kushtohet krye-

sisht faktit se para çlirimit qyteti nuk pati ndonjë zhvillim ekonomiko-social kështu që ato nuk pësuan transformime. Mbas çlirimit, megjithë zhvillimin e qytetit, në sajë të masave të marra për mbrojtjen e monumenteve, transformimet nuk e ulën në mënyrë të ndjeshme vlerën e tyre historike e kulturalo-artistike. Ndër lagjet e qytetit që paraqesin interes dhe vlerë të veçantë janë: lagjia Pllakë, Pazari i Vjetër (Tab II, 1) dhe Dunavat i Parë që shtrihen në të njëjtin kurriz kodrinor mbi të cilin ngrihet kalaja; lagjet Hazmurat (Tab. II, 2), Meçite, Teqe, që shtrihen në afërsi të qendrës dhe tregut të qytetit, si dhe pjesë të lagjeve Varosh e Palorto. Interes dhe vlerë paraqesin gjithashtu dhe disa ansamble të lagjeve prapa kalasë, Manalat e Cfakë (Tb. II, 3) të cilat kurorëzojnë kreshtat kodrinore e shkëmbore të kësaj ane. Tregu gjithashtu përbën një ansambël me vlerë të madhe për qytetin. Ai shtrihet në kryqëzimin e rrugëve kryesore të qendrës së qytetit të sotshëm (Tab. III, 1). Dyqanet janë dykatëshe, të ndërtuara me mur guri të gdhëndur në katet e para, të cilat ruhen në gjëndje shumë të mirë. Rrugët në të dy anët përshkohen nga trotuare të shtruara me pllaka guri dhe të shkallëzuara për t'ju përgjigjur pjerrësisë së theksuar të rrugëve. Deri në 10-vjeçarin e parë të shekullit tonë rrugëve ruheshin pjergulla, të cilat krijonin një hije të dendur gjatë stinës së verës. Nga sa thamë më sipër del se tregu i ri, siç e quan Çelebiu në shek. XVII, me zhdukjen e tregut të vjetër pranë kalasë, filloi të quhet tregu i qytetit, emër që e mban edhe sot. Nga ana tjetër, numuri i kateve, sasia e dyqaneve dhe teknika e ndërtimit na lejojnë të supozojmë se edhe si ndërtim ky treg i takon shek. XVII.

E gjithë kjo dëshmon se qyteti ruan vlera të mëdha. Këto vlera rriten akoma më shumë për faktin se skema radiale që ndoqi qyteti dhe shtrirja e zhvillimi i tij në të kaluarën ruhen në gjëndje pothuaj të paprekur. Ajo që bie në sy në qytetin e Gjirokastrës është uniteti i gjuhës arkitektonike me të cilën është trajtuar jo vetëm qyteti por edhe lagjet, ansamblet, monumentet dhe çdo ndërtim i tij. Rritmi i lëvizjes së volumeve, i shpërndarjes së vlerave urbanistike, i interkalimit të pjesëve bosh dhe plot dhe i dritës e hijes e bëjnë Gjirokastrën një ndër qytetet më karakteristikë dhe piktoreskë të vëndit tonë.

Edhe banesat e shumta që trashëgojmë në qytetin e Gjirokastrës, përbëjnë një pasuri të madhe kulturale të këtij qyteti. Ato përfaqësojnë një vlerë të veçantë dhe janë një burim me rëndësi për ndriçimin e prejardhjes, krijimit dhe evolucionit të banesës së këtij qyteti gjatë shekujve.

Banesat që ruhen sot në qytetin e Gjirokastrës i takojnë shek. XVIII-XIX kryesisht shek. XIX. Për fat të keq banesat e hershme nuk ruajnë datën e ndërtimit, ndërsa rindërtimet apo adaptimet e tyre gjatë shek. XIX si dhe banesat që ndërtohen gjatë këtij shekulli fillojnë të datohen. Në mungesë të datimeve më të plota, jemi mbështetur në të dhëna të tërthorta: në kompozimin dhe trajtimin e tyre, në degradimin e lëndës së drurit, në kalimin nga përdorimi i gozhdave të kovaçit në ato të fabrikës dhe në datimet e adaptimeve të banesave më të hershme. Bashkërenditja e fakteve të mësipërme në të gjitha rastet e konstatuara na kanë lejuar diferencimin e tyre simbas lashtësisë.

Banesat më të hershme, si ndërtim, i takojnë shek. XVIII. Ato janë zhvillimi i mëtejshëm, pas zgjerimit të qytetit jashtë mureve rrethuese të tij, i banesës së lashtë të parapushtimit turk që përshkruan Çelebiu në shek. XVII. Me sa duket, gjatë shek. XVIII, me zhvillimin e madh ekonomik, politik dhe kultural, kjo banesë arriti kulmin e zhvillimit të saj. Këto banesa janë në përgjithësi me dy-tre kate (Tab. IV), dhe jo rrallë me katër kate (Tab. III, 2). Numri i kateve dhe ambientet e banimit, shpesh me dy rradhë dritare ua shtojnë atyre akoma më shumë lartësinë. Janë ndërtuar me mure të gjera guri, të gdhëndur në pjesët më të rëndësishme dhe më në pah. Katet e para mbulohen me konstruksione të harkuara ndërsa catitë me rrasa guri. Trajtimi i kateve të para, ku vendosen ambientet ekonomike, me mure të gjera, me mbulesa të harkuara, me frengji dhe me dritare të vogla e të vendosura lart nga toka dhe pajisja, në shumicën e rasteve me stera, i japin banesës gjirokastrite një karakter të theksuar mbrojtës duke e kthyer atë në një kështjellë të vogël (Tab. IV, 5). Nga ana tjetër, trajtimi i kateve të sipërme ku vendosen ambientet e banimit dhe ndihmëse, me dritare të mëdha, me çardake, qoshke e shanishane, me strehë të dala në mënyrë të theksuar (Tab. IV) dhe me muret e ambienteve kryesore të jashtme shpesh të pikturuara me dekoracione floreale, pamje panoramike apo skena gjuetije (fig. 6) e bëjnë këtë banesë, në kushtet konkrete të këtij qyteti dhe të materialeve lokale të ndërtimit, një ndër banesat më tipike dhe më origjinale të qytetit mesjetar shqiptar.

Më vonë, duke filluar nga fundi i shek. XVIII sidomos gjatë shek. XIX, me shtimin e kontakteve dhe marrëdhënjeve me vendet fqinjë banesat e hershme fillojnë të adaptohen dhe të transformohen. Në këtë kohë mbyllen çardaket, qoshket dhe shanishanet; strehët e theksuara shkurtohen dhe suvatohen; musandrat dhe mafilet humbasin funksionin e tyre dhe kthehen në elemente dekorative e kështu me radhë. Gjatë kësaj periudhe mund të themi kristalizohet dhe lind një tip i ri, i cili ruan në thelb kompozimin dhe strukturën e banesës së hershme.

DOKTORIK

DO NOT COPY



Fig. 5 — Rruga kryesore e lagjes Varosh.

Karakteri mbrojtës i banesës gjirokastrite si duket ka influencuar rrënjësisht në trajtimin planimetriko-funksional, në kompozimin e volumeve në hapësirë (Tab. IV) në zgjidhjen dhe trajtimin arkitektonik si dhe në teknikën e ndërtimit, duke krijuar kështu një banesë me tipare të veçanta në kuadrin e banesës mesjetare të qyteteve shqiptare të para pushtimit otoman. Karakteristikë e kësaj banese në këtë drejtim është edhe vendosja e saj në pjesën më të ngritur të parcelës dhe mundësisht, lirshëm nga të katër anët (Tab. IV, 3). Parcelat shkallëzohen me terraca për vendosjen e banesës, krijimin e oborrit, kopshtit dhe vreshtës. Oborri rrethohet me mure të larta të cilat kishin funksion mbrojtjeje. Ky tipar mbrojtës i banesës shihet edhe në vendosjen e saj, karshi rrugëve, dhe në shfrytëzimin e terrenit të aksidentuar.

Banesa gjirokastrite ashtu si banesat e qyteteve të tjera mesjetare të parapushtimit otoman përbën tipin më origjinal dhe më karakteristik të banesës qytetare shqiptare. Këto banesa nuk i takojmë në qytetet e tjera mesjetare që lindën dhe u zhvilluan gjatë pushtimit turk. Pra jemi të mendimit se kjo banesë nuk është produkt i periudhës së pushtimit otoman, por më i hershëm. Ajo lindi dhe u zhvillua krahas lindjes dhe zhvillimit të këtyre qyteteve, pra gjatë shek. XII-XIV. Në prag të këtij pushtimi ajo kishte arritur një zhvillim të madh.

* * *

Nga sa thamë arrimë në përfundim se në qytetin e Gjirokastrës ruhet nga e kaluara një trashëgimi kulturale me vlerë të madhe. Kjo pasuri zë një vënd me rëndësi të veçantë në fondin e krijimtarisë popullore. Ajo përbën një dëshmi të gjallë historike të dorës së parë për ndriçimin dhe thellimin e mëtejshëm të problematikës së gjerë të zhvillimit ekonomik, shoqëror e kultural të së kaluarës dhe në radhë të parë të lindjes, zhvillimit dhe karakterit të qytetit mesjetar shqiptar.

Qyteti i vjetër i Gjirokastrës përbën pjesën kryesore të qytetit të sotshëm. Ai ze një sipërfaqe prej rreth 160 ha. Zhvillimi i tij, gjatë këtij shekulli, filloi vetëm mbas çlirimit, sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Gjatë kësaj kohe, ai filloi njëkohësisht të shtrihet poshtë, në verilindje, përbri rrugës nacionale.

Zonifikimi i qendrës historike të qytetit, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë që ruhet brënda kufijve të saj dhe ndërtimi e zhvillimi i mëtejshëm i qytetit nuk janë probleme të thjeshta. Qyteti i vjetër flet qartë me gjuhën e shekujve të kaluar; ndërtimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tij, gjithashtu, duhet të flasë qartë e fuqishëm me gjuhën e rendit të ri socialist. Pikërisht bashkërendimi dhe harmonizimi i së resë me të vjetrën përbën problemin kryesor dhe më të ndërlikuar që duhet zgjidhur e përballuar.

Shpejtësia e rritjes demografike, progresi i vazhdueshëm ekonomiko-social, zhvillimi i industrisë dhe kërkesa gjithnjë në rritje për përmirësimin e konditave të jetesës, sjellin me vete edhe një varg problemesh urgjente që kanë të bëjnë me mbrojtjen e vlerave kulturale që ruan qyteti. Kërkesa e drejtë e qytetarëve për të patur komoditetet e kohës përbën një ndër problemet kryesore për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e qendrës historike. Kjo kërkon para së gjithash të kuptohet dhe të vlerësohet drejt bashkërenditja dhe harmonizimi i mbrojtjes dhe i konservimit të qendrës historike të qytetit me kërkesat dhe nevojat për zhvillimin e mëtejshëm të tij. Eksperienca e derisotme ka vërtetuar se ndërtimi i shpejtuar i godinave të reja administrative, shoqërore e kulturale, i blloqeve të banimit shumëkatëshe dhe i ndërtesave

DO NOT COPY

private, si dhe adaptimi e transformimi i banesave të vjetra apo zgjerimi e rektifikimi i disa rrugëve karakteristike, pa marrë parasysh se kemi të bëjmë me një qendër historike, kanë sjellë si pasojë një degradim të ambientit dhe të ansambleve e monumenteve. Nuk është çështja të ruajmë monumente të veçanta me vlerë të madhe apo unikale, por t'i ruajmë ato së bashku me ambientin që i rrethon. Po qe se do t'i zhveshim nga ky ambient atëhere këtyre monumenteve u kemi shkaktuar një dëm të pariparueshëm; ato do të mbeten vetëm dëshmi të izoluara dhe të zbeta të kohës tyre. Sado serioze të jenë në të ardhmen përpjekjet për një rikonstruksion mbi bazën e mbeturinave, sado e madhe të jetë forca e imagjinatës, nuk do të arrihet kurrë të krijohet një kuadër i plotë e aq besnik i asaj që është.

Prandaj mbrojtja e shumëanëshme, me tërë seriozitetin që kërkohet nga një dëshmi historike është detyrë e domosdoshme për të shpëtuar këto pasuri arkitektonike e artistike që trashëgojmë sot në qytetin e Gjirokastrës.

Për vënien në mbrojtje të kësaj trashigimije, të mbështetur edhe në kriteret e zonifikimit të qytetit-muze të Beratit, qytetin e Gjirokastrës e kemi ndarë sipas vlerës e rëndësisë në tri zona (fig. 7). Dy të parat, zona muze dhe zona e mbrojtur përbëjnë qendrën historike, ndërsa e treta përbën zonën e lirë. Gjithashtu ndërtimet që përbëjnë qendrën historike i kemi klasifikuar sipas vlerës, në monumente të kategorisë së parë dhe në monumente të kategorisë së dytë.

Zona muze përfaqëson atë pjesë të qytetit që ruan në kompleks më së miri vlera me rëndësi të madhe historike, urbanistike dhe arkitektonike. Zona e mbrojtur ruan gjithashtu vlera relativisht të rëndësishme, të cilat, së bashku me ato të zonës muze plotësojnë brënda kufijve të qendrës historike, kuadrin e qytetit muze. Zona e lirë përfaqëson pjesën më të madhe të qytetit të vjetër të Gjirokastrës. Në këtë zonë ruhet vetëm një numur shumë i kufizuar monumentesh me vlerë të veçantë.

Monumentet e kategorisë së parë janë përfaqësues me vlerë të madhe për arkitekturën gjirokastrite në veçanti dhe për atë qytetare shqiptare në përgjithësi. Monumentet e kategorisë së dytë ruhen vetëm brënda kufijve të qendrës historike. Këto duke u marrë të shkëputura nuk paraqesin ndonjë vlerë të veçantë por në kompleksin e qendrës historike luajnë një rol vendimtar.

Kriteret kryesorë për ndarjen e qendrës historike në zonë muze dhe në zonë të mbrojtur janë diferencimi sipas vlerave i ansambleve dhe monumenteve; dhe shkalla dhe metoda e ndërhyrjes për konservimin e tyre. Ndërsa klasifikimi i ndërtimeve që përbëjnë qendrën historike në dy kategori monumentesh është bërë në bazë të dallimit sipas vlerës, duke shkallëzuar për to dhe masat përkatëse për adaptim dhe shfrytëzim.

Në përvizimin e kufijve të qendrës historike janë patur parasysh: terreni dhe ambienti karakteristik mbi të cilin lindi qyteza mesjetare dhe më vonë u zgjerua dhe u zhvillua qyteti jashtë mureve rrethuese; ansamblet, lagjet dhe pjesë karakteristike të lagjeve si dhe monumente të veçantë, më tipike dhe më me vlerë, të gjinive të ndryshme.

Pjesa e qytetit që i plotëson më së miri kërkesat ndaj qendrës historike, është qendra e qytetit dhe pjesa që shtrihet në verilindje. Qendra historike, pa llogaritur gjelbërimet dhe brezin mbrojtës, përbën rreth 25% të qytetit të vjetër, ndërsa zona muze dhe e mbrojtur që e përbëjnë, zënë respektivisht rreth 11% dhe 14%. Brënda kësaj qendre përfshihen: kalaja, gjurmët e ujësjellësit (akueduktit), tregu i sotshëm, lagjet Pazari i Vjetër, Pllakë, Hazmurat, Meçite dhe Teqe; pjesë të lagjeve Varosh dhe Palorto si dhe disa



Fig. 6 — Trajtim dekorativ i pamjes së jashtëme të banesës Gjirokastrite.



DO NOT COPY

Fig. 7

ansamble që kurorëzojnë kreshtat kodrinore e shkëmbore të lagjeve Manalat e Cfakë.

S'ka dyshim se ruajtja e qendrës historike, si qëllim në vetvete, pa marrë parasysh se qyteti jeton dhe zhvillohet, do të ishte e pamundëshme. Në këto rrethana, një rol vendimtar për konservimin e qendrës historike lot dhe do të luajë shfrytëzimi, për nevojat e jetesës, i kësaj pjese të qytetit dhe i ndërtimeve që e përbëjnë. Praktika ka treguar se nga çdo pikëpamje shfrytëzimi i monumenteve për funksionet për të cilat u krijuan është rruga më e përshtatëshme për mbrojtjen e tyre. Prandaj edhe plotësimi i kërkesave të qytetit dhe të banorëve që jetojnë në këto pjesë, me ecjen përpara të jetës dhe të komoditetit, pa cënuar vlerat që ato përfaqësojnë, përbën një faktor me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e qendrës historike. Nga adaptimi i diferencuar për shfrytëzim nuk përjashtohet asnjë monument apo ndërtim që është vënë në mbrojtje. Kur monumentet e kategorisë së parë, që përbëjnë një numër shumë të kufizuar, nuk mund të shfrytëzohen ashtu siç janë ndërhyrjet për adaptimin e tyre duhet të jenë të heqshme (reversibël) ndërsa monumenteve të kategorisë së dytë mund t'u bëhet çdo adaptim i brëndshëm por pa cënuar pamjen e jashtme, në radhë të parë të atyre që ruhen në zonën muze.

Ndërtimet e reja, siç e ka treguar eksperienca e derisotme, kanë dëmtuar unitetin dhe vlerën e qendrës historike. Kur, për arësye të paevitueshme, do të detyrohemi të bëjmë ndërtime të reja, dhe këto vetëm në zonën e mbrojtur, kompozimi i volumeve të tyre në hapësirë dhe trajtimi arkitektonik i pamjes së jashtme është e domosdoshme t'i nënshtrohet ambientit dhe monumenteve me të cilët do të bashkëjetojë.

Sigurisht të tëra këto në zgjidhjen praktike të tyre paraqesin shumë probleme që kërkojnë studime të veçanta dhe të thelluara. Megjithatë mendojmë se ky studim mund të shërbejë si mbështetje për zgjidhjen e disa problemeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e qendrës historike dhe të ndërtimeve që e përbëjnë, si dhe me zhvillimin e mëtejshëm të këtij qyteti.

DO NOT COPY

TAB. I



1. — Pamja veri lindore e qendrës së qytetit dhe e kalasë.



2. — Pamja jug-perëndimore e kalasë, në plan të parë kulla në formë bastioni.



3. — Hyrje në pjesën veri-lindore të kalasë.



4. — Galeri në pjesën jug-lindore

DO NOT COPY

DO NOT COPY



1. — Lagja Pazari i Vjetër.



2. — Pamje nga lagja Hazmurat.



3. — Pamje e pjesëshme e lagjes Cfakë.

TAB. III.



1 – Qëndra e qytetit (Pazari) në plan të parë dhe pjesa e lagjes Teqe dhe Palorto në plan të dytë.



2 – Banesa në lagjen Teqe.

DO NOT COPY







DO NOT COPY

1 – Kompleks banesash në lagjen Dunavat.

2 – Banesë në lagjen Palorto.

3 – Banesë në lagjen Dunavat.

4 – Banesë në lagjen Dunavat.

5 – Banesë në lagjen Palorto.





DO NOT COPY

Gani STRAZIMIRI

GJIROKASTËR ET SES VALEURS CULTURELLES

RESUME

La ville de Gjirokastër conserve, en bon état, un riche patrimoine de monuments de la culture matérielle, créés à travers les siècles par le génie populaire. Ils constituent une source authentique qui jette la lumière sur notre histoire et en particulier sur l'oeuvre créatrice du peuple en matière d'architecture. Ces monuments, de genre divers, comportent des éléments très précieux, mais le fait qu'ils sont groupés en ensembles et traités dans le même langage architectural en accroît grandement l'intérêt. Appréciant les importantes valeurs que cette ville renferme, le Conseil des Ministres l'a proclamée, en 1961, ville-musée.

En tant que ville, Gjirokastër doit sa naissance à la nécessité d'un centre d'échanges qui desserve la vallée agricole du Drino et les hautes régions pastorales de Kurvelesh et de Zagorija. La ville est mentionnée pour la première fois sous nom d'Argyrocastro en 1336, par le chroniqueur byzantin, J. Cantacuzène, qui la qualifie d'abord de cité puis de citadelle. Sa population a dû s'accroître vers le XIVe s. ou vers le début du XVe, lorsqu'elle devint le centre des possessions des Zenevisi. Par la suite, à partir de 1417, date où la ville tomba aux mains des Turcs, sa population, de même que celle des autres cités d'Albanie, dut vraisemblablement diminuer. Jusqu'au début du XVIe siècle, la ville ne comptait alors, que 143 maisons. C'est au cours du XVIIe siècle, lorsque commence la désagrégation de l'économie naturelle des villages et la rapide croissance des villes, que Gjirokastër se développe à un rythme accéléré. Si l'on tient compte du fait que la ville comptait à cette époque quelque 380 maisons et que, selon Evlia Tchélébi, le voyageur turc connu, qui la visita en 1672, l'enceinte ne pouvait en contenir plus de 200, il apparaît que l'expansion de la ville a dû se produire au cours du XVIe siècle, période qui correspond au début d'une stabilisation relative du pouvoir turc dans notre pays. Le premier quartier qui surgit en dehors des murs d'enceinte de la cité fut apparemment le quartier Pllakë. Plusieurs données témoignent en faveur de cette hypothèse; il se situe en effet dans le prolongement du dos de colline sur lequel se dresse la cité, très près des murs d'enceinte de la citadelle; il s'étend le long de la rue principale qui menait de ce côté à la place où avait lieu le marché des villages environnants; et enfin Tchélébi qualifie les habitations de ce quartier de mauvaises maisons, c'est à dire de plus anciennes par rapport à celles des autres maisons de la ville. Immédiatement après, et ce avant le début du XVIIe siècle, les quartiers de Teqe, Meçite, Hazmurat, Varosh, Palorto, Dunavat et Munalat virent le jour et se mirent à croître tour à tour. Au XVIIIe s. à l'endroit où se situe aujourd'hui le centre de la ville, fut créé un nouveau marché appelé pazar i Memi beut. Il est facile d'en déduire que l'ancienne ville médiévale avait, à l'époque, commencé à perdre en partie sa fonction séculaire et que le nouveau marché avait réduit à tel point l'importance de l'ancien, que celui-ci

DO NOT COPY

disparut complètement par la suite, sur son emplacement se constitua un quartier d'habitation. Selon ces données, le nouveau centre se déplaça donc de la citadelle médiévale à Varosh e Poshtëm; et, en conséquence, dès lors, ce ne fut plus la citadelle, mais le nouveau centre et le nouveau marché qui servirent d'épicentre au développement de la ville.

Enfin, si l'on tient compte de l'absence de vestiges anciens sur le territoire de la ville et du fait qu'il n'est pas fait mention de celle-ci dans les sources écrites antérieures au XVI siècle, on peut en conclure que Gjirokastër est éclose pendant le moyen âge, et que, comme la plupart des villes médiévales albanaises, elle a dû vraisemblablement être fondée aux XIIe et XIIIe siècles.

Gjirokastër s'étend sur le flanc du Mali i Gjerë, sur un assemblement de dos de colline, d'éminences rocheuses et de versants, coupés d'impétueux torrents saisonniers, qui vont se jeter dans le fleuve Drino. Au sud-ouest et au nord-ouest, la ville est respectivement bornée par les hauteurs du Mali i Gjerë et la plaine du Drino; au sud-est et au nord-ouest par les torrents saisonniers de la Bufane et du Çavo.

La culture matérielle du passé y a laissé comme témoignages: la citadelle, l'embryon de réseau routier qui reliait les zones environnant la cité et le marché adjacent à la citadelle, le système des rues de la ville après son expansion hors des murs d'enceinte, les différents quartiers, le marché, ainsi que des monuments et des constructions de genre divers.

La citadelle est située sur un plateau rocheux qui surplombe le dos de colline, qui, partant du Mali i Gjerë, traverse la ville dans le sens sud-ouest-nord-est. Son périmètre de forme oblongue, a une longueur maximale de 500 m et une largeur maximale de 75 m. Ses murs d'enceinte, d'une épaisseur atteignant 3 mètres, sont conservés pour ainsi dire intacts sur toute leur hauteur. On accède à la citadelle par trois portes. L'une donne sur le nord-est, les deux autres sur les faces latérales, presque vis-à-vis l'une de l'autre. Le noyau de la citadelle est constitué par la forteresse qui date de la période antérieure à l'occupation ottomane et occupe le nord-est et le centre du territoire enceint. L'extension de la citadelle s'est opérée en 1813-1814 vers le sud-ouest, à l'époque d'Ali pacha de Tépélène, après que celui-ci se fut emparé de la ville. Il est fort probable que l'aqueduc qui approvisionnait la citadelle en eau, et dont il ne subsiste aujourd'hui que quelques pâles vestiges, ait été construit ces années-là.

Dans la première moitié du XVIe siècle, la ville déborda des murs d'enceinte. Elle se développa durant le troisième quart du XVIIe siècle, pour atteindre son apogée au cours du XVIIIe s. Après avoir débordé de ses murs, la ville s'étendit selon un schéma concentrique. En témoigne le réseau routier, dont les artères convergent en rayons vers le centre de la ville. La cité ancienne, le marché adjacent et les communications avec la région environnante dictèrent précisément ce schéma concentrique d'extension et de développement de la ville.

Tous les quartiers de la ville qui sont nés et se sont développés durant les siècles passés sont conservés en excellent état. D'un intérêt particulier sont ceux de Pllakë, Pazar i Vjetër et Dunavat i parë, qui couvrent le même dos de colline sur lequel s'élève la citadelle; les quartiers d'Hazmurat, Meçit et Teqe, qui s'étendent à proximité du centre et du marché de la ville, certaines parties des quartiers Varosh et Palorto, quelques ensembles de constructions des quartiers situés derrière la citadelle, ainsi que le marché qui occupe les carrefours des principales routes du centre de la ville actuelle.

Les plus anciennes habitations de la ville datent du XVIIIe siècle. Elles représentent un développement ultérieur de l'ancienne habitation type de la période qui précéda l'occupation turque, habitation qui, apparemment, avec le grand essor économique, politique et culturel de l'époque, atteignit au cours du XVIIIe s. l'apogée de son développement. Les maisons ont un, deux, et, assez souvent trois étages au-dessus du rez-de-chaussée. La conception du rez-de-chaussée, qui comprend les locaux à usage ménager,

avec leurs murs épais, leurs meurtrières et leurs petites fenêtres placées haut au-dessus du sol, confère à l'habitation de Gjirokastër un caractère défensif et en fait un petit château-fort. D'autre part, la conception des étages supérieurs, où sont situées les pièces d'habitation et les annexes, avec leurs grandes fenêtres, et leurs galeries souvent décorées de peintures, fait de cette demeure l'une des plus typiques et des plus originales de la ville médiévale albanaise.

Pour la mise sous protection de cet héritage culturel, nous avons divisé Gjirokastër en trois zones, la zone-musée, la zone protégée et la zone libre. Les parties de la ville qui remplissent le mieux, à notre sens, les conditions pour devenir zone-musée et zone protégée sont certains quartiers situés au centre et au nord-est. Elles couvrent au total quelque 28%, et respectivement 16 et 12% des 160 ha que compte la superficie de l'ancienne ville. Nous pensons que les limites du centre historique devraient englober: la citadelle, les vestiges de l'aqueduc, le marché actuel, les quartiers Pazari i Vjetër, Pllakë, Hazmurat, Meçite et Teqe, quelques parties des quartiers Varosh et Palorto, ainsi que certains ensembles de constructions qui couronnent les collines au sud-est de la citadelle.

Nul doute que la conservation de ce centre historique en tant que but en soi ne peut être conçue qu'en fonction de la vie et du développement de la ville. Dans ces conditions, un rôle déterminant dans la conservation de ce centre historique devra notamment revenir à l'exploitation de cette partie de la ville et des monuments qu'elle contient, en fonction des exigences de la vie quotidienne.

Les constructions nouvelles, comme l'a montré l'expérience acquise à ce jour, ont nui à l'unité et à la valeur de ce centre historique. Quand, pour des motifs impérieux, nous nous verrons contraints d'entreprendre des constructions nouvelles, il sera indispensable que la composition de leurs volumes et la conception architecturale de leur aspect extérieur soient subordonnés aux monuments aux côtés desquels elles s'élèveront. Nous espérons que cette étude pourra servir de fondement pour la solution de certains problèmes relatifs à la protection de ce centre historique et des bâtiments qui le composent, ainsi que pour l'expansion ultérieure de la ville.

DO NOT COPY

Skënder BEJKO

DO NOT COPY

KALAJA E TEPELENËS

Tepelena është vendosur buzë Vjosës, në një nyje kyçe pranë grykës së Këlcyrës, nga ku kalonin rrugë të rëndësishme, që lidhnin që në antikitet Lindjen me Perendimin.

Gjurmë antike gjejmë edhe sot te ura nën kala, e cila u është nënshtruar riparimeve edhe në kohën e Ali Pashës, gjë që kuptohet nga ngjashmëria me teknikën e ndërtimit të kalasë. Pasi kalon urën, rruga shkon përbri kalasë nga ku një degëzim të çon në hyrjen lindore.

Tepelena përmendet për herë të parë nga burimet historike në vitin 1492, kur Sulltan Bajaziti II sulmoi Himarën [1]). Në këtë kohë Tepelena ka pasur një kala, në të cilën ishin mbyllur kryengritësit shqiptarë së bashku me venedikasit. Këtë kala turqit gjatë rrethimit e prishën dhe materialin e saj e përdorën për ndërtimin e një tjetre, pranë të parës. [2])

Nga kështjella e parë nuk kemi asnjë gjurmë, ndërsa ajo që ndërtuan turqit ruhet në gjendje pak a shumë të mirë dhe ndodhet brenda kalasë së ndërtuar nga Ali Pasha. Kalanë e ndërtuar nga turqit, E. Çelebiu e përshkruan me perimetër gjashtëqind hapa, me mure të trasha e të larta 40 kut dhe me dy porta nga veriu e lindja.



Fig. 1

1) **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** vol. II, f. 362.
2) E. Çelebiu — **Shqipëria para dyqind vjetësh,** Tiranë 1930, f 48.

DO NOT COPY



Fig. 2 — Planimetria.

Në vitin 1789 [3]), Tepelena, që më parë ishte nën vartësinë e Ibrahim Pashës, sundimtar i pashallëkut të Vlorës, bie në dorë të Aliut. Në 10-vjeçarin e parë të shek. XIX Aliu mbaroi në Tepelenë ndërtimin e sarajit të tij, të cilin më 21 tetor 1809 e vizitoi lordi Bajron.

Ndërtimin e kalasë (fig. 1), Aliu e ka filluar vonë, në kohën kur po hynte në konflikt të hapur me Portën e Lartë. Një mbishkrim në gjuhën greqisht, që është murosur mbi hyrjen lindore, e daton atë në vitin 1819, ndërsa në vitin 1820 marrëdhënjet me Stambollin u prenë [4]).

Kalaja turke, ka formë katërkëndëshe me përmasa 56 x 40 m. (fig. 2). Në gjendjen e sotme ajo ka dy kulla të rrumbullakta në faqen perendimore, nga të cilat atë të jugut e zbuluam gjatë punimeve restauruese të vitit 1968. Kullat kanë diametrin e jashtëm 10 m. dhe lartësi rreth 5 m. Kalaja ka dy hyrje: nga veriu dhe nga lindja. Në krahun e majtë të hyrjes veriore gjejmë gjurmët e bazamentit të një minareje të përfshirë në murin e kalasë; ashtu si dhe një pjesë e murit në këtë vend; ajo është ndërtuar me teknikën «cloisonnage» (Fig. 3).

Mbi këto fragmente si dhe në faqet e tjera muratura është ndërtuar me gurë të lidhur me shumë llaç.

Ekzistenca paralele e dy teknikave, veçanërisht në faqen veriore, na shtyn të mendojmë se kjo kala ka pësuar një rindërtim të mëvonshëm. Muret kanë trashësi rreth 1,5 m. Për shkak të rrënimit të mureve, trapin e gjejmë vetëm në pjesën e sipërme të murit perendimor, ndërsa në muret e tjera ai mungon.

Kalaja e ndërtuar nga Ali Pasha (Fig. 2) është trajtuar në përshtatje me terrenin. Ajo ka formën e një shumëkëndëshi të përzgjatur nga veriu. Zgjedhja e kujdesshme e terrenit e bën kalanë dhe veçanërisht faqen lindore të saj të pangjitshme. Kalaja ka tri kulla poligonale që ndodhen në qoshen veriperendimore, jugperëndimore dhe juglindore. Për të kontrolluar më mirë faqet e murit, ndërtuesi, përveç kullave të qosheve, ka përdorur daljen e herëpashershme të murit duke zëvendësuar kështu kullat ndërmjetëse. Këto dalje janë të pajisura dhe me frengji. Në këtë mënyrë kalaja ka një aftësi mbrojtëse të mirë, megjithëse është e varfër me kulla.

3) **Historia e Shqipërisë,** vol. II, Tiranë 1959, f. 448.
4) **Historia e Shqipërisë,** vol. I, Tiranë 1959, f. 473.

Kalaja ka tri hyrje që ndodhen në faqet: lindore, jugore dhe perëndimore, nga të cilat më pak të dëmtuara janë hyrjet lindore dhe jugore, ndërsa perëndimorja ruan vetëm harkun. Nga jashtë, muret e kalasë janë punuar me shije të hollë, kryesisht me gurë të punuar e të vendosur në rreshta horizontalë me pak llaç. Muret vinë duke u zgjeruar në bazë me një pjerrësi rreth 10°, për të rritur qëndrueshmërinë, pasi, pothuajse deri në gjysmën e lartësisë së tij, ky mur shërben dhe si mur mbajtës, për shkak të disnivelit të madh midis terrenit të brendshëm dhe të jashtëm. Zhvillimi vertikal i murit qëndron në unitet të plotë arkitektonik me elementet horizontale, siç janë kornizat e punuara me mjeshtëri. Këto punime me shije të kujtojnë dhe ndërtimet e tjera të Ali Pashës si kalatë në Libohovë, Porto Palermo, Gjirokastër etj. Një teknikë tjetër ndërtimi është përdorur në faqen e jashtme të murit verior, i cili është ndërtuar me gurë lumi të lidhur me shumë llaç. Si duket, kjo pjesë është ndërtuar më parë si mur mbajtës për territorin e sarajit të Ali Pashës dhe më vonë është shfrytëzuar si mur i jashtëm i kalasë. Siç kemi theksuar dhe më sipër, terreni mbi të cilin ngrihet muri lindor është mjaft i aksidentuar me formacion konglomerati. Shkëmbinjt dalin në pjesën e sipërme në formë konsoli, por, për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre ata janë përforcuar nga poshtë me mure guri.

Në faqet e brendshme muri është ndërtuar me gurë të papunuar, me shumë llaç. Për të rritur fortësinë në muret janë përdorur breza druri, të cilat kanë seksione rreth 10 x 10 cm.; ata vendosen horizontalisht në largësi 30-40 cm. dhe lidhen tërthorazi me breza të tjerë (Tab I, 1). Largësia vertikale e brezave është 1 m. Brezat e drurit nuk dalin në faqet e jashtme të mureve. Trashësia e mureve nuk është e njëllojtë, ajo në pjesën e sipërme lëviz nga 2-4 m kurse në pjesën e poshtme nga 2,5-5 m.

Kullat në gjendjen e sotme janë të dëmtuara; ato i kanë faqet e poshtme shumë të pjerrta dhe janë punuar me të njejtën teknikë si dhe muret.

Veçanërisht kujdes ndërtuesi i ka kushtuar kompozimit arkitektonik të hyrjeve. Hyrja kryesore është ajo lindore TAB II mbuluar me hark të madh, rrethuar me një kornizë guri katërkëndëshe, mbi të cilën ndodhet pllaka me mbishkrimin: «Hyrja e Vezirit». Balli i hyrjes ka katër frëngji. Ndryshe nga hyrjet e tjera kjo fillon rrafsh me rrugën dhe ka patur portë me dy kanata me akse rrotullimi vertikal. Gjurmët e mbështetjeve të kanatave ekzistojnë dhe janë unaza metalike të fiksuara në pjesën e sipërme të portës në të dy anët e saj. Ambienti i hyrjes ka formë katërkëndëshi, i mbuluar me qemer në formë kryqi. Përballë portës ka qenë një mur me trashësi 1 m., nga i cili sot ruhet pjesa e poshtme



Fig. 3 — Fragment muri në kalanë turke.

dhe gjurma e bashkimit të tij me qemerin; ky mur ndante ambientin e truprojës me hyrjen dhe duhet të ketë shërbyer si dhe muri pritës me frengji në hyrjen jugore. Në këtë mur kemi gjurmën e shpatullës së djathtë të frëngjisë së parë si dhe një portë me gjerësi 85 cm. që lidhte këto ambiente. Porta, sikurse dhe muri, është e dëmtuar dhe ruan vetëm pragun, shpatullën e majtë pa paturë dhe gjurmën e mbështetjes së harkut në shpatullën e majtë. Porta ka qënë mbuluar me qemer guri, rrethuar me një kornizë të hollë dekorative. Prapa këtij muri, gjatë punimeve restauruese të vitit 1968, kemi gjetur ambientin e truprojës me oxhak dhe me një kthinë të ndarë me mur që ka shërbyer si një nyje sanitare, ku gjenden dhe gjurmët e portës. Në krahun e majtë të ambientit të hyrjes nëpërmjet një hapësire mbuluar me hark, hyjmë në kala. Kjo mbyllej me portë dykanatëshe, nga e cila kanë mbetur vetëm gjurmët e mbështetjeve të tyre. Sikurse e pamë nga përshkrimi i mësipërm, kjo hyrje ka një sistem të studjuar mbrojtës pa përmendur elementët e jashtëm si frëngji, etj.

Hyrja jugore (TAB III) është ndërtuar pranë njërës nga kullat. Porta mbulohet me një hark prej dy rreshta gurësh porozë të punuar shumë mirë me pak llaç. Mbi portë ka një kornizë horizontale të punuar prej guri me trashësi rreth 15 cm, mbi të cilën kemi një hark të dytë. Këto dy harqe e pasurojnë hyrjen dhe e theksojnë atë në lartësi. Në pjesën e brendshme, dallohen gjurmët e mekanizmit të hapjes së portës me akse rrotullimi vertikal; nga sa duket, porta e dytë ka qenë me dy kanate. Hyrja mbrohej dhe nga ura e lëvizshme, e cila shërbente edhe si plan i

POSTUAR



Fig. 4

DO NOT COPY

pjerrët për barazimin e niveleve të rrugës dhe të ambientit të brendshëm, disniveli i të cilave në gjendjen e sotme është 2 m. Mekanizmi i lëvizjes së urës ndodhej mbi portë. Nga ky mekanizëm sot kanë mbetur vetëm gjurmët e mbështetjeve të trarëve të dyshemesë dhe dy kamare në të dy muret anësore të hyrjes që kanë shërbyer për mbështetjen e traut të çikrikut. Te mekanizmi i lëvizjes së urës shkohej nepërmjet shkallës së ndodhur brenda murit, në krahun e majtë të hyrjes, e cila ndriçohej nga dy dritare të vogla të hapura në këtë faqe. Nën shkallë, në krahun e majtë të hyrjes, ndodhet një nike që ka shërbyer si vendroje. Nga ana funksionale kjo hyrje është realizuar mirë. Armiku nuk mund të hynte në kala pa parakaluar më parë murin masiv me katër frëngjitë. Frëngjitë bëjnë pjesë në ambientet e truprojës që nuk janë përfunduar. Në murin masiv ka një portë që bën të mundur daljen e përnjëhershme të mbrojtësve në rast nevoje apo komunikimi me ambientin e truprojës.

Ambienti i hyrjes jugore në kalanë e Tepelenës mbulohet me një qemer guri cilindrik. Kjo mbulesë cilindrike lidhet me murin përballë hyrjes me anën e një elementi sferik që ka formën 1/4 sfere. Nga ky ambient shkohet në kala nëpërmjet hyrjes së dytë mbuluar me hark të dyfishtë. Me një sistem mbrojtjeje të tillë, që fillon me kullën juglindore së bashku me frëngjitë në pjesën e sipërme të hyrjes dhe që vazhdon me portat e dyfishta e përfundon me murin me katër frëngji, ndërtuesi ka arritur më së miri zgjidhjen e problemeve që dilnin para mbrojtësve.

Po me të njëjtin sistem mbrojtës ka qenë ndërtuar dhe hyrja perëndimore (TAB II) e cila sot është mjaft e dëmtuar.

Sistem të tillë mbrojtës për hyrje, kemi dhe në kalatë e tjera të kësaj kohe si në të Gjirokastrës, Butrintit, Porto Palermos etj. Në këto kala gjejmë ngjashmëri edhe në teknikën e ndërtimit si dhe në format e kullave.

Frëngjitë në kalanë e Tepelenës (TAB I) janë të shumëllojshme, sipas armëve dhe vendit që zenë në sistemin mbrojtës. Sipas armëve ato ndahen në frëngji topash dhe frëngji pushkësh. Kur në faqen e brendshme të murit ka ambiente dhe nevojitet largimi i ujërave të shiut, ndërtuesi përdor frëngji me kanale shkarkimi. Ndërsa kur kërkohet ndryshimi i fushëpamjes, ai përdor frëngji dyshe.

Një element tjetër që të bie në sy në këtë kala janë hundë-hedhjet mashikulat (TAB, I) mjaft të përdorur në mesjetë, nga ku mbrojtësit derdhin rrëshirë, katran, etj.

Ambientet e shërbimit i janë mbështetur murit të kalasë, për dy arësye: e para, për ekonomi materiali dhe kohë pune, e dyta, ekonomizohet dhe terreni brenda kalasë. Në pjesën e brendshme të kullës juglindore (fig. 4) kemi dy ambiente: i pari, me përmasa 5,8 x x 6,4 m. mbuluar me qemer guri cilindrik, nga i cili kanë mbetur vetëm gjurmët e mbështetjeve në muret anësorë, i dyti, me përmasa 5,8 x 6,15 m. mbuluar po me qemer. Që këtu vazhdojnë ambientet me dy hapësira mbuluar me qemerë cilindrikë, nga të cilët kemi gjurmët e shpatullave dhe të harqeve përforcuese me gjerësi 70 cm që fillojnë në lartësinë rreth 1 m. nga niveli i terrenit. Këto ambiente ndriçohen nga 8 dritare me formë katërkëndëshi mbuluar me hark të verbër, që fillon mbi një arkitra guri, i cili më të shumtën e rasteve është i dëmtuar. Nën dritare ka frëngji me përmasa 6 x 30 cm. Sikurse duket muri i ambientit mbështetet në murin e kalasë në një të dalë të lënë për këtë qëllim. Pas këtyre ambienteve

vazhdojnë ambientet dykatëshe të cilat tani janë të rrënuara. Që këto ambiente kanë qënë dykatëshe na bind një mur 70 cm i gjerë që ndodhet në anën e brendshme të trapit dhe ka shërbyer si mur i jashtëm i katit të dytë të këtyre ambienteve. Në pjesën veriore të murit lindor ndodhen dhe sot tre ambiente paralele me mure të përbashkëta, dy nga të cilat janë mbuluar me qemerë guri, ndërsa i treti është i rrënuar. I pari ndriçohet nga katër dritare, ndërsa i dyti është i errët dhe ka qenë depo uji; ky lidhet me të tretin, ku dallohen qartë tubat keramike të furnizimit me ujë nga mbulesat. Tubat kanë gjatësi rreth 40 cm dhe diametër rreth 11 cm; tuba të padëmtuara kemi gjetur në fshatin Bënçë prej ngë vinte ujësjellësi i Tepelenës, si edhe në depot e ujit të kalasë së Gjirokastrës.

Në vazhdim të murit verior gjejmë burgun me anekset përkatëse me dy hapësira, (TAB, I) nga të cilat kanë mbetur vetëm gjurmët e shpatullave anësore të harqeve përforcues dhe vijat e takimit të mbulesës me murin e kalasë. Nga të dhënat që na ka dhënë monumenti kemi arritur të bëjmë rikonstruksionin e mbulesës së burgut. Ujrat e sipërfaqes të kësaj mbulese largoheshin drejtpërdrejt nëpërmjet tubave keramike apo kanaleve me pllaka guri ndërtuar për këtë qëllim, ndërsa kundër filtrimit të mundshëm të ujit ndërtuesi ka marrë masat përkatëse, me pllakat e gurit vendosur në murin mbështetës duke e çuar atë në kanalet midis çdo dy harqeve.

Kalaja e Tepelenës është mjaft e pasur dhe me elemente të tjera mbrojtëse dhe funksionale. Në faqen perëndimore, jugore dhe pjesërisht në atë veriore vëmë re disa thellime në mur.

Kalaja e Tepelenës e ndërtuar nga Ali Pasha është një nga kalatë më të vona të ngritura në vendin tonë. Megë ajo filloi të ndërtohej në prak të konfliktit të Ali Pashës me Portën e lartë, nuk arriti të përfundohej. Kjo vepër mjaft e goditur flet qartë për mjeshtrinë e lartë të ndërtuesve shqiptarë.

DO NOT COPY

TAB. I





Ambjente në murin verior



Legjenda

1 – SHTRESE HARASANI
2 – MBUSHJE ME ÇAKALL
3 – MBULESE ME TOB GULLA
4 SHTRESE HARASANI
5 SHTRESE ÇAKELLI
6 QEMERI

DO NOT COPY

FRENGJITE



FRENGJI TOPASH



FRENGJI PUSHKE



FRENGJI PUSHKE ME SHKARKIM UJI



FRENGJI DYSHE

HUNDE HEDHJE





HYRJA LINDORE



Pamje ballore



Planimetria



Premje tërthore



Premje gjatsore

0 1 2 3 4 5m

HYRJA PERENDIMORE



PAMJA BALLORE



0 1 2 3 4 5 M

DO NOT COPY

DO NOT COPY


HYRJA JUGORE
(RIKONSTRUKSIONI)
PLANIMETRIA
PAMJE BALLORE
PREMJE TERTHORE
PREMJE GJATESORE
0 1 2 3 4 5 m

DO NOT COPY

S. BEJKO.

LA FORTERESSE DE TEPELENE

RESUME

Tepelene est située sur les rives de la Vjose et occupe une position-clé aux abords de la gorge de Këlcyrë, carrefour d'importantes voies dès l'époque antique.

Les sources historiques révèlent qu'au XVe siècle, avant l'invasion turque, Tepelene possédait une forteresse que les Turcs détruisirent en assiégeant la ville, et dont ils utilisèrent les matériaux pour en construire une autre à proximité de l'ancienne. Il ne subsiste aucune trace de la première forteresse, alors que celle bâtie par les Turcs est conservée en relativement bon état et se trouve à l'intérieur de la forteresse élevée par Ali pacha. Celle-ci a un périmètre rectangulaire de 56 m. sur 40 m. (fig. 2), avec deux tours flanquant le côté ouest, et deux entrées, respectivement au nord et à l'est. On y discerne deux phases de construction, dont la plus ancienne a pour caractéristique la technique du «cloisonnage».

La forteresse reconstruite par Ali pacha est conçue de façon à s'adapter au terrain. Elle a la forme d'un polygone de forme oblongue, s'allongeant du sud au nord, et elle s'élève dans sa partie est, sur un terrain accidenté. Elle est renforcée de trois tours d'angle polygonales. Afin de permettre un meilleur contrôle des parois extérieures des murs, les constructeurs ont eu recours, outre aux tours d'angles, à des saillants successifs, remplaçant ainsi les tours intermédiaires. Ces saillants sont percés aussi de meurtrières. Ainsi la capacité défensive de la forteresse n'est pas réduite, malgré sa pauvreté relative en tours. On y accède par trois entrées, qui s'ouvrent respectivement sur les côtés est, sud et ouest, les moins endommagées étant les deux premières.

De dehors, les murs sont travaillés avec goût, et construits en pierres de taille disposées en rangées horizontales et assemblées à l'aide d'une mince couche de mortier. Sur sa paroi intérieure, le mur est construit en pierres non taillées et jointes par une épaisse couche de mortier. Afin d'accroître la solidité des murs on les a renforcés de ceintures de bois. L'épaisseur du mur varie, selon les endroits, de 2 m. 50 à 5 m. à sa partie inférieure, et de 2 à 4 mètres à sa partie supérieure.

Il a été fait preuve d'un soin particulier pour la composition architectonique des entrées, dont la principale est «l'Entrée du Vizir» sur le côté est, qui porte aussi des inscriptions.

Les meurtrières sont de forme variée, selon les armes auxquelles elles étaient destinées et la place qu'elles occupaient dans le système défensif.

Un autre élément qui frappe dans cette forteresse sont les machicoulis, assez usités au moyen âge, et d'où les assiégés versaient de la poix bouillante sur les assaillants.

Les communs s'adossent au mur de la forteresse pour deux raisons: d'abord pour économiser les matériaux et le temps de travail, ensuite pour utiliser au maximum le terrain à l'intérieur de l'ouvrage.

La forteresse de Tepelene élevée par Ali pacha est l'une des plus récentes ocae dans notre pays.

Sa construction ayant été entreprise à la veille du conflit d'Ali pacha avec la Sublime Porte, la forteresse ne put être achevée. Cet ouvrage assez remarquable témoigne clairement de la haute maîtrise des constructeurs albanais.

DO NOT COPY

Emin RIZA, Koço ZHEKU

BANESA TIRANASE

Tirana njihet si qytet që prej fillimit të shek. XVII [1]). Kushtet që përcaktuan kthimin e Tiranës nga fshati në qytet qenë nevoja për një treg në trevën e begatshme bujqësore të Tiranës, dhe qenja e fshatit të Tiranës në një vend ku kryqëzoheshin rrugët e karvaneve nga veriu në jug, nga perëndimi në lindje e anasjelltas. Rritja e qytetit me banorët e fshatrave të rrethit ka ndodhur gjatë shek. XVII e sidomos gjatë gjysmës së dytë të tij [2]).

Zejtaria dhe tregëtia filluan të lozin, që në fillim, një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike të Tiranës. Por Tirana deri në fillim të shek. XX nuk u bë një qytet zejtaro-tregëtar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Banorët e saj nuk u shkëputën asnjëherë krejtësisht nga ekonomia bujqësore e blegtorale. Të shumta ishin rastet kur një pjesë e anëtarëve të familjes merrej me zejtari, ndërsa pjesa tjetër me bujqësi. Fakti që ekonomia bujqësore ruajti një vend të rëndësishëm në jetën qytetare, shprehet shumë qartë dhe në tipin e banesës tiranase, e cila duke pasqyruar këto kushte të jetës, gjatë gjithë zhvillimit të saj nuk arriti të shkëputej nga banesa fshatare, prej së cilës zuri fill.

Në fillim të shek. XX, e pikërisht duke filluar nga viti 1920, për Tiranën si qytet fillon një etapë e re zhvillimi, e cila pati shkas shpalljen e saj kryeqytet. Në një planimetri të Tiranës të vitit 1916 (fig. 1) vërejmë se qyteti ka një shtrirje shumë të madhe dhe se ai ishte zhvilluar kryesisht në rrafshinën që gjendet ndërmjet lumit të Tiranës dhe përroit të Lanës. Nga sa na lejon kjo planimetri, vërejmë se banesat janë të veçuara nga njëra-tjetra e të rrethuara me kopshte të mëdha. Rrugët e qytetit janë në përgjithësi të lakuara, ato kryesoret drejtohen për në qendrën e tij ku ndodhej pazari.

Banesa tiranase nuk është trajtuar deri më sot në ndonjë monografi si tip karakteristik me tipare të veçanta. Por, autorë të ndryshëm si, J. Han [3]), R. Almaxhio [4]), F. Nopça [5]) dhe A. d'Osat [6]) e kanë përmendur shkarazi Tiranën, duke e karakterizuar banesën e saj si një ndërtim me qerpiç, pa i prekur pothuajse fare tiparet e saj arkitektonike.

Për mbledhjen e materialit janë gjurmuar të gjitha banesat e vjetra të Tiranës. Gjatë kësaj pune vumë re se qyteti ruan tipe të ndryshëm banesash. Por ndërmjet tyre bije në sy tipi karakteristik vëndas, i cili dallohet si në formulimin arkitektonik ashtu dhe në

1) K. Frashëri, **Fillimet e Historisë së Tiranës,** «Buletini për shkencat shoqërore», Nr. 2, 1955, f. 142.
2) K. Frashëri – **Vep.cit.,** f. 144.
3) Johan Georg Von Hahn, **Albanesische Studien** Jena, vol. I, 1854.
4) R. Almagio, **Relazione della Commissione per lo studio dell'Albania,** Parte I, Roma, 1915.
5) F. Nopcsa, **Albanien,** 1925.
6) G. de Angelis d'Ossat, Panorama dell'architettura rustica Albanese, **«Albania»** 1942.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1

teknikën e ndërtimit. Nga sa kemi vërejtur banesat e tipit vendas janë ndërtime që i përkasin periudhës prej fundit të shek. XVIII e deri në fundin e shek. XIX. Ndërsa banesat e tjera, të ndërtuara sidomos që prej fillimit të shek. XX, ndryshojnë nga tipi vendas. Këto tipe nuk do të trajtohen në këtë punim, i cili ka për objekt vetëm banesën me tipare karakteristike thjesht vendase. Materiali i mbledhur që pasqyron gjendjen ekzistuese, nuk na jepte mundësi të ndiqnim zhvillimin e banesës tiranase, mbasi pothuajse të gjitha banesat me kohë kanë pësuar ndryshime e shtesa. Prandaj na u desh një analizë e hollësishme e banesave më tipike, të cilat janë dhe objekt i këtij studimi, analizë e cila bëri të mundur të përcaktojmë fazën fillestare të ndërtimit të secilës prej këtyre banesave. Ky rikonstruksion ishte i domosdoshëm për të përcaktuar prototipin e banesës tiranase dhe rrugën e zhvillimit të saj.

Banesa e fazës së parë është tipi me «një kthinë», i cili përbëhet nga një ambient i vetëm banimi dhe hajati para tij. Ambienti i banimit quhet nga vendasit «shpi zjermi» ose «shpi buke». Ky ambient shërbente për qëndrimin e familjes, gatim, pritjen e miqve dhe për fjetje, pra në të zhvillohej e gjithë jeta familjare. Ky ambient zë një sipërfaqe të madhe që shkon nga 30-55 m²; përmasat më të zakonshme janë 6 x 8 m. Ai ka gjithmonë formë drejtkëndëshe; lartësia shkon nga 2.5-4 m.. Në këtë ambient gjejmë gjithmonë «votrën e zjermit» të vendosur në shumicën e rasteve në drejtim të boshtit gjatësor; zakonisht në të djathtë të hyrjes, rreth 2 m. larg murit. Vatra është një nga elementet kryesore të këtij ambienti; ajo shërben për ngrohjen e tij dhe për gatim. Këtë element e gjejmë në një formë shumë primitive. Vatra ndërtohet drejtpërdrejt mbi truallin e dyshemesë, ajo ka formën e drejtkëndëshit të ndarë në dy sipërfaqe në nivele të shkallëzuara. Në pjesën e ulët, vërejmë një gropëzim ku ndizet zjarri; drutë vendosen horizontalisht në pjesën e ngritur, duke u zgjatur sipër gropës së zjarrit. Në kufirin midis dy pjesëve anash vatrës gjejmë gjithmonë dy gurë të ngulur në truall që quhen «carunj», vatra ndërtohet me baltë të punuar. Mbi vatër varet një zinxhir hekuri i lidhur në njërin nga trarët e çatisë që thirret «kamostër». Në të varen enët e gatimit. Tymi i zjarrit gjen rrugëdalje nëpërmjet tjegullave të mbulesës. Shtëpia e zjarrit ka një hyrje kryesore të vendosur gjithmonë nën strehën e hajatit. Ajo është me dy kanata zakonisht me përmasa 1.5 x 1.8 m dhe sigurohet me anën e shulit, një binar që rrëshqet në një kanal të hapur në mur. Dyer të dorës së dytë gjejmë në rastet kur ky ambient lidhet me kopshtin, ose me ambientet sanitare. Ndriçimi i shtëpisë së zjarrit sigurohet kryesisht me anën e dy ose katër baxhave. Dy nga baxhat vendosen gjithmonë mbi vatër, për të patur në këtë pjesë një ndriçim më të mirë. Baxhat mendojmë se, së bashku me derën, janë elementet më të vjetra që siguronin ndriçimin e shtëpisë së zjarrit. Dritaret, një ose dy, që i gjejmë në anën e hajatit, janë elemente të futura më vonë. Këto dritare kanë përmasa të vogla; së jashtmi sigurohen me një kafaz druri dhe nga brenda me kapakë dërrase, 1 ose 2 kanatëshe. Jeta familjare zhvillohej kryesisht rreth vatrës së zjarrit. Në afërsi të saj gjejmë një element karakteristik, «shtratin», që ndërtohej rreth 50 cm mbi truallin, i mbajtur nga një sistem i thjeshtë shtyllash dhe binarësh mbi të cilët shtrohej një dysheme dërrasash. Ai ka formë drejtkëndëshi me përmasa rreth 4 x 2 m dhe shërbente si vëndfjetje dhe ndejtje. Në muret e shtëpisë së zjarrit gjejmë dollapë të vegjël, të hapur, ose të mbyllur me dy kapakë. Në njerën nga dy faqet e mureve gjatësore vendosen tri dërrasa në drejtim horizontal, të mbajtur nga binarë të futur në mur, që formojnë të ashtuquajturin «sergjen». Në të rreshtohet i gjithë inventari i enëve të guzhinës. Në ballin karshi vatrës së zjarrit në afërsi me hyrjen gjejmë, të rreshtuara mbi një drrasë diçka mbi nivelin e truallit, enët e ujit. Një element tjetër karakteristik i shtëpisë së zjarrit është «mafili», një lloj ballkoni i brendshëm. Atë e gjejmë të ndërtuar në një lartësi rreth 2 m nga trualli në formën e një ballkoni që mbahet nga trarë të inkastruar në muret perimetrale që dalin rreth 1.5 m.; mbi trarët vendoset dyshemeja e drurit. Mafili rrethohet nga parmakë të thjeshtë druri të lidhur në shtylla vertikale që shkojnë deri në trarët e çatisë. Ngjitja në mafil bëhet nëpërmjet një palë shkallëve druri të vendosura përbri njërit prej mureve anësorë. Mafili nuk ndërtohet asnjëherë në faqen që ka pranë vatrën e zjarrit. Ky element ka lindur nga nevoja për të shtuar sipërfaqen e banueshme brenda shtëpisë së zjarrit, nevojë që diktohej nga numri i madh i kurorëve në familjet me mbeturina të theksuara patriarkale, Ky realizim ishte praktikisht i mundshëm për shkak të lartësisë së madhe të shtëpisë së zjarrit. Mafili, pra, ishte një element që i shtohej sipërfaqes së banueshme. Siç do ta shohim më poshtë, mafili, duke ruajtur funksionin e vendit të fjetjes për beqarët, në tipat e zhvilluara të banesës tiranase merr dhe funksionin ndërlidhës të dhomave të fjetjes me shtëpinë e zjarrit. Shtëpinë e zjarrit e gjejmë gjithmonë të shtruar me baltë të ngjeshur dhe pa tavan. Muret suvatohen me llaç baltë dhe lyhen me sherbet gëlqereje. Hajatin e gjejmë gjithmonë të vendosur përpara hyrjes kryesore të shtëpisë së zjarrit. Ky, së bashku me shtëpinë e zjarrit, ka një çati të përbashkët, të mbuluar me tjegulla në formë lugu. Pjesa e çatisë që mbulon hajatin mbështetet mbi shtylla druri të vendosura zakonisht mbi një bazament të thjeshtë guri. Shtyllat kurorëzohen me jastekë prej druri të latuar, me profil të dhëmbëzuar. Hajati krijon një ambient të mbrojtur para hyrjes, i cili shërbente kryesisht për përpunimin e produkteve bujqësore, për vendosjen e avlemendit dhe veglave bujqësore. Në periudhën e stinës së verës hajati merr dhe funksionin e banimi.

Banesën me një kthinë ne nuk e hasëm në Tiranë, por është krejt e qartë se një banesë e tillë ka qenë në përdorim të gjerë. Në radhë të parë për këtë bindemi nga vetë emërtimi i ambientit «shtëpi zjarri» dhe së dyti, shtëpia e zjarrit ekziston si bërthamë me të gjitha karakteristikat që përshkruam më sipër në

DOKTORATË

DOKTORIK

të gjitha fazat e evolucionit të banesës tiranase duke përfshirë dhe ato më të zhvilluarat. Banesën me një kthinë pa mafil dhe me mafil dhe fazat e tjera primitive të banesës tiranase, i gjejmë në fshatin Mullet të rrethit të Tiranës ku është i përhapur, ashtu si dhe në gjithë fshatrat e këtij rrethi, i njëjti tip banese.[7])

Banesa me një kthinë, që përshkruam më sipër, zhvillohet në drejtim horizontal dhe atë vertikal. Si tipe me interes të varianteve me shtrirje horizontale kemi banesat në rrugën Vllazën Huta Nr. 65 (Tab I) dhe në rrugën Avni Rustemi Nr. 22 (Tab II).

Këto banesa, që paraqesin faza të ndërmjetme të evolucionit në drejtimin horizontal, na lejojnë që të ndjekim rrugën e zhvillimit duke filluar nga banesa me një kthinë. Ne e mendojmë të tillë këtë evolucion: Së pari banesës me një kthinë ju shtua një ambient ndihmës që thirret «qur» e që shërben kryesisht si vënd depozitimi prodhimesh ushqimore dhe orendish shtëpijake. Ai vendosej zakonisht në drejtim ajatësor, por nuk mungojnë raste që qurin e gjejmë dhe në anën e mbrapme të banesës; në këtë rast quri mbulohet me zgjatimin e strehës së çatisë. Quri komunikon ajthmonë vetëm me shtëpinë e zjarrit. Ai është përdhes, i pasuvatuar dhe pa tavan.

Një hap me rëndësi përpara në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës, si rriedhim i zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe i fillimit të shthurjes së familjes patriarkale, është shtimi i ambienteve që shërbenin kryesisht si dhomë fjetje për çiftet.

Nevoja për një dhomë për pritjen e miqve mendojmë se ka ndikuar gjithashtu në këtë drejtim. Ambienti i shtuar është me përmasa të vogëla, zakonisht në të djathtë të shtëpisë, me hyrje gjithënjë nëpërmjet hajatit dhe në komunikim me shtëpinë e zjarrit. Dhoma e miqve quhet nga vëndasit «konak». Ajo është me tavan e dysheme dërrasash, dhe me mure të suvatuar e të lyer me sherbet gëlqereje. Konaku ka oxhak dhe ambiente sanitare; ai ndriçohet nga 2 ose 3 dritare të hapura në muret perimetrale.

Në vazhdim të këtij zhvillimi, numri i këtyre dhomave fillon e shtohet në vartësi nga numri i kurorave brenda familjes. Rruga e zhvillimit horizontal të banesës tiranase, me sa kemi vënë re, nuk është pëlqyer shumë; faza më e zhvilluar e kësaj rruge është banesa në rrugën Avni Rustemi Nr. 22 objekt që është ndërtuar që në fillim për nevojat e dy familjeve, d.m.th. në fakt kemi dy banesa nën një çati të përbashkët.

Por banesa tiranase, sikundër na del nga materiali i mbledhur, zhvillimin e saj më të natyrshëm e arriti në drejtimin vertikal. Në këtë rrugë zhvillimi, në të gjitha fazat e së cilës shtëpia e zjarrit mbeti epiqendra e banesës, plotësohen më së miri kërkesat e familjes patriarkale. Jeta e përditshme vazhdon të zhvillohet në shtëpinë e zjarrit, kurse ambientet e tjera janë kryesisht dhoma gjumi ose anekse të dorës së dytë. Zhvillimi horizontal për familje të mëdha i kufizonte mundësitë e shtimit të dhomave me lidhje të drejtpërdrejt me shtëpinë e zjarrit, prandaj dhe u përforcua zhvillimi vertikal i banesës, i cili në fakt dyfishonte numrin e ambienteve në lidhje të drejtpërdrejt me shtëpinë e zjarrit. Materiali i mbledhur në Tiranë dhe ato në fshatin Mullet, na i japin qartë fazat e zhvillimit në këtë rrugë.

Në banesën në rrugën Bajram Curri Nr. 34 (Tab. II), gjejmë gjurmët e para të zhvillimit të banesës në drejtim vertikal. Faza e parë e ndërtimit të saj na paraqet banesën me një kthinë, pra shtëpinë e zjarrit me lartësi 4,5 m. dhe me një element të ri të krijuar mbi hajat, çardakun e hapur nga të gjitha anët. Ky element që e hasim gjerësisht në banesat e zhvilluara në lartësi, vendoset zakonisht në gjithë ballin kryesor të banesës e gjithmonë mbi hajatin. Në banesën në fjalë çardaku ka përmasa të mëdha; ai bile shtrihet dhe në faqen e majtë të shtëpisë së zjarrit.

Ashtu siç kemi vërejtur dhe në shumë raste të tjerë, çardaku përbën një sipërfaqe rezervë, në të cilën, simbas nevojës, ndërtohen ambiente banimi. Kio duket dhe në këtë banesë, në të cilën gjejmë të shtuar më vonë një dhomë pritje në çardak, si dhe një dhomë banimi në hajat. Shtëpia e zjarrit lidhet drejtpërdrejt nga mbrenda me çardakun nëpërmjet një palë shkallëve druri. Gjithashtu dhe hajati komunikon me çardakun me shkallë të veçanta.

Një tip interesant që tregon hapin e parë në drejtim të zhvillimit vertikal është banesa në rrugën Ludovik Shllaku Nr. 3 (Tab. I). Në këtë banesë, shtëpia e zjarrit është ndërtuar me lartësi rreth 4.8 m., për të bërë të mundur vendosjen e dhomës së miqve në krahun e djathtë të banesës. Dhoma e miqve ka hyrje të veçantë, me shkallë të jashtme; përpara saj është vendosur një çardak i vogël. Ajo gjithashtu ka lidhje të drejtpërdrejt me shtëpinë e zjarrit. Dhoma e miqve ka dhe ambjentin sanitar, i cili del në formë konsoli jashtë murit fundor të saj. Në të djathtë të

7) K. Zheku, **Shtëpia e banimit në fshatin Mullet dhe zhvillimi i saj.** Etnografia Shqiptare I, Tiranë, 1962.

hyrjes nga çardaku është vatra e zjarrit me oxhak. Oda e miqve ndriçohet nga dy dritare që shohin në çardak. Hajati i banesës vazhdon në gjithë lartësinë e saj.

Banesa në rrugën Maliq Muço Nr. 42 (Tab. III) na paraqet një variant më të zhvilluar. Këtu i gjejmë ambientet e banimit të vendosura në anën e mbrapme të shtëpisë së zjarrit; në katin e dytë është ndërtuar çardaku. Të bën përshtypje fakti që ai është i vendosur jo si zakonisht mbi hajatin, por në anën e kundërt të tij. Mendojmë se faktori kryesor që ka ndikuar për këtë zhvendosje të çardakut nga vendi i tij i zakonshëm është synimi për drejtimin e tij nga jug-perëndimi. Kjo banesë në kohë të ndryshme ka pësuar shumë ndryshime dhe shtesa. Por ajo ruan akoma shtëpinë e zjarrit dhe çardakun pak të ndryshuar, elemente këto që na bënë të mundur të arrijmë në rikonstruksionin e saj.

Në vazhdim të zhvillimit të saj banesa tiranase bën një hap të rëndësishëm përpara me shtimin e ambienteve të reja. Vendosja e këtyre ambienteve ndryshon dhe formën e planimetrisë, duke kaluar nga ajo drejtkëndëshe në atë këndore, por gjithmonë mbulesa e banesës ruan formën drejtkëndëshe. Ambientet e shtuara vendosen në krahun e majtë ose të djathtë të hyrjes për në shtëpinë e zjarrit. Ky zhvillim, sjell ndryshime me rëndësi në formulimin arkitektonik të pamjes kryesore të banesës tiranase. Shëmbuj karakteristik të këtij varianti janë rikonstruksionet e banesave në rrugën Tefta Tashko Nr. 4 (Tab. IV dhe në rrugën Dervish Hekali Nr. 13/17 Tab. III).

Në variantet më të zhvilluara shohim se shtëpia e zjarrit vazhdon të jetë bërthama e kompozimit, ambientet janë vendosur në të dy krahët e saj, ndërsa në ballë ruhen të paprekur hajati dhe çardaku. Ky variant i zhvilluar i banesës tiranase (Tab. V), ka një afri shumë të madhe në konceptin kompozicional me banesën qytetare shqiptare me çardak të variantit me dy krahë, të cilin e gjejmë të përhapur sidomos në Berat e Shkodër. Por megjithkëtë ngjashmëri, ky variant i banesës tiranese ruan tiparet themelore të saj, shtëpinë e zjarrit në formën karakteristike dhe përdorimin e ambienteve të katit të parë me funksione banimi, në dallim nga banesa dykatëshe e Beratit dhe Shkodrës, në të cilat këto ambiente nuk janë me funksione të tilla. Banesa së cilës i kemi bërë dhe rikonstruksionin është një shëmbëll tipik i këtij varianti.

Nevoja për një numër më të madh ambientesh banimi bëri që shtëpia e zjarrit të rrethohet nga të tre anët me te. Në këtë variant, problemi i komunikimit me shtëpinë e zjarrit nuk mund të zgjidhet vetëm me ndërtimin e mafilit në një faqe muri, të cilit tani i rritet shumë funksioni ndërlidhës, kështu që ai rrethon të tria faqet e shtëpisë së zjarrit dhe zakonisht lidhet me dy palë shkallë. Shëmbullin më tipik të një mafili të tillë e gjejmë në banesën rruga Vildan Luarasi Nr. 22 (Tab. VI), e cila paraqet fazën më të zhvilluar të banesës tiranase. Hyrja kryesore e banesës mbetet ajo e shtëpisë së zjarrit, para së cilës gjejmë hajatin dhe cardakun karakteristik. Te kjo banesë të bie në sy numri i madh i ambienteve: këto i gjejmë të ndriçuara mirë dhe të paisura me musandra dhe nyje sanitare.

Evolucioni i banesës tiranase nga format më primitive, në një rrugë të natyrshme, në ato më të zhvilluarat, tregon për karakterin origjinal e autokton të saj. Në të gjitha hallkat e këtij zhvillimi koncepti i saj mbeti në drejtimet kryesore i njëjtë.

Banesa tiranase është gjithmonë e rrethuar me mure, të ndërtuar me qerpiç, ata janë të lartë rreth 2-5 m. Në të ndërtohet porta e hyrjes dy kanatëshe prej druri, me përmasa të mëdha; disa herë, në njerën fletë, ndërtohet një kanatë që është në fakt porta e përdorimit të përditshëm. Porta e hyrjes mbrohet nga një çati mbuluar me tjegulla. Banesa vendoset në qendër të oborrit i cili është me përmasa shumë të mëdha. Nga porta e hyrjes deri te banesa shtrohet një rruginë me kalldrëm e cila zë dhe një pjesë të mirë të oborrit para vetë banesës. Ambientet sanitare për familjen ndërtohen veças, diku në oborr. Pusin e ujit e gjejmë në çdo banesë tiranase, ashtu si dhe kopshtin me pemë.

Teknika e ndërtimit. Banesa e Tiranës, ashtu si e mjaft qendrave të banuara në Shqipërinë e mesme dhe bregdetare, ndërtohet prej qerpiçi. Ky material me të cilin janë ndërtuar të gjitha muret e banesës tiranase, me përjashtim të ballit të dhomës së miqve në tipin e zhvilluar në lartësi që ndërtohet me çatma, është shumë i lashtë. Pregatitja e qerpiçëve nuk kërkon ndonjë aftësi të lartë teknike; balta e punuar, mbasi merr formë në kallëp druri, zakonisht me përmasa (31 x 15 x 11 ose 28 x 14 x 10 cm), thahet në diell. Muratura me qerpiç në banesat e Tiranës ka një trashësi që shkon nga 60-70 cm. Qerpiçët

DO NOT COPY

DO NOT COPY

lidhen me llaç balte përzjerë me kashtë. Qerpiçi është një materjal ekonomik, me fortësi të mjaftueshëm dhe cilësi shumë të mira termoizoluese. Karakteristikë e rëndësishme konstruktive e muraturës është lidhja e saj në çdo 0.70-100 m. me breza druri. Këta, gjithsej dy binarë për çdo brez, me përmasa rreth 7 x 7 cm., vendosen njëri në faqen e jashtme e tjetri në faqen e brendshme; lidhur tërthorazi me binarë të vegjël zakonisht 5 cm. në largësi 65 cm. nga njëri-tjetri. Kjo lidhje me breza druri i jep konstruksionit të muraturës një fortësi të madhe dhe kryen edhe funksionin e brezit antisismik. Brezat e drurit i gjejmë dhe në muret e avllisë; kurse themelet ndërtohen me gurë lumi e lidhen me llaç balte. Zokoli zakonisht ngrihet rreth 20 cm. mbi kalldrëmin që rrethon ndërtesën, ky i fundit me gjerësi sa strehët ka pranë tij një kanal për largimin e ujërave. Konstruksioni i çatisë ndërtohet me trarë të rrumbullakët, material që nxirrej nga pyjet e shumta që rrethonin Tiranën. Ajo ka konstruksion të thjeshtë stropil, në vartësi të llojit të strehës, njëfishe që del nga muratura deri në 80 cm. ose dyfishe deri në 120 cm. Struktura e çatisë formohet në rastin e parë nga trarët e tavanit me seksion rreth 16 x 16; mbi ta shtrohen ura, ku mbështeten qeprat çdo 60 cm.; drejtpërdrejt mbi to shtrohen patavrat e pastaj mbulesa me tjegulla vëndi. Në rastin e strehës dyfishe, mbi qeprat çdo rreth 1.20 m. vendosen arkareçë 8 x 8 çdo 1 m., sipër tyre binarë 5 x 5 çdo 40 m., që zgjaten për të formuar strehën e dytë rreth 50 cm.; mbi ta shtrohen patavrat dhe tjegullat. Në konstruksionin e çatisë nuk përdoren kontraventime. Strehët në qoshe zakonisht janë të rakorduara me hark.

Mbi murin që lidh shtëpinë e zjarrit me hajatin, duke filluar nga niveli i trarëve të tavanit ndërtohet një kallkan, zakonisht me gardh të suvatuar në të dy anët me baltë.

Banesa tiranase i ka të suvatuar ambientet nga brenda; zakonisht dora e parë hidhet me baltë kurse dora e dytë me llaç gëlqereje. Pamja kryesore suvatohet, kurse zakonisht faqet e tjera lihen të pasuvatuara.

Tavane ndërtohen në dhomën e miqve e në dhomat e gjumit dhe asnjëherë në shtëpinë e zjarrit. Ata janë prej dërrase zakonisht të thjeshtë, por në disa raste me gdhëndje. Dyshemetë e çardakut dhe të dhomave ndërtohen me dërrasa të afruara. Dyert janë të thjeshta e rrallë të zbukuruara me gdhëndje. Dritaret mbrohen zakonisht nga një kafaz karakteristik druri që e hasim në mbarë banesat qytetare shqiptare, si dhe në shumë fshatra. Ato janë me dy kanata me lëvizje vertikale. Shkallët e banesës tiranase janë të thjeshta e primitive; parmakët e tyre, ashtu si ata të mafilit dhe të çardakut, formohen nga binarë vertikalë të lidhur me binarë horizontalë.

Mjeshtrat që ndërtonin banesat në Tiranë kanë qënë nga rrethet e Dibrës.

Karakteristikat e banesës tiranase. Banesa tiranase zë një pozitë të veçantë në arkitekturën e banesës qytetare shqiptare. Ajo, ashtu si banesa e Shkodrës, Elbasanit, Beratit dhe Gjirokastrës, në tipet fillestare është banesë fshati, por në zhvillimin e saj dhe në format më të përkryera ajo nuk arriti të shkëputej shumë nga banesa fshatare që e lindi; është pikërisht ky shkaku që banesa tiranase në fillim të shek. XX nuk qe në gjëndje që t'u përgjigjej kërkesave të kohës dhe prandaj ajo nuk u ndërtua më.

Në banesën tiranase që prej tipeve të thjeshta e deri tek ato më të zhvilluarat ne gjejmë të njëjtin koncept funksional që shprehet në grupimin e ambienteve rreth një bërthame qëndrore, shtëpisë së zjarrit. Kjo në asnjë fazë të evolucionit të banesës tiranase nuk e humbi vendin fillestar, dhe mbeti ambient kryesor i përbashkët i familjes tiranase që deri nga fillimi i shek. XX pati mbeturina patriarkale. Formulimi tepër i thjeshtë arkitektonik i banesës tiranase dhe ekzistenca në të e elementeve shumë të lashta si vatra në mes të shtëpisë së zjarrit, tregojnë se ajo trashëgon forma shumë të vjetra të trashëguara brez pas brezi. Banesa tiranase dallohet për volumin e madh të shtëpisë së zjarrit, në dallim nga dhomat e vogla për fjetje, zakonisht tepër të thjeshta. Hajati dhe çardaku në tipat e zhvilluar në lartësi janë elemente karakteristike të saj. Konfiguracioni i banesës tiranase është katërkëndësh kënddrejtë që i afrohet shumë katrorit dhe çatia gjithmonë katërujshe. Oxhakun e gjejmë në dhomën e miqve; né mendojmë se ai ka hyrë relativisht vonë në banesën tiranase. Orenditë e lëvizshme mungojnë krejtësisht, në shtëpinë e zjarrit gjejmë vetëm shtratin, disa bloqe muri e sergjenat, kurse ndër dhomat musandra e dollape muri.

Siç u tregua, banesa tiranase në evolucionin e saj, ka lidhje jo vetëm me banesat fshatare të rrethit, por ajo dhe në tipet më të zhvilluara të saj nuk u largua tepër nga banesa fshatare. Në rrethet e Tiranës ne gjejmë të njëjtin tip banese që zhvillohet duke

pasur si epiqendër kompozicionale shtëpinë e zjarrit. Në zonat kodrinore të malësisë së Tiranës më tepër u zhvilluan tipet në lartësi, të ndikuara kryesisht nga terreni i pjerrët, por në këto fshatra gjejmë dhe banesa të zhvilluara horizontalisht. Me shumë interes janë banesat e fshatit Mullet, ku, siç thamë, gjenden akoma të ruajtura variantet fillestare të banesës tiranase Nga materialet e njohura deri më sot ne nuk jemi në gjendje të japim shtrirjen territoriale të këtij tipi banese. Ne këtë tip e kemi gjetur të përdorur gjërësisht në qytetin e Kavajës. Në këtë qytet mbizotërojnë variantet me shtrirje horizontale, e rrallë gjenden fazat e para të zhvillimit të banesës në drejtim vertikal. Banesa e Kavajës (Tab. I) është përdhese. Ambienti kryesor është shtëpija e zjarrit primitive dhe me të njëjtat karakteristika si e Tiranës; pas saj ndërtohet quri e përpara hajati. Të bie në sy vendosja e qurit gjithmonë prapa shtëpisë së zjarrit dhe mbulimi i tij, me zgjatimin e strehës së çatisë. Anash ndërtohet zakonisht dhoma e miqve. Me rritjen e familjes ambientet shtohen varg duke i dhënë banesës kavajase një shtrirje karakteristike. Por ka dhe raste që këto ambiente vendosen normal në ballin e banesës duke arritur në formën e njohur dy krahëshe. Në Kavajë tipet e zhvilluara në lartësi duhet të kenë qenë të rralla. Teknika e ndërtimit të banesës kavajase është e njëjtë me atë të banesës tiranase. Arkitektura e banesës tiranase si në konceptin funksional ashtu dhe në teknikën e ndërtimit nuk lidhet me banesën e qyteteve të tjera shqiptare. Ajo përbën një tip më vehte të karakterizuar qartë.

DO NOT COPY

TAB. I

BANESE NE Rr VLL HUTA Nr65



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA 0 2 4M

BANESE NE KAVAJE Rr K.KARAFILI Nr4





BANESE NE Rr LUDOVIK SHLLAKU Nr 3





KATI I II^te



KATI I Ire 0 2 4

DO NOT COPY

DO NOT COPY

SHTËPIA NË SHESHIN "AVNI RUSTEMI" Nr 22



FAMIJE KRYESORE

0 2 4 6M

BANESE NE Rr BAJRAM CURRI Nr 34



FAMIJE KRYESORE

0 1 2



PLANIMETRIA

0 2 4 6M



KATI I Ire



KATI I II^te

0 2 4M

DO NOT COPY

RIKONSTRUKSIONI I BANESES NE Rr DERVISH HEKALI Nr 13-17



PAMJE KRYESORE



KATI I rë



KATI IITE

0 2 4M.

RIKONSTRUKSIONI I BANESES Rr MALIQ MUÇO Nr 42



PAMJE KRYESORE



KATI Irë



KATI IITE

0 2 4M

BANESE NE Rr TEFTA TASHKO Nr 4



PAMJE KRYESORE

RIKONSTRUKSION I BANESES NE Rr TEFTA TASHKO Nr 4



PAMJE KRYESORE



KATI I -rë



KATI I -rë



KATI I -të II



KATI I -të II

0 2 4 M

DO NOT COPY

TAB. V

DO NOT COPY

BANESE NE Rr ALI PASHE GUCIA Nr 14



KATI I I-rë



KATI I II-të

0 2 4M

RIKONSTRUKSIONI I BANESES NE Rr ALI PASHE GUCIA Nr 14



PAMJE KRYESORE



KATI I I-rë



0 2 4M.

KATI I II-të

BANESE NE RRUGEN VILDAN LUARASI Nr 22



PAMJE KRYESORE



PREMJE TERTHORE

0 2 4M



KATI I Ī

0 2 4M



KATI I II

DO NOT COPY

DO NOT COPY

E. RIZA, K. ZHEKU

LA MAISON TIRANOISE

RESUME

Tirana, en tant que ville, date du XVIIe siècle. Elle est née du développement du bourg du même nom et de ce que la zone agricole prospère qui l'environne avait besoin d'un marché. C'est à la même époque que, par suite de l'afflux des habitants des villages de la région, la population de Tirana commence à s'accroître et son commerce à se développer. Jusqu'au début du XXe siècle, Tirana ne réussit cependant pas à devenir une ville artisanale et commerciale proprement dite, car l'économie agricole y conservait une place prépondérante.

La maison type de Tirana n'a pas été étudiée jusqu'à ce jour. Certains auteurs, et notamment G. Hahn, A. Almagià, F. Nopça et G. de A. D'ossat, l'ont évoquée en passant. Nous chercherons dans cette étude à définir l'habitation typique locale et à dégager les voies de son développement, en nous basant principalement sur les vieilles maisons conservées jusqu'à ce jour.

Pour rassembler les matériaux relatifs à la présente étude, des recherches ont été faites dans toutes les vieilles maisons de Tirana, présentant des caractéristiques locales. Dans leur état actuel, les habitations les plus typiques qui seront décrites dans cette étude, comportent presque toutes des modifications, ce qui a rendu leur reconstitution difficile et nécessité des observations minutieuses effectuées dans chaque demeure, ainsi que la confrontation de leurs éléments de construction ou d'architectonique avec ceux préservés çà et là dans d'autres habitations de la ville.

La maison tiranoise de la première phase est du type «une pièce», constitué par une seule pièce d'habitation appelée «shtëpi zjarri» (salle du feu) ou «shtëpi buke» (salle à manger). A peu près au centre de cette pièce se trouve le foyer, où l'on fait du feu. Un élément caractéristique de la salle du feu est le «mafil», une sorte de balcon intérieur, ménagé sur les murs périmétraux. Ce balcon est apparu pour satisfaire au besoin d'étendre la surface habitable et, dans les variantes évoluées de l'habitation de Tirana, il sert aussi à faire communiquer la «salle du feu» avec les chambres à coucher. La «salle du feu» n'a pas de plafond et est toujours située au rez-de-chaussée. La maison d'une pièce existe aujourd'hui encore au village de Mullet du district de Tirana. Cette construction s'est développée dans deux directions: horizontale et verticale. Les figures 2 et 3 reproduisent des exemplaires intéressants des variantes à développement horizontal. Toutefois, la maison tiranoise atteint son développement plus naturel en direction verticale; au cours de ce développement, la salle du feu est restée l'épicentre de l'habitation. Des exemples intéressants de l'évolution de l'habitation tiranoise dans ce sens sont donnés dans les figures 4 à 10.

La maison type tiranoise est construite en pisé consolidé par des ceintures en bois, le toit est bâti en poutres rondes et couvert de tuiles creuses.

Ce type de maison occupe une situation particulière dans l'architecture de l'habitation citadine albanaise; elle est, tout comme l'habitation citadine à galerie et la «kulla» citadine des types initiaux, une maison rurale, mais au cours de son évolution et dans ses variantes les plus perfectionnées, la maison tiranoise n'a pas pu s'écarter beaucoup de l'habitation rurale qui est à son origine. Dans l'habitation de Tirana, depuis les types les plus simples jusqu'aux plus évolués, on trouve le même concept fonctionnel, qui se traduit par le regroupement des pièces autour d'un noyau central, ou salle du feu. Celle-ci, à aucune phase de l'évolution de l'habitation, n'a perdu sa place et elle est demeurée la pièce principale, commune, de la famille tiranoise, chez laquelle subsistèrent jusqu'au début du XXe siècle, des survivances patriarcales. Le type de l'habitation tiranoise, et particulièrement la variante à extension horizontale, est également répandu dans la ville de Kavaje.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

STUDIM MBI RESTAURIMIN E NJË BANESE NË SHKODËR

Banesa e Ymer Ramadanit është një ndër banesat e vjetra që ruhen në qytetin e Shkodrës. Ajo ndodhet në lagjen Perash, në hyrje të qytetit, dhe është ndërtuar rreth vitit 1800 [1]) nga fisi i Rrojve, që merreshin me tregëti, por pa qënë të shkëputur nga prodhimi bujqësor. Sot kjo banesë ruhet, me ndryshime të bëra më vonë, për të plotësuar nevojat për strehim të banorëve të saj dhe në gjëndje relativisht jo të mirë të elementeve konstruktive, gjë që kërkon një ndërhyrje të tillë restauruese, që do të prekë tërë monumentin. Menduam se kjo ndërhyrje duhet të jetë e tillë, që jo vetëm të përforcojë monumentin por dhe të nxjerrë në dukje vlerat e tij, duke e çliruar nga shtesat që mbulojnë disa elemente karakteristike të arkitekturës së tij.

Kjo banesë, edhe pse me adaptime, dallohet që është e tipit me çardak si shumica e banesave të vjetra të qytetit të Shkodrës (Tab. II) që ndërtoheshin nga shtresa zejtaro-tregtare e qytetit. Elementi kryesor arkitektonik, çardaku, shërbente si vend për punime të ndryshme të artizanatit, si tezgjah etj. Po këtu bëhej dhe përpunimi i produkteve bujqësore. Kjo shtresë shoqërore iu shmang ndërtimit të banesës qytetare të mbrojtur, duke pëlqyer tipin e pambrojtur me çardak, sepse, duke qenë e organizuar në esnafe, siguronte mbrojtjen kolektive të personit, që ishte kushti themelor për zhvillimin e zejtarisë dhe tregëtisë. Por megjithatë ekzistenca e gjakmarrjes dhe e fanatizmit, karakteristikë për sistemin e prapambetur feudal, ndikoi dhe në ndërtimin e kësaj banese. Këto u rrethuan me avlli me mure të larta dhe dritaret u siguruan me hekura ose u mbuluan me kafaze druri. Banesa e Y. Ramadanit rrethohet me mure të larta avllije në tri drejtime: jugperëndim, juglindje dhe veriperëndim, ndërsa nga verilindja kufizohet me një banesë fqinjë. Në murin rrethues juglindor ndodhet porta kryesore me përmasa 3 x 3.3 m., hapësira e së cilës mbulohet me një arkitra druri dhe me çatinë mbi të. Muret e portës nuk janë të pajisura me frengji e vend ndenje si shumë porta të qytetit të Shkodrës. Nëpërmjet portës kalohet në oborr, në të djathtë të të cilit shohim gjurmët e një ndërtimi përdhes, që quhet jerevi ose shtëpijashtë. Zakonisht, me sa shohim në shtëpi të tjera të vjetra të Shkodrës, kjo ngrihej duke shfrytëzuar një pjesë të murit të avllisë dhe kishte dy-tre ambiente përdhese, në njerin prej të cilëve ishte vatra për ngrohje. Në jerevi pronari i shtëpisë strehonte mysafirinjtë, malësorët, etj. Gjatë fazës së ndërtimit të banesës, jerevija, pasi ndërtohej e para, shërbente edhe si vend ku mjeshtrit vazhdonin punimet e gdhendjes, kur jashtë nuk mund të punohej prej shiut. Afër jerevisë ndodhet pusi me grykë guri të punuar me motive të ndryshme prej daltës së mjeshtrit (fig. 1). Përbri pusit janë dy lugje prej guri për larjen e teshave. Afër tyre duken gjurmët e një furre për pjekje. Në një qoshe të oborrit ndodhet kulla e bagëtisë, një ndërtim i ulët me bodrum, në pjesën e sipërme të së cilës vendosej ushqimi i bagëtisë, ndërsa poshtë bëhej strehimi i tyre. Prapa banesës ndodhet dera e fshehtë, arkapia, me anën e së cilës të zotët e shtëpisë lidheshin me komshinjtë, por që përdorej dhe për të dalë në rast rreziku.

1) Gj. Shëldia – Doreshkrim në Muzeun e Shkodrës 1958.

DO NOT COPY



Fig. 1

Banesa e Ymer Ramadanit është një ndërtesë e fortë dykatëshe e ngritur me mure guri (Tab. II). Kjo, si gjithë banesat tipike të Shkodrës, ka formën e një katërkëndëshi këndrejët. Kati përdhes i banesës është përdorur kryesisht si depo për ushqime, për produktet bujqësore dhe për lëndë djegëse. Në këtë kat janë katër ahre dhe një ambient banimi. Dyert e ahreve janë me qemer guri, ndërsa ndriçimi bëhet nëpërmjet dritareve të vogla dhe frengjive, të cilat, me sa duket, mbronin edhe shkallët. Burgje ose bodrume strehimi nën ahër nuk ka, ashtu siç mund të gjejmë në ndonjë banesë tjetër. Ambienti i banimit në katin përdhes është soba për bujqit mysafirë. Ahret lidhen midis tyre me anën e hajatit, ambient i hapur, që përdorej dhe për tharjen e teshave në kohë shiu si dhe për përpunimin e produkteve bujqësore. Kalimi nga hajati në çardak kryhet nëpërmjet shkallëve të dyanshme prej guri të ngritura mbi qemerë cilindrikë. Çardaku është nga elementet kryesore funksionale dhe arkitektonike në banesën shkodrane. Këtu ndodhet dhe qoshku i dividit për pritjen e miqve. (Fig. 2). Çardaku shërben si vënd komunikimi për ambientet e banimit të katit të sipërm. Epiqendra e kompozimit funksional të banesës, rreth së cilës vendosen ambientet e tjera, është oda e zjarrit. Këtu bëhej gatimi dhe përdorej si dhomë ndejtje. Elementi kryesor në këtë ambient është votra, e vendosur në një nga muret e dhomës. Oda e zjarrit ka dy dollapë muri për ushqime, sqollin për larjen e duarve dhe në qoshe të saj ka një portë që lidhet me ahrin poshtë, ndërsa në anën e korridorit, nën trapazan, lidhet me odën e pleqve dhe të vajzave, me furrën e pjekjes dhe me ambientin sanitar, elemente këto të vendosura në aneksin prapa, ngjitur me banesën. Kjo odë ndriçohet nga ana e çardakut. Hyrja nga çardaku në odën e pleqve bëhet nëpërmjet trapazanit që është element karakteristik me funksion të caktuar i interiorit të banesës shkodrane. Ky element i drunjtë ndahet në dy kate, në pjesën e sipërme vendosen teshat e fjetjes dhe rrinë gratë në raste festash, ndërsa në pjesën e poshtme ndodhet musandra dhe vendi i arkës. Në të tri anët e odës së pleqve ndodhet një minder 40 cm. i lartë. Kjo odë ndriçohet nga tri dritare të mëdha dhe ka një tavan druri me punime dekorative. Majtas, ngjitur me odën e zjarrit, ndodhet një odë e vogël, që ka oxhak dhe një baxho në çati, e cila, nëpërmjet një rrugine, lidhet me odën e të zotit të shtëpisë dhe të djemve. Ky ambient ka trapazan, nën të cilin kalohet në aneksin e shërbimit që ndodhet prapa. Oda e të zotit të shtëpisë lidhet me derë me odën e miqve, e cila e ka hyrjen nga ana e çardakut.

Oda e miqve është ambienti më i zbukuruar i banesës së Ymer Ramadanit. Në pjesën e hyrjes, sipër, ndodhet trapazani me ballkonin e grave të punuar me motive bimore. Në të tri anët e odës është vendosur minderi 1 m. i gjërë dhe 15 cm. i lartë. Meqenëse këtu, si në të gjitha odat shkodrane, nuk ka dollapë të lëvizshëm, plaçkat dhe ushqimet vendosen në dollapët prej druri me kapakë të gdhëndur të vendosur në mur. Në odën që po përshkruajmë, ndodhen disa dollapë të tillë, që të tërheqin vëmendjen për zbukurimet e tyre. Oxhaku i odës së miqve është një nga më të goditurit që hasim në Shkodër. I derdhur në allçi, ai është i pasur me motive bimore. Pasi nuk ka dalje me tymar në çati, ky oxhak ka kryesisht funksion dekorativ. Brënda tij ndodhet një dritare e vogël për daljen e gazit të qymyrit, kur në votër vendosej tagari i ndezur (Tab. I). Në dy krahët e oxhakut shohim dy kamare për vendosjen e enëve të kafesë. Në lartësinë 1.5 m. nga dyshemeja janë sergjitë e drunjta dhe palicat në qoshet e odës për vendosjen e sendeve të imta. Oda e miqve zbukurohet shumë nga tavani i pasur me ornamente të ndryshme, që ka for-

mën e një tetëkëndëshi, hapësira e të cilit mbushet nga tetë trekëndëshe, me kulme të drejtuara nga qendra. Ambienti i miqve ndriçohet nëpërmjet nëndritareve të vendosura në të tri faqet e mureve. Ngjitur me odën e miqve, në krah të saj, ndodhet një ambient banimi, kati përdhes i të cilit mbulon pjesën e majtë të shkallës. Në krahun e djathtë të çardakut ndodhet oda divide, ambient që shërbente si një lloj zyre tregëtare për pronarin e shtëpisë. Elementet kryesore të këtij ambienti janë: trapazani sipër, vëndi i plaçkave dhe nyja sanitare. Oda ka tavan me linjë të rregullt gjeometrike dhe ndriçohet nga tri dritare të mëdha të pajisura me grila. Në murin e prapëm të banesës, ngjitur me të, është ndërtuar aneksi i shërbimit. Kati përdhes i tij nuk funksionon, pasi është i mbushur, ndërsa në katin e sipërm janë ambientet e shërbimit si furrat e pjekjes, sqolli, hamami dhe WC.

Muri rrethues i avllisë është ndërtuar me gur gëlqeror të kovës, ndryshe nga shtëpitë e tjera të Shkodrës, që përdorin gurin e lumit. Çdo 50 cm. lartësi shtrihen rreshta pllakash guri në formë brezi, ndërsa lidhja e murit është bërë me llaç gëlqere të varfër. Në katin përdhes ahret janë shtruar me gur lumi, kurse hajati është shtruar me pllaka gëlqerore të vendosura në formë mozaiku. Muret kryesore të banesës, me trashësi 70 cm., janë me gurë kave të lidhur me llaç gëlqereje. Fakti që në muraturë është përdorur gurë kave e jo lumi, mund të lidhet me aftësinë që ka kjo lagje me malin e Taraboshit. Muret e banesës gjatë gjithë lartësisë nga jashtë dhe nga brenda, janë suvatuar me llaç gëlqereje. Bazamakët e shkallës janë shtruar me pllaka guri. Dyshemeja prej dërrase e ndërkatit mbështetet mbi trarë lisi dhe lidhet me ta me gozhdë kovaçi. Çatia është me sistem mahish të mbështetura mbi ura. Elementet janë lidhur me gozhdë kovaçi pa përdorur dhëmbëzime. Nga vrojtimet e bëra në strukturën e drunjtë, rezulton se pothuaj gjithë elementet e përdorura kanë seksioni ekonomik.

Në Shkodër, për ndërtimin e banesave kanë punuar shumë mjeshtër dibranë, sidomos muratorë dhe skalitës guri.

Në banesën e Ymer Ramadanit vërejmë një sërë ndryshimesh në kompozicionin planimetriko-arkitektonik të saj. Duke bërë krahasimin e pjesëve të ndryshme të ndërtesës, mendojmë se kjo banesë ka kaluar në për tri faza ndërtimi. Në fazën e parë kemi hajatin me ahret poshtë., çardakun me ambientet e banimit në katin e sipërm si dhe aneksin e shërbimit prapa. Në fazën e dytë në të majtë të çardakut shtohet oda e miqve (Tab. II-III). Faza e tretë e ndërtimit përputhet me gjendjen e sotme të banesës, ku shohim



Fig. 2

si shtesa të fundit odën divide dhe ambientin e banimit ngjitur me odën e miqve (Tab. I-II). Banesa ndahet në dy pjesë me anën e një muri të lartë që është ndërtuar më vonë për arësye të ndarjes së dy familjeve. U arrit në përfundim se oda e miqve është ndërtuar në fazën e dytë, sepse pasi bëmë një sërë sondazhesh e vëzhgimesh, doli që streha e çardakut vjen rreth 50 cm. më e ulët se ajo e odës së miqve, gjë kjo e pajustifikueshme, pasi në rastet e tjera shihet që streha vjen në një nivel gjatë gjithë fasadës. Trarët e brezit të poshtëm të çatisë, në pjesën e çardakut, janë vendosur tërthor gjatësisë, ndërsa në pjesën e odës së miqve janë paralel me gjatësinë sikurse dhe mbi shtesën tjetër të odës divide. Sheshi para ngjitjes në shkallë, nën odën e miqve, është i ngushtë rreth 1 m. duke vështirësuar në këtë mënyrë ngjitjen e njerëzve. Trarët e vjetër të dyshemesë të odës së miqve ndërpriten në një rrafsh me çardakun, kështu që trarët e tjerë jashtë këtij rrafshi, janë vendosur si pasojë e ndërtimit shtesë të odës së miqve. Në katin përdhes duket e theksuar fuga në lidhjen e mureve të odës së miqve me murin gjatësor të banesës. Jashtë, duke krahasuar strehët, vërejmë se materiali i strehës së odës së miqve është më i ri se ai i strehës së vjetër të çardakut. Të njejtin rast vemë re edhe në banesat e tjera të këtij tipi. Duke i hequr banesës së Muzhanit shtesën prej çatmaje, dalim në fazën e parë të ndërtimit të rastit tonë.

DO NOT COPY

Oda divide dhe ambienti që mbyll pjesën e majtë të shkallës, janë të vona, pasi, duke qënë të ndërtuar me tulla, ato i përkasin një teknike që nuk përdorej gjatë periudhës së fazës së parë të ndërtimit të kësaj banese. Oda e vogël e zjarrit në fazën e parë duhet të ketë qenë qilar për ushqime dhe me krijimin e dy familjeve, nevoja diktoi që ky ambient të adaptohej si odë zjarri. Megjithëse gjurmë nuk kemi, por sipas thënjeve të banorëve dritarja e odës së zjarrit, në fazën e parë, ka qenë më e vogël. Në aneksin prapa duket gjurma e një dere që lidhte banesën me komshinjtë nëpërmjet një ure të vogël prej druri në katin e sipërm. Pra shohim se monumenti i arkitekturës që mendojmë të restaurojmë, është produkt jo i një, por i disa periudhave ndërtimi, krijim jo i një mjeshtri, por i disa brezave. Pasi kemi të qartë monumentin, ndryshimet që ai ka pësuar në kohë dhe vlerat e tij, mund të trajtojmë problemin e restaurimit, të menduar si një ndërhyrje për një forcim dhe vlerësim të tij.

Me këtë nuk kuptojmë kthimin e monumentit në gjëndjen fillestare, megjithëse ajo është e mundshme meqënëse tërë pjesët e fazës së parë të ndërtimit ruhen. Në projektin e restaurimit që paraqesim mendojmë të heqim shtesat e fazës së tretë të ndërtimit, që janë oda divide dhe dhoma mbi shkallë Tab. II-III. Kjo për dy arësye: e para, sepse këto ambiente nuk paraqesin ndonjë vlerë nga ana e trajtimit arkitektonik të interierëve, dhe e dyta, sepse qenja e tyre, sidomos e dhomës mbi shkallë, deformon tërë formulimin arkitektonik të banesës së Ymer Ramadanit, ambienti qendror i së cilës, në anën jugperëndimore, është çardaku me shkallët nën të. Përveç kësaj, duke e ruajtur ndërtesën në fazën e dytë të ndërtimit, ruajmë jo vetëm dhomën e miqve, që është mjaft e goditur, por edhe një ndryshim të tillë në planimetri, që lidhet organikisht me banesën. Më vonë, rreth fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX në shumicën e banesave shkodrane shohim humbjen e çardakut. Ruajnë pra atë embrion që sjell më vonë krijimin e një banese të një tipi të ri. Përveç këtyre punimeve të rëndësishme restauruese, do të bëhen dhe mjaft ndërhyrje të tjera, që do të konsistojnë në rindërtimin e pjesshëm të konstruksionit të çatisë si dhe të dyshemesë së ndërkatit, dritareve, etj., të cilat, me kohë, janë kalbur duke ndikuar negativisht qoftë në anën estetike, qoftë në konstruksionin e banesës.

Në zbatimin e punimeve restauruese do të lindin dhe çështje të reja, që sigurisht do të sjellin edhe ndonjë ndryshim në projektin e restaurimit.

DO NOT COPY





GJENDJA E SOTME

DO NOT COPY

TAB. II



GJENDJA E SOTME



PROJEKTI I RESTAURIMIT



FAZA FILLESTARE

DO NOT COPY



PROJEKTI I RESTAURIMIT



FAZA FILLESTARE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

V. SHTYLLA

ETUDE DE RESTAURATION D'UNE HABITATION A SHKODËR

RESUME

L'habitation d'Ymer Ramadan, l'une des plus anciennes existant aujourd'hui dans la ville de Shkodër, est située dans le quartier de Perash, à l'entrée de la ville. Elle a été construite vers 1800. Depuis lors, elle a subi des modifications et, dans son état actuel, ses éléments de construction sont quelque peu dégradés.

Cette maison, comme la plupart des anciennes habitations de Shkodër, est du type des maisons à galerie ouverte. La couche sociale de marchands et d'artisans qui créa ce type, renonça aux habitations urbaines fortifiées, car son organisation en corporations lui permettait d'assurer la protection collective de chaque membre, condition essentielle du développement de l'artisanat et du commerce. Néanmoins, l'existence de la vendetta et du fanatisme, caractéristique du système régressif féodal, se reflète aussi dans la construction de l'habitation.

L'habitation d'Ymer Ramadan est une construction d'un étage aux murs de pierre et à la base rectangulaire. Le rez-de-chaussée était surtout réservé à l'emmagasinage de vivres, de produits agricoles et de combustibles. Il comprend quatre écuries et une pièce d'habitation. On monte à la galerie ouverte par un escalier de pierre à double volée reposant sur des voûtes cylindriques. La galerie, qui constituait un des principaux éléments fonctionnels et architecturaux de l'habitation shkodrane, servait à faire communiquer les pièces de l'étage supérieur.

L'épicentre de la composition fonctionnelle de l'habitation, autour de laquelle sont disposées les autres pièces, est la chambre à cheminée, où l'on préparait les aliments et qui servait de pièce de séjour. La pièce la plus richement ornée est la chambre d'amis. Citons parmi les autres pièces: la chambre des parents, celle des jeunes filles, le four à cuire, etc.

L'habitation d'Ymer Ramadan révèle une série de modifications dans la structure architecturale. La comparaison des différentes parties du batiment ainsi qu'une observation attentive nous ont porté à croire que la construction de cette maison a connu trois phases successives. Sous sa première forme, la maison comportait le «hayat» au rez-de-chaussée, la galerie et les pièces d'habitation au premier étage, ainsi que l'annexe des communs à l'arrière de la construction. La seconde phase est marquée par l'adjonction de la chambre d'amis. La troisième phase, à l'issue de laquelle la maison a pris son aspect actuel, a consisté dans la construction de la chambre «divitë» et de la chambre contiguë à la chambre d'amis.

En en projetant la restauration, nous n'avons pas visé à ramener le monument à son état initial, encore que cela soit possible, toutes les parties de la construction primitive étant intactes. Nous nous proposons de supprimer les adjonctions de la troisième phase de la construction, les intérieurs de ces pièces ne présentant guère d'intérêt du point de vue architectonique et leur existence venant fausser la conception architecturale d'ensemble de la bâtisse. En outre, en conservant la maison telle qu'elle était après la seconde phase de sa construction, nous préservons non seulement la chambre d'amis, qui présente une certaine valeur du point de vue de la conception architecturale de l'intérieur, mais sauvegardons aussi une certaine modification planimétrique qui constitue l'embryon d'un nouveau type d'habitation.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Shpëtim HAXHIHYSENI

MATERIALE DHE KUMTESA

VENDBANIMI I FORTIFIKUAR ILIR NË TERVOL

DO NOT COPY

Me këtë komunikim ne dëshirojmë të japim disa të dhëna, të cilat do të ndihmojnë sadopak për tu njohur me ekonominë dhe kulturën e këtij vendbanimi të lashtë, për të cilin, deri më sot, nuk kemi asnjë njoftim për disa periudha të zhvillimit të tij historik.

Fshati Tërvol shënon fillimin te krahinës së Vërçës (rreth i Gramshit). Në veri të këtij fshati, gjysmë ore larg qendrës, gjendet një shkëmb që mban emrin Kala. E ndodhur në majë të shkëmbit, me lartësi gati 700 m., kalaja ka një pozitë mbizotruese, shikimi prej saj kap një pjesë të mirë të fshatit dhe në perëndim ai ndalet deri në kurrizin e kodrave të Sulovës. Vetë shkëmbi, duke qënë i zhveshur dhe mjaft i thepisur, paraqet në vetëvete një fortifikim të mirë natyral, krejt të pangjitshëm në anët lindore, veriore dhe perëndimore. Kështu në kala mund të futesh vetëm nga ana jugore.

Rrëzë shkëmbit, në faqen perëndimore të tij, vazhdon një pjerrësi që sot quhet «Drizë». Është pikërisht ky territor, ku ne gjetëm shumë objekte të kulturës materiale të kësaj qendre banimi. Me sa duket këtu, kemi të bëjmë me një banim të hapët përbri atij të fortifikuar. Ky banim i hapët përfshin një territor prej afro gjysmë hektari, i cili është i terracuar me mure dy-tri radhësh. Në pjesën më të madhe këto mure janë të prishur për shkak të veprimit gërryes të ujërave dhe shkarjes së dheut; megjithatë kalaja i ruan mirë gjithë gjurmët e mureve rrethues. Lartësinë maksimale prej 7 m. muret e ruajnë në juglindje. Në përshkrimin tonë mbi gjithë këto objekte ne do të mundohemi të ruajmë rendin kronologjik, prandaj po i trajtojmë veçanërisht periudhat e ndryshme të jetës në qytezë.

Muret e kohës ilire.

Muret e kohës ilire kufizojnë një territor në formë të një katërkëndëshi jo të rregullt me sipërfaqe prej afro 1200 m^2 (30 x 38 m.), që mban emrin «Sheshi i Kalasë». Më mirë janë ruajtur ato nga ana jugore dhe veriperëndimore. Muri jugor, me gjatësi 20 m., është i punuar me bloqe të vetë shkëmbit, duke pasur për bazament po atë (TAB. I, 4). Bloqet e gurëve nuk janë të lidhur me llaç me njeri-tjetrin. Duke mos pasur formë dhe madhësi të njejtë, ata janë vendosur njeri mbi tjetrin në mënyrë të çrregullt, pa u puthisur mirë (TAB I, 3). Përmasat e tyre janë: 0,90 x 0,50 x 0,30 m.; 1,10 x 0,80 x 0,60 m.; 1,80 x 0,80 x 0,65 m. Në pjesën veriperëndimore muri i ndërtuar me bloqe të tilla arrin trashësinë 3 m. Bloqeve u mungon puna e hollë, ato janë të paskalitur me ndonjë vegël pune. Të kësaj teknike punimi janë dhe muret e terracimeve, gjurmët e të cilëve i gjejmë në perëndim dhe verilindje, në pjerrësitë jashtë fortifikimit. Për t'u shënuar është veçanërisht muri i pjerrësisë verilindore, me gjatësi 55 m. dhe trashësi 2 m. I vetmi dallim është se në muret e terracimit ka përdorim më të madh guri me madhësi mesatare. Qëllimi i këtyre mureve është të krijojnë terraca për banesat.

Muret me llaç

Në muret me llaç ne shikojmë disa duar punimi, por, në pamundësi të përcaktojmë kohën e ndërtimit, po mjaftohemi vetëm me përshkrimin e tyre. Muri më karakteristik është ai i anës juglindore. Nga baza e tij lartësia maksimale arrin 7 m. dhe trashësia 3 m.



Fig. 1

Gurët që janë përdorur kanë madhësi të zakonshme dhe janë të lidhur midis tyre me llaç. Veç llojit të gurit të vetë shkëmbit, në këtë mur gjejmë shpesh dhe një lloj tjetër, gurin ranor, i sjellë këtu nga larg, si duket për t'i shpëtuar punës së madhe që do të kërkonte guri si: faqezim, thyrje etj. Ky lloj guri është vendosur në mure pa kriter, dhe është shpërndarë në mënyrë të çrregullt. Muri në faqen e jashtme vjen shkallë-shkallë, (fig. 1; TAB I, 1) si duket kjo është bërë me qëllim që të zvogëlohej gjerësia dhe pesha e tij e madhe e kushtëzuar nga trashësia e madhe e bazamentit. Muri në fjalë në njërin skaj lidhet drejtpërdrejt me shkëmbin.

Një ndërtim tjetër gjendet në lartësinë më të madhe të këtij territori, në majën e shkëmbit që ndodhet në veri të sheshit të kalasë dhe që quhet «Maja e Znanit». Ky është një shesh shkëmbor me sipërfaqe rreth 40 m. katrore. Pjesa veriore dhe lindore e tij zihet prej një ndërtimi pothuaj kuadrat me përmasa 3,5 x 4,5 m. Këto mure kanë po atë teknikë punimi, që kishin muret fortifikuese juglindore. Gurët e përdorur këtu janë të të dy llojeve, por mbizotëron guri i zakonshëm ranor, i lidhur me llaç në sasi të bollshme. Të habit fakti se si janë sjellë këto gurë deri në lartësinë 700 m. për më tepër nëpër një rrugë ku shpesh duhet të ngjitesh me këmbë e me duar. Në pjesën e ruajtur mirë muri ka trashësi 1,10-1,20 m.

Ndërtimi i këtij objekti në majën më të lartë na bën të mendojmë se kemi një kullë vrojtimi nga ku mund të kontrollohej një hapësirë e gjerë. Në pjesën perëndimore të territorit të majës së Znanit vërejmë dy gropa me diametër më tepër se 1 m. Gropat zgjerohen në thellësi. Për ndërtimin e tyre janë përdorur tullat. Nga brenda suvatimi ruhet shumë mirë dhe është shumë i fortë. Anën e jashtme të kësaj pjese, ku ndodhen këto dy gropa, që, për mendimin tonë, s'janë gjë tjetër veçse dy depozita (stera) për ujë të pijshëm, e kufizon një mur me lartësi maksimale 4 m. dhe gjatësi 4,5 m. Teknika e punimit është po ajo e mureve të kullës së vëzhgimit, me përdorim të gurit të sjellë. Faqja e jashtme e murit përshkohet nga disa kanale gjatësore me thellësi 10 cm., të cilët shkojnë paralel, duke ruajtur largësinë e ndërmjetme 1 m. (TAB I, 2). Gjatë kanaleve vërehen disa vrima të rrumbullakta, të cilat përshkojnë transversalisht murin. Këto kanale janë gjurma të përdorimit të brezave të drunjtë, të cilët janë kalbur. Çështja e sigurimit të ujit të pijshëm e ka shqetësuar shumë banorin e këtij vendbanimi. Për një kohë, kalaja ka qënë furnizuar me ujë të pijshëm me kanalizime nga një burim që ndodhet pak larg në anën jugore të saj dhe që quhet «Kroi i Njerifit». Ka një gojëdhënë që flet për marrjen e kalasë, kur asaj ju pre ujët e pijshëm. Për të siguruar ujin janë përdorur dhe shpellat. Në njerën prej tyre, që quhet «Shpella e Kecrit», gjejmë të punuara në faqen karstike disa govata gjysmërrethore të vendosura njëra mbi tjetrën, të cilat janë formuar duke gdhëndur shkëmbin dhe shërbejnë për të pritur pikat e ujit që kullojnë nga lart. Vendosja e tyre është bërë në një mënyrë të tillë që të mbusheshin të gjith me radhë, duke filluar nga lart poshtë.

Siç e përmendëm edhe më lart në vendbanimin tonë janë të shumta gjetjet prej keramike. Po mundohemi t'i përshkruajmë këto gjetje sipas epokave që u përkasin [1]).

---

[1]) Për klasifikimin kronologjik të materialit patëm ndihmën e arkeologut N. Ceka.

DO NOT COPY

Keramika ilire e periudhës së parë të hekurit.

Në vendin e quajtur Drizë u gjetën me shumicë fragmente keramike të kësaj periudhe. Midis tyre dallojmë vegja e gryka enësh me parete të holla. Me interes është një fragment gryke i zbukuruar nga jashtë me dy vija paralele që ndërpriten transversalisht nga tri të tjera. Pikturimi është bërë me ngjyrë kafe para pjekjes. Nuk mungon edhe keramika e papiktuar ilire, megjithse është më e pakët.

Keramika e kohës së qyteteve ilire (shek. IV-I p.e.r.)

Keramikën e kësaj periudhe po e japim sipas funksioneve që kryente:

Tjegullat: Gjenden me shumicë brenda territorit të kalasë, në vendbanimin e hapur dhe për më tepër, në një kodër që është gati 20 minuta nga kalaja. Këtu punimet bujqësore kanë nxjerrë në sipërfaqe fragmente të mira tjegullash, pjesë pa vlerë si edhe dhé të pjekur. Prania e tyre është një e dhënë që provon karakterin lokal të prodhimit të tjegullave. Në tjegulla mbizotëron tipi solen.

Enët. Aty ku dikur vendosej banimi i hapur, janë gjetur fragmente enësh me parete të trashë, pitosa dhe amfora.

Me interes janë tre fragmente të gjetun në të njëjtin vend, të cilat mbajnë vula anepigrafike. Këto vula janë të vendosura mbi barkun dhe buzët e pitosave. Ato paraqesin emblema të ndryshme në relief: dy vija të kryqëzuara midis tyre në qendër, me pamjen e shkronjës X, ose tri vija të tilla të ndara nga një bosht simetrie. Në krahasim me zbulime të tjera të kësaj natyre si në Irmaj, ku krahas vulës epigrafike ndodhet një vulë anepigrafike, ne gjejmë një rast të veçantë, përdorimin e dy vulave anepigrafike të ndryshme në të njejtin fragment të një pitosi. Rrjedhimisht: ose duhet të pranojmë karakterin e përdorimit të tyre si dekoracione ose të pranojmë që prodhuesi duhet të ketë përdorur si shenjë dalluese të prodhimeve të tij jo një vulë të vetëme. Me interes është dhe përdorimi i një vule në dy fragmente, në paretet dhe buzët e pitosit. Këtu vërejmë dy shenja në relief, që ngjasojnë shumë me shkronjat I dhe F të lidhura së bashku.

Fragmentet e enëve me parete të holla që i përkasin periudhës së shek. IV-I p.e.r. janë të shumta në gjetjet tona. Ato paraqesin buzë, anë, funde, vegja amforetash, kupash, pjatash, vazosh etj. Për t'u shënuar është fragmenti i një fundi ene, i punuar me një baltë shumë të pastër, në pjesën e fundit i lyer me vernik të zi, kurse pjesa e sipërme me një ngjyrë midis të kuqes e kafesë. Nga përmasat e saj të vogla mendojmë se ka qënë një vazo zbukurimi. Në dy fragmente të tjera, që përfaqësojnë fundet e amforetave, nuk gjejmë elemente zbukurimi si më sipër. Me shumicë paraqiten fragmentet e vegjëve të enëve, të cilat janë të rrumbullakta, horizontale, shpatuke me dy kanelyra etj.

Peshat. Të këtilla ne kemi 6 ekzemplarë, nga të cilët një është me formë piramidale. Format, përmasat e tyre (lartësi 5-8 cm. dhe diametër bazë 4-5 cm.) tregojnë se nuk ndryshojnë me ato të zbuluara në vende të tjera, vetëm se, në njerën prej tyre, zbukurimi me vija të pikëzuara nuk është lart por anash. Në lidhje me përdorimin e tyre ne përkrahim mendimin se këto pesha kanë shërbyer për vendosjen e penjëve në vegjët për endje.

Gjetjet e kohës romake.

Këto përfaqësohen kryesisht me fragmente të tullave, të tjegullave, të enëve me parete të holla dhe disa fragmente metalike. Megjithëse gurët e ndërtimit janë në sasi të bollshme, në gjetjet tona tulla nuk mungon, bile është me shumicë. Ato paraqiten me përmasat 4 x 17 cm., pra vetëm dy përmasa ruhen të plota. Ato i kemi gjetur në po ato vende ku kemi gjetur edhe tjegullat, të cilat i përmendëm më sipër por fragmente tullash gjenden të vendosura në mënyrë jo të rregullt edhe në muret juglindore të po kësaj kohe. Objektet metalike janë të pakta. Këto përfaqësohen nga mbeturina të shkrirjes së hekurit, nga një gozhdë hekuri dhe nga një fragment në formën e trungut konik bosh përbrenda, që me sa duket ka qenë ose majë hosteni, ose majë e një shtize, në të cilën futet pjesa e drunjtë dhe është përdorur si armë. Ndër gjetjet prej bronxi kemi vetëm, një sumbull të vogël me kokë në formë këpurdhe, siç duket e destinuar për zbukurim.

Gjetje mesjetare.

Kësaj periudhe i përkasin pak objekte në gjetjet tona: disa fragmente tjegullash, enësh me smaltim të verdhë dhe një kazmë e plotë prej hekuri e gjetur nga fshatarët. Tjegullat ngjasojnë me ato të sotmet: janë gjysmë rrethore, veçse me përmasa më të mëdha. Kazma ruhet mirë. Tehun e saj e ka në formë të drejtkëndëshit të ngjashme me kazmat e sotme të tipit rrahe.

DO NOT COPY

TAB. I









DO NOT COPY

Përfundim:

Gjetjet e keramikës dhe teknika e ndërtimit të mureve rrethuese që përfaqësohet nga një punim jo i hollë i bloqeve, na çon në përfundimin se fillimin e kësaj qendre të fortifikuar të vogël ilire duhet ta kërkojmë në kohën e parë të hekurit. Rrethanat që përcaktuan ndërtimin e këtij banimi të fortifikuar kanë qenë: a) pozita gjeografike dhe strategjike e tij, e cila i ka siguruar kontrollin mbi një grykë, që ka shërbyer e shërben si rrugë lidhjeje midis luginës së mesme të Devollit dhe malësive në thellësi dhe b) kushtet natyrore me kullota shumë të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë.

Nëpërmjet gjetjeve na del në pah jeta ekonomike e shoqërore e këtij vendbanimi. Sado i vogël që ishte, banorët e tij, të shtyrë nga nevojat e përditshme, zhvilluan dy degët e ekonomisë: bujqësinë dhe blegtorinë, zhvilluan keramikën sidomos atë të material-ndërtimit. Masiviteti, vulosja e tyre tregon egzistencën e punishteve të veçanta të keramikës, tregon futjen dhe kalimin e prodhimit zejtar në rrugën e prodhimit privat.

Jeta e kësaj qendre banimi vazhdoi edhe në mesjetë. Kalaja kishte funksionin e një pike të mbrojtur që kontrollonte lëvizjen për në krahinën e thellë të shpatit e anasjelltas. Toponimet që ruhen akoma sot si: «Shpella e Barutit», «Lami i Barutit», dëshmojnë për rolin e saj deri në kohën e përdorimit të armëve të zjarrit.

DO NOT COPY

Sh. HAXHIHYSENI

L'AGGLOMERATION FORTIFIEE ILLYRIENNE DE TERVOL

RESUME

La forteresse se dresse sur une éminence rocheuse à une altitude de 700 m. au nord du village de Tervol, dans le district de Gramsh.

Au pied du rocher, sur le versant ouest, on trouve les vestiges d'un petit centre habité qui occupe une superficie d'environ un demi-hectare et qui s'étage en plusieurs terrasses successives étayées par trois rangs de murs.

Les traces des murs d'enceinte de l'agglomération fortifiée, sont bien conservées, et ils atteignent au sud-est une hauteur maximale de 7 mètres.

Parmi les ruines de cette citadelle, on distingue des murs d'époques diverses.

Les murs de l'époque illyrienne entourent un quadrilatère de 1200 m². Ils sont construits en pierres non taillées disposées les unes sur les autres à sec et ont une épaisseur de 3 mètres.

Les murs de soutien des terrasses, sur ce territoire, sont construits selon la même technique.

Les murs au mortier révèlent plusieurs procédés de travail. Dans l'impossibilité d'en dater la construction, nous nous bornerons à les décrire. Sur le côté sud, le mur atteint une hateur maximale de 7 mètres et une épaisseur de 3 mètres. Sur sa face externe, le mur, en redan, diminue graduellement d'épaisseur vers le haut, ce qui a été fait pour en réduire le grand poids conditionné par la grande largeur des fondations. A une extrémité, le mur se rattache au rocher. Il est construit en pierres de moyennes dimensions assemblées à l'aide d'une épaisse couche de mortier. Une autre construction, sur laquelle a été utilisée une technique identique, se trouve au sommet du rocher dénommé «Maja e Znanit». Cette construction, au périmètre rectangulaire de 3 m. 50 sur 4 m. 50, semble avoir servi de tour de guet. Au même endroit on trouve deux citernes.

De nombreuses trouvailles en céramique ont été faites sur l'emplacement de ce centre habité.

La céramique illyrienne de la première période du fer se relève ici dans des fragments de céramique peinte, à motifs linéaires parallèles de couleur brune. La peinture a été faite avant la cuisson.

La céramique de l'époque des cités illyriennes (IVe-Ier siècles av.n.è.) On trouve des quantités de tuiles à l'intérieur du territoire de la citadelle ou aux abords de celle-ci. Parmi ces objets, on note aussi des produits de rebut qui attestent le caractère local de cette production.

DO NOT COPY

ques présentent un intérêt particulier. Les fragments de vases aux parois minces, qui appartiennent à la période allant du IVe au Ier s.av.n.è., sont également nombreux. On a trouvé en outre certains types de poids à peser.

Les trouvailles de l'époque romaine sont principalement représentées par des fragments de briques, de tuiles, de vases aux parois minces et par certains fragments métalliques.

A la période médiévale appartiennent peu d'objets: quelques fragments de tuiles, des vases émaillés en jaune et une pioche entière en fer, découverte par les paysans.

Les trouvailles de céramique et la technique de construction des murs les plus anciens datent, dans cette agglomération, de la première période du fer. Les habitants de ce centre ont développé dans l'Antiquité diverses branches de l'économie: l'agriculture, l'élevage et l'artisanat, qui avait aussi revêtu le caractère de production privée. Cette agglomération a continué de connaître une vie active au moyen âge également.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Lutfi DERVENI

GJURMË TË REJA NË KALANË E MARGËLLIÇIT

DO NOT COPY

Në afërsi të Patosit, në një kodër me lartësi 200 m. mbi nivelin e detit, ndodhen gjurmët e një qyteti antik, që njihet me emrin «Kalaja e Margëlliçit». Në krahasim me kodrat përreth, kodra e kalasë ka një lartësi mbizotëruese. Nga ana perendimore ajo ka formën e një trungu piramide. Pozita strategjike në një vend prej ku mund të kontrollohej lehtë zona përreth, qe njera nga arësyet që i tërhoqi themeluesit. Arësyeja tjetër ishte vështirësia për ta pushtuar këtë kodër, pasi shpatet e saja nga ana veriore, jugore e lindore janë shumë të pjerrta; vetëm në pjesën perendimore ndodhet një qafë ku kodra fillon të zbutet dhe ky është i vetmi vend ku duhet kërkuar hyrja për në qytet.

Gjatë luftës së parë botërore arkeologu austriak Prashniker i bëri një përshkrim qytetit antik të Margëlliçit. Në atë kohë, siç duket, muret e tij ruheshin ende në gjendje të mirë. Sot ato pothuaj janë zhdukur dhe ne mund të mbështetemi vetëm në përshkrimin dhe planimetrinë e tij. Prej mureve të ndërtuara me bloqe katrore na ka mbetur ndonjë gjurmë (fig. 1) ndërsa muret e ashtuquajtura ciklopike nuk diktohen më.

Më poshtë do të bëjmë fjalë mbi zbulimin e disa elementeve të reja në këtë qendër. Prej tyre vemë në dukje, në radhë të parë, një kullë që e vërtetuam në anën juglindore të murit rrethues dhe disa stera për grumbullimin e ujit. Sterat janë ndërtuar për faktin se kodrina, duke qenë më e lartë se të tjerat dhe e përbërë prej formacionesh shtufore, nuk kishte burime, prandaj, në raste rrethimi, kjo ishte e vetmja mënyrë për sigurimin e ujit. Sterat i gjejmë brenda mureve rrethuese ose në ambientet dhe godinat e ndryshme. Ne pastruam njerën nga këto stera, në shpatin jugor të kodrës ku është ndërtuar qyteti.

Stera (fig. 2) ka formën e një pusi të rrumbullakët ndërtuar me tulla sektoriale me harkun e jashtëm 43 cm., të brendshmin 32 cm., me gjerësi 22 cm., dhe me trashësi 7 cm. (në raste të rralla 8 cm). Tullat janë lidhur me llaç në ngjyrë të bardhë, përzier me një lloj pluhuri gri. Pjesa e brendshme e sterës është izoluar me llaç gëlqeror të përzier me grimca tullash që ka një trashësi 2 cm. Për të siguruar më mirë hidroizolimin e sterës, ndërtuesit kanë izoluar edhe faqet e jashtme të murit, duke i veshur me një këmishë argjili (fig. 3). Stera mbulohet me një rras guri dy pjesshe që ka në qendër një boshllëk në formën e elipsit. Mbi këtë pllakë është vendosur gryka e sterës, e cila del 57 cm. mbi sipërfaqen e tokës dhe përbëhet nga një blok guri monolit në formë paralelopipedi me përmasa bazë 70 x 70 cm. Stera është ndërtuar në një godinë. Kjo kuptohet nga muret e ndërtuara rreth saj, siç është një mur me tjegulla helenistike me gjerësi 40 cm. në anën e majtë të grykës së sterës, gjithashtu në anën tjetër, duken dy radhë tullash në formën e një muri që zgjatet nga lindja dhe përfundon në një themel me gurë kuadratikë. Mbi nivelin e këtij muri, në profilin e dheut, duken fragmente të shumta solenësh dhe kalipterësh, mbeturina të çatisë së hajatit. Këto që thamë na lejojnë të mendojmë se stera ka qenë e ndërtuar në hajatin e një godine.

Stera mbushej me ujin e shirave, i cili grumbullohej nga çatitë e shtëpive, prej aty uji drejtohej nëpërmjet një kanali në murin e fundit të hajatit. Ndërsa një kanal tjetër, i ndërtuar vertikalisht brenda murit, e përcjell ujin me anën e një bërryli në sterë. Ky mur lidhet me pjesën jugore të grykës së sterës ne-



Fig. 1



Fig. 2

përmjet një dritareje katrore 18 cm. më poshtë buzës së grykës, e cila nga njëra anë komunikon me bërrylin që vjen nga kanali vertikal, kurse nga ana tjetër, me pjesën e brendshme të grykës. Brenda dritares shkarkuese është vendosur një pllakë guri që del në pjesën e brendshme 2 cm. më jashtë në mënyrë që uji i ardhur nga kanali vertikal nepërmjet bërrylit të mos përhapet në faqet e brendshme të grykës, por të rrjedhi në formën e një currili.

Ndër materialet që janë gjetur nga gërmimi i sterës, mbizotëronin fragmentet e amforave të mëdha dhe fragmente enësh tavoline. Këtu vlejnë të përmenden në shtresën e poshtme të depozitimit enët helenistike si amforiska të vogla, enë guzhine, enë tavoline me vegjë kornute dhe fragmente të tjera të thyera gjatë mbushjes së ujit. Këto fragmente keramike datohen në shek. II-I p.e.s. Një datë «ante quem» më të saktë për datimin e sterës na japin 4 monedha bronxi, të gjetura në fund të sterës – të gjitha të Apollonisë të shek. II-I p.e.s. (dy Apollon – obelisk, një Artemis – – Trekëmbësh me emër nëpunësi dhe e katërta Apollon – Lyrë).

Vëzhgimet tona në disa pika e plotësojnë punimin e Prashnikerit, sidomos për karakterin e vendbanimit në shekujt kur në Iliri u zhvilluan marrëdhënjet skllavopronare.

Keramika e grumbulluar në këtë vend shkon nga shek. IV p.e.s. deri në shek. II-III të epokës sonë. Përsa i përket keramikës të shek. IV dhe të III p.e.s. përmendim një lekyth helenistik me vernik të zi e të shkëlqyer me profilin e një femre (Tab I, b), një kotyle dhe një kupe (Tab. I a, c), shumë fragmente me vernik dhe profile enësh helenistike. Periudhës së sundimit romak në Iliri i takon keramika e fragmentuar e tipit të enëve terra-sigillata dhe keramike lokale (Tab I d). Në numrin e madh të objekteve të keramikës zenë një vend të rëndësishëm ato me origjinë nga Apollonia.

Deri tani nuk janë hasur gjurmë të keramikës më të hershme që ka të bëjë me periudhën e parë të hekurit, megjithëse Prashniker përmend se ka parë fragmente të tilla me shumicë. Gjetje të shumta ka edhe përsa i përket materialit të punuar prej guri si: sarkofag, altarë prej guri gëlqeror dhe mermeri, urna të vogla për varrim, fragmente parmaku prej mermeri, mokra prej guri vullkanik, kollona të stilit dorik etj. Në zbukurimet artistike janë gjetur dhe grumbulluar fibula, pasqyra, sumbulla dhe ornamente të tjera që flasin për një zejtari artistike të zhvilluar. Materialet që përmendëm më lart dhe gjurmët nekropolit që shtrihen në një sipërfaqe të madhe jashtë qytetit, sjellin prova të reja në lidhje me jetën dhe aktivitetin e këtij qyteti.

Qyteti ka patur një ekonomi të zhvilluar. Banorët vendas merreshin me bujqësi në luginat jashtë qytetit dhe me blegtori në zonat kodrinore. Në shek. IV-III zhvillohen marrëdhënjet ekonomike, sidomos me Apolloninë. Për këtë dëshmon keramika e shumtë me breza të kuq dhe profilet e enëve që janë tipike për keramikën e punishteve të Apollonisë. Këtu duhet përmendur dhe keramika e lyer brenda me një shtresë zifti, e cila haset shpesh në qytetin e Margëlliçit. Për

DO NOT COPY

zhvillimin e zejtarisë na lë të gjykojmë edhe një majë heshte prej hekuri e papërfunduar. Këtë e plotësojnë fragmentet prej hekuri të dy thikave, të disa gozhdëve, të një çelsi dhe prodhime të zejtarisë artistike, nga të cilat vlen të përmendim disa terakota. (Tab. I, f, g, h). Në njerën nga këto paraqiten dy vasha të mbuluara me një pelerinë. Zhvillimi i zejtarisë në këtë qytet, si edhe pozicioni i rëndësishëm midis Ilirisë bregdetare dhe të brendshme, i dha shkas zhvillimit të madh të tregëtisë në qytetin e Margëlliçit. Një provë faktike për këtë është gjetja e monedhave, e cila tregon për një qarkullim të mallrave në shumë qendrave antike të Ilirisë dhe jashtë saj. Numri i monedhave të gjetura rastësisht i kalon të 130 copët. Këto flasin për lidhjet tregëtare me vendet më afër Margëlliçit respektivisht me Apolloninë, Dyrrahin, Bylisin, Orikun dhe me vendet më të largta, si Ambrakinë, Argosin, Thesalinë, Histian, etj., të cilat fillojnë që nga shek. IV p.e.s. dhe vazhdojnë pa ndërprerje deri në shek. IV të epokës sonë me dy monedha të Kostancit. Këto monedha në japin një tabllo të qartë të vazhdimësisë të jetës në këtë qytet.

Këto monedha na tregojnë edhe se me cilat qytete i pati lidhjet tregëtare Margëlliçi në etapa të ndryshme. Për shek. IV dhe fillimin e shek. III p.e.s. kemi monedha të Apollonisë, Ambrakisë, Maqedonisë dhe Argosit.

Për shek. III-II p.e.s. materiali bëhet më i bollshëm si në keramikë edhe në monedhë. Këto të fundit tregojnë se Margëlliçi vazhdoi lidhjet tregëtare duke i zgjeruar ato me një numër qytetesh të tjera. Në këtë periudhë, lidhjet tregëtare u zhvilluan me Bylisin, Orikun, Dyrrahin, Apolloninë dhe Thesalinë.

Për zhvillimin e mëtejshëm dhe jetën tregëtare të Margëlliçit të shek. II dhe fillimin e shek. I p.e.s., na flasin kryesisht monedhat e Apollonisë, të cilat tregojnë lidhjet e shumta që pati me qytetin e mësipërm. Në këtë qytet gjejmë edhe monedha të shek. I të e.s. por deri tani të pakta në numër. Monedha të shek. II-III deri tani nuk kemi gjetur, por kjo nuk do të thotë se gjatë kësaj kohe ishte ndërprerë jeta tregëtare, por me sa duket pati vetëm një rënje të saj. Vazhdimin e tregëtisë na e dëshmojnë dy monedha prej bronxi të Konstancit, që datohen në fillimin e shek. IV të e.s.

Nga sa thamë më lart, mendojmë se Margëlliçi, si një qytet që ka filluar jetën para shek. IV p.e.s., lidhjet tregëtare më të shumta i pati me Apolloninë për sa kohë që kjo lulëzoi në bregdetin e Ilirisë. Qytete të tjera të Ilirisë me të cilat Margëlliçi zhvilloi tregëti ishin: Bylisi, Oriku, Dyrrahi, etj.

Në afërsi të qytetit ka patur qendra më të vogla banimi. Këtë e vërtetojnë gjurmët e gjetura në afërsi të kalasë së Margëlliçit si në Ruzhdije, Manxarend, Patos Fshat dhe Dukas.

Në lidhje me emrin e këtij qyteti ilir, duke u nisur nga ngjashmëria e tingëllimit të fjalëve Orgesos (Polyb V 108,8) dhe Argias, mendojmë se qyteti i Margëlliçit emrin antik e ka pasur Orgesos. Kjo tezë është e drejtë në qoftë se do të pranohej identifikimi i lumit Argias me Gjanicën [1]) e sotme, e cila kalon në jug të kësaj kalaje. Një mendim i tillë mbetet për t'u vërtetuar nga ndonjë mbishkrim që mund të dalë në dritë nga gërmimet arkeologjike.



Fig. 3

1) C. Patsch – **Das Sandschak Berat in Albanien** – Wien 1905, f. . . .

DO NOT COPY

TAB. I



DO NOT COPY

DO NOT COPY

L. DERVENI

RECENTES FOUILLES A LA FORTERESSE DE MARGËLLIÇ

RESUME

A proximité de Patos, sur une colline de 200 m. d'altitude, se trouvent les vestiges d'une cité antique, connue sous le nom de «Forteresse de Margëlliç». Parmi les constructions non relevées par Praschniker, celles qui attirent le plus l'attention sont deux citernes. Le déblayage de l'une d'elles a permis de recueillir les données suivantes: la citerne (fig. 1) a la forme d'un puits cylindrique construit en briques trapézoïdales de 7 cm. d'épaisseur. Les briques sont assemblées à l'aide d'un mortier blanchâtre mélangé d'une sorte de poudre grise. A l'intérieur, les parois, de 2 cm. d'épaisseur, sont revêtues d'un mortier à chaux mélangé de fragments de briques. Pour mieux en assurer l'étanchéité, la citerne est revêtue sur ses paroi extérieures d'une chemise d'argile. La citerne est couverte d'une double dalle de pierre percée en son centre d'une ouverture en forme d'ellipse sur laquelle est posé le col de la citerne, lequel est constitué d'un bloc de pierre monolithe en forme de parallélépipède: Cette citerne est construite dans le péristyle d'une maison et elle était alimentée par les eaux de pluie qui y étaient conduites du toit par un canal qui passait sur le mur du péristyle.

Les objets trouvés au cours du déblayage de la citerne et surtout les monnaies d'Apollonie qui y ont été découvertes incitent à en fixer la date à une époque antérieure au Ier siècle avant notre ère.

Les observations faites dans cette forteresse complètent aussi le travail de Praschniker sur le caractère de l'agglomération, surtout pour la période marquée par le développement des rapports esclavagistes en Illyrie.

La céramique recueillie couvre une période s'étendant du IVe siècle avant notre ère jusqu'aux IIe et IIIe siècles de notre ère, et les pièces de monnaie trouvées par hasard dépassent le chiffre de 130. Elles sont de périodes diverses qui vont du IVe siècle avant notre ère au IVe siècle de notre ère. Les plus récentes sont deux monnaies de Constance.

Les monnaies trouvées non seulement attestent, par la diversité de leurs dates, la continuité de la vie dans cette agglomération, mais indiquent aussi les villes avec lesquelles cette agglomération entretint des relations commerciales.

Il est fort possible que cette agglomération ait été l'antique cité d'Orgesos.

DO NOT COPY

Fabian MIRAJ

MURET ANTIKE TË PERSQOPIT

Gjatë rrugës që shkon nga Petrela për në fshatrat Durisht dhe Shënkoll, jo më larg se 1500 metra nga Petrela, në shpatin e malit, në anën e majtë, duken disa mure të lartë [1]) që i takojnë një qyteti ilir. Në të parë, të habisin për madhështinë e tyre dhe tërheqin vërejtjen e çdo kalimtari.

Përveç mureve rrethuese të qytetit të vjetër, ka edhe objekte të tjera me rëndësi si banesa me shumë kthina, një varr monumental dhe një çesmë monumentale.

Ne po ndalemi këtu vetëm në përshkrimin e teknikës së ndërtimit të mureve rrethuese të qytetit, duke dhënë përfundimet e vrojtimeve tona gjatë punimeve konservuese e restauruese, që ndërmori Instituti i monumenteve vitin e kaluar në këtë qendër.

Nga muret rrethuese më mirë ruhen dy kulla, njëra në anën jugore dhe tjetra në pjesën veriore të qytetit. TAB. I, 1).

Kulla jugore, 58 m. e gjatë dhe 12 m. e gjerë, paraqet ndërtimin më madhështor që ruhet sot. Në këtë kullë lartësia e mureve arrin deri në 7 m. me 10 rreshta gurësh të vendosur njëri mbi tjetrin. Muret mbështeten mbi themele të thelluara deri 1.10 m. Gurët e themeleve janë të paskalitur dhe në shumë raste janë hedhur në themel si janë gjetur në natyrë. Themeli del jashtë 10-15 cm. për të krijuar një mbështetje më të saktë të murit. Muret janë ndërtuar me bloqe guri shumë të mëdha me një lartësi rreshti 80-85 cm. Rreshti i murit shkon pothuaj në nji nivel dhe në raste të rralla lidhet rreshti i poshtëm me atë që vjen sipër. Gurët e faqes, të shumtën e herës, janë daltuar nga të gjitha anët. Me anë të disa gurëvet, të vënë kliç lidhet faqja e jashtme me murin e brendshëm. Në këtë mënyrë muri lidhet më mirë dhe fiton një rezistencë më të madhe.

Në proçesin e ndërtimit të murit më parë kanë qenë vendosur gurët e rreshtit të mveshjes d.m.th. gurët e faqes dhe më vonë mbushej pjesa e brëndshme e murit me gurë të madhësive të ndryshme dhe me ata gurë që nuk ishin të përshtatshëm për faqen e jashtme. Nga kjo shpjegohet që rreshtat e mveshjes së jashtme shkojnë në një nivel me mbushjen e brendshme. Në gjerësinë e tij muri lidhet në këtë mënyrë: Ndërtohen dy mure gjatësor: njëri si faqe e jashtme dhe tjetri si faqe e brendshme. Muri i faqes së jashtme arrin një gjerësi deri 2 m. dhe muri i faqes së brendshme deri në 1 m. Këta dy mure lidhen me njëri tjetrin me mure të tjera të tërthorta të gjera deri 1 m. Boshllëqet që formohen, mbushen me gurë dhe me dhé. Në këtë mënyrë formohet trashësia e murit që kalon 6 m.

Në muret rrethuese të kullës bien në sy edhe pilastrat. Këto përforcojnë më tepër muret dhe njëkohësisht hijeshojnë pamjen e jashtme të tyre.

Vërehet se pilastrat janë ndërtuar në një drejtim me muret e tërthorta, të cilat, në këtë rast, nuk janë gjë tjetër veçse vazhdimi i tyre në thellësi për të lidhur murin e jashtëm me atë të brendshmin. Pilastrat, si në ndërtimet jugore ashtu edhe në ato veriore, kanë një dalje nga faqja e murit 45-50 cm. dhe një gjerësi deri në 1 m. Aty ku mbështeten pilastrat, zgjerohet edhe më tepër themeli për të krijuar një mbështetje më të mirë. Gurët e pilastrave vendosen në një kuotë me gurët e murit të mveshjes. Për ve-

1) Shih dhe I. G. von Hahn, **Albanesische Studien.** Vienë, 1853, f. 78. H. Ceka dhe I. Adam kanë dhënë një raport me skicat përkatëse për vrojtimet që kanë bërë në këtë qendër antike N. Ceka ka bërë një përshkrim të monumenteve që ruheshin në sipërfaqe dhe ka drejtuar rilevimin topografik të kalasë. Materialet ruhen në arkivin e sektorit të arkeologjisë në Institutin e historisë dhe të gjuhësisë.

DO NOT COPY



Fig. 1

ndosjen e gurit gjatësor, skalitet një djep i vogël që hyn në faqen e murit rreth 2 cm. Në këtë vend puthiset guri i parë i pilastrit. Mbi këtë gur vendosen, të shumtën e herës, 2 gurë të tjerë, në pozicion të tërthortë, të cilët futen në pjesën e brendshme të murit. Në këtë mënyrë vazhdon muri i pilastrave deri në lartësi.

Numri i pilastrave arrin në 12 për të dy kullat, nga të cilat vetëm për 2 copë kemi gjurma. Hapësira në mes tyre lëviz nga 5-6.23 m. Në kullën jugore, në qoshe, nuk janë ndërtuar të tilla, kurse në kullën veriore janë ndërtuar edhe nëpër qoshe.

Nga ana lindore e kullës jugore gjindet porta e hyrjes për në qytet (TAB I, 2). Hyrja në fillim është e gjerë 2.70 m. dhe përfundon në 2.90 m. Përsa i përket murit të brendshëm të kullës, sot për sot shihet vetëm drejtimi nga dy pikat e nisjes anësore. Nga ana e kundërt e hyrjes vazhdon muri rrethues i qytetit. Gjerësia e murit arrin në 5.85 m. Duke vazhduar drejt juglindjes zhduken gjurmat e murit dhe fillon pjesa shkëmbore e shfrytëzuar për rrethim. Muri rrethues është ndërtuar po me atë teknikë sikundër muri i kullës, d.m.th. me mure gjatësore që lidhen me mure të tërthorta. Në pikëpamje konstruktive edhe kulla veriore është ndërtuar si kulla jugore, por nga madhësia është shumë më e vogël se ajo. Megjithëse deri më sot nuk është pastruar mirë vendi, del se muri i faqes së brendshme nuk ka teknikën e ndërtimit të anëve të tjera. Kjo gjë do të dalë më e qartë, kur të pastrohet muri deri në thellësi. Muri që shkëputet nga kulla dhe vazhdon në drejtimin veriperëndimor është ndërtuar me gurë të vegjël, si mur i parregullt dhe me sa duket, nuk i takon kohës së ndërtimit të kullës.

Të gjitha ndërtimet që përmendëm më sipër janë punuar me bloqe të mëdha me forma të ndryshme trapezoidale dhe shumë rrallë drejtkëndëshe. Gurët janë prej formacioneve konglomerate. Ky lloj guri gjendet me shumicë sidomos në anën e lindjes së malit të Petrelës. Edhe mali i Durishtit është i formuar po me këtë lloj guri. Bloqet e gurëve të punuar kanë madhësi të ndryshme: gjatësia maksimale arrin deri 2.35 m. ndërsa lartësia e gjërësia 60-85 cm. Pesha mesatare arrin deri 15 kv.

Nxjerrja e gurit është bërë nëpër gurore duke i prerë shkëmbinjt në vend. Në anën veriore të malit të Durishtit, aty ku ai lidhet me malin e Petrelës, gjendet një gurore antike, ku do të jenë nxjerrë këto bloqe.

Gurët që ndodhen në murin jugor nga ana e jashtme janë punuar me sipërfaqe të sheshta. Nëpër pjesët anësore, ku bashkohet guri me gur ka një prerje të vogël të tehave të gurit. Prerja lëviz nga 2-3 cm. Aty ku bashkohet guri me gur formohet një kanal i vogël në formë trekëndëshi, gjë që e zbukuron edhe më tepër sipërfaqen e rrafshtë të murit.

Guri me gur është puthisur në një mënyrë aq të përsosur sa në shumë raste, është vështirë të kuptohet vendi i ndarjes së tyre, po mos të ishte kanali i vogël që përshkruam më sipër. Nga format e ndryshme të gurëvet kuptohet se çdo gur është punuar në vend dhe është përshtatur sipas vendit. Kjo teknikë është paraardhëse e teknikës kuadrate, kur gurët janë prodhuar në seri dhe guri mund të zinte vende të ndryshme në një radhë.

Në ndërtimet e kullës veriore prerjet dhe natyra e punimit të gurit është e njëllojtë me teknikën e përpunimit të gurëve të kullës jugore. Gurët përreth faqes së dukshme kanë një shirit të skalitur 5-8 cm. ndërsa pjesën e sipërfaqes që mbetet e kanë më të ngritur.

DO NOT COPY



1



2

DO NOT COPY

DO NOT COPY

F. MIRAJ

LES MURS ANTIQUES DE PERSQOP

RESUME

Sur le versant d'une montagne dominant la route qui conduit de Petrele aux villages de Durisht et de Shënkollë, se voient de hauts murs, vestiges d'une ancienne cité illyrienne. Outre les murailles de la vieille ville, il s'y trouve aussi d'autres vestiges importants, notamment ceux d'une habitation a nombreuses pièces, une fontaine et un tombeau monumentaux.

Des murailles d'enceinte les mieux conservées, subsistent deux tours qui se dressent respectivement au sud et au nord de la ville. La tour sud à base rectangulaire de 58 mètres sur 12, constitue la construction la plus imposante des vestiges de cette citadelle. Les murs se composent de gros blocs de conglomérat, de formes diverses, généralement trapézoïdale et très rarement rectangulaire. Les blocs de pierre sont de dimensions variées: leur longueur maximale est de 2 m. 35, leur largeur et hauteur de 60 à 85 cm.

Les fondations sont constituées de pierres non équarries dont seule la face supérieure a été aplanie. Elles saillent de 10 à 15 centimètres sur le plan vertical des murs pour créer un soutien plus sûr. Les murs extérieur et intérieur qui forment la muraille ont, le premier 2 mètres, le second un mètre d'épaisseur. Ils ont reilés entre eux par d'autres murs transversaux épais d'un mètre, l'épaisseur totale de la muraille dépassant six mètres.

Les murs de tours sont aussi renforcé de contreforts qui ne sont que les prolongements des murs transversaux sur la paroi extérieure de la muraille. L'espace entre les contreforts varie de 5 m. à 6 m. 25.

Les pierres ont été extraites d'une carrière et les rocs taillés sur place. On trouve des traces de cette carrière sur le versant nord du mont de Durisht.

Thanas KAMBERI

DISA TË DHËNA MBI TEKNIKËN E NDËRTIMIT TË BANESËS GJIROKASTRITE

Banesat gjirokastrite i përkasin shekullit XVIII dhe më shumë shekullit XIX. Teknika e ndërtimit të tyre ka specifikat e saja të kushtëzuara nga materialet e ndërtimit që janë përdorur, nga karakteri i veçantë i banesës gjirokastrite dhe nga mjeshtrit popullorë, që punuan për ndërtimin e tyre. Teknika e ndërtimit është një tregues me rëndësi i nivelit të ndërtuesve. Evolucioni i saj jep të dhëna të rëndësishme për datimin relativ të ndërtimeve, si edhe për shkollat e ndryshme të mjeshtërve shqiptarë.

Zakonisht, në Gjirokastër, muratura e banesave dhe mureve ndërtohet me gur e shumë rrallë me çatma, kurse druri përdoret në çati, tavan dysheme, dyer e dritare, si dhe në brezat e muraturës.

Trashësia e themeleve arrin deri në 130 cm.; ajo është në vartësi të ngarkesës e lartësisë së banesës. Për ndërtimin e themeleve përdoreshin gurët më të mëdhenj ose pjesë shkëmbinjsh, të dalë nga kavat e gurit në afërsi të objektit që ndërtohej. Përgjithësisht themelet e qytetit janë të thata, të palidhura me llaç, gjë që siguronte kullimin e ujërave nëntokësore dhe mënjanonte ngjitjen kapilare të ujit në katet e mësipërme. Kjo mënyrë ndërtimi krijonte mundësinë që ambientet e sipërme të ishin pa lagështirë. Muratura përpjetë, duke u rritur në lartësi nga kati në kat, vjen duke u ngushtuar, ose, siç thonë muratorët, shkelet në 8-12 cm. Numri i kateve ndikon si në themelet ashtu edhe në trashësinë e muraturës, që lëviz nga 80-130 cm.. Për ndërtimin e mureve përdoret guri i bardhë dhe guri i zi, prej të cilëve i bardhi gjen përdorim më të gjerë, për arësye se dhe shumica e banesave të Gjirokastrës gjënden mbi këto shtresa. Në lagjet Pllakë dhe Pazari i Vjetër, ku ka vetëm gur të zi, muratura ndërtohet ose me këtë gur ose përzihet me gurin e bardhë. Duke qenë se guri i zi është më i dobët se i bardhi, mjeshtri, në vëndet kyçe të godinës, si qemerë, qoshe etj., përdor vetëm gurin e bardhë.

Si material lidhës në këto mure përdorej llaçi i argjilit, shumë herë i dalë nga kavat e gurit, si dhe llaçi i gëlqeres. Llaçi gjen përdorim vetëm në rreshtat e faqes së jashtme dhe të brendshme të banesës dhe nuk përdoret në mesin e trashësisë së muraturës. Përdorimi i llaçit vetëm në faqen e jashtme dhe në të brendshmen, për mendimin tonë, shpjegohet nga këta faktorë:

a) Guri i një kualiteti të mirë shtresor lejon ndërtimin e një murature solide pa llaç.

b) Duke qenë Gjirokastra e asaj kohe një qytet pa ujë të bollshëm, sigurimi i tij duke e prurë nga lumi, kërkonte shumë shpenzime.

c) Leverdia ekonomike nga kufizimi i përdorimit të llaçit.

d) Shkaku i fundit, për mendimin tonë më i rëndësishmi, është se muratura me gur të thatë heq mundësinë e depërtimit të lagështirës kapilare nga jashtë brënda. Dhe në të vërtetë, nëse do të krahasojmë muret e lidhura me llaç me ato të ndërtuara me gurë të thatë, do të vërejmë se nga jugu ose perendimi në të parët kemi lagështi, e cila në të shumtën e rasteve ka shkaktuar rrëzimin e suvatimit.

Arësyen e fundit jemi të prirur ta quajmë më kryesoren në përdorimin e gjerë të muraturës me gur të thatë, pa llaç, edhe sepse në Gjirokastër, ku ka banesa shumë të mëdha e të zbukuruara me dekorime të kushtueshme, nuk do të ishte llogjik kursimi në gëlqere dhe ujë. Faktikisht në Gjirokastër ka banesa, si ajo e Zekatëve, ku muret e avllisë, që zenë pothuajse gjysmën e volumit të mureve të godinës,

DO NOT COPY



Fig. 1

janë ndërtuar me llaç gëlqereje, ndërsa ato të vetë banesës janë gjysmë të thata.

Muraturën përpjetë, në vartësi nga trashësia e saj, mund ta klasifikojmë: në muraturë të trashë guri dhe në muraturë të hollë guri. Muret e trasha të thata prej guri pa breza druri, kronologjikisht janë muret më të vjetra të ndërtuara në këtë qytet. Këta i gjejmë përgjithësisht të zbatuara në godinat njëkatëshe. Këta lloj muresh kërkojnë gurë të mëdhenj në mënyrë që ai i faqes së jashtme të shkelë gurin e faqes së brendshme. Në godinat e ndërtuara në shek. XVIII, XIX gjejmë mure gjysmë të thata, lidhja e të cilave realizohet me anë të lidhjes së gurëve në trashësi dhe në lartësi të tij.

Lidhja në trashësi e murit, që është njëkohësisht më e rëndësishmja, është lidhja brenda-jashtë. Kjo lidhje është e përkryer tek muret me trashësi deri 60 cm.. Ndërtimi i këtyre mureve kërkon, si dhe në muret e thata, gurë me madhësi të konsiderueshme. Kur trashësia e murit rritet, për të mos humbur shkeljen e gurëve të dy faqeve, është e domosdoshme dhe rritja e madhësisë së gurit, (tab. 1). Kur gurët e kësaj madhësie nuk përballonin kërkesat, lindte nevoja e ekonomizimit të tyre. Mjeshtrit, për ekonomizimin e gurëve të mëdhenj, lejonin që kjo lidhje të bëhej të paktën në çdo katër gurë. Ajo bëhej në formë asimetrike dhe garantonte qëndrueshmërinë e murit. Kur muret arrinin 60-75 cm., lidhja në më të shumtën e rasteve realizohej nëpërmjet tre gurëve, ku dy gurët e faqeve shkelnin mbi atë të mesit. Kjo lidhje nuk ka dhënë përfundimet e dëshiruara, gjë që vihet re në mjaft godina të Gjirokastrës, në të cilat faqja e jashtme është e deformuar dhe në shumë raste është shkëputur nga faqja e brendshme. Kjo e ka burimin nga që lidhja duhej të bëhej me tre gurë të së njëjtës trashësi, të cilët nuk i kanë patur mjeshtrit ndërtimit.

Lidhja e murit në lartësi (tab. 1), e cila është gjithashtu e rëndësishme, qëndron në mosrënien e fugave mbi njera-tjetrën. Megjithatë, lejohej që mbi njëra-tjetrën të binin të shumtën tri fuga. Kjo lidhje vihere dhe del më qartë në të gjitha ato godina ku guka trashësi të njejtë.

Në disa raste kur muret e kalojnë trashësinë 60 cm., ato ndërtohen me gurë të mëdhenj, të vendosur në të dy faqet anësore dhe me gurë të vegjël nëmes të tyre, duke u lidhur me breza druri. – Vendosja e brezave të drurit (tab. 1) siguron një lidhje të tërthortë shumë të mirë, ulje gjatësore uniforme dhe nuk lejon të çara në mur, pavarësisht nga çdo ulje e vogël e rastit e themelit ose prishje e ndonjë pjese të vogël të murit. Meqenëse në Gjirokastër rreshjet e shiut vijnë kryesisht nga ana e jugut dhe e perëndimit, mjeshtrit, që të mos kalbeshin brezat e drurit, kanë gjetur zgjidhjen e drejtë, duke i veshur nga ana e jashtme me mur deri në 12 cm. Brezat fillojnë 120-130 cm. nga toka dhe gjithmonë në pjesën e jashtme janë të veshur me muraturë. Veshja e brezave vazhdonte deri në lartësinë 3.5-4 m. nën strehët e çatisë, meqënëse mbi këtë lartësi mbroheshin prej saj. Largësia e vendosjes së brezave është 80--110 cm.. Nga ana e lindjes dhe e veriut brezat janë krejtësisht të paveshur. Përmasat e brezave janë të ndryshme; ata kanë trashësi 3 cm më tepër dhe në gjërësi 6-12 cm. Më të përdorshëm janë ata me trashësi 6-7 cm.; të cilët të gjithë pa përjashtim janë prej lënde lisi. Brezat janë dyshe, një nga jashtë dhe një nga brënda, por i gjejmë dhe treshe, duke vënë një në mes (tab. 1). Si ato dyshet dhe ato treshet janë të lidhura midis tyre me traversa po prej lisi, me të njëjtat përmasa dhe që vendosen në një largësi 60--70 cm.

Kur kemi breza dyshe, ata vendosen në faqen e jashtme të murit, (sigurisht që flasim për ato të mbrojtura nga shiu). Kur kemi breza treshe, ata vendosen simetrikisht, në mënyrë që rreshti i jashtëm i gurëve të shkelet nga dy breza dhe të krijohet një lidhje më e mirë. Në rast se brezi i mesit vendosej në mes të murit, nuk do të siguronte asnjë lidhje, se ai mbetej në boshllëk. Brezi i mesit nuk vendoset mbi rreshtin e brendshëm të gurit, se pesha më e madhe e çatisë bie mbi këtë faqe, kështu që kjo faqe ka qëndrueshmëri më të madhe, prandaj edhe muret në Gjirokastër hapen më shumë nga jashtë. Mbërthimi i brezave bëhet gjithmonë me gozhdë kovaçi. Qoshet e bashkimit të mureve (tab. 1) bëhen me shumë kujdes, në mënyrë që të gjithë brezat të mbivendosen, d.m.th. të kemi kryqëzime. Lidhjet e vet brezave (tab. 1) (zgjatja) bëhen me fallco (kalem) dhe në mbivendo-

DO NOT COPY

sje; mënyra e parë është më e mirë se nuk prish rradhitjen e gurëve.

Mbulimi i hapësirave të dyerve e të dritareve bëhet me qemer guri, ndërsa vetëm në katin e sipërm me arkitrarë druri. Arkitrau i drurit, gjithmonë prej lisi, përdoret dhe brenda qemerëve të dritareve dhe të dyerve, në katet e poshtme. Guri që përdorej në këto qemerë, ishte shumë i madh dhe disa herë kemi qemerë me dy të tilla. Për mbulimin e hapësirave të mëdha, si të kamerjeve dhe të sterave të ujit etj., përdorej harku cilindrik. Teknika e ndërtimit dhe lidhjet e këtyre harqeve janë si ato të muraturës. Në këto harqe përdorej gjithmonë llaç gëlqereje dhe nuk takojmë në asnjë rast qemerë me llaç argjili ose pa lidhës. Mbi harkun, i cili ka një trashësi rreth 35 cm., hidhet një sasi mbeturinash ndërtimi ose çakëlli për nivelim dhe mbi të llaç gëlqereje dhe rrasa guri (kapak). Kamerjet meqë ndodhen jashtë mbulesës së çatisë, kanë një shtresë hidroizoluese me harasan. Në qemerët vendosen tiranta prej lisi, të cilat kryqëzohen në brezat e mureve.

Muratura e hollë prej guri (tab. 1) është gjithashtu mjaft e përhapur në këtë qytet. Ajo përdoret në muret ndarse në katet e sipërme dhe në ballin e godinave. Muret e holla ndërtohen me skelet druri të mbushur me gurë të gdhendur me dimensione 12 x 20-40 cm. dhe të lidhur me llaç argjili. Trashësia e këtij muri nuk i kalon të 12 cm.

Në godinat ku gjen përdorim ky lloj muri, nuk takojmë asnjëherë mur çatma. Kjo na lë të kuptojmë se çatmaja është shumë e vonë në këtë qytet; ajo duhet të ketë hyrë aty rreth fundit të shek. XIX. Këtë bindje na e përforcon dhe karakteri mbrojtës i banesës gjirokastrite.

Zakonisht të gjitha muret perimetrale përfundojnë në një kornizë guri të thjeshtë (Tab I, 4), të përbërë prej dy rreshta gurësh të latuar njeri mbi tjetrin, jo më pak se 50 cm, të vendosur në formë shkallësh. Kjo kornizë përgjithësisht është përdorur deri nga fillimi i shek. XIX. Nga fillimi i këtij shekulli deri në fund të tij fillon e përdoret gjerësisht korniza e gurit, e ashtuquajtur nga mjeshtrit korniza me kokosha, e cila formohet nga një gur me lartësi 20 cm., të profiluar në formë çerek rrethi.

Përveç këtyre rreth fundit të shek. XIX filluan të përdoreshin tipe të tjera kornizash të profiluara.

Më e vjetra është ajo me dy radhë kapakë, me rreshtin e mesit si dhembë sharre (tab. 1), e cila përdorej më shumë në mesin e godinave, në pjesën e sipërme të kamerjeve si dhe në fund të qestekëve më të gjatë, në ballin e godinës.

Suvatimi më i përhapur dhe më i vjetër është ai me baltë argjili, që është njëkohësisht më i thjeshti. Balta e argjilit përzihej mirë me kashtë dhe lihej dy-tri ditë për të fituar lagështi uniforme, pastaj hidhej në mur dhe rrafshohet. Ky lloj suvatimi përdorej kudo me përjashtim të dhomave të miqve. Suvatimi me baltë argjili dhe gëlqere është nga më të mirët. Ai përdorej sidomos në mure pa llaç ose kur muri ka si lidhës llaç argjili. Mbi murin e gurit hidhej një shtresë llaç argjili me trashësi deri 2 cm., me përmbajtje kashte të prerë. Pas rrafshimit ajo lihej për tu tharë, derisa të mirrte të plasura nga tkurrja e argjilit. Mbi shtresën e parë hidhej shtresa e dytë, që nuk i kalonte të 5 mm. Shtresa e dytë pregatitej duke marrë lesh dhije dhe duke e rrahur me një shufër, deri në hapjen e tij të plotë. Pastaj përzihej me gëlqere shumë të pastër, derisa të krijohej një lëndë viskoze. Në stinën e verës për të ulur tkurrjen e gëlqeres hidhej dhe pak rërë e larë. Llaçi i pregatitur shtrohej mbi shtresën e parë me mistri dhe pastaj me anën e një malloje vazhdohej fërkimi për tri-katër ditë. Pas kësaj pune përftohej një sipërfaqe e rrafshtë si patinaturë. Mbi të kalonte sherbeti i gëlqeres dhe pastaj dy duar emulsion me përmbajtje 1% tutkall, për të mbajtur sherbetin e gëlqeres.

Kjo mënyrë suvatimi është më e mirë, sepse nga fërkimi i madh i saj krijohej një sipërfaqe e lëmuar, e cila, me që gëlqerja e shuar është hidroizoluese, nuk lejonte hyrjen e ujit në thellësi. Këto lloj suvatimesh janë më të bukura dhe më ekonomike se suvatimet me gëlqere.

Suvatimi me harasan përdorej në sterat e ujit (muslluqet) dhe në shtresat ku kërkohej hidroizolim. Trashësia e suvasë është deri në 3 cm.. Shtresa e parë përbëhet nga pluhur tulle dhe gëlqereje; mbi këtë hidhet një shtresë tjetër, e cila është shumë më e fortë, që mund të jetë një përzierje me të bardhë veze dhe vaj.

Çatitë e banesave të Gjirokastrës janë të ndërtuara me lëndë të rrumbullakuar (latuar) bredhi, ndërsa strehët me lëndë lisi dhe mbulohen me rrasa guri. Përdorimi i tjegullave të vëndit në qytet është i vonë. Mbeturinat e tjegullave, më të mëdha se tjegullat e sotme, të gjetura gjatë pastrimeve në kala, tregojnë se ato janë përdorur te godinat e ndërtuara në kala në vitet e Ali Pashës. Strehët e çatisë dalin jashtë faqes së murit deri 1.5 m., e mbështeten mbi qestekë të shkurtër prej lisi 6-7 cm. dhe të gjatë po prej lisi 7 x 11 cm. Qestekët e shkurtër zakonisht, mbështeten në mur mbi brezin e parë të drurit. Nga perëndimi ose nga jugu strehët janë të shkurtëra, pa qestek, si kornizat që përmendëm më lart. Strehët 60 cm., me tavan dërrase, janë të vona në qytet; ato mund të kenë hyrë atëhere kur është vënë në përdorim çatmaja. Pjerrësia e çative në Gjirokastër shkon nga 25°-30°, më të zakonshmet janë 27°. Të gjitha çatitë me strehë të shkurtëra, kanë si lartësi të ba-

DO NOT COPY



LIDHJE E MURIT ME2GURE



LIDHJE E MURIT ME 3 GURE



PAMJE E MURIT





BREZAT GJATSORE



KRYQZIMI BREZAVE



ZGJATJA BREZAVE



MUR GURI ME TRASHESI 12cm ME SKELET DRURI



KORNIZE GURI TIP I I



KORNIZE GURI TIP I II



KORNIZE GURI (KOKOSHA)



NDARJE ME MURE GURI 12cm

DO NOT COPY

ballëkut 1/4 e hapësirës së brendshme, ndërsa në çatitë me strehë të gjatë merret 1/4 e hapësirës brenda plus trashësinë e dy mureve, duke hequr zinxhirin e poshtëm, të sipërm, si dhe trashësinë e mahive. Kufiri i pjerrësisë, që përcaktohet nga 25°-30°, është në përpjestim të zhdrejtë me madhësinë e rrasës së gurit dhe trashësinë e lëndës së drurit. Lënda e përdorur për trarët e poshtëm (tavan) dhe mahitë, është e trashë 12 x 15 cm, ndërsa për pajandimet është me përmasa më të vogla. Konstruksioni më i thjeshtë i çative, që nuk ndryshon nga ato të sotmet, është ai me hapësirë drite deri 4 m. Zgjidhje interesante kanë çatitë me hapësirë drite mbi 4 m (Fig. 1), në të cilën mjeshtri, pa ndonjë llogaritje statike, ka arritur që, edhe me lëndë të holla, të ndërtojë konstruksione të tilla që, megjithë peshën e madhe të rrasës së gurit, të qëndrojnë në gjëndje të mirë më tepër se një shekull. Mbulesa me rrasa guri bëhej po ashtu si dhe në kohët tona: duke filluar me vendosjen e rrasës më të madhe afër strehëve, sepse atje është më e madhe sasia e ujit, dhe duke u ngjitur për në kulm me rrasa më të vogla. Kulmi ka rrasa të mëdha dhe të mënjanuara nga ana e jugut ose e perëndimit. Kjo varet prej drejtimit të kulmit, por në asnjë rast ky nuk ka pjerrësi nga veriu ose lindja, sepse andej nuk ka reshje të shumta. Ky shkak shpjegon dhe kalbjen më të madhe të lëndës nga jugu ose perëndimi. Çatitë me rrasa guri kanë dhe anë negative, se kërkojnë shumë lëndë, dhe anë pozitive, sepse rrasat janë më ekonomike, mbasi gjenden në vend, janë më termoizoluese se tjegullat dhe nuk i transmetojnë lëndës as lagështirën më të vogël.

Punimet e ndërtimit të banesave kryheshin nga grupe, që udhëhiqeshin nga një kryemjeshtër. Grupi arrinte deri në 20 vetë dhe përbëhej nga kryemjeshtri, mjeshtrat, punëtorë e kafsharë. Këta merrnin përsipër, në marrëveshje me pronarin, të gjithë punimet dhe materialet, përveç lëndës së drurit e gëlqeres, të cilën porositësi e siguronte shumë kohë përpara fillimit të punimeve.

Të dhënat e teknikës së ndërtimit, që trajtuam, do të plotësohen në të ardhmen me materialet e reja, që do të dalin gjatë punimeve restauruese, të cilat, njëkohësisht, do të hedhin dritë dhe mbi një sërë problemesh të tjera të pazgjidhura ose të papërcaktuara përfundimisht.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Th. KAMBERI

DONNEES SUR LA TECHNIQUE DE CONSTRUCTION APPLIQUEE DANS L'HABITATION TYPE DE GJIROKASTËR

RESUME

La maçonnerie des habitations des XVIIIe et XIXe siècles à Gjirokastër est faite de pierres, le bois étant utilisé pour la toiture, les plafonds, les planchers, les portes et les fenêtres, ainsi que pour les ceintures de renforcement des murs.

Les fondations sont construites en pierres disposées à sec, procédé qui permet le drainage des eaux souterraines et élimine la montée capillaire. L'épaisseur des murs diminue, d'un étage à l'autre, de 8 à 12 centimètres; pour la liaison de la maçonnerie on se servait de mortier d'argile ou de mortier à chaux, celui-ci n'étant employé que pour les parois et non pour l'intérieur des murs. Les raisons qui ont fait adopter un tel procédé de construction sont les suivantes:

a) Les pierres stratifiées permettent de bâtir des murs solides sans mortier.

b) Gjirokastër n'ayant pas été jusqu'à récemment encore, approvisionnée abondamment en eau, il était coûteux d'en faire transporter de la rivière.

c) Il avait l'avantage d'économiser le mortier.

d) Ce procédé rend impossible l'infiltration de l'humidité capillaire du dehors à l'intérieur.

Nous sommes enclins à considérer cette dernière raison, comme ayant été essentielle.

Nous diviserons la maçonnerie de pierres en murs épais et en murs minces. Les premiers, construits selon le procédé à sec, sans ceintures en bois, sont chronologiquement les plus anciens. Dans les habitations bâties au cours des XVIIIe-XIXe siècles, on trouve des murs à demi secs, liés en épaisseur et en hauter. La liaison en épaisseur se fait en évitant que les joints soient superposés. La maçonnerie est consolidée par des ceintures de bois, qui assurent une bonne liaison transversale de la construction, et un nivellement longitudinal uniforme. Sur les parois sud et ouest qui sont les plus battues par la pluie, les ceintures sont revêtues de maçonnerie à l'extérieur pour les empêcher de pourrir.

Les encadrements des portes et des fenêtres sont surmontés de linteaux en pierre, et, au deuxième étage, seulement d'architraves en bois. Les grandes ouvertures sont surmontées d'arcs en plein cintre. Les murs minces en pierres servent de cloison, et au troisième étage de façade. Ils sont constitués d'une ossature en bois comblée de pierres appareillées.

D'ordinaire, tous les murs périmétraux sont terminés par des corniches de divers types, en pierre.

Le revêtement le plus usité et le plus ancien est celui en terre argileuse. Comme pratique répandue citons aussi l'enduit d'une première couche de terre argileuse, suivi d'un second à la chaux, procédé qui a donné d'excellents revêtements. Le revêtement au mortier de sable et de chaux a été utilisé là où il fallait empêcher l'infiltration de l'eau, autrement dit pour les citernes.

Les toits des habitations de Gjirokastër sont construits en charpentes de bois et recouverts de plaques de pierre ordinaire, (dalles minces). Les avant-toits, en général, ne sont pas revêtus, ils avancent de 1,5 mètre environ et s'appuient sur des contre-fiches en bois.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dail HALILAJ

GJURMË TË VJETRA NË GOLLOBORDË

DO NOT COPY

Golloborda është një zonë malore me reliev të thyer e shkëmbor me rrafshina të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë. E gjithë zona përshkohet nga një rrjetë e dendur ujore, që ka krijuar kushte të përshtatshme për banim të përhershëm në këtë krahinë, sikurse e vërtetojnë dhe gjurmët e shumta të lashtësisë. Më poshtë po parashtrojmë rrjedhimet e kërkimeve dhe të studimeve të disa prej këtyre gjurmëve.

Lladimericë. Në verilindje të fshatit Lladimericë, afër Dibrës së Madhe, buzës së një lumi, ngrihet një kodër në formë trung-koni 75 m. e lartë, e cila në pjesën e sipërme përfundon me një pllajë. Në anën perendimore dhe veriore kodra qarkohet nga lumi, ndërsa në anën lindore, ku lartësia është më e vogël, kalon një rrugë. Pjesa e sipërme e kodrës rrethohet nga muret e një kalaje që ka një planimetri rrethore, portat e së cilës kanë qenë në anën lindore, nga ana e rrugës. Në faqen perendimore të kodrës duken gjurmët e një tuneli, i cili të nxirrte lart në kala; me sa kuptohet, ai shërbente për furnizimin e fshehtë me ujë. Muret e kalasë janë ndërtuar me gurë të vegjël, të palatuar, të lidhur me llaç dhe me tulla. Sipas të dhënave të vendasve, në afërsi të kalasë ka pasur rrënoja shtëpish dhe varre. Mendojmë që kjo kala duhet të ketë bërë pjesë në vargun e fortesave të afërta që mbronin Sfetigradin gjatë epopesë së lavdishme të Skënderbeut.

Kojovec. Në fshatin malor Kojovec gjendet një kala, muret e së cilës janë të ndërtuara me të njejtën teknikë si ajo e Lladimericës. Në të gjënden dhe mbeturina qyngjesh keramike të lidhura me llaç, që i përkasin një ujësjellësi që bashkonte kalanë me një përrua.

Borovë. Përveç rrënojave të një kalaje gjendet dhe një shpellë, e cila vazhdon me shkallë në brendësi të malit. Gojëdhëna thotë se këtu gjendet një kishë.

Trebisht. Në lindje të fshatit, mbi një kodër, gjendet një pllajë prej 10 ha., që ndahet nga kufiri shtetëror me Jugosllavinë në dy pjesë. Sipas të dhënave të banorëve, në të janë gjetur mbeturina keramike ndërtimi, skulptura dhe mbishkrime.

Një çështje tjetër me interes që duam të trajtojmë është ai i organizimit dhe i shtegtimit të mjeshtrave vendas. Gollobordasit njihen prej kohësh si mjeshtra të talentuar ndërtimi. Të detyruar nga kushtet ekonomike që të shtegtojnë, ata organizoheshin në grupe prej 10-20 vetësh dhe niseshin për të kërkuar punë, kryesisht në Jugosllavi, Bullgari, Greqi, Turqi, Egjypt deri në Siri. Zakonisht niseshin në pranverë dhe qendronin nga një, deri në pesë vjet e më tepër. Pas kësaj periudhe kthehesin për disa muaj dhe e vazhdonin sërishmi shtegtimin e tyre.

Grupet udhëhiqeshin nga ustabashi dhe përbëheshin nga ustallarët, të cilët zotëronin njëkohësisht të tëra specialitetet e ndërtimeve si dhe nga baltaxhinjtë, që merreshin me pregatitjen e llaçit dhe me furnizimin e ustallarëve. Kur ndërtimet ishin voluminoze, tërë grupi përqëndrohej në një objekt, ndërsa, kur ishin të vogla, ndahej në dy pjesë.

Në këtë komunikim përmendëm një sërë vrojtimesh, të cilat në të ardhmen do të mundohemi t'i zgjerojmë dhe t'i plotësojmë.

DO NOT COPY

D. HALILAJ

VESTIGES ANTIQUES A GOLLOBORDE

RESUME

Golloborde, région montagneuse, réunit les conditions naturelles appropriées qui en ont fait un habitat permanent. Les vestiges de vie ancienne que l'on retrouve dans cette contrée nous en apportent un témoignage.

Lladimerice. *Au nord-est du village, sur une colline de 75 mètres de haut, apparaissent les vestiges, d'une forteresse. Les murs sont construits en pierres et en briques assemblées au mortier. Sur le versant ouest se voient les traces d'un tunnel qui conduisait au sommet de la colline dans la forteresse.*

Kojovec. *C'est un village de montagne où subsistent les ruines d'une forteresse aux murs construits selon la même technique que ceux de Lladimerice. On y a également découvert des conduites en céramique d'un aqueduc.*

Borove. *Outre les ruines d'une citadelle il y existe aussi une grotte qui, selon les légendes, devait abriter une église.*

Trebishte. *Les habitants de l'endroit affirment qu'à l'est du village, sur une colline, ont été recueillis des débris d'objets en céramique, de matériaux de construction, de sculptures et des inscriptions.*

Une autre question traitée dans cette étude est celle de l'organisation et de la migration des maîtres locaux. Ils s'organisaient en groupes de 10 à 20 et gagnaient la Yougoslavie, la Bulgarie, la Grèce, la Turquie, l'Egypte ou la Syrie, où ils séjournaient de un à cinq ans. Au bout de cette période de travail, ils retournaient dans leurs pays pour quelques mois, puis émigraient à nouveau.

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

DO NOT COPY

Theofan POPA

H. NALLBANI
RRETH KRIJIMTARISË SË PIKTORIT
DAVID SELENICASI

Artikulli i Hasan Nallbanit «Piktori David Selenicasi dhe piktura e tij murale në kishën e shën Kollit në Voskopojë», paraqet një studim interesant dhe me vlerë, që përbën një kontribut në studimet e pikturës sonë të vjetër.

Autori ka kapur mirë dhe drejt dhe ka ekspozuar një varg tiparesh dhe veçorish të pikturës së Davidit, të cilat nxjerrin në relievë shumë vija të fizionomisë artistike të kësaj figure të madhe të artit shqiptar të shek. XVIII. Të tilla janë: «koncepti modern mbi kompozimin, përgjithësimin e formës. . .» «aftësia për t'ja përshtatur zgjidhjen dekorative dhe kompozicionale përmasave arkitektonike të interierit» — interesimi i piktorit për ambientin dhe materien në pikturë, etj. Autori i kumtesës nga vepra e Davidit ve në dukje vizatimin e lirë, plastikën reale, konceptin realist të kompozimeve. Por me rëndësi na duket konstatimi i tij, që «në drejtim të koloritit piktori mundohet të arrijë gjithë disavantazhin që krijon zgjidhja kompozicionale simetrike, duke i vlerësuar figurat me tone e njolla të ndryshme». Përveç vënjes drejt në dukje të interesimit të piktorit për ambientin, për detajet, planet dhe perspektivën, një element nga më të përparuarit të Davidit, që e vëren mirë autori, është ai i përdorimit të ngjyrave në mënyrë realiste, por sidomos ai i përdorimit të dritës «duke ruajtur një burim drite natyrale», që d.m.th. dhënja e dritës në mënyrë reale dhe jo si në pikturën e mëparshme.

Si këto dhe të tjera elemente realiste nga vepra pikturale e Davidit, të cilat e nxjerrin në pah vlerën e lartë artistike të saj ,si dhe fizionominë prej artisti të shquar të autorit të saj, janë vënë mirë në dukje në këtë kumtesë. Por e shohim të nevojshme që në këtë drejtim të sjellim disa plotësime.

Sipas studimeve tona rreth veprës së Davidit, megjithë idetë përparimtare të kohës, që ndikuan në krijimin e një pikture aq të përparuar, me gjithë ndryshimet që ka pësuar ajo me elementet e shumta realiste, bile dhe moderne, që vërehen në disa figura të saj, pa shenja grafike të pikturës bizantine dhe asaj pasbizantine piktura e Davidit duhet të cilësohet si pikturë pasbizantine dhe jo pikturë moderne as pikturë e re.

Përcaktimi me termin pikturë pasbizantine e cilëson mirë këtë pikturë për faktin sepse ajo ngrihet mbi traditën bizantine vendase duke trashëguar shumë elemente nga ajo traditë, si dhe për faktin se është krijuar pas rënjes së Bizantit, në një nga viset e asaj perandorie; kështu e përjashton atë nga rrymat artistike të reja e moderne.

Duke qenë se në fillim Davidi ushqehet dhe formohet me ndjenjën artistike të pikturës bizantine e pasbizantine vendase, do të ishte e pamundur që në pikturën e tij, sado të përparuar drejt realizmit, të mos trashëgoheshin nga ajo traditë e lartë një sërë elementesh. Kështu në veprën e Davidit shohim të trashëgohet i gjithë sistemi i pikturimit të Kishës lindore, ciklet ikonografike bizantine të plotësuar me cikle e tema të reja nga manastiret e Atosit, të krijuara gjatë etapës së robërisë otomane.

Në kompozimin e shumë skenave, sidomos në ato të festave të mëdha, që janë me origjinë të vjetër,

Davidi ruan mënyrën e radhitjes së figurave në skenë sipas traditës. Një element tjetër nga tradita, që paraqitet si thelbësore dhe ndeshet në disa skena të Davidit, është punimi gati në mënyrë skematike i ambientit shkëmbor si dhe të atij detar, p.sh. në skenën vrasja me gurë e diakon Stefanit, shkëmbinjt punohen prej disa linjash të thjeshta, ose në skenën «shën Kolli në varkë» në mes të valëve të detit, valët janë punuar prej disa linjash të lakuara sa për të dhënë idenë e detit. Si këto dhe shumë të tjera me siguri nuk tregojnë paaftësinë e këtij kryemjeshtri të talentuar për t'i punuar ato në mënyrë realiste, veçse dëshirën e tij për të koresponduar me ndjenjën artistike të Kishës lindore, të shumtën e rasteve nga ana formale e jashtme.

Kështu cilësimi i pikturës së Davidit si pikturë pasbizantine, jo vetëm që e përcakton mirë atë në vijat kryesore dhe njeriut i jep një ide të qartë për cilën rrymë arti ose pikturë është fjala, por na shtyn të mendojmë dhe për trashigiminë në të nga piktura e vjetër. Sepse në të janë të dukshme ndikimet e pikturës sonë të rilindjes bizantine nga ajo e ristozit të Mborjes (1389) pranë Korçës, nga ato të kishave të Beratit (shek. XIV), sidomos nga ajo e Perivleptës së Ohrit (1295) dhe ajo e manastirit Protaton (gjysma e parë e shekullit XIV) në Atos.

Kështu njohja e ndikimeve të shumta nga piktura vendase dhe ajo fqinje e rilindjes bizantine dhe pasbizantine do të na lejojë të kapim në të, më drejt e më saktë, ndikimet e fuqishme e të pakundërshtueshme nga rrymat e mëdha të artit perendimor.

Për skenën «kungimi i apostujvet» në absidë të basilikës së shën Kollit të Voskopojës, autori mendon se figurat e saja nuk janë të së njejtës dorë, se ato të gjysmës veriore të absidës nuk janë të dorës së Davidit, sikurse janë ato të gjysmës jugore. Për ne kjo skenë tërësisht është e një dore, e dorës së Davidit. Për të mos bërë këtu krahasime ndërmjet atyre figurave dhe për të mbështetur pikëpamjen tonë, po mjaftohemi me pohimin se e gjithë forca e talentit artistik në ndërtimin e figurave të gjysmës veriore të absidës përputhet plotësisht me atë jugore; në plastikën e figurave, në lëvizjet elegante, në shprehjet e thella psikologjike të fytyrave dhe në vlerësimin e koloritit e të gamës. Vetëm se qëndrimet e figurave të gjysmës jugore të absidës paraqiten të realizuara me një statikë pak më reale, por për këtë, ne ato nuk mund t'i quajmë si punë e një artisti tjetër.

Në atë bazilikë ka figura dhe të «shoqëruesve të Davidit», të Konstandinit e të Kristos, siç lexohet në mbishkrimin ktitorial të kishës në fjalë; por këtë çështje ne nuk do ta prekim.

Duke përfunduar diskutimin tonë përgëzojmë autorin për kontributin e vlefshëm që dha në studimin e pikturës sonë të vjetër duke vlerësuar në të elementet realiste, që, sipas mendimit tonë, vlejnë të kihen parasysh.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Th. POPA

A PROPOS DE L'OEUVRE DU PEINTRE DAVID SELENICASI

RESUME

L'article d'Hasan Nallbani «David Selenicasi et ses peintures murales de l'église de Shënkoll (Saint-Nicolas) à Voskopojë», constitue une intéressante étude, qui apporte une réelle contribution à la connaissance de notre peinture ancienne. L'auteur a fait justement ressortir nombre de traits et de particularités de l'oeuvre de David. Tels sont entre autres: «la conception moderne de la composition et de la généralisation de la forme» ...«l'adaptation harmonieuse de la composition et des motifs décoratifs aux proportions architecturales des intérieurs», etc. L'auteur a également très justement mis en lumière: la liberté du dessin, la tendance à la plasticité des formes, la conception réaliste des compositions, etc.

Néanmoins, certaines considérations complémentaires à cet egard, ne nous paraissent pas superflues.

En dépit des idées progressistes de l'époque qui influèrent sur la création d'une peinture si avancée et malgré l'évolution que celle-ci a subie du fait des nombreux éléments réalistes qui y furent introduits, l'oeuvre de David doit être définie comme une peinture post-byzantine.

David a hérité une série d'éléments de la peinture byzantine, héritage qui se reflète notamment dans la composition de nombreuses scènes selon la tradition antique, dans le traitement schématique du paysage, etc. Ainsi en définissant la peinture de David comme étant post-byzantine, on est plus près de la réalité et l'on marque en même temps la part qu'y occupe l'héritage de la peinture ancienne:

De même, la scène de «la communion des apôtres» en l'abside de la basilique de Shën Koll de Voskopojë, est l'oeuvre d'une seule main et non pas, comme l'estime l'auteur de l'article, de deux peintres différents.

DO NOT COPY

KRONIKË

DO NOT COPY

PUNA KONSERVUESE RESTAURUESE DHE KËRKIMORE NË INSTITUTIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS GJATË VITIT 1970

Gjatë vitit 1970 Instituti i monumenteve të kulturës ndërmori një sërë punimesh konservuese, restauruese dhe ekspeditash informative. Dhe këtë vit një pjesë të mirë të punimeve e zinin punimet konservuese, që synonin ruajtjen e gjendjes së monumenteve dhe marrjen e masave për evitimin e dëmtimit të mëtejshëm. Veç këtyre u ndërmorën një sërë ekspeditash restauruese, që synonin për kryerjen e të gjithë punimeve të nevojshme për vlerësimin e plotë të monumenteve. Po kështu u ndërmorën disa ekspedita informative për njohjen dhe vënien nën mbrojtje të monumenteve të reja.

Në fushën e monumenteve antike në qytetin ilir të Lezhës vazhdoi për të katërtin vit restaurimi i mureve rrethues. Punimet u përqëndruan në njerën nga portat e murit të brëndshëm të rrethimit, e cila u zbulua vitin e kaluar në një gjendje mjaft të keqe. Muret e korridorit të hyrjes dhe kulla që e mbronte atë ishin shvendosur dhe shëmbur gjatë një rrëshqitje dheu, si rjedhim ndjehej nevoja e një ndërhyrje të gjerë restauruese. Punimet paraprake të pastrimit sqaruan të tërë planimetrinë e hyrjes që formohet nga spostimi në brëndësi i linjës së murit të brëndshëm rrethues. Hyrja mbrohet nga një kullë në anën perëndimore dhe nga një ball muri përballë portës që e detyronte sulmuesin të kthehej nga e djathta. Shtresat kulturale që lidhen me këtë mur nuk e kalojnë në vjetërsi shek. I p.e. sonë. Kjo gjë krahas tipareve stilistike, provon se hyrja, si gjithë muri i brendshëm u ndërtua gjatë luftës civile, në vitin 48 p.e. sonë. Gjatë restaurimit u çuan në vend linjat e mureve të korridoreve dhe të kullës dhe u bë anastiloza e tyre.

Në qytetin ilir në malin e *Persqopit* pranë Petrelës vazhdoi pastrimi i monumenteve i filluar vitin e kaluar. U kryen disa punime anastiloze në kullën e murit verior të qytetit dhe u muarën masat paraprake për pastrimin, për nivelimin dhe për restaurimin e varrit monumental me qemer në këtë anë të qytetit.

Instituti i kushtoi vemendje mbrojtjes së varreve monumentale të zbuluara në *Selcën e Poshtme* në krahinën e Mokrës nga rrethi i arkeologëve amatorë të Pogradecit. Varret që ndodhen në një zonë në veri të mureve të qytetit antik janë të gdhendura në një shkëmb prej shtufi, ndërsa njëri prej tyre është me qemer, i ndërtuar me gurë katrorë. Instituti i vuri vehtes si detyrë sistemimin e zonës së gërmuar dhe marrjen e masave me karakter konservues, që qëndronin në përforcimin e elementeve të dëmtuara të varrit me gurë katrorë dhe mbulimin e tij me një konstruksion të lehtë druri, për ta mbrojtur përkatësisht nga reshjet. Gjatë këtyre pastrimeve u zbulua rastësisht kamera e varrimit e njërit prej varreve të hapur në shkëmb. Kamera ka qënë hapur në shkëmbin mbi të cilin ndodhet varri. Ajo ka formën e një dhome katërkëndëshe me përmasa 2.82 x 2.77, me dysheme të sheshtë dhe tavan në formë qemeri 1.95 m. të lartë. Një hyrje e punuar thjeshtë që e lidhte dhomën me ambientin e jashtëm ishte bllokuar me një derë monolite prej guri. Dhoma ishte përdorur dy herë për qëllime funerale. Nga varrimi i parë, me të cilin lidhet monumenti në shkëmb kanë mbetur vetëm sarkafagët. Varrimi i dytë shoqërohet nga një inventar i pasur, megjithëse është prekur nga një grabitës që në kohën antike.

Inventari përbëhet nga 26 enë balte, 5 enë bronzi dhe paisje luftarake, heshta, shpata, thika dhe një këmishë lufte e thurrur prej telash hekuri. U gjetën edhe

dymbëdhjetë stoli ari si dhe një paftë brezi prej hekuri e veshur me një petë argjëndi me reljev. Pesë nga vathët janë të një tipi helenistik me fytyrë negri të punuar në gur, formë e njohur nga zbulimet në Durrës dhe Maqedoni. Një tjetër ishte i njohur si tip, por i veçantë si zgjidhje me figurën e erosit që fluturon i hipur mbi një gur. Skema e paftës së brezit paraqet përfundimin triumfues të luftës për tri luftëtarë ilirë: dy kalorës dhe një këmbësor në këmbët e të cilëve shtrihet një ushtar armik i vrarë dhe një grifon.

Të gjitha varret e dhomës lidhen me një diapazon jo shumë të gjerë kohe nëpërmjet objekteve të gjetura në të cilat në përgjithësi i takojnë fundit të shek. III dhe fillimit të shek. II p.e. sonë. Kjo na jep edhe një «terminus ante quem» për ndërtimin e këtij varrit në gjysmën e parë të shek. III p.e. sonë, gjë që përputhet edhe me stilin arkitektonik të varrit. Materialet e botuara do të pregatiten për një botim të veçantë në shtyp.

Në *Zgërdhesh.* Vazhduan punimet e pastrimit dhe të konservimit të mureve rrethuese.

Në *Apolloni.* Në fontanën monumentale të qytetit antik filloi restaurimi i murit mbajtës, i dëmtuar nga rrëshqitjet e dheut. Në buleterionin e qytetit (ndërtesa e agonotetit) filluan punimet pregatitore për anastilozën e kollonadës dhe frontonit të godinës, gjë që do të kryhet vitin e ardhshëm.

Në *Bradashesh (Elbasan).* U bë përforcimi i kubesë së frigidariumit të termeve romake të zbuluara në vitin 1968 dhe u rindërtuan harqet prej tulle të dritareve të tij. Gjithashtu u bë përforcimi i mureve të termeve dhe i furrës së tyre.

Sektori i monumenteve antike bëri edhe ekspedita për njohjen e gjendjes së monumenteve në rrethe të ndryshme të vëndit dhe plotësimin e dokumentacionit. U vizituan për këtë qëllim qendrat antike të *Apollonisë, Butrintit, Amantias, Bylisit* etj. Në një punë të tillë dhanë kontribut edhe bashkëpuntorë të jashtëm.

Në fushën e monumenteve të antikitetit të vonë e të mesjetës u kryen punime në disa kala dhe në disa kisha bizantine.

Në *Kalanë e Elbasanit.* Këtë vit u punua për pastrimin dhe marrien e masave me karakter konservimi në kullat e murit perëndimor të kalasë, u pastruan nga hedhjet dy kullat e qoshеve duke kaluar në një sondazh deri në taban në kullën e qoshes juaperëndimore. U përcaktuan tri shtresa kulturale. Më e hershmja përmban fragmente keramike të shek. IV të e. sonë. Shtresa e dytë përmban më tepër materiale ndërtimi, ndërmjet të cilave edhe tulla me vula të punishteve të ndryshme, dhe një keramikë karakteristike për shek. VI të e. sonë. Shtresa e tretë përmban objekte që datohen pas shek. XV, deri në ditët tona. Këto shtresa përfaqësojnë edhe tri periudhat kryesore të ndërtimit të kalasë. U restauruan dritaret dhe frëngjitë e kullave.

Në *Muret e Portës (Durrës).* U bë pastrimi i murit që mbyllte dikur hyrjen për në kodrat e Durrësit nga ana e veriut, midis detit dhe kënetës. Dolën në dukje kullat që mbronin hyrjen dhe muri në krah të tyre. Kjo punë ndihmoi në saktësimin e planimetrisë së murit dhe dha elemente të reja për datimin e këtij sistemi fortifikimi në shek. VI të e. sonë.

Objekt tjetër në të cilin u kryen punime ishte *Kalaja e Beratit.* Në muret rrethuese të Beratit u kryen punime me karakter pastrimi dhe konservimi. Kullat pranë hyrjes kryesore u lehtësuan nga presioni i dheut. U pastrua nga jashtë muri në anën perëndimore duke nxjerr në dritë edhe këtu periudhën më të lashtë të ndërtimit prej bloqesh katrorë, si dhe një sërë kullash. Veç tyre u zbulua dhe u pastrua ambienti i jashtëm i çisternës së çitadelës.

Për njohjen e gjendjes së monumenteve dhe dokumentacionin e tyre u kryen ekspedita në rrethet *Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Gjirokastër,* gjatë të cilave u zbuluan edhe një numur qendrash të reja antike dhe mesjetare si Zaradishta, Zvezda, Memkulazit, Ganjollës etj.

Punime konservimi dhe restaurimi u ndërmorën edhe në një sërë monumentesh kulti mesjetare. Në *kishën e shën Mëhillit në Berat* që i përket shek. XIV u arrit të rikrijohej një pamje e jashtme më autentike duke hequr shtresat e mëvonshme pa vlerë arkitektonike dhe duke rikrijuar kornizën dhe çatinë në formën më të hershme. Në punimet e brëndshme, gjatë pastrimit të suvatimeve në narteks, u zbuluan fragmente afresku të shek. XIV, po kështu në *kishën e shën Triadhës,* monument i shek. XIII-XIV u punua për çlirimin e mureve të anës jugore, lindore e veriore nga dheu i depozituar që fshihte një pjesë të mirë të tyre dhe absidën. U hoqën shtesat e bëra gjatë kohëve mbi kornizën e hershme dhe u ul në këtë nivel çatia. Pllakat prej guri të mbulesës u hoqën duke rikrijuar çatinë prej tjegullash. Punime të këtij karakteri u morën edhe në *kishën e shën Kollit në Perondi.* U hoqën të gjitha shtesat e mëvonshme që fshihnin formën e vjetër të bazilikës bizantine të shek. XI-XII dhe kumbanoren unike bizantine të shek. XIII. Edhe nga dyshemeja u larguan vendosjet e mëvona duke nxjerrë në dy zona dyshemenë më të hershme. Gjatë pastrimeve të brëndshme u zbuluan afreske të shek. XIII. Në *kishën e Kurjanit* u restaurua çatia duke larguar

DO NOT COPY

tavanin që është një shtesë më e vonë. Nën kapriatën dolën afreske të panjohura të piktorëve të shek. XVI Joanit dhe Nikollës së Onufrit.

Punime konservimi u kryen edhe në kishat e *Libofshës, Vanajt (Fier), Bishqethmit, Ardenicës (Lushnje), Goranxisë, Labovës së Kryqit, Dhuvjanit (Gjirokastër), Pecajt, Leshnicës, Dhivrit (Sarandë).*

Volumi më i madh i punimeve dhe këtë vit u krye në fushën e arkitekturës popullore. Në *qytetin e Gjirokastrës* përfunduan punimet në banesat e Zekatëve dhe Kikinove ku u restauruan dhe ambientet e brëndshme. Në banesat e Galanxhiut, Toros e Raqit punimet e këtij karakteri janë në vazhdim. Në lagjet Pllakë, Pazari i Vjetër, Hazmurat dhe Meçite, që përfshihen brënda zonës muze të qytetit u kryen punime të gjera restaurimi në fasadat e një numri të madh banesash duke nxjerrë në dritë vlerat arkitektonike të ansambleve të këtyre lagjeve. Në një sërë monumentesh të tjerë të kategorisë I dhe II vazhdojnë të kryhen punime konservimi. Po kështu në *qytetin muze të Beratit* në banesën e Tapit u krye restaurimi i jashtëm dhe i brëndshëm i godinës. Punime të këtij karakteri janë në vazhdim edhe në banesat e Mishaxhiut dhe Xhokaxhiut.

Në *Kavajë.* Banesa e Arkaxhijve iu nënshtrua punimeve të jashtme dhe të brëndshme restauruese. Godina që fitoi në këtë mënyrë pamjen autentike të saj do të kthehet në një muze etnografik për qytetin.

Në kuadrin e studimit të banesës fshatare, për vënjen nën mbrojtje të ekzemplarëve përfaqësues të saj dhe zgjedhjen e tipeve për muzeun e fshatit në natyrë, u kryen disa ekspedita me karakter informativ. U mblodh materiali i nevojshëm grafik dhe fotografik për banesën fshatare *në malësitë e Krujës* dhe në *fushën e Zadrimës.* Në *fshatin Goranxi të Gjirokastrës* u dokumentuan ndërtime të tipit kullë të shek. XVIII-XIX me një arkitekturë dhe teknikë ndërtimi miaft interesante. Ato përbëjnë një material që sjell fakte të reja për problemin e lindjes dhe përhapjes së godinave të tipit kullë në vendin tonë.

Në kuadrin e festimit të 50 vjetorit të Kongresit të Lushnjes u krye restaurimi i godinës ku u bë mbledhja historike. Godina u kthye në muze historik; po kështu *në Salari (Tepelenë)* u bë restaurimi i shtëpisë së heroit të luftës së Vlorës Selam Musait, e cila u kthye në një muze të jetës dhe veprimtarisë së tij.

N. C.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës

Adresa e Redaksisë **Rruga Alqi Kondi Nr. 7**

DO NOT COPY

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Rreshti	Si është	Si duhet të jetë
5	2	Zhegu	Zheku
18	–	–	Fig. 14
28	7	Costantio	Costantino
78	27	Crikva	Crkva
100	33	XVIII	XVII
131	20	kovës	kavës
149	21	në	na
153	1/kol.II	Kliç	Klliç
158	(Në krye)	Të hiqet fjala «Reaksioni Volik»	
171	28	Sarkafagët	Sarkofagët
172	28/kol.II	Memkulazit	Menkulasit
173	21	Tapit	Topit

DO NOT COPY

Tirazhi 2000 kopje Formati 70x100/12 Stash: 2204-65

Shtypur në N.I.SH. Shtyp. «M. Durri» Tiranë

DO NOT COPY